



PROGRAMI I TRAJNIMEVE 2019

Prishtinë, dhjetor 2018



Programi i Trajnimeve 2019

Prishtinë, dhjetor 2018

Program Trajnues për vitin 2019 është miratuar nga Këshilli Drejtues i Akademisë së
Drejtësisë me datën 27.11.2019

© AD 2018, Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij materiali mund
të përdoret për qëllime edukative dhe jo-komerciale duke ju referuar Akademisë si
burim. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi apo çfarëdo forme tjetër e publikimit pa
konfirmimin e Akademisë.

Publikuar nga Akademia e Drejtësisë



Tabela e përmbajtjes

Fjala e Kryesuesit të Këshillit Drejtues	9
Hyrje	10
Qëllimi.....	10
Objektivat e programit të trajnimeve	10
 1. Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm	 12
1.1 Trajnimet nga fusha penale	14
1.1.1 Dënimet kryesore, alternative dhe plotësuese	14
1.1.2 Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale	16
1.1.3 Mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike	17
1.1.4 Përgjegjësia penale e personave juridik	18
1.1.5 Procedurat alternative.....	19
1.1.6 Shqyrtimi fillestar dhe shqyrtimi i dytë	20
1.1.7 Shqyrtimi kryesor dhe marrja e provës	21
1.1.8 Veprat penale kundër martesës dhe familjes	22
1.1.9 Veprat penale kundër ekonomisë me theks të posaçëm luftimi ekonomisë jo formale	23
1.1.10 Sekuestrimi dhe konfiskimi	24
1.1.11 Veprat penale kundër integritetit seksual	25
1.1.12 Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë	26
1.1.13 Mundësia e hetuese e veçantë	27
1.1.14 Procedura parapenale, para fillimit të hetimit	28
1.1.15 Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale	29
1.1.16 Procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore	30
1.1.17 Krimet e luftës	31
1.1.18 Masat e fshehta	32
1.1.19 Trajnim hyrës lidhur me krimin kibernetik, provat elektronike dhe përfitimet ilegale nga këto krime.....	33
1.1.20 Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve.....	35
1.1.21 Korrupsioni zyrtar dhe vepra penale kundër detyrës zyrtare.....	36
1.1.22 Krimi i organizuar	37
1.1.23 Shpërlarja e parasë	38
1.1.24 Parashkrimi	39
1.1.25 Veprat penale kundër jetës dhe trupit, me theks të veçantë veprat penale të vrasjes dhe vrasjes së rëndë	40
1.1.26 Veprat penale të narkotikëve	41
1.1.27 Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës	42
1.1.28 Trafikimi me qenie njerëzore.....	43

1.1.29 Dëshmitarët bashkëpunues	44
1.1.30 Ekspertiza dhe shfrytëzimi i saj nga prokurorët në procedurën penale	45
1.1.31 Zbatimi i Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore	46
1.2 Programet e specializuara	48
1.2.1 Program i Specializuar Trajnimi për Zhvillimin e Kapaciteteve në Luftën Kundër Korrupsionit	48
1.2.2 Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës	50
1.2.3 Program i Specializuar Trajnimi në Forcimin e Kapaciteteve Profesionale në Luftimin e Krimit Kibernetik	52
1.2.4 Program i Specializuar Trajnimi në Forcimin e Kapaciteteve Profesionale në Luftimin e Shpëlarjes së Parave	54
1.3 Fusha civile	58
1.3.1 Shqyrtimi paraprak i padisë	58
1.3.2 Sigurimi i kërkesëpadisë	59
1.3.3 Mënyrat e fitimit të pronësisë dhe mbrojtja e saj	61
1.3.4 Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë	62
1.3.5 Mbrojtja gjyqësore nga pengim posedimi dhe servituti	63
1.3.6 Mbrojtja gjyqësore në rastet e fyerjes dhe shpifjes	64
1.3.7 Mbrojtja gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit të Punës.....	65
1.3.8 Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve dhe pjesëtimi i saj	66
1.3.9 Shpërblimi i dëmit material dhe jo material dhe praktika gjyqësore	67
1.3.10 Shpronësimi dhe caktimi i kompensimit	68
1.3.11 Shkaqet e anulimit të kontratave, me theks të veçantë të kontratave të shitjes	69
1.3.12 Parashkrimi sipas dispozitave të LMD-së	70
1.3.13 Zgjidhja alternative e kontesteve, me theks të veçantë ndërmjetësimi	71
1.3.14 Aktgjyqimi dhe llojet e aktgjyqimit sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore	72
1.3.15 Mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike sipas LPK-së	73
1.3.16 Lejimi i përmbarimit dhe vendosja sipas prapësimit	74
1.3.17 Përmbarimi i vendimeve gjyqësore në çështjet familjare dhe kontestet e punës	75
1.3.18 Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile	76
1.4 Drejtësia për fëmijë	78
1.4.1 Drejtësia penale për fëmijë.....	78
1.4.1.1 Abuzimi seksual dhe veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve	78
1.4.1.2 Burgu për të mitur.....	79
1.4.1.3 Masat e diversitetit.....	80
1.4.1.4 Masat edukative dhe dënimet ndaj të miturve	81
1.4.1.5 Masat për sigurimin e prezencës së të miturve në procedurën penale	82
1.4.1.6 Procedura penale me kryes madhor ku viktimat janë të miturit	83

1.4.1.7 Procedura penale ndaj të miturve	84
1.4.2 Drejtësia civile për fëmijë	85
1.4.2.1 Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore – familjare	85
1.4.2.2 Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre	86
1.4.2.3 Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror	87
1.5 Fusha Ekonomike	90
1.5.1 Kontrata e ndërtimit	90
1.5.2 Kontrata e sigurimit	91
1.5.3 Kontratat në ekonomi	92
1.5.4 Trajtimi praktik i kontratës për kreditë	93
1.5.5 Shkëputja e kontratës dhe efektet e shkëputjes	94
1.5.6 Të drejtat e pronësisë industriale – Markat tregtare	95
1.5.7 Të drejtat e pronësisë intelektuale – të drejtat e autorit	96
1.5.8 Ligji për shoqëritë tregtare	97
1.5.9 Procedura e Falimentimit të shoqërive tregtare	98
1.6 Fusha Administrative.....	102
1.6.1 Lëvizja dhe qëndrimi i të huajve si dhe procedurat ligjore ndaj tyre në Republikën e Kosovës	102
1.6.2 Fillimi dhe zhvillimi i procedurës së konfliktit administrativ	103
1.6.3 Zbatimi i Ligjit për Azilin në Republikën e Kosovës	104
1.6.4 Procedurat e prokurimit sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës në veçanti kontestet me OSHP-në	105
1.6.5 Procedura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, dhe mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.....	106
1.6.6 Procedura dhe objekti i konfliktit administrativ	107
1.6.7 Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës	108
1.6.8 Interpretimi i legjislacionit tatimor në Kosovë	109
1.6.9 Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	110
1.6.10 Zbatimi i Ligjit për Shtetësinë i Kosovës	111
1.6.11 Zbatimi i Ligjit për Regjistrimin Civil, (Regjistrat e gjendjes civile, regjistrimi i mëvonshëm dhe ri-regjistrimi)	112
1.6.12 Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.....	113
1.7 Fusha e kundërvajtjeve	116
1.7.1 Personat Juridik si kryes të kundërvajtjes	116
1.7.2 Prishja e rendit dhe e qetësisë publike	117
1.7.3 Fillimi dhe zhvillimi i procedurës kundërvajtëse	118
1.7.4 Administrimi i provave - parimet	119
1.7.5 Aktgjykimi në procedurën kundërvajtëse	120
1.8. E drejta kushtetuese	122
1.8.1 Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe efektet juridike të tyre	122

1.9 Trajnimet për DHPGJS	124
1.9.1 Procedura me shkrim dhe ajo verbale para Dhomës së Posaçme	124
1.9.2 Kompetencat e Dhomës së Posaçme dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit, parashtruesit dhe palët kundërshtare para Dhomës së Posaçme	125
1.9.3 Procedura gjyqësore për kundërshtimin e vendimeve të Agjencisë që krijohen nga procesi i Privatizimit dhe i Likuidimit	126
1.9.4 Roli i Agjencisë dhe procesi i privatizimit të subjekteve nga AKP	127
1.9.5 Mjetet e goditjes në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës	128
1.10 Trajnimet për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe të drejtën e BE-së	130
1.10.1 E Drejta për Jetën – Neni 2 i KEDNJ	130
1.10.2 E drejta për liri dhe siguri – neni 5 i KEDNJ	131
1.10.3 E drejta për një proces të rregullt gjyqësor– neni 6 i KEDNJ	132
1.10.4 E drejta për jetë private, jetë familjare, të vendbanimit dhe korrespondencës, për tu martuar dhe krijuar familje dhe për barazi të bashkëshortëve – neni 8 i KEDNJ	133
1.10.5 Liria e shprehjes dhe e informimit - neni 10 i KEDNJ	134
1.10.6 E drejta e mbrojtjes së pronës - neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ	135
1.10.7 Zbatimi i së drejtës së Bashkimit Evropian nga ana e gjykatave nacionale – veçmas në Republikën e Kosovës dhe efekti i saj interpretativ para anëtarësimit	136
1.11 Kompetenca interdisiplinare.....	138
1.11.1 Kodi i etikës	138
1.11.2 Menaxhimi i rasteve	139
1.11.3 Menaxhimi i kohës si predispozitë e menaxhimit të stresit	140
1.11.4 Shkathtësitë e përfaqësimit në gjykim	141
1.11.5 Hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore.....	142
1.11.6 Vendimarrja dhe qasja në drejtësinë mjedisore -- standardet ndërkombëtare dhe legjislacioni në fuqi	143
1.12 Trajnimet kundër diskriminimit	146
1.12.1 Barazia gjinore në procedurë gjyqësore në përgjithësi dhe në rastet e dhunës në familje në veçanti	146
1.12.3 Barazia gjinore në kontestet për të drejtën e trashëgimisë dhe në kontestet nga marrëdhënia e punës	149
2. Trajnimet për avancim për Gjyqtarët dhe Prokurorët e Shtetit	152
2.1 Gjyqtarët dhe prokurorët e avancuar nga një departament në tjetrin në kuadër të njëjtë nivel	152
2.2 Gjyqtarët dhe Prokurorët e avancuar nga niveli themelor në atë të Apelit	152
2.3 Gjyqtarët e avancuar nga Gjykata e Apelit në Gjykatën Supreme	152
2.4 Prokurorët e avancuar nga Prokuroria e Apelit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit	152
3. Programi i Trajnimit Fillestar	154
4. Ndryshimet legjislative	156

5. Programi për Hulumtime dhe Publikime	158
5.1 Analiza dhe hulumtime	158
5.2 Veprimtaria botuese – publikimet	158
5.3 Biblioteka	159
6. Trajnimet për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive	162
6.1 Menaxhimi i gjykatës dhe prokurorisë	162
6.2 Komunikimi në gjykata dhe prokurori	163
7. Trajnimet për gjyqtarë porotë	166
7.1 Roli dhe detyrat e gjyqtarit porotë në procedurë gjyqësore	166
8. Trajnimi i stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive	168
8.1 Moduli 1 - Sistemi gjyqësor dhe prokurorial, struktura dhe kompetencat	169
8.2 Moduli 2 - Menaxhimi i punës në administratën e sistemit gjyqësor dhe prokurorial	170
8.2.1 Nën moduli 1 - Menaxhimi dhe Udhëheqja	172
8.2.2 Nën moduli 2 - Proceset e brendshme dhe të jashtme të punës	173
8.2.3 Nën moduli 3 - Planifikimi dhe vendimmarrja	174
8.2.4 Nën moduli 4 - Efikasiteti dhe Llogaridhënia	175
8.3 Moduli 3 - Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore	176
8.3.1 Nën moduli 1 - Teknikat e hulumtimit ligjor	178
8.3.2 Nën moduli 2 - Shqyrtimi paraprak i rasteve dhe ndërmarrja e veprimeve për përgatitjen e fazave pasuese në procedurë	179
8.3.3 Nën moduli 3 - Shkrimi dhe arsyetimi ligjor	180
8.4 Moduli 4 - Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial	181
8.4.1 Nën moduli 1 - Regjistrat e gjykatave dhe prokurorive	183
8.4.2 Nën moduli 2 - Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial	184
8.4.3 Nën Moduli 3 - Mbledhja e të dhënave statistikore dhe raportimi	185
8.5 Moduli 5 - Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun	186
8.5.1 Nën Moduli 1 - Qasja në komunikim dhe marrëdhënie me media	188
8.5.2 Nën moduli 2 - Prezantimi institucional dhe informata për publikun	189
8.6 Moduli 6 - Integriteti dhe sjelljet etike	190
8.6.1 Nën moduli 1 - Parimet dhe normat e sjelljes etike	191
8.6.2 Nën moduli 2 - Sjellja brenda dhe jashtë zyrës	192
8.6.3 Nën moduli 3 - Ndërgjegjësimi social dhe përgjegjësia	193
8.7 Shkathtësitë e buta	194
8.7.1 Nën moduli 1 - Puna në ekip dhe sjellja sociale	196
8.7.2 Nën moduli 2 - Menaxhimi i kohës dhe stresit	197
8.7.3 Nën moduli 3 - Zgjidhja e problemeve dhe konflikteve	198

8.7.4 Nën moduli 4 - Komunikimi ndërpersonal.....	199
8.7.5 Nën moduli 5 - Menaxhimi i TIK-ut.....	200
9. Programi për trajnimin e trajnuesve	202
10. Mësimi në distancë	204
11. Trajnimet me donatorë	206
12. Anekset	208

Fjala e Kryesuesit të Këshillit Drejtues

Të nderuar,

Trajnimi gjyqësor si instrument shumë i rëndësishëm për zhvillim profesional, dhe mundësi e fuqishme në dorën e gjyqtarëve dhe prokurorëve në njërën anë, si dhe institucioneve që administrojnë me sistemin gjyqësor e prokurorial në anë tjetër, është i njohur dhe vlerësohet lartë nga aktet e ndryshme dhe mekanizma ndërkombëtarë. Një rëndësi e tillë është e vlerësuar edhe nga legjislacioni i Kosovës, duke themeluar për këtë arsye, Akademinë e Drejtësisë, si institucion kompetent për hartimin dhe zbatimin e programeve të trajnimit.

Ky program i trajnimit është i hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës të vlerësimit të nevojave për trajnime, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive përmes ofrimit të trajnimeve në të gjitha fushat si dhe burimeve dhe materialeve tjera ligjore.

Sfidat dhe vështirësitë e shumta me të cilat përballlet sistemi gjyqësor dhe prokurorial, kanë të bëjnë edhe me kapacitetet profesionale brenda sistemit. Kjo vërehet edhe në disa raporte të organizatave të ndryshme që monitorojnë punën e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Gjithashtu edhe nga procesi i vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve është vërejtur nevoja për ngritje të performancës në disa raste, e cila është rekomanduar që të bëhet përmes trajnimeve. Në të njëjtën kohë edhe ndryshimet legjislative jo rrallë herë i vënë në vështirësi gjyqtarët dhe prokurorët në zbatimin efikas të ligjeve. Në këtë kontekst paraqitet si nevojë ngritja e performancës së sistemit gjyqësor e prokurorial në zbatimin e standardeve më të larta për sundimin e ligjit. Në funksion të këtij qëllimi Akademia e Drejtësisë ka përgatitur edhe këtë program trajnimi i cili do të zbatohet gjatë vitit 2019, në bashkëpunim edhe me autoritetet tjera të sistemit gjyqësor.

Përmes këtij programi të trajnimit synohet që puna e gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë të bëhet në mënyrë më efikase, cilësore, si dhe të vlerësohet shumë më pozitivisht nga publiku.

Në fund, dëshiroj të falënderoj të gjithë akterët vendor dhe ndërkombëtar që kanë kontribuar në këtë proces, përmes raporteve dhe rekomandimeve dhe formave tjera, si dhe ekspertëve të ndryshëm që kanë mundësuar që të kemi një program gjithëpërfshirës dhe që i përgjigjet nevojave reale të përfituesve.

Sinqerisht,

Aleksandër Lumezi
Kryesues i Këshillit Drejtues

Hyrje

Akademia e Drejtësisë është institucion publik, i pavarur dhe përgjegjës për organizimin e trajnimeve për gjyqtarë, prokurorë të shtetit, stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive si dhe sipas mundësive edhe për profesionet e lira si dhe profesionistë tjerë. Bazuar në Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, përveç trajnimeve Akademia kryen edhe vlerësimin e nevojave trajnuese për përfituesit e saj, si dhe kryen analiza, hulumtime dhe veprimtari të tjera botuese në përmbushje të mandatit, për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira.

Programi i Trajnimeve hartohet duke u bazuar në procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime, të gjyqtarëve, prokurorëve, kërkesave të institucioneve që administrojnë me sistemin gjyqësor si dhe proceseve tjera nëpër të cilat kalon vendi. Ky program përqendrohet në zhvillimin e kompetencave profesionale dhe interdisiplinare, si dhe mbështetet në parimet e transparencës, qasjes së barabartë si dhe në standardet më të larta për trajnimet gjyqësore.

Edhe për vitin 2019, Programi i Trajnimit do të përmbaj trajnimet e vazhdueshme, parimet bazë për organizimin e trajnimit fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar, programe të specializuara, trajnimet për menaxhimin dhe administrimin e gjykatave dhe prokurorive, trajnimet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive, trajnimet nga distanca, trajnimet për trajnues, si dhe aktivitete tjera nga fusha e hulumtimeve dhe publikimeve.

Në realizimin e këtij programi trajnues përveç aktiviteteve të lartpërmendura do të organizohen edhe aktivitete të ndryshme në sferën e bashkëpunimit të brendshëm dhe ndërkombëtarë, me pjesëmarrje të vazhdueshme në trajnime, takime regjionale dhe konferenca ndërkombëtare të cilat kanë në fokus zhvillimin e trajnimit gjyqësor. Po ashtu do të vazhdojë koordinimi dhe bashkëpunimi me donatorë dhe partnerë ndërkombëtar të cilët mbështesin zbatimin e programeve të ndryshme të trajnimit në Akademi të Drejtësisë.

Qëllimi

Ky program ka për qëllim përcaktimin e temave të trajnimeve, objektivave, përmbajtjes së trajnimeve për vitin 2019, si dhe njëkohësisht shërben si një lloj plani pune për Akademinë në fushën e trajnimeve dhe aktiviteteve tjera në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale brenda gjyqësorit, por nuk përfshinë punën e Akademisë në pikëpamje të menaxhimit dhe administrimit të përgjithshëm.

Në program do të paraqitet përmbledhja e temave të trajnimit sipas fushave kryesore të punës së gjykatave dhe prokurorive, pastaj trajnimet interdisiplinare si komponentë mjaft të rëndësishme për bartësit e funksioneve gjyqësore, si dhe forma tjera të arsimimit ligjor.

Objektivat e programit të trajnimeve

Me zbatimin e këtij programi të trajnimeve do të arrihet të realizohet:

- Ngritja profesionale e vazhdueshme e gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Zbatimi i trajnimeve, të karakterit ligjor dhe interdisiplinar për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Ngritja e kapaciteteve profesionale të trajnuesve dhe metodologjisë gjatë zbatimit të

PROGRAMI I TRAJNIMEVE 2019

- programeve trajnuese;
- Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore për gjyqtarët e prokurorët e sapoemëruar, apo që janë avancuar;
- Zhvillimi i trajnimeve të nevojshme për stafin e gjykatave dhe prokurorive dhe profesionistëve tjerë;
- Zbatimi i aktiviteteve hulumtuese, kërkimore, analizave dhe botimi i publikimeve;

Komponentët përbërëse të Programit të Trajnimeve

Programi i trajnimeve për vitin 2019, përmban këto komponentë të trajnimeve:

- Trajnimet e Vazhdueshme
- Trajnimet Fillestare për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar
- Trajnimet për Avancim
- Hulumtimet dhe Publikimet
- Trajnimet për Trajnues
- Trajnime për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive
- Trajnimet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive
- Trajnimet nga distanca
- Trajnimet që do të realizohen me donatorë

1. Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm

Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm është program trajnues, i cili ka për qëllim zhvillimin e vazhdueshëm dhe avancimin e shkathtësive dhe ekspertizës së duhur profesionale dhe interdisiplinare, të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Trajnimet e vazhdueshme kanë në fokus ngritjen e kapaciteteve profesionale, etike dhe praktike për ushtrimin e funksioneve të gjyqësorit. Trajnimet e vazhdueshme gjithashtu kontribuojnë në pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë të sistemit gjyqësor.

Struktura e programit të trajnimeve të vazhdueshme përmban tema të karakterit kryesisht profesional duke i përfshirë edhe temat të karakterit interdisiplinar dhe ndër personal.

Në aspektin profesional përfshihen fushat si: legjislacioni penal, civil, komercial, administrativ, kushtetues, drejtësia për fëmijë, e drejta evropiane dhe ndërkombëtare, të drejtat e njeriut, barazia gjinore dhe mos-diskriminimi, kundërvajtjeve etj. Për të gjitha fushat do të përfshihet aspekti material dhe procedural duke përfshirë edhe ekzekutimin e sanksioneve penale, si dhe aspektin civil dhe penal të drejtësia për të mitur.

Ndërsa në aspektin interdisiplinar dhe ndërpersonal do të përfshihen trajnimet që kanë për qëllim të zhvillojnë shkathtësitë e përfituesve që nuk kanë të bëjnë me zbatimin e legjislacionit, por shkathtësive praktike për të ushtruar funksionin e tyre si: shkrimi dhe arsyetimi i vendimeve dhe akteve tjera në procedurë gjyqësore, etika profesionale, menaxhimi i rasteve, menaxhimi i stresit, fusha e IT-së etj.

Për hartimin e Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm për vitin 2019 janë përdorur mekanizmat si në vijim:

- Pyetësorët për vlerësimin e nevojave të plotësuar nga gjyqtarët dhe prokurorët;
- Formularët e vlerësimit pas secilit sesion trajnues;
- Rekomandimet e KGJK dhe KPK,
- Takimet me kryetarë të gjykatave;
- Rekomandimet e institucioneve dhe organizatave vendore e ndërkombëtare;
- Propozimet e trajnuesve të AD-së;
- Raportet e Punës të Gjykatave dhe Prokurorive;
- Analiza e agjendës së institucioneve për hartim dhe amandamentim të ligjeve;
- Propozimet e stafit, Këshillit Programor dhe Këshillit Drejtues të AD-së;
- Strategjitë dhe dokumentet e miratuara nga institucionet të cilat përmbajnë rekomandime për gjyqësorin dhe sundimin e ligjit;
- Monitorimi e medieve të shkruara dhe elektronike;

Trajnimet nga fusha penale

1.1 Trajnimet nga fusha penale

Trajnimet nga fusha penale, pjesë e Programit të Trajnimeve për vitin 2019, përfshinë trajnime nga pjesa materiale, procedurale, e drejta ndërkombëtare penale, bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë, si dhe programe të specializuara nëpërmjet të cilave do të trajtohet krimi kibernetik, veprat penale përmes prokurimit publik, krimi i organizuar, shpëlarja e parave dhe hetimi financiar. Pjesë e këtij programi janë gjithsej 31 tema si dhe 4 programe të specializuara të trajnimit.

1.1.1 Dënimet kryesore, alternative dhe plotësuese

Kodi Penal i Republikës së Kosovës përveç dënimeve kryesore, një rendësi të veçantë i ka kushtuar edhe dënimeve alternative dhe atyre plotësuese duke përcaktuar kushtet për shqiptimin e tyre dhe kategorinë e veprave penale sipas denueshmërisë së tyre si dhe procedurën për shqiptimin e tyre.

Duke marrë parasysh se në praktikën gjyqësore këto dënime nuk janë duke u shqiptuar me obligimet përkatëse ligjore, e në anën tjetër në praktikë paraqiten mjaft dilemat gjatë shqiptimit të këtyre dënimeve dhe njëkohësisht edhe revokimit të tyre, është parë e nevojshme që në këtë program të trajnimit ti kushtohet vëmendje shqiptimit të këtyre dënimeve. Në veçanti tek kryesit madhor të moshës më të re, do të ndikojnë efektivisht si në parandalimin nga kryerja e veprave të tjera penale ashtu edhe me efekt edukativ në këtë kategori të moshave të shoqërisë tonë. Andaj, bazuar nga të lartcekura gjatë këtij sesi të trajnimit do të identifikohen dhe adresohen të gjitha këto vështirësi në praktikë nëpërmjet këtij trajnimi.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Avancojnë njohuritë në lidhje me infrastrukturën ligjore;
- Analizojnë propozimet për shqiptimin e këtyre dënimeve;
- Zbatojnë procedurën për shqiptimin e këtyre dënimeve dhe revokimin e tyre si dhe
- Hartojnë aktgjykimet për shqiptimin e dënimeve alternative dhe plotësuese.

Përmbajtja

- Dënimi me burgim të përjetshëm;
- Dënimi me burgim;
- Dënimi me gjobë;
- Dënimi me kusht, gjysmë liria, urdhri për punë në dobi të përgjithshme;
- Heqja e të drejtës për të zgjedhur;
- Urdhri për kompozimin e humbjes apo dëmit;
- Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik;
- Ndalimi i ushtrimit të profesionit, i veprimtarisë ose detyrës;
- Ndalimi i drejtimit të automjetit;
- Marrja e lejes së vozitjes;
- Konfiskimi;
- Urdhri për publikimin e aktgjykimet dhe
- Dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoret metoda e prezantimit të materialeve në Power Point; bashkëbisedim aktiv me pjesëmarrës; prezantim të rasteve nga praktika gjyqësore dhe diskutim në grupe të rasteve hipotetike; analizim i situatave të ndryshme në të cilat do të mund të gjendeshin gjyqtarët gjatë shqyrtimit dhe shqiptimit të sanksioneve penale.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.2 Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale

Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë, shpeshherë nuk janë zbatuar sipas mënyrës dhe kushteve të parapara me ligj, andaj në praktikë gjyqësore ende ka vështirësi në identifikimin, vlerësimin dhe analizimin e rrethanave lidhur me vendosjen për secilën bazë për këto masa. Në praktikën gjyqësore, po ashtu paraqiten vështirësi në përgatitjen e kërkesave për këto masa, e veçanërisht për paraburgim ka vështirësi në raport me arsyetimin e bazave për caktimin e këtyre masave, sepse dispozitat ligjore kërkojnë që për secilën bazë ligjore të këtë arsyetim konkret e jo abstrakt.

Cilat janë bazat e caktimit-vazhdimin të këtyre masave, ku janë vështirësitë në identifikimin e rrethanave që e arsyetojnë kërkesën për këto masa dhe që e arsyetojnë caktimin e tyre?

Përmes këtij trajnimi synohet që përfituesit të mund të analizojnë masat e për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë dhe të mund ti tejkalojnë dilemat që paraqiten në praktikën gjyqësore.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Vlerësojnë drejtë elementet për përcaktimin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë;
- Zbatojnë parimet bazë lidhur me këto masa;
- Hartojnë dhe arsyetojnë mjaftueshëm vendimet për shqiptimin e këtyre masave.

Përmbajtja

- Thirrja;
- Urdhër-arresti;
- Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin;
- Ndalimi për tu afruar vendit ose personit të caktuar;
- Paraqitja në stacionin policor;
- Dorëzania;
- Arresti shtëpiak;
- Diversioni;
- Paraburgimi.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij sesiioni të trajnimit do të përdorim metodën e prezantimeve të materialeve në PowerPoint, bashkëbisedimi aktiv me pjesëmarrës si dhe përmes prezantimit të rasteve nga praktika gjyqësore, diskutimi në grupe me rastet hipotetike dhe më pas do të analizohen situata të ndryshme në të cilat do të mund të gjendeshin gjyqtarët dhe prokurorët gjatë shqyrtimit gjyqësor për këto vepra penale.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.3 Mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike

Kodi i Procedurës Penale parasheh që palët e pakënaqura me vendimet gjyqësore në procedurë penale, kanë të drejtë nën kushtet e caktuara që të përdorin mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Qëllimi i përdorimit të mjeteve juridike është evitimi i të metave juridike dhe faktike që pretendohet se janë bërë nga gjykata përkatëse.

Cilat janë bazat për ushtrimin e këtyre mjeteve juridike, Cila është procedura që duhet të respektohet me rastin e paraqitjes së mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike? Kush janë personat e autorizuar që kanë të drejtë të paraqesin mjetet juridike? Këto dhe çështje tjera do të adresohen përmes këtij trajnimi duke analizuar rastet kur kanë të bëjë me mjete juridike dhe duke i zbërthyer dispozitat ligjore që i referohen kësaj natyre.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë drejtë rregullat e përgjithshme lidhur me mjetet juridike;
- Identifikoj bazat për të cilat mund të paraqitet mjetet juridike; dhe
- Evitojnë disa nga dilemat e mundshme që janë paraqitur në praktikën gjyqësore;

Përmbajtja

- Ankesa kundër aktgjykimit;
- Ankesat kundër aktvendimeve të gjykatave;
- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë;
- Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit;
- Rishikimi i procedurës penale.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij sesiioni të trajnimit do të përdoren metoda të prezantimit me PowerPoint, bashkëbisedim aktiv me pjesëmarrësit lidhur me çështje dhe dilema nga praktika gjyqësore, po ashtu edhe raste hipotetike, duke mos e lënë anash diskutimin edhe i situatave të ndryshme para të cilave do të gjendeshin gjyqtarët dhe prokurorët në vendosjen e rasteve lidhur me mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Përfitues: Gjyqtarët dhe Prokurorët e të gjitha niveleve.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.4 Përgjegjësia penale e personave juridik

Përveç personave fizik, si kryes të veprave penale mund të jenë edhe personat juridik. Personat juridik mund të përgjigjen për vepra penale nga pjesa e veçantë e Kodit Penal të Republikës së Kosovës edhe për vepra tjera penale, nëse janë plotësuar kushtet për përgjegjësinë e personit juridik të parapara me Ligjin për Përgjegjësinë e Personave Juridik për vepra penale. Sipas ligjit të lartcekur, personi juridik është përgjegjës për vepër penale të personit përgjegjës i cili duke vepruar në emër të personit juridik në kuadër të autorizimeve ka kryer vepër penale me qëllim që për atë, personi juridik të realizoj ndonjë dobi ose ka shkaktuar dëme. Përgjegjësia e personit juridik ekziston edhe atëherë kur veprimi i atij personi juridik ka qenë në kundërshtim me politikën afariste apo urdhrat e personit juridik. Mirëpo, edhe përkundër këtyre dispozitave ligjore, në praktikën gjyqësore paraqiten probleme të shpeshta në përcaktimin e përgjegjësisë penale të personave juridik.

Çfarë është përgjegjësia penale e personave juridik? Cili është kufiri i kësaj përgjegjësie? Cilat janë sanksionet që mund të shqiptohen ndaj personave juridik?

Ky program trajnimi pra, adreson pyetjet duke analizuar institutin e përgjegjësisë penale të personave juridike si dhe dispozitat ligjore që i referohen këtij instituti përmes rasteve praktike.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë drejtë institutin e përgjegjësisë penale të personave juridik sipas ligjit;
- Kuptojnë në mënyrë të drejtë se në cilat raste dhe çfarë lloji të sanksioneve mund t'u shqiptohen personave juridik;
- Interpretojnë drejtë normat ligjore përgjegjësinë penale të personave juridik;

Përmbajtja

- Baza dhe kufiri i përgjegjësisë penale të personave juridik;
- Procedura ligjore për shqiptimin e sanksioneve kundër personave juridik;
- Llojet e sanksioneve që mund të shqiptohen ndaj personave juridik;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij sesiioni të trajnimit do të përdoren prezantime të materialeve në PowerPoint, metoda interaktive të trajnimit duke i shoqëruar me raste praktike dhe hipotetike për situata të ndryshe gjatë të cilave janë gjendur gjyqtarët dhe prokurorët me rastin e vendosjes lidhur me përgjegjësinë penale të personave juridik.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor dhe të apelit.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.5 Procedurat alternative

Kodi i Procedurës Penale tani i parasheh edhe procedurat alternative në krahasim me kodin e mëparshëm të procedurës penale. Këto procedura ofrojnë mundësi për zgjidhjen e rasteve pa i dërguar ato në gjykatë gjegjësisht pas negocimit të marrëveshjes, gjykata të vlerësoj këtë marrëveshje nëse do të pranoj si të tillë për procedim të mëtutjeshëm. Kjo është veçanërisht e dobishme për të rritur efikasitetin dhe për të krijuar një sistem të drejtësisë penale që garanton një gjykim të drejtë të rasteve penale, por që e bënë këtë me shpejtësinë e duhur për ruajtjen e të drejtave të të gjitha palëve. Ky trajnimi është hartuar të iu përgjigjet pyetjeve dhe dilemave të ngritura, si dhe fokusi do të qëndroj në analizimin e zbatimit të procedurës alternative në praktikë. Gjithashtu synohet që përmes këtij trajnimi të adresohet rëndësia e procedurës alternative si mundësi më shpejtë në zgjidhjen e rasteve penale.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë dispozitat e procedurës alternative;
- Vlerësojnë nevojën e zgjidhjes së lëndëve përmes procedurave alternative;
- Zbatojnë procedurat alternative;

Përmbajtja

- Përzullimi i përkohshëm i procedurës penale;
- Procedura e ndërmjetësimit;
- Negocimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij sesi të trajnimit do të përdoren metoda e prezantimeve të materialeve në power-point, bashkëbisedimi interaktiv me pjesëmarrës si dhe përmes prezantimit të rasteve nga praktika gjyqësore. Gjithashtu diskutimi në grupe për raste hipotetike dhe më pas do të analizohen situata të ndryshme në të cilat do të mund të zbatohen këto alternativa në procedurë penale.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët.

Kohëzgjatja: Dy ditë.

1.1.6 Shqyrtimi fillestar dhe shqyrtimi i dytë

Me hyrje në fuqi të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në praktikën gjyqësore, janë paraqitur mjaft vështirësi me rastin e aplikimit të dispozitave ligjore që i referohen shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë. Në cilat situata do të duhej të caktohet shqyrtimi i dytë dhe në cilat situata mund të kërkohej vetëm paraqitja e kërkesës për hedhjen e aktakuzës ose të kundërshtimit të provave? Si do të veprohet nëse i pandehuri e pranon fajësinë gjatë shqyrtimit të dytë? Cili do të jetë roli i gjyqtarit të vetëm gjykues ose të kryetarit të trupit gjykues gjatë shqyrtimit fillestar ose gjatë shqyrtimit të dytë? Si do të rrjedh seanca për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me dënimin?

Të gjitha këto situata do të adresohen përmes këtij trajnimi duke zbërthyer procedurën e shqyrtimit fillestar, të dytë dhe shqyrtimin gjyqësor përmes rasteve praktike dhe analizimit të dispozitave ligjore që i referohen kësaj procedure.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë drejtë dispozitat e procedurës penale për udhëheqjen e shqyrtimit fillestar dhe në shqyrtimin e dytë;
- Identifikojnë rolin e gjyqtarit dhe prokurorit të shtetit gjatë shqyrtimit fillestar dhe të dytë;
- Vlerësoj drejtë pranimin e fajësisë së të pandehurit në shqyrtimin fillestar dhe atë të dytë;

Përmbajtja

- Pranimi i fajësisë;
- Kundërshtimi i provave;
- Kërkesa për hedhje të aktakuzës;
- Aktakuza e ndryshuar;
- Hedhja e aktakuzës;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij sesi të trajnimit do të përdoret metoda e prezantimit të materialeve prezantuese dhe metoda interaktive me pjesëmarrës, si dhe përmes prezantimit të rasteve nga praktika gjyqësore dhe diskutimit në grupe të situatave të ndryshme në të cilat do të mund të gjendeshin gjyqtarët dhe prokurorët gjatë shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.7 Shqyrtimi kryesor dhe marrja e provës

Kodi i Procedurës Penale përveç tjerash ka pësuar ndryshme mjaftë thelbësore për procedurën e shqyrtimit gjyqësor duke filluar nga fazat përgatitore për mbajtjen dhe parakushtet e mbajtjes së shqyrtimit kryesor, po ashtu edhe në radhën dhe mënyrën e nxjerrës së provave. Po ashtu edhe koncepti i marrjes në pyetje të dëshmitarëve, ekspertëve, dëmtuarve, respektivisht kush duhet i pari të parashtroj pyetje nëpërmjet mënyrës së drejtpërdrejtë dhe kush mund dhe duhet të parashtroj pyetjet e tërthorta, gjegjësisht rimarrja në pyetje ka pësuar ndryshime të theksuara e deri tek marrja e provave në shqyrtim kryesor. Andaj, bazuar nga të lartcekura gjatë këtij sesiioni të trajnimit do të identifikohen dhe adresohen të gjitha këto risi dhe vështirësi në praktikë nëpërmjet këtij trajnimi.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Aplikojnë drejtë dispozitat për udhëheqjen e shqyrtimit gjyqësor;
- Zbatojnë drejtë radhën e marrjes në pyetje të dëmtuarve, dëshmitarë dhe ekspertëve;
- Identifikojnë rastet e marrjes së provës së re gjatë shqyrtimit gjyqësor;

Përmbajtja

- Shqyrtim gjyqësor;
- Provat ne procedurën penale dhe ligjshmëria e provave;
- Deklarata e të pandehurit si provë;
- Provat e pranueshme;
- Deklarata e dëshmitarit;
- Provat e pa-pranueshme;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij sesiioni të trajnimit do të përdoren metodat e prezantimeve të materialeve në PowerPoint, bashkëbisedimi me pjesëmarrës si dhe përmes prezantimit të rasteve nga praktika gjyqësore dhe diskutimi në grupe me rastet hipotetike, ku do të analizohen situata të ndryshme të cilat dalin si dilema gjatë vendosjes dhe nxjerrjes së provave në shqyrtim gjyqësor.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.8 Veprat penale kundër martesës dhe familjes

Dihet se familja është celula kryesore në shoqëri andaj, jo rastësisht është paraparë edhe mbrojtja juridiko -penale e familjes dhe martesës. Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, një vend të veçantë zënë këto vepra, pikërisht në kapitullin e XXI. Në kohën e fundit në praktikën tonë gjyqësore kemi mjaftë raste ku trajtohen këto vepra penale, dhe jo rrallë herë na paraqiten dilemat e ndryshme të të kuptuarit drejtë për zbatimin e interpretimin e këtyre dispozitave nga ky kapitull. Andaj, në këtë sesion të trajnimit gjatë paraqitjes së rasteve të ndryshme në praktikë do të pretendohet që prokurorëve dhe gjyqtarëve t’iu lehtësohet puna në praktikë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojmë legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e familjes dhe martesës;
- Avancojnë njohuritë për këto lloje të veprave penale;
- Të identifikojnë personat që mund të jenë kryerësit e këtyre veprave penale dhe viktimat e këtyre veprave penale;
- Interpretimi i drejtë i këtyre dispozitave ligjore;

Përmbajtja

- Bigamia;
- Mundësimi i lidhjes së martesës së kundërligjshme;
- Martesa e detyruar;
- Bashkësia martesore me personin nën moshën 16 vjet;
- Ndryshimi i statusit familjar të fëmijës;
- Marrja apo mbajtja e kundërligjshme e fëmijës;
- Keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës;
- Shkelja e detyrimeve familjare;
- Shmangja nga sigurimi i mjeteve të jetesës;
- Pengimi dhe mosekzekutimi e masave për mbrojtjen e fëmijëve;
- Mos raportimi i abuzimit të fëmijëve;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij sesioni të trajnimit do të përdoren prezantime të materialeve në Power Point, bashkëbisedimi interaktive me pjesëmarrës për raste nga praktika gjyqësore dhe diskutimit në grupe lidhur me shtjellimin dhe vendosjen për raste hipotetike.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.9 Veprat penale kundër ekonomisë me theks të posaçëm luftimi ekonomisë jo formale

Në kapitullin e veprave penale kundër ekonomisë hyjnë veprat penale që ndërlidhen me mashtrimin, keqpërdorimin, falsifikimin, lidhjen e kontratave të dëmshme, falsifikimin e shenjave me vlerë, cenimin e të drejtë së patentave, falsifikimin e parasë etj.

Në kuadër të këtij kapitulli hyjnë edhe vepra penale keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike, të cilën vepër e kryen personi përgjegjës gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për ndonjë person tjetër.

Si të rritet efikasiteti profesional i prokurove dhe gjyqtarëve në këtë fushë, si të përfitojnë përvojat dhe praktikatat më të mira të shteteve në rajon, të gjitha këto pyetje të ngritura gjatë këtij sesi të trajnimit do të adresohen nëpërmjet prezantimit dhe studimit të rasteve praktike.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë drejt dispozitat ligjore lidhur me veprat penale kundër ekonomisë;
- Avancojnë njohuritë për këto lloje të veprave penale;
- Identifikojnë personin përgjegjës në institucione publike dhe
- Bëjnë dallimin në mes personit përgjegjës në kompani private dhe ato publike.

Përmbajtja

- Shmangia nga tatimi;
- Skemat piramidale;
- Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij sesi të trajnimit do të përdorim metodën e prezantimeve të materialeve në PowerPoint, prezantim të rasteve hipotetike dhe rasteve nga praktika lidhur me këtë temë, e duke nxitur debatin interaktiv ndërmjet pjesëmarrësve lidhur me çështjet dhe dilemat e identifikuara në këtë fushë.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.10 Sekuestrimi dhe konfiskimi

Kapitulli i sekuestrimit dhe konfiskimit sipas Kodit të Procedurës Penale (KPP) paraqet një ndryshim substancial në legjislacionin vendor, ku trendi global lëviz në drejtim të asaj që me sekuestrim dhe konfiskim më shumë arrihet në parandalimin e krimit, sepse me heqjen e aseteve nga duart e kriminelëve arrihen efekte të shumta. Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfutur me Vepër Penale, është mundësi e mirë për sekuestrim dhe konfiskim.

Cila është rëndësia e sekuestrimit të aseteve si provë, si mjet me të cilin është kryer vepra penale apo si dobi pasurore e fituar me vepër penale? Cilat masa mund të propozohen për sigurimin e pasurisë dhe cilat masa të ngrirjes pas akuzës? Si mund të ngritët zbatimi i dispozitave të Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfutur me Vepër Penale? Përmes krahasimeve të legjislacionit vendor dhe atij ndërkombëtarë, rasteve të praktikës gjyqësore, si dhe prezantimit të trendëve globale në këtë fushë, synohet që të arrihet ngritja profesionale dhe të shpjegohen paqartësitë në kornizën ligjore aktuale.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë drejtë legjislacionin ekzistues në lidhje me gjurmimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga vepra penale;
- Identifikojnë metodat kryesore për zbulimin e aseteve të fituara me vepër penale;
- Zbatojnë procesin e sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve të fituara me vepër penale

Përmbajtja

- Korniza ligjore për gjurmimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të fituara me vepër penale;
- Metodatat për identifikimin e aseteve dhe procesi i sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve të fituara me vepër penale;
- Ngrirja e aseteve – urdhrat për konfiskimin e aseteve të fituara me vepër penale;
- Administrimi i pasurisë së sekuestruar;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metodat të diskutimit interaktiv në lidhje me dilemat konkrete nga praktika si dhe rastet studimore. Pjesëmarrësve do tu ndahen rastet hipotetike dhe më pas ndarja në grupe dhe ofrimin e zgjidhjes së këtyre rasteve. Gjithashtu do të përdoren prezantimet në Power Point.

Përfutues: Gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët tjerë të përfshirë në gjurmimin, ngrirjen dhe konfiskimin e aseteve.

Kohëzgjatja Një ditore.

1.1.11 Veprat penale kundër integritetit seksual

Ndjeshmëria e veprave penale kundër integritetit seksual kërkon një trajtim më të detajuar për të hequr dilemat nga fakti se dispozitat ligjore lënë vend për interpretim dhe konfuzion. Po ashtu, në kuadër të kapitullit të veprave penale kundër integritetit seksual ndër të tjera parasheh edhe disa vepra që prekin integritetin seksual të fëmijëve. Zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore nga ky kapitull shpesh herë paraqitet si sfidë për gjyqtarët dhe prokurorët.

Cilat janë veprat penale kundër integritetit seksual sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës? Cilat janë elementet dhe karakteristikat e veprave penale kundër integritetit seksual? Ky trajnim do iu jep përgjigje këtyre pyetjeve dhe dilemave.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zgjerojnë njohuritë lidhur me procedurën penale kur fëmija është viktimë;
- Analizojnë format e paraqitjes së dhunimit dhe veprave tjera të ngjashme lidhur me integritetin seksual;
- Zbatojnë drejtë dispozitat lidhur me këto vepra penale.

Përmbajtja

- Dhunimi;
- Keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime mendore ose paaftësi mendore ose emocionale;
- Veprat tjera penale që bëjnë pjesë në këtë kapitull.

Metodologjia e trajnimit

Përmes prezantimit të rasteve nga praktika gjyqësore dhe diskutimit në grupe, do të ofrohen alternativa për shumë çështje që kanë të bëjnë me veprat penale kundër integritetit seksual. Trajtimi i këtyre çështjeve do të bëhet përveç tjerash edhe me një pjesëmarrje dhe diskutim interaktiv me pjesëmarrësit, për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjet dhe dilemave që mund të paraqiten në praktikën gjyqësore.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor dhe të apelit, si dhe hetuesit policor.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.12 Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë

Luftimi i krimit nuk është vetëm nevojë dhe detyrë e një shteti apo shoqërie të caktuar. Në kohën e zhvillimit të teknologjisë informative, lëvizjes së lirë dhe migrimit të popullatës në vendet e ndryshme nëpër botë, për të jetuar dhe vepruar, ka rezultuar nevoja e bashkëpunimit të shteteve në ofrimin e ndihmës juridike penale dhe atë civile me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit të të gjitha formave. Në këtë drejtim edhe shteti ynë, nxjerr Ligjin për bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë me qëllim të lehtësimit dhe vënies në veprim të parimit të reciprocitetit në mes të vendeve të ndryshme dhe vendit tonë, aprovon dhe ratifikon marrëveshjet në çështje të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar. Në praktikën tonë të përditshme nëpër gjykata dhe prokurori çdo ditë e më tepër na paraqiten rastet nga më të ndryshme duke filluar nga dhënia e ndihmës minimale juridike-akt lutjet e ndryshme për marrjen e deklaratës së dëshmitarëve, apo dorëzimin e dokumenteve / ftesave, apo aktvendimeve të ndryshme, e deri tek ekstradimi i të kërkuarve sipas akt lutjes së shtetit të kërkuar.

A është e mjaftueshme infrastruktura ligjore për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar? A janë të njoftuar rregullisht gjyqtarët dhe prokurorët me marrëveshjet e nënshkruara në nivel shteti për këtë fushë? Si të vepohet me rastet e kërkesave të konfiskimi të pasurisë sipas akt lutjes së shtetit të kërkuar?

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit do të njoftohen me infrastrukturën ligjore për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, do të analizohet situata e mundësisë së vazhdimin të masës së paraburgimit për personin e kërkuar sipas akt lutjes së shtetit të kërkuar.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohurit në fushën e ndihmës juridike ndërkombëtare;
- Hartojnë kërkesat për ndihmë juridike ndërkombëtare;
- Analizojnë kërkesat e paraqitura nga shteti i kërkuar dhe
- Hartojnë aktvendimet për lejimin e ekstradimit të personave të kërkuar;

Përmbajtja

- Urdhëresat e lëshuara për paraburgim për personat e kërkuar;
- Kërkesat për caktimin e paraburgimi për personat e kërkuar nga shteti i kërkuar;
- Aktvendimet për caktimin e paraburgimit dhe kohëzgjatja e tyre dhe aktvendimi për lejimin e ekstradimit të personit të kërkuar;
- Njohja dhe ekzekutimi i aktgjykimeve të huaja;

Metodologjia e trajnimit

Trajnimi do të realizohet duke zbatuar metodën interaktive me pjesëmarrësit, prezantimi i materialit në PowerPoint, ndarja në grupe të përfituesve me qëllim të studimit të rasteve hipotetike e me theks të veçantë të dilemave dhe sfidave të lindura në praktikën gjyqësore.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.13 Mundësia e hetuese e veçantë

Në këtë trajnim pjesëmarrësit do të njoftohen për veprimin konkret hetimor e që është mundësia hetuese e veçantë. Parimi i veprimit me shpejtësi në procedurë penale shumë herë është vendimtar në mbledhjen dhe sigurimin - ruajtjen e provës relevante në procedurë penale. Andaj një ndër veprimet hetimore që KPP i rendit në kuadër të tij, është edhe mundësia hetuese e veçantë.

Në veçanti, pjesëmarrësit do të njoftohen për cilat lloj të veprave penale mund të aprovohet kërkesa për mundësin e hetuese të veçantë nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake. Masat e nevojshme që duhet ti ndërmarr gjyqtari i procedurës paraprake për të mbrojtur të drejtat e të pandehurit. Si bëhet marrja e dëshmisë nga gjyqtari i procedurës paraprake dhe cilat dispozita ligjore zbatohen?

Rëndësi të veçantë ka analizimi i fuqisë provuese të provave të marra përmes mundësisë hetuese të veçantë dhe se kur këto prova të marra përmes këtij veprimi hetimor, janë plotësisht të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor.

Këto dhe çështje tjera do të adresohen përmes këtij trajnimi duke bërë dallimin e fuqisë provuese të provave të marra përmes këtij veprimi hetimor specifik.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Identifikojnë rëndësinë e veprimit hetimor të mundësisë hetuese të veçantë;
- Bëjnë dallimin në mes të marrjes në pyetje si provë, deklaratës në procedurë penale si provë dhe mundësisë hetuese të veçantë si prove;
- Vlerësojnë se kur dhe si zhvillohet seanca e mundësisë hetuese të veçantë;

Përmbajtja

- Veprimi hetimor i mundësisë hetuese të veçantë;
- Mënyra e zbatimit të këtij veprimi hetimor;
- Rëndësia e veprimit hetimor të mundësisë hetuese të veçantë;
- Pranueshmëria e provës së marrë përmes mundësisë hetuese të veçantë;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdorët një metodologji e kombinuar, ku përveç prezantimeve përmes PowerPoint, do të aplikohen metodat interaktive me pjesëmarrësit. Gjithashtu pjesëmarrëseve do t'u ofrohen për të diskutuar edhe rastet praktike gjyqësore dhe hipotetike me qëllim të shtjellimit dhe diskutimit të dilemave të cilat lindin në praktikën gjyqësore.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.14 Procedura parapenale, para fillimit të hetimit

Në këtë trajnim pjesëmarrësit do të njoftohen për veprimet policore të cilat kryhen nga policia në pajtim me nenin 70 të KPP-së dhe raportimi prokurorit të shtetit sa më shpejtë që është e mundur. Pastaj mbledhja e informacioneve për arritjen e standardit të dyshimit të arsyeshëm për një vepër penale, zbulimin e kryerësit të veprës penale, vendndodhjen e tij, ndalimin e kryerësit ose ndihmësit nga fshehja ose arratisja, të zbuloj e ruaj gjurmët dhe provat tjera të veprës penale dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si provë dhe mbledhja e të gjitha informacioneve të cilat mund të përdorën në procedurë penale.

Në veçanti, pjesëmarrësit do të njoftohen për rolin, relevancën, besueshmërinë dhe fuqinë provuese të informacioneve dhe provave të mbledhura në procedurën parapenale.

Këto dhe çështje tjera do të adresohen përmes këtij trajnimi duke bërë dallimin e informacioneve dhe provave relevante për një çështje konkrete penale, cila është besueshmëria - rruga e sigurimit të informacionit dhe provës konkrete dhe cila është fuqia provuese e informacionit dhe provës konkrete.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë burimin e informacioneve dhe të ndërtojnë standardin e dyshimit të arsyeshëm;
- Bëjnë dallimin në mes të informacioneve, provave relevante, të besueshme dhe fuqisë provuese të tyre;
- Vlerësojnë se kur dhe si informacionet shndërrohen në prova të pranueshme në procedurë penale;

Përmbajtja

- Burimi i informacionit;
- Klasifikimi i informacionit;
- Shndërrimi i informacionit në provë të artikulueshme;
- Pranueshmëria e informacioneve dhe provave në procedurë penale;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdorët një metodologji e kombinuar, ku përveç prezantimeve përmes PowerPoint, do të aplikohen metodat interaktive me pjesëmarrësit. Gjithashtu pjesëmarrëseve do t'iu ofrohen për të diskutuar edhe rastet praktike dhe hipotetike të cilat në vete përmbajnë dilemat dhe sfidat nga praktika gjyqësore.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët nivelit themelore.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.15 Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale

Kodi Penal i Republikës së Kosovës parasheh përgjegjësinë penale në situatën kur dy apo më shumë persona bashkëpunojnë në kryerjen veprave penale, marrin pjesë në kryerjen ose i kontribuojnë kryerjes së tyre në ndonjë mënyrë tjetër. Ligjdhënësi ka paraparë që varësisht prej cilës formë të bashkëpunimit secili kryerës i veprës penale të përgjigjet për veprimin ose mosveprimin e ndërmarrë duke synuar që gjatë procedurës së zhvilluar penale të sigurohet dhe identifikohet saktë dhe qartë se me cilin veprim ose mosveprim kanë kryer veprën penale.

A identifikohen drejt në praktikë format e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale? Si duhet të identifikojmë format e bashkëpunimit në rastet konkrete? Si të zbatohet procedura lidhur me bashkimin kriminal? Si të përcaktohet përgjegjësia individuale e secilit kryerës?

Këto dhe çështje tjera do të adresohen përmes këtij trajnimi duke analizuar rastet praktike dhe duke zbërthyer dispozitat ligjore që i referohen këtyre çështjeve.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Dallojnë format e bashkëpunimit;
- Analizojnë rastet kur kanë të bëjë me shtytjen dhe ndihmën në kryerjen e veprës penale;
- Zbatojnë drejtë procedurën lidhur me bashkimin kriminal;
- Vlerësojnë kufijtë e përgjegjësisë penale dhe ndëshkimit për bashkëpunim.

Përmbajtja

- Bashkëkryerja;
- Shtytja dhe ndihma në kryerjen e veprës penale;
- Bashkimi kriminal dhe marrëveshja për të kryer vepër penale;
- Kufijtë e përgjegjësisë penale dhe ndëshkimi për bashkëpunim;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoret një metodologji e kombinuar, ku përveç prezantimeve në PowerPoint, do të aplikohen edhe metodat inter-aktive të diskutimit me pjesëmarrësit. Gjithashtu, pjesëmarrësve do t'iu ofrohen për të diskutuar në grupe edhe rastet nga praktika gjyqësore.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor dhe të apelit.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.16 Procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore

Personat me çrregullime mendore janë kategori e veçantë e kryerësve të veprave penale, kështu që edhe me KPP është parashikuar procedurë specifike tek rastet kur përfshihen këta persona si kryerës të veprave penale. Trajtimi i këtyre rasteve kërkon një kujdes të veçantë, për shkak të gjendjes mendore në të cilën gjenden në momentin e zhvillimit të procedurës ndaj tyre. Po ashtu, edhe vendimet pa dyshim se duhet të jenë të përshtatura me gjendjen e tyre mendore, në mënyrë që masa e cila shqiptohet të ndikoj në përmirësimin e gjendjes së këtyre personave.

Si identifikohen këta persona? Çfarë veprimesh procedurale fillestare ndërmerren ndaj tyre? Cilat ekzaminime duhet të kryhen? Cilat masa shqiptohen ndaj tyre dhe në cilin institucion duhet të vendosen? Sa zgjatë mbikëqyrja e zbatimit të këtyre masave nga gjykata?

Ky program trajnimi pra, adreson pyetjet duke analizuar procedurën e cila zhvillohet ndaj kryerësve me çrregullime mendore, pastaj ekspertizat të cilat duhet të kryhen për përcaktimin nëse një person vuan nga ndonjë çrregullim mendor dhe kur mund t'iu caktohet paraburgimi këtyre personave. Në trajnim do të trajtohen kriteret të cilat merren parasysh për shqiptimin e masave të trajtimit të detyrueshëm, si dhe mbikëqyrja e ekzekutimit të këtyre masave.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zgjerojnë njohuritë lidhur me veçoritë e procedurës penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore;
- Vlerësojnë caktimin e paraburgimit si masë për personat me çrregullime mendore;
- Analizojnë llojet e trajtimit të detyrueshëm me ndalim në institucionet e kujdesit shëndetësor dhe trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri;

Përmbajtja

- Veçoritë e procedurës penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore;
- Paraburgimi për personat me çrregullime mendore;
- Zbatimi i ekzaminimit psikiatrik dhe
- Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionet e kujdesit shëndetësor dhe në liri;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoret një metodologji e kombinuar, ku do të aplikohen metodat të diskutimit interaktiv me pjesëmarrësit dhe të njëjtëve do t'ju ofrohen për të diskutuar edhe raste praktike.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor dhe të apelit.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.17 Krimet e luftës

Trajnimi do të përqendrohet në format e zbatueshme të përgjegjësisë penale për krimet e luftës, siç janë adresuar nga tribunalet penale ndërkombëtare. Pjesëmarrësit do të pasurojnë sfondin e tyre teorik dhe do të praktikojnë studime konkrete të rasteve, me qëllim të fitimit të mjeteve shitesë për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e luftës brenda juridiksionit të Kosovës. Njohja me mjete të tilla ligjore do të ndihmojë në ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të krimeve të luftës, duke i synuar jo vetëm kryerësit e veprave penale, por edhe individët që mbajnë poste më të larta në hierarkitë ushtarake dhe politike që vendosën ose lejuan kryerjen e krimeve ndërkombëtare.

Në cilat raste një komandant ushtarak ose një udhëheqës politik mund të mbahet përgjegjës për krimet e luftës të kryera nga vartësit? Si të ndërtohet një hetim për krimet e luftës kundër udhëheqësve të lartë ushtarakë dhe politikë kur kryerësit e krimeve të luftës nuk mund të identifikohen? Si të aplikoni përvojën dhe jurisprudencën e tribunaleve penale ndërkombëtare për të ndjekur penalisht dhe gjykuar krimet e luftës brenda juridiksionit të Kosovës? Si të sigurohen dhe të përdoren provat e mbledhura nga tribunalet penale ndërkombëtare dhe gjetjet e arritura nga gjykatat ndërkombëtare, me qëllim të ndjekjes dhe gjyimit të krimeve të luftës brenda juridiksionit të Kosovës?

Trajnimi do të zhvillohet nëpërmjet studimit të rasteve, shembujve praktikë dhe hartimit të shkresave ligjore me qëllim të rritjes së kapaciteteve të prokurorëve dhe gjyqtarëve për t'i zbatuar konceptet ligjore të përpunuara nga tribunalet ndërkombëtare penale për provat e mbledhura në raste konkrete.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Përvetësojnë njohuritë për tu marrë me rastet e krimeve të luftës;
- Njohin format e zbatueshme të përgjegjësisë penale për krimet e luftës;
- Identifikojnë grupet e përbashkëta kriminale;
- Njohin përgjegjësinë komanduese;
- Njohin konceptet kyçe të së drejtës materiale ndërkombëtare penale;

Përmbajtja

- Baza ligjore vendore dhe ndërkombëtare për krimeve të luftës;
- Format e zbatueshme të përgjegjësisë penale për krimet e luftës;
- Vendimet e Gjykatës Supreme dhe të Apelit në zbatimin e të drejtës penale ndërkombëtare në juridiksionin e Kosovës;
- Raste të studimit;
- Grupet e përbashkëta kriminale;
- Përgjegjësia komanduese;

Metodologjia e trajnimit

Pas një pasqyre të shkurtër të koncepteve juridike, trajnimi do të përqendrohet në studimet e rasteve, aplikimin e kategorive ligjore në skenarët faktik dhe hartimin e shablloneve operative të cilat do të ndihmonin punën praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve që merren me procedimin e çështjeve të kësaj natyre.

Përfituesit: Prokurorët e Kosovës - veçanërisht Prokurorët e PSRK, Gjyqtarët nga Departamentet e Krimeve të Rënda në gjykatat themelore dhe në Gjykatën e Apelit e në Gjykatën Supreme.

Kohëzgjatja: Tre ditore.

1.1.18 Masat e fshehta

Shikuar nga aspekti i rregullimit procedural, masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit janë relativisht të reja. Arsyeja e hartimit të këtyre dispozitave, sikurse e dispozitave lidhur me mbrojtjen e të dëmtuarve, të dëshmitarëve si dhe dëshmitarëve bashkëpunues qëndron në domosdoshmërinë shoqërore për shtimin e efikasitetit procedural në luftimin e kriminalitetit të rëndë, të krimit të organizuar dhe të korrupsionit.

Me aplikimin e masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit ndërhyhet, apo cenohen të drejtat dhe liritë e njeriut si kategori kushtetuese e sidomos e drejta e privatësisë së personave. Prandaj me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës në kapitullin e IX janë paraparë kushtet, metodat dhe mënyrat e përdorimit të urdhrit dhe zbatimit të masave. Çdo cenim i këtyre dispozitave të procedurës penale paraqet cenim të drejtave individuale, private dhe personale të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, konventa dhe instrumente tjera ndërkombëtare.

Si të rritet efikasiteti profesional i prokurorëve dhe gjyqtarëve por edhe e zyrtarëve policor në këtë fushë? Si të krijohet praktikë gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare? Të njihen me përvojat dhe praktikat më të mira të shteteve në rajon? Si të aplikohen instrumentet vendore që rregullojnë këtë sferë? Cilat janë dispozitat që duhet të aplikohen për sigurimin e masave të fshehta.

Qasja në adresimin e këtyre dilemave do të bëhet në atë mënyrë që edhe pjesëmarrësit do të kenë mundësi të shkëmbejnë përvojat e tyre në këtë drejtim duke ju referuar edhe rasteve praktike.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Avancojnë njohuritë për këto lloje veprime hetimore;
- Njohin kushtet që duhet të plotësohen për lëshimin e këtyre masave;
- Zbatojnë afatet kohore për lëshimin e këtyre masave;
- Njohin të drejtat e palëve të prekur nga këto masa.

Përmbajtja

- Kushtet për lëshimin e këtyre masave;
- Afatet kohore për lëshimin e këtyre masave;
- Të drejtat e palëve të prekura nga këto masa;
- Mundësitë teknike të mbikëqyrjes së zbatimit teknik-praktik të këtyre masave;

Metodologjia

Këtë trajnim do ta karakterizoj puna në grupe dhe trajtimi i rasteve të studimit nga praktika gjyqësore, ku gjithashtu do të shoqërohet edhe me prezantime të materialeve në PowerPoint.

Përfitues: Gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit policor.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.19 Trajnim hyrës lidhur me krimin kibernetik, provat elektronike dhe përfitimet ilegale nga këto krime

Tani në botën bashkëkohore është shumë i shprehur edhe krimi kibernetik, për shkak të zhvillimit të shpejtë të teknologjisë. Nga përvoja mësojmë se në shumicën e rasteve, gjyqtarët dhe prokurorët ballafaqohen me vështirësi në përballimin e realitetit të ri të botës kibernetike. Me rritjen e numrit të paraqitjes së krimeve që kanë elemente të krimit kibernetik ose provave elektronike rritet nevoja që gjyqtarët dhe prokurorët të jenë të trajnuar sa duhet për ta kuptuar natyrën e këtyre krimeve, si dhe të jenë në dijeni për legjislacionin dhe instrumentet në dispozicion për bashkëpunim ndërkombëtar për trajtimin e rasteve të tilla. Në përgjithësi, aktivitetet e kriminelëve dhe organizatave kriminale janë të dizajnuara që të krijojnë përfitime. Koncepti i shënjestrimit të përfitimeve nga krimet online i prezantuar në këtë kurs trajnues, i sjellë së bashku qasjen e krimit kibernetik, hetimin financiar dhe atë të shpëlarjes së parave me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe suksesit të hetimeve penale dhe procedurave penale, qoftë nga perspektiva e ndjekjes së një kriminelit apo edhe të shënjestrimit të përfitimeve nga veprat ilegale.

Hetimet financiare, parandalimi dhe hetimi i shpëlarjes së parave, mund të ndërliken me çfarëdo përfitimi të krijuar nga krimi, megjithatë vëmendje e veçantë i kushtohet krimit kibernetik (sipas përkufizimit të Konventës së Budapestit, nenet 2-11) dhe llojeve tjera të krimeve online, ku provat elektronike, anonimiteti dhe hapësira kibernetike e pa-kufijshme janë një sfidë e përbashkët. Më çështjet e krimeve kibernetike, provave elektronike, përfitimeve nga veprat penale dhe shpëlarjes së parave kanë të bëjnë shumë institucione të ndryshme dhe përfshijnë në veçanti, krimin kibernetik, njësitet e hetimit financiar, Njësitë e Inteligjencës Financiare (NJIF) dhe prokuroritë. Sido që të jetë, hetimet e krimit kibernetik rrallë shoqërohen me hetime financiare apo anasjelltas, hetimet e krimeve financiare apo të tjera rrallë shoqërohen me hetime të krimit kibernetik.

Kursi është dizajnuar që t'i japë gjyqtarëve dhe prokurorëve një nivel hyrës të njohurisë për krimin kibernetik, provat elektronike dhe bastisja, ndalimi dhe konfiskimi i përfitimeve të krijuara nga krimet online. Kursi do të ofrojë informata ligjore, si dhe praktike lidhur me temat dhe do të jetë i koncentruar në aspektin se si këto çështje ndikojnë në punën e përditshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Përfitojnë njohuri bazike lidhur me krimin kibernetik dhe provat elektronike;
- Të zbatojnë hetimet financiare të përfitimeve nga krimet kibernetike;
- Përfitojnë njohuri rreth ligjeve substanciale dhe procedurale, si dhe teknologjinë që mund të aplikojnë, si dhe
- Vlerësojnë se sa shpejtë mund të ndërmerret dhe cili është niveli i efikasitetit të masave dhe bashkëpunimit ekstensiv ndërkombëtar.

Përmbajtja

Trajnimi është i kombinuar i bazuar në dy kurse të veçanta: kursi bazë për kërkimin, konfiskimin dhe sekuestrimin e të ardhurave nga krimi online dhe kursi hyrës për krimin kibernetik dhe dëshmitë elektronike.

Temat që do të trajtohen gjatë këtij moduli trajnues janë:

- Hyrje në krimin kibernetik – trendet dhe mjetet;
- Teknologjia e përfshirë në krim kibernetik;
- Krimi kibernetik si vepër penale në legjislacionin vendor;
- Praktika e dëshmive elektronike, procedura dhe legjislacioni;
- E drejta procedurale / masat hetuese sipas legjislacionin vendor;
- Bashkëpunimi ndërkombëtarë;
- Bazat e hetimit financiar;
- Roli dhe funksioni i Njësitit të Inteligjencës Financiare (NJIF);
- Hyrje në veprën penale pastrim i parave;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar për krimin kibernetik dhe hetimin financiar;

Metodologjia e trajnimit

Kursi aktualisht është strukturuar dhe projektuar për tu prezantuar në trajnim, duke përdorur udhëzimet e trajnuesve. Përdorimi i rasteve të studimit për të informuar pjesëmarrësit, konsiderohet i përshtatshëm për këtë lloj trajnimi dhe është në përputhje me stilet e të mësuarit për të rritur, sesa mësimi thjesht didaktik. Përdorimi i shembujve fizikë të teknologjisë së referuar dhe përdorimi i internetit mund të përmirësojë të mësuarit. Trajnuesit duhet të marrin parasysh përfshirjen e ushtrimeve dhe metodave të tjera të mësimdhënies në program në nivel vendor. Trajnuesit duhet të kontrollojnë njohuritë e pjesëmarrësve gjatë kursit, përmes pyetjeve, kuizeve ose metodave të tjera për të siguruar që objektivat e mësimit janë arritur.

Materialet e trajnimit (planet mësimore) gjithashtu përmbajnë informata të rëndësishme që kanë për qëllim udhëzimin e trajnuesve gjatë çdo leksioni/sesioni/teme.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor dhe të apelit.

Kohëzgjatja: Dy ditorë.

1.1.20 Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve

KPP njeh si kategori të posaçme dëshmitarët dhe të dëmtuarit, që për shkak të rrezikut serioz që u kanoset atyre apo anëtarëve të familjes së tyre, që mund të kenë nevojë për mbrojtje. Në praktikë ka shumë raste që të dëmtuarit dhe dëshmitarët nuk dëshmojnë për shkak të ndjenjës së rrezikut për shëndetin, jetën dhe pasurinë e tyre, si dhe anëtarëve të familjes së tyre. Andaj, në procedurën penale, mbrojtjes së të dëmtuarit dhe dëshmitarëve duhet t'i kushtohet kujdesi i duhur dhe i veçantë, në mënyrë që të njëjtit mos të kenë frikë për të dëshmuar dhe bashkëpunuar me zbatuesit e ligjit, në njërën anë dhe në anën tjetër, aq sa është e mundur të sigurohet shëndeti, jeta dhe pasuria e tyre. Meqenëse në praktikën gjyqësore ende ka dilema se si duhet trajtuar rastet e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve të mbrojtur, gjatë këtij trajnimi do të shtrohen pyetje si në vijim: Çka kuptojmë me rrezik serioz? Çka është anonimiteti? Cili është dallimi në mes të dëshmitarëve të mbrojtur nga publiku dhe dëshmitarëve anonim? Cilat procedura duhet ndjekur për të mbrojtur të dëmtuarin dhe dëshmitarin, etj. Dhënia e përgjigjeve të sakta dhe të qarta për pyetjet e tilla do të dërgojë deri të zbatimi më i mirë dhe më i drejtë i dispozitave ligjore për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Hartojnë kërkesën për masë mbrojtëse apo anonimitet dhe urdhrit mbrojtës;
- Hartojnë urdhëratë mbrojtës;
- Zhvillojnë drejtë procedurën për shpalljen e personit dëshmitar të mbrojtur;
- Kuptojnë në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore që i referohen mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të dëmtuarve;

Përmbajtja

- Kërkesa për masë mbrojtëse apo anonimitet dhe lëshimi i urdhrit mbrojtës nga gjyqtari;
- Urdhri për anonimitet si dhe format e tij;
- Procedura për shpalljen e personit dëshmitar të mbrojtur dhe përfitimet e tij sipas ligjit

Metodologjia

Gjatë këtij trajnimi do të përdorët një metodologji e kombinuar, ku përveç prezantimeve në PowerPoint, do të aplikohen edhe metodat interaktive të diskutimit me pjesëmarrësit. Gjithashtu, pjesëmarrësve do t'ju ofrohen për të diskutuar në grupe edhe rastet nga praktika gjyqësore, do të bëhet simulim i marrjes së deklaratës së dëshmitarit të mbrojtur dhe hartim i urdhrit mbrojtës.

Përfituesi: Gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor dhe të apelit.

Kohëzgjatja: Një ditë.

1.1.21 Korrupsioni zyrtar dhe vepra penale kundër detyrës zyrtare

Luftimi i korrupsionit zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare janë një prej sfidave gati më të mëdha jo vetëm në shtetin tonë por edhe në praktikën juridike të shteteve tjera e në veçanti të shteteve në tranzicion. Kryerja e këtyre veprave penale nga personat zyrtar cenojnë sundimin e ligjit zhvillimin ekonomik dhe perspektivën e vendit. Hetimi i suksesshëm i këtyre veprave është kompleks dhe varet nga siguri i resurseve të mjaftueshme në hetim dhe bashkëpunim të ngushtë në mes organeve shtetërore kompetente për luftimin dhe gjykimin e këtyre veprave.

Sa është efektive korniza ligjore në vend për luftimin e këtij krimi, sa arrihet në praktikë që të bëhet kualifikimi adekuat i veprimeve inkriminuese me emërtimin ligjor të veprës penale nga ky kapitull. Si të dallojmë vijën ndarëse ndërmjet veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe veprës penale të konfliktit të interesit, të gjitha këto dhe çështje tjera do të jenë në fokus të trajnimit, ku pjesëmarrësit do të kenë rastin që përmes rasteve studimore dhe diskutimeve të avancojnë praktikat e tyre në implementimin e drejtë të ligjit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Analizojnë situatat e tejkalimit të kufijve të autorizimeve zyrtare;
- Identifikojnë veprat penale kundër detyrës zyrtare, ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre;
- Zhvillojnë hetim efektiv dhe kualifikim adekuat ligjor në raport me veprimet inkriminuese;

Përmbajtja

- Keqpërdorimi i pozitës apo autoriteti zyrtar;
- Keqpërdorimi i informatës zyrtare;
- Konflikti i interesit;
- Përvetësimi dhe mashtrimi në detyrë;
- Mashtrimi në detyrë;
- Përdorimi i paautorizuar i pasurisë;
- Marrja dhe dhënia e ryshfetit, dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj;
- Ushtrimi i ndikimit;
- Nxjerrja e kundërligjshme e vendimit gjyqësor;
- Zbulimi i fshehtësisë zyrtare;
- Falsifikimi i dokumentit zyrtar;
- Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme;
- Përvetësimi i kundërligjshme i pasurisë me rastin e bastisjes dhe ekzekutimit të vendimit gjyqësor;
- Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij sesiioni të trajnimit do të përdoren metoda e prezantimeve të materialeve në PowerPoint, duke shoqëruar edhe me raste nga praktika gjyqësore e me qëllim të nxitjes së diskutimit interaktiv lidhur me sfidat dhe çështjet e diskutueshme të cilat lindin në praktikë.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelorë dhe të apelit dhe prokurorë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Kohëzgjatja Një ditore.

1.1.22 Krimi i organizuar

Krimi i organizuar kërcënon seriozisht zhvillimin e demokracisë dhe sundimin e shtetit të së drejtës duke cenuar të drejtat e njeriut, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik të shtetit. Për këtë formë të kriminalitetit, mjaftë mirë i referohet Konventa ndërkombëtare për luftimin e krimit të organizuar, që nënkupton se kjo vepër penale cenon zhvillimin ekonomik si të shoqërisë dhe shtetit tonë po ashtu edhe shteteve të tjera.

Cila është infrastruktura ligjore për luftimin e krimit të organizuar, cilat janë format apo veprimet që duhet të ndërmerren për parandalimin e krimit të organizuar dhe si të zbatohen në mënyrë efektive mekanizmat përkatës të gjitha këto pyetjeve dhe dilemave do të adresohen nëpërmjet prezantimit të rasteve nga praktika vendore dhe ndërkombëtare.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Demonstrjnë shkathtësitë profesionale për hetimin e kësaj vepre penale;
- Identifikojnë strukturën ligjore për luftimin e krimit të organizuar;
- Zbatojnë drejtë legjislacionin vendor dhe ndërkombëtarë .

Përmbajtja

- Përkufizimin ligjor i krimit të organizuar;
- Korniza ligjore vendore dhe ndërkombëtare;
- Elementet identifikuese të kësaj vepre penale;

Metodologjia

Metodologjia e cila do të përdoret në këtë trajnim, do të përkushtohet më shumë metodës interaktive të diskutimit me pjesëmarrësit, e sidomos diskutimit të dilemave dhe sfidave të cilat shfaqen në praktikën gjyqësore duke e shoqëruar trajnimin me raste praktike dhe prezantime në PowerPoint.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët e departamenteve për krime të rënda dhe prokurorët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.23 Shpërlarja e parasë

Shpërlarja e parave është vepër penale që hyn në grupin e veprave penale kundër ekonomisë dhe paraqet rrezik permanent për ekonominë e të gjitha vendeve. Operacionet e pastrimit të parave janë të dizajnuara për të marrë të ardhurat nga veprimtari të paligjshme, të tilla si fitimet nga mashtrimet, dhe duke fshehur ekzistencën, burimin, ose zbatimin e këtyre fondeve në mënyre që të ardhurat të duket se vijnë nga një burim legjitim. Me pak fjalë, “paratë e pista” janë bërë për të dalë i pastër. Pasi paratë e paligjshme janë pastruar, kryerësi është në gjendje të shpenzojë apo të investojë të ardhurat e paligjshme në asete të ligjshme. Kosova si një vend i dal nga lufta e me specifikat e veta, ka vështirësi në luftimin e ekonomisë joformale ku pjesa më e madhe e transaksioneve kryhet në para të gatshme, pa i përfillur dhe pa kaluar nëpër institucione financiare. Kjo në veçanti paraqet vështirësi në punën e institucioneve që kanë obligim raportimin e transaksioneve. Kësaj i kontribuon po ashtu edhe bashkëpunimi i dobët ndërkombëtar në këtë fushë dhe mosharmonizimi i legjislacionit vendor me Direktivën e BE-së.

Cilët janë faktorët për identifikimin e ekonomisë joformale? Cili është roli i NJIF-it? Ku qëndron raporti i legjislacionit vendor me atë të BE-së? Trajnimi do të fokusohet në adresimin e këtyre dilemave dhe pyetjeve të ngritura duke analizuar në hollësi legjislacionin vendor dhe atë të BE-së përfshirë dhe praktikën më të mira

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Klasifikojnë veprat penale të shpërlarjes së parave;
- Krahasojnë legjislacionin vendor me atë të BE-së;
- Njohin dhe analizojnë punën e institucioneve financiare dhe obligimet që i kanë këto institucione në luftimin e kësaj dukurie;
- Përdorin teknikat e ekzaminimit të mashtrimeve tek pastrimi i parave;
- Njohin format e bashkëpunimit ndërkombëtar;
- Analizojnë paraqitjen e rastit në gjykatë.

Përmbajtja

- Të kuptuarit e nocionit dhe elementeve të veprës penale të pastrimit të parave;
- Hetimi i pastrimit të parave dhe identifikimi i aktiviteteve të pastrimit të parave;
- Fazat e pastrimit të parave dhe çfarë e karakterizon atë;
- Teknikat më të shpeshta të përdorura në pastrimin e parave;
- Gjykimi i pastrimit të parasë;

Metodologjia e trajnimit

Metodologjia e cila do të përdoret në këtë trajnim, do të përkushtohet më shumë metodës interaktive të diskutimit me pjesëmarrësit, e sidomos diskutimit të dilemave dhe sfidave të cilat shfaqen në praktikën gjyqësore duke e shoqëruar trajnimin me raste praktike dhe prezantime në PowerPoint.

Përfituesit: Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Apelit, prokurorë të prokurorisë themelore dhe të Apelit dhe të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe hetues.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.24 Parashkrimi

Parashkrimi është një institut i rëndësishëm i së drejtës penale, i cili konsiston në atë se me kalimin e afateve të caktuara dhe në situata të caktuara, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret, përkatësisht dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet. Shpeshherë në praktikën tonë gjyqësore paraqitet situata dhe raste kur gjyqtarët dhe prokurorët kanë dilema dhe paqartësi të theksuara sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me parashkrimin.

Çka është parashkrimi i ndjekjes penale? Çka është parashkrimi i ekzekutimit të dënimit? Kur fillon afati i parashkrimit të ndjekjes penale dhe të ekzekutimit të dënimit? Në cilat raste bëhet ndërprerja e afateve të parashkrimit?

Këto dhe çështje tjera do të adresohen përmes këtij trajnimi duke analizuar rastet praktike dhe duke zbërthyer dispozitat ligjore që i referohen këtyre çështjeve.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij programi trajnues, përfituesit do të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë në mënyrë të drejtë parashkrimin e ndjekjes penale dhe të ekzekutimit të dënimit;
- Analizojnë rastet kur fillon afati i parashkrimit;
- Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me parashkrimin;
- Vlerësojnë situatat kur mund që të ndërpritet afati i parashkrimit;

Përmbajtja

- Parashkrimi i ndjekjes penale;
- Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit;
- Afatet e parashkrimit;
- Ndërprerja e afateve të parashkrimit;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdorët një metodologji e kombinuar, ku përveç prezantimeve në PowerPoint, do të aplikohen edhe metodat interaktive të diskutimit me pjesëmarrësit. Gjithashtu, pjesëmarrësve do t'iu ofrohen për të diskutuar në grupe edhe rastet nga praktika gjyqësore.

Përfituesit: Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor dhe të apelit.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.25 Veprat penale kundër jetës dhe trupit, me theks të veçantë veprat penale të vrasjes dhe vrasjes së rëndë

E drejta e njeriut për jetë është e drejta më e rëndësishme në grupin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kjo e drejtë është absolute, pa marrë parasysh interesin jetësor të individit, aftësinë për jetë, moshën dhe gjendjen shëndetësore të njeriut. Për këtë arsye, kjo e drejtë është e garantuar me aktet më të rëndësishme ndërkombëtare, por garantohet edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Përveç këtyre, mbrojtjen e të drejtës në jetë e sanksionon edhe KPRK, duke parashikuar disa forma të veprave penale të vrasjeve. Gjithashtu, përveç të drejtës në jetë, një rëndësi të veçantë KPRK i kushton edhe mbrojtjes së integritetit trupor të personit.

Si përkufizohet vrasja? Cilat janë elementet esenciale të veprës penale të vrasjes? Në cilat rrethana mund të kryhet vepra penale e vrasjes? Si kualifikohet dhe çka e karakterizon vrasjen e rëndë? Cilat janë forma tjera të vrasjes sipas KPRK? Cilat janë veprat tjera penale që bëjnë pjesë në kuadër të veprave penale kundër jetës dhe trupit.

Këto dhe çështje tjera do të adresohen përmes këtij trajnimi duke analizuar rastet praktike dhe duke zbërthyer dispozitat ligjore që i referohen këtyre veprave.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij programi trajnues, përfituesit do të jenë në gjendje të:

- Zgjerojnë njohuritë lidhur me veprat penale të vrasjes dhe vrasjes së rëndë;
- Zbatojnë në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore të Kapitullit të veprave penale kundër jetës dhe trupit;
- Identifikojnë elementet esenciale të secilës formë të veprave penale të kësaj natyre;
- Shpjegojnë pasojat dhe rrezikshmërinë e këtyre veprave penale;

Përmbajtja

- Vrasja;
- Vrasja e rëndë;
- Veprat tjera penale që bëjnë pjesë në Kapitullin e veprave penale kundër jetës dhe trupit;

Metodologjia e trajnimit

Metodologjia e cila do të përdoret në këtë trajnim, do të përkushtohet më shumë metodës interaktive të diskutimit me pjesëmarrësit, e sidomos diskutimit të dilemave dhe sfidave të cilat shfaqen në praktikën gjyqësore duke e shoqëruar trajnimin me raste praktike dhe prezantime në PowerPoint.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor dhe të apelit.

Kohëzgjatja: Një ditore

1.1.26 Veprat penale të narkotikëve

KPRK i kushton një rëndësi të veçantë veprave penale të narkotikëve, për shkak të rrezikshmërisë dhe pasojave të rënda që shkaktohen me rastin e kryerjes së këtyre veprave penale. Në këtë drejtim, për shkak të rëndësisë dhe rrezikshmërisë së këtyre veprave penale, në pjesën e posaçme të KPRK i kushtohet një kapitull i tërë, ku janë parashikuar disa vepra penale që ndërlidhen me narkotikët dhe format e veçanta të tyre. Për këto arsye, edhe dënimet e parashikuara janë më të larta, në krahasim me legjislacionin e mëparshëm penal.

Cili është përkufizimi ligjor i veprave penale të kësaj natyre? Cilat janë rrethanat që këto vepra penale i bëjnë të cilësuar? Cilat janë sanksionet që parashihen për këto vepra penale?

Këto dhe çështje tjera do të adresohen përmes këtij trajnimi, duke analizuar rastet praktike dhe duke zbërthyer dispozitat ligjore që i referohen këtyre veprave.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij programi trajnues, përfituesit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore të kapitullit të veprave penale të narkotikëve;
- Identifikojnë elementet esenciale të secilës formë të veprave penale të kësaj natyre;
- Shpjegojnë pasojat dhe rrezikshmërinë e këtyre veprave penale.

Përmbajtja

- Veprat penale të narkotikëve sipas KPRK;
- Rrethanat që këto vepra penale i bëjnë të cilësuar;
- Llojet e sanksioneve që mund të shqiptohen ndaj kryerësve të këtyre veprave penale.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoret një metodologji e kombinuar, ku përveç prezantimeve në PowerPoint, do të aplikohen edhe metodat interaktive të diskutimit me pjesëmarrësit. Gjithashtu, pjesëmarrësve do t'ju ofrohen për të diskutuar në grupe edhe rastet nga praktika gjyqësore.

Përfituesit: Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor dhe të apelit.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.1.27 Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës

E drejta në punë dhe të drejtat tjera që burojnë nga e drejta në punë konsiderohen të drejta elementare dhe shumë të rëndësishme të njeriut. Këto të drejta janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligje dhe akte tjera nënligjore. Për shkak të rëndësisë së madhe që kanë këto të drejta për ekzistencën materiale të njeriut, cenimi i këtyre të drejtave konsiderohet edhe vepër penale. Kështu, KPRK me një kapitull të veçantë ka parashikuar disa vepra penale të kësaj natyre, kapitull ky i cili është emërtuar si “Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës”.

Si përkufizohet cenimi i të drejtave në marrëdhëniet e punës? Cilat janë elementet e veprës penale cenimi i të drejtave të punësimit dhe papunësisë? Kush mund të jetë kryerës dhe viktimë e këtyre veprave penale? Cilat janë veprat tjera penale që bëjnë pjesë në kuadër të këtij Kapitulli të veprave penale? Këto dhe çështje tjera do të adresohen përmes këtij trajnimi duke analizuar rastet praktike dhe duke zbërthyer dispozitat ligjore që i referohen këtyre veprave.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij programi trajnues, përfituesit do të jenë në gjendje të:

- Zgjerojnë njohuritë lidhur me veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës;
- Zbatojnë në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore të këtij kapitulli;
- Identifikojnë elementet esenciale të secilës formë të veprave penale të kësaj natyre;
- Shpjegojnë pasojat dhe rrezikshmërinë e këtyre veprave penale.

Përmbajtja

- Cenimi i të drejtave në marrëdhëniet e punës;
- Cenimi i të drejtave të punësimit dhe të papunësisë;
- Veprat tjera penale që bëjnë pjesë në këtë Kapitull.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdorët një metodologji e kombinuar, ku përveç prezantimeve në PowerPoint, do të aplikohet edhe diskutimi me pjesëmarrësit. Gjithashtu, pjesëmarrësve do t’iu ofrohen për të diskutuar në grupe edhe rastet nga praktika gjyqësore të cilat raste i karakterizojnë dilemat dhe sfidat e shfaqura në praktikë.

Përfituesit Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor dhe të apelit.

Kohëzgjatja: Një ditor.

1.1.28 Trafikimi me qenie njerëzore

Trafikimi i qenieve njerëzore paraqet një vepër penale mjaft komplekse dhe një fenomen global, që në vetvete përfshinë elementet e disa veprave penale dhe shkeljet më të rënda të të drejtave të njeriut. Të rrezikuar nga trafikimi i qenieve njerëzore mund të jenë të gjithë personat pa dallim moshe, gjinie, race apo përkatësie kombëtare, por në veçanti më të rrezikuarit janë gratë dhe fëmijët për qëllime të shfrytëzimit seksual. Institucionet përgjegjëse janë plotësisht të vetëdijshme për shumëllojshmërinë e shfrytëzimit të qenieve njerëzore. Bazuar në këtë, është e nevojshme ngritja e mëtejme e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatim të drejtë të legjislacionit në fuqi dhe përforcimi i bashkëpunimit me institucionet tjera relevante për luftimin e suksesshëm të kësaj dukurie.

Cilat janë elementet e veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore dhe veprave tjera të ndërlidhura më trafikimin? Si mund të bëhet identifikimi i viktimave të trafikimit? Cilat janë të drejtat e viktimave të trafikuar? Si mbrohen viktimat e trafikimit? Si të parandalohet trafikimi me njerëz? Si bëhet rehabilitimi dhe ri-integrimi i viktimave të trafikuar? Cilat janë mënyrat adekuatë të bashkëpunimit në mes të institucioneve përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore? Cilat janë elementet e veprës penale të kontrabandimit me migrantë?

Për të dhënë përgjigje për pyetjet e sipërpërmendura, gjatë trajnimit pjesëmarrësit do të kenë mundësinë e qasjes në raste nga praktika, ku mund të shihen sfidat dhe problemet e zbatimit të drejtë të legjislacionit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe mënyrat se si mund të tejkalohen apo zgjidhen këto sfida dhe probleme.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë legjislacionin lidhur me trafikimin me njerëz;
- Identifikojnë elementet e veprës penale të trafikimi me njerëz;
- Dallojnë elementet e veprës penale të trafikimi me njerëz nga elementet e veprave tjera penale;
- Zbatojnë dhe respektojnë të drejtat e viktimave të trafikimit në procedurën penale ;
- Zbatojnë procedurën për kompensimin e dëmit.

Përmbajtja

- Kuptimi dhe elementet e trafikimit të qenieve njerëzore;
- Veprat penale të ndërlidhura më trafikimin e qenieve njerëzore;
- Të drejtat e viktimave të trafikuar gjatë procedurës penale;
- Mbrojtja dhe asistimi i viktimave të trafikimit;
- Përforcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit mes akterëve kyç;
- Kompensimi i viktimave të trafikimit.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda interaktive, simulime të rasteve, punë në grupe për raste nga praktika si dhe pyetje e diskutime për temat e përfshira në këtë trajnim.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët e shkallës së parë dhe shkallës së dytë.

Kohëzgjatja: Një ditorë

1.1.29 Dëshmitarët bashkëpunues

KPPK, njeh si kategori të posaçme dëshmitarët në procedurën penale, dhe ka paraparë procedurën përkatëse për procedimin me dëshmitarë. Si dëshmitarë mund të thirret personi, për të cilin besohet se jep informata të duhura për veprën penale të kryer si dhe kryerësit e veprës penale, veçanërisht dëshmitari bashkëpunues, prandaj mbrojtja e dëshmitarëve është me rëndësi të veçantë. Në praktikë ka shumë raste që dëshmitarët bashkëpunues nuk dëshmojnë për shkak të ndjenjës së rrezikut për shëndetin, jetën e tyre dhe anëtarëve të familjes. Andaj, në procedurën penale, mbrojtjes së të dëmtuarit dhe dëshmitarëve duhet t'i kushtohet kujdesi i duhur që të njëjtit mos të kenë ndonjë ndërhyrje ose shqetësim eventuale nga jashtë dhe brenda.

Çka kuptojmë me dëshmitarët bashkëpunues? Çka është anonimiteti? Cilat janë të drejtat e tyre në procedurë? Çka kuptojmë me rrezik serioz? Cili është dallimi në mes të dispozitave të KPP, për masat për mbrojtjen e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve në raport me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve? Cili është dallimi në mes të dëshmitarëve të mbrojtur nga publiku dhe dëshmitarëve anonim?

Trajnimi synon që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, si dhe përmes elaborimit të dilemave të lartpërmendura të kontribuoj në mbrojtjen më efektive të dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor. Përfituesit e këtij trajnimi kanë mundësinë që të bashkëbisedojnë dhe ndajnë përvojat e tyre lidhur me sfidat të cilat i kanë gjatë punës, në cilësinë e gjyqtarit apo prokurorit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë dispozitat ligjore përkitazi me pozitën e dëshmitarëve bashkëpunues në procedurën penale;
- Ngritin shkathtësitë profesionale për zbatimin e dispozitave ligjore gjatë punës së tyre;
- Demonstrjnë standarde të larta profesionale gjatë intervistimit të dëshmitarëve bashkëpunues.
- Interpretojnë drejtë përfitimet e dëshmitarit bashkëpunues sipas ligjit.
- Zhvillojnë drejtë procedurën për shpalljen e personit dëshmitar bashkëpunues.

Përmbajtja

- Dëshmitarët bashkëpunues në fazat e ndryshme të procedurës penale;
- Të drejtat e dëshmitarëve bashkëpunues në procedurën penale;
- Kush mund të dëshmojë në cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues.
- Procedura për shpalljen e personit dëshmitar bashkëpunues dhe përfitimet e tij sipas ligjit

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët e shkallës së parë.

Kohëzgjatja: Një ditore

1.1.30 Ekspertiza dhe shfrytëzimi i saj nga prokurorët në procedurën penale

Dihet se gjatë zhvillimit të procedurës penale, detyrë kryesore është vërtetimi i fakteve relevante kundër dhe në dobi të pandehurit, përmes të cilëve bëhet vërtetimi i gjendjes faktike. Gjatë procedurës shpeshherë për vërtetimin e fakteve të ndryshme kërkohen njohuri të posaçme nga shkencat jo juridike, që gjyqtari nuk i posedon, për këtë arsye kërkohet edhe kryerja e ekspertimeve të ndryshme. Ekspertimi është kryerja e një veprimtarie të caktuar nga eksperti për vërtetimin ose vlerësimin e ndonjë fakti relevant, për çështjen kur për vërtetimin ose vlerësimin e tij kërkohet njohuri ose mjeshtri profesionale të posaçme.

Kur nevojitet ekspertimi? Në cilën fazë të procedurës mund të kërkohet një ekspertim i caktuar? A mundet i pandehuri apo edhe pala e dëmtuar të kërkoj nga një ekspert kryerjen e ekspertimit? Si vlerësohet ekspertimi si provë nga gjykata?

Përmes këtij trajnimi do të trajtohen rastet e caktuara kur nevojitet ekspertimi, situatat kur është ekspertimi i domosdoshëm, apo se si administrohet raporti mbi ekspertimin e kryer dhe dëgjimi i vet ekspertit si dhe sa është e varur gjykata nga vlerësimet e bëra në ekspertim për vërtetimin e një fakti të caktuar.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Vlerësojnë rastet se kur është i nevojshëm ekspertimi;
- Zgjerojnë njohuritë mbi administrimin e ekspertizës;
- Analizojnë raportin e ekspertit;

Përmbajtja

- Caktimi i ekspertit;
- Fushat e veçanta ku mund dhe duhet të caktohet ekspertimi;
- Administrimi i ekspertizës gjatë shqyrtimit kryesor;
- Vlerësimi i raportit të ekspertit nga gjykata;

Përfituesit Gjyqtarët e çështjeve penale të të gjitha instancave si dhe prokurorët.

Kohëzgjatja: Një ditor.

1.1.31 Zbatimi i Udhëzuesit për Politikat Ndëshkimore

Praktika e politikës ndëshkimore nëpër gjykatat e Kosovës vlerësohet të mos jetë e njëjtë dhe e harmonizuar. Vendimet kanë shfaqur mangësi serioze në mënyrën në të cilën gjykatat i qasen caktimit të dënimeve. Për këtë qëllim Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore i cili ka për qëllim që të trajtojë problemet në përcaktimin e dënimeve dhe të ofrojë një qasje uniforme në këtë drejtim. Edhe pse udhëzuesi nuk është ligjërish i detyrueshëm, megjithatë, mund të ndikojë që të shmangen dallimet e paarsyetuara në caktimin e dënimeve. Udhëzuesi paraqet një mjet mjaft të rëndësishëm për gjyqtarët në vlerësimin e një sërë rrethanash individuale të të pandehurve si dhe një kornizë për vlerësimin e vendimit mbi dënimin.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Vlerësojnë drejtë rrethanat lehtësuese dhe rënduese gjatë caktimit të dënimit;
- Vlerësojnë rrethanat e zbutjes dhe ashpërsimit të dënimit;
- Zbatojnë parimet relevante në caktimin e dënimit;
- Zbatojnë standard të unifikuara në caktimin e dënimeve alternative;

Përmbajtja

- Aspektet procedurale të politikës ndëshkimore;
- Parimet relevante në caktimin e dënimit - zbutja dhe ashpërsimi
- Rrethanat rënduese dhe lehtësuese sipas nenit 74
- Zbatimi i dënimeve alternative dënimet plotësuese dhe dispozitat tjera
- Shqyrtimi i vendimeve për dënimin nga apeli
- Tabela për matjen e dënimit

Përfituesit Gjyqtarët e çështjeve penale të nivelit themelor dhe të apelit si dhe prokurorët.

Kohëzgjatja: Një ditë.

Programet e specializuara

1.2 Programet e specializuara

1.2.1 Program i Specializuar Trajnimi për Zhvillimin e Kapaciteteve në Luftën Kundër Korrupsionit

Ky program i specializuar trajnimi synon që në mënyrë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse t'i adresojë nevojat për zhvillim profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve që merren me luftimin e veprave penale korruptive. Programi do të trajtojë sfidat rreth zbatimit të legjislacionit vendor në luftimin efikas të korrupsionit duke u fokusuar në aspekte specifike që paraqiten si problematike në praktikë. Krahas tyre, po ashtu do të trajtohet legjislacioni ndërkombëtar në këtë fushë me fokus në atë të BE-së, përfshirë standardet dhe praktikat e suksesshme të vendeve që kanë arritur sukses në luftimin e kësaj dukurie. Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut do të jetë në kuadër të këtij programi.

Po ashtu në fokus do të jenë aspekte të avancimit të hartimit të akteve ligjore. Format e bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional të institucioneve të mandatuara për luftën kundër korrupsionit. Ndër temat që përfshihen në këtë program, ku gjithsesi do të trajtohen edhe aspektet e menaxhimit efikas të rasteve të korrupsionit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij programi trajnues, përfituesit do të jenë në gjendje të:

- Demonstronjë përdorimin e saktë të koncepteve dhe parimeve në luftimin më efikas të veprave korruptive;
- Zbatojnë ligjet dhe teoritë në situata praktike;
- Vlerësojnë relevancën e të dhënave dhe burimeve në qasjen ndaj kësaj dukurie;

Përmbajta: ky program realizohet në tri sesione që zgjasin nga dy (2) ditë secili.

Përfituesit: Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Apelit, prokurorët e prokurorive themelore dhe të Apelit dhe të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, zyrtarë policor të departamenteve për luftimin e korrupsionit, zyrtarë doganorë.

Përmbajtja

Sesioni I

1. Identifikimi dhe Vlerësimi i Korrupsionit të mundshëm zyrtar:

- Struktura ligjore vendore dhe ndërkombëtare si dhe praktikrat;
- Njohja dhe vlerësimi i çështjeve potenciale korruptive.

2. Analizimi i informatave publike të disponueshme:

- Planet hetuese dhe hapat e parë;
- Zhvillimi i një plani hetues;
- Qasja në dokumente dhe informata jo publike;
- Marrja dhe kërkimi i evidencave elektronike;

Kohëzgjatja: Dy ditore.

Sesioni II

1. Analizat forenzike:

- Përdorimi i mjeteve të institucioneve relevante për luftimin e korrupsionit në qasjen në të dhënat financiare.

2. Analizimi i transaksioneve të rrishtit të lartë:

- Përdorimi i mjeteve të institucioneve relevante për luftimin e korrupsionit në qasjen në rekordet financiare;
- Analizimi i transaksioneve të rrishtit të lartë;

3. Intervistat dhe përgatitja për gjykim:

- Teknikat e intervistimit dhe sfidat;
- Intervistimi i dëshmitarëve potencial;
- Intervistimi i objektivëve të mundshëm
- Radhitja e provave;
- Argumentet e mundshme të mbrojtjes dhe sfidat në gjyq;

Kohëzgjatja: Dy ditore.

Sesioni III

- Zgjidhja e rasteve të korrupsionit zyrtar;
- Shkuarja në gjyq - paraqitja e rastit;
- Zgjidhjet e mundshme alternative;
- Masat për parandalimin dhe ekspozimin ndaj korrupsionit zyrtar;

Kohëzgjatja: Dy ditore.

1.2.2 Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës

Bazuar në raportet e institucioneve dhe organizatave që monitorojnë gjyqësorin në Republikën e Kosovës, vlerësohet se prokurimi publik është një prej fushave ku ka korrupsion dhe se ka nevojë për zhvillim të njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për këtë fushë. Po ashtu, është kërkesë e vazhdueshme e gjyqtarëve dhe prokurorëve që të diskutojnë me të gjithë akterët relevant në vend rreth procedurave të prokurimit publik dhe problemeve të zbatimit të tyre në praktikë.

Ky program adreson kërkesat e lartpërmendura duke u fokusuar në elaborimin praktik të të gjitha fazave të prokurimit publik. Në këtë kuadër do të analizohen rastet nga praktika rreth mënyrës së vlerësimit të nevojave dhe përcaktimit të kërkesave, dosja e tenderit dhe procesi i vlerësimit të një tenderi. Në fokus të këtij programi do të jenë edhe faza e implementimit të kontratës dhe po ashtu hetimi dhe gjykimi i veprave penale të kësaj natyre.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Analizojnë procesin e planifikimit të prokurimit;
- Kuptojnë dhe zbërthejnë dosjen e tenderit;
- Vlerësojnë specifikacionet teknike dhe njoftimin indikativ;
- Kuptojnë elementet për zgjedhjen e kontraktorit dhe dhënies së çmimit;
- Identifikojnë indikatorët e korrupsionit që lidhen me prokurimin publik;
- Të hartojnë një plan për hetimin e veprave penale të korrupsionit në prokurimin publik.

Struktura: Struktura e këtij programi realizohet në dy sesione që zgjasin nga dy (2) ditë secili.

Përfituesit: Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Apelit, prokurorët e prokurorive themelore dhe të Apelit dhe të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, hetues policor, zyrtarë doganorë, zyrtarë nga ATK dhe NJIF.

Përmbajtja

Sesioni I

Vlerësimi i nevojave/Përcaktimi i kërkesave:

- Planifikimi i prokurimit;
- Njoftimi indikativ;
- Specifikimi teknik;

Përgatitja/Procesi i dizajnit dhe përgatitja e dokumenteve të ofertimit:

- Dosja e tenderit;
- Dorëzimi i dosjes së tenderit (s qarimet);
- Hapja publike;

Zgjedhja e kontraktorit dhe faza e dhënies së çmimit:

- Komisionet vlerësuese;
- Kriteret e vlerësimit;
- Rekomandimi i operatorit fitues;

Kohëzgjatja: Dy ditore

Sesioni II

Faza e implementimit të kontratës:

Rreziqet indikative të korrupsionit në fazat e prokurimit

- Vlerësimi i Nevojave/përcaktimi i kërkesave;
- Përgatitja/Procesi i dizajnit dhe përgatitja e dokumenteve të ofertimit;
- Zgjedhja e kontraktorit dhe faza e dhënies së çmimit;
- Faza e implementimit të kontratës;

Skemat korruptive dhe problemet e ndërlidhura me mashtrim:

- Pagesa e haraçit;
- Konflikti i interesit;
- Skemat e kurdisjes së ofertave
- Ofertomi konspirativ;
- Skemat mashtruese;

Planifikimi i hetimit dhe ndjekja:

- Përmbajtja e planit të hetimit;
- Identifikimi i burimeve të informacionit;
- Planifikimi i kontrollit të shtëpisë dhe përgjimi;
- Planifikimi i përdorimit të informatorëve;
- Planifikimi i gjurmimit të aseteve;

Kohëzgjatja: Dy ditore

1.2.3 Program i Specializuar Trajnimi në Forcimin e Kapaciteteve Profesionale në Luftimin e Krimit Kibernetik

Përdorimi i teknologjive të reja të informacionit dhe veçanërisht i internetit ka marrë një rëndësi të veçantë në jetën e përditshme. Ky fenomen prek jo vetëm aktivitetet e një organizmi qoftë ai shtetëror apo privat, i përfshirë në sferën e biznesit apo të një aktiviteti jo fitimprurës, por mund të prekë dhe njeriun e thjeshtë në aktivitetin e tij të përditshëm, në sferën e tij private apo profesionale. Si çdo teknologji e re e vënë në dispozicion të një numri të madh përdoruesish, interneti paraqet jo vetëm të mira dhe përfitime, por në të njëjtën kohë dhe një sërë problemesh. Krimi kibernetikë është një fenomen kompleks dhe e vetmja mënyrë për t'i bërë ballë do të ishte trajtimin globalë i këtij problemi. Për këtë duhet një bashkëpunim i të gjitha institucioneve relevante dhe ekspertëve të fushave të ndryshme për të shmangur zgjidhjet segmentare. Për këtë është e rëndësishme të konceptojmë një arkitekturë globale të sigurisë së informacionit që të marrë në konsideratë brenda saj dimensionin teknik dhe operacional, dimensionin juridik dhe rregullator, dimensionin organizativ dhe ekonomik duke mos harruar dimensionin human.

Çka është krimi kibernetikë? Nga vjen? Çfarë e ndihmon të jetë kaq i përhapur? Si të luftohet dhe të parandalohet krimi kibernetikë? Sa jemi të rrezikuar nga ky krim? Kush janë viktimat e mundshme të krimit kibernetikë? Cili është legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar që e sanksionon krimin kibernetikë?

Programi trajnues është hartuar në mënyrë që të ofroj njohuri për gjyqtarët dhe prokurorët lidhur me tendencat aktuale të krimit kibernetikë dhe teknikave kyçe për luftim të suksesshëm të veprave të kësaj natyre.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Vlerësojnë riskun potencial të krimit kibernetikë dhe zhvillojnë teknikat për luftimin e tij;
- Menaxhojnë hetimet për krimin kibernetikë;
- Identifikojnë dhe parandalojnë më mirë veprat penale të kësaj natyre;
- Njohin tendencat e krimit kibernetikë.

Përmbajtja: Struktura e këtij programi realizohet në tri sesione që zgjasin nga dy (2) ditë secili.

Përfituesit: Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Apelit, prokurorët e prokurorive themelore dhe të Apelit dhe të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, zyrtarë policor të departamenteve përkatëse për luftimin e krimit kibernetikë.

Përmbajtja

Sesioni I

- Teknologjia dhe krimi;
- Interneti dhe krimi;
- Kërcënimet, tendencat dhe sfidat e krimit kibernetikë;
- Krimi kibernetikë si vepër penale dhe sfidat në luftimin e tij.

Kohëzgjatja: Dy ditore

Sesioni II

- Vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut;
- Luftimi i reziqeve të sigurisë virtuale: email, viruset dhe hakerat;
- Zbulimi dhe parandalimi i pastrimit të parave;
- Roli i forenzikës në zbulimin e krimit kibernetikë;
- Marrja e provave elektronike;
- Provat elektronike – procedura dhe praktika.

Kohëzgjatja: Dy ditore

Sesioni III

- Bashkëpunimi ndërkufitar dhe ndërkombëtar në luftën kundër krimit kibernetikë; Skemat e kurdisjes së ofertave;
- Mundësitë e ndjekjes së suksesshme të e-krimin ndërkombëtar dhe krimit kibernetikë.

Kohëzgjatja: Dy ditore.

1.2.4 Program i Specializuar Trajnimi në Forcimin e Kapaciteteve Profesionale në Luftimin e Shpëlarjes së Parave

Shpëlarja e parave është vepër penale që hyn në grupin e veprave penale kundër ekonomisë dhe paraqet rrezik permanent për ekonominë e të gjitha vendeve. Operacionet e pastrimit të parave janë të dizajnuara për të marrë të ardhurat nga veprimtari të paligjshme, të tilla si fitimet nga mashtrimet, dhe duke fshehur ekzistencën, burimin, ose zbatimin e këtyre fondeve në mënyre që të ardhurat të duket se vijnë nga një burim legjitim. Me pak fjalë, “paratë e pista” janë bërë për të dalë i pastër. Pasi paratë e paligjshme janë pastruar, kryerësi është në gjendje të shpenzojë apo të investojë të ardhurat e paligjshme në asete të ligjshme. Kosova si një vend i dal nga lufta e me specifikat e veta, ka vështirësi në luftimin e ekonomisë joformale ku pjesa më e madhe e transaksioneve kryhet në para të gatshme, pa i përfillur dhe pa kaluar nëpër institucione financiare. Kjo në veçanti paraqet vështirësi në punën e institucioneve që kanë obligim raportimin e transaksioneve. Kësaj i kontribuon po ashtu edhe bashkëpunimi i dobët ndërkombëtar në këtë fushë dhe mosharmonizimi i legjislacionit vendor me Direktivën e BE-së.

Cilët janë faktorët për identifikimin e ekonomisë joformale? Cili është roli i NJIF-it? Ku qëndron raporti i legjislacionit vendor me atë të BE-së?

Trajnimi do të fokusohet në adresimin e këtyre dilemave dhe pyetjeve të ngritura duke analizuar në hollësi legjislacionin vendor dhe atë të BE-së përfshirë dhe praktikën më të mira.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Klasifikojnë veprat penale të shpëlarjes së parave;
- Krahasonë legjislacionin vendor me atë të BE-së;
- Njohin dhe analizojnë punën e institucioneve financiare dhe obligimet që i kanë këto institucione në luftimin e kësaj dukurie;
- Përdorin teknikat e ekzaminimit të mashtrimeve tek pastrimi i parave;
- Njohin format e bashkëpunimit ndërkombëtar;
- Analizojnë paraqitjen e rastit në gjykatë.

Struktura

Struktura e këtij programi realizohet në tri sesione që zgjasin nga dy (2) ditë secili.

Përfituesit

Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Apelit, prokurorët e prokurorive themelore dhe të Apelit dhe të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, zyrtarë policor të departamenteve për luftimin e korrupsionit, Gjyqtarë dhe prokuror të nivelit themelor, prokuroria speciale dhe zyrtar nga Policia e Kosovës.

Përmbajtja

Sesioni I

- Vepra penale e shpëlarjes së parave, financimi i terrorizmit dhe sanksionet;
- Dobësitë e institucioneve financiare tek pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit;
- Luftimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në praktikë;
- Luftimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit - struktura ligjore;
- Njësia për inteligjencë financiare dhe subjektet raportuese.

Kohëzgjatja: Dy ditore

Sesioni II

- Teknikat e ekzaminimit të mashtrimeve tek pastrimi i parave;
- Mbledhja e informatave;
- Përgatitja e profilin personal;
- Gjurmimi i fondeve nga ana e marrësit;
- Gjurmimi i fondeve nga ana e paguesit;
- Rikthim të pasurive të fshehura.

Kohëzgjatja: Dy ditore

Sesioni III

- Bashkëpunimi ndërkufitar dhe ndërkombëtar për luftimin e pastrimit të parave;
- Shkuarja në gjyq - paraqitja e rastit;
- Zgjidhjet e mundshme alternative;
- Masat për parandalimin e pastrimit të parave.

Kohëzgjatja: Dy ditore.

Fusha civile



1.3 Fusha civile

1.3.1 Shqyrtimi paraprak i padisë

Gjykata nga momenti i pranimit të padisë në gjykatë, e deri në marrjen e vendimit meritator lidhur me çështjen e ngritur sipas padisë, duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare nëse padia i plotëson kushtet për të proceduar sipas saj. Shpesh ndodhë që në praktikën gjyqësore të mos i kushtohet rëndësi kësaj faze të procedurës, përkatësisht të mos merren masat e duhura nga gjykata për të verifikuar se a janë plotësuar prezumimet procedurale për zhvillimin e procedurës kontestimore. Shqyrtimi paraprak i padisë është një filtër që i ndihmon gjykatës në eliminimin e të gjitha pengesave, në mënyrë që të vazhdohet me faza të tjera të procedurës dhe të kemi një gjykim më efikas.

Në këtë fazë të procedurës gjykata vlerëson se a janë prezumimet procedurale dhe atë: prezumimet lidhur me gjykatën, palët, dhe me objektin e kontesti si dhe prezumimet lidhur me rregullsinë e padisë.

Cilat prezumime procedurale lidhen me gjykatën, palët, objektin e kontestit dhe rregullsinë e padisë? Cilat veprime dhe vendime duhet t'i merr gjykata varësisht nga të gjeturat e shqyrtimit paraprak të padisë? Si ndikon shqyrtimi paraprak i padisë në procedimin e mëtejshëm gjyqësor?

Trajnimi është hartuar me qëllim që t'ju përgjigjet pyetjeve dhe paqartësive të ngritura më lartë përmes analizës së të gjitha prezumimeve procedurale që duhet të vlerësohen me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Vlerësojnë përmbushjen e prezumimeve procedurale për zhvillimin e drejtë të procedurës kontestimore;
- Identifikojnë vendimet që merren në këtë fazë të procedurës;
- Ndërmarrin veprimet dhe vendimet adekuate në këtë fazë të procedurës;

Përmbajtja

- Vlerësimi i padisë;
- Veprimet e gjykatës në këtë fazë të procedurës;
- Vendimet që merren në këtë fazë të procedurës;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, të përcjella me shembuj praktik dhe diskutime të përbashkëta dhe interaktive.

Përfituesit: Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe bashkëpunëtorët profesional

Kohëzgjatja: Një ditë

1.3.2 Sigurimi i kërkesëpadisë

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë ta gëzojë pasurinë e tij në mënyrë të qetë dhe askush nuk duhet të privohet nga pasuria e tij, përveç kur kjo bëhet për interesin publik dhe në përputhje me kushtet e parashikuara me ligj dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Me rastin e garantimit të drejtave të garantuara pronësore, por edhe të drejtave tjera, caktimi i masave të sigurisë është një mjet i fuqishëm dhe i rëndësishëm në dispozicion të palëve ndërgjyqësore në rastet civile.

Qëllimi i masave të sigurisë është që të mbrohen të drejtat dhe interesat e palëve në rastet pranë gjykatave, duke parandaluar që të ndodhin humbje apo dëme të riparueshme, para se gjykata të merr vendim përfundimtar mbi meritat e padisë. Masa të tilla më së shpeshti propozohen në raste ku përfshihen konteste pronësore, por nuk mungojnë edhe në kontestet sipas padisë për borxhe, si dhe në kontestet familjare. Masat e sigurisë janë një lloj urdhri i gjykatës që ndalon palën që të ketë në dispozicion, apo në ndonjë tjetër mënyrë të disponojë me të mirat e veta, derisa është në pritje vendimi mbi merita të rastit. Ato po ashtu mund të marrin formën e urdhrit që disa të mira të ngrihen, ose si alternativë të konfiskohen në pritje të aktgjykimit.

Kush mund të parashtrojë propozimin për sigurimin e kërkesëpadisë? Në cilën fazë të procedurës mund të paraqitet propozimi? Cilat janë llojet e masave për sigurimin e kërkesëpadisë? Cila gjykata kanë kompetencë për të vendosur lidhur me këto masa? Cilat janë dallimet në mes masave të përkohshme të sigurimit të kërkesëpadisë dhe masave siguruese? Kur duhet të caktohet garancioni?

Nëpërmjet këtij trajnimi synohet që pyetjeve dhe dilemave të parashtruara më lartë t'iu jepet përgjigje adekuate, duke mbështetur profesionistët gjyqësor në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore lidhur me sigurimin e kërkesëpadisë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Vlerësojnë kush mund të parashtrojë propozimin për sigurimin e kërkesëpadisë;
- Në cilën fazë të procedurës mund të paraqitet propozimi;
- Dallojnë llojet e masave për sigurimin e kërkesëpadisë;
- Përcaktojnë kompetencën e gjykatës e cila duhet të vendos lidhur me këto masa;
- Dallojnë masat e përkohshme të sigurimit të kërkesëpadisë nga masat siguruese; dhe
- Vlerësojnë rastet kur duhet të sigurohet garancioni;

Përmbajtja

- Sigurimi i kërkesëpadisë
- Kushtet për caktimin e masave të sigurimit
- Llojet e masave të sigurimit të kërkesëpadisë
- Masat e përkohshme
- Kompetenca për të vendosur për masat e sigurimit të kërkesëpadisë
- Përmbajtja e aktvendimit mbi caktimin e masës së sigurimit.
- Dallimi në mes të masës së përkohshme siguruese dhe masës siguruese
- Garancioni me rastin e caktimit të masës së sigurimit të kërkesëpadisë

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, të përcjella me shembuj praktik dhe diskutime të përbashkëta, në mënyrë që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

Përfituesit: Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe bashkëpunëtorët profesional

Kohëzgjatja: Një ditor

1.3.3 Mënyrat e fitimit të pronësisë dhe mbrojtja e saj

Për fitimin e të drejtës së pronësisë në sendet e luajtshme dhe të pa luajtshme doktrina juridike dhe dispozitat ligjore në fuqi përcaktojnë kushtet dhe mënyrat e fitimit të saj. Ligji në fuqi për pronësisë dhe të drejtat tjera sendore ka risi rreth mënyrave të fitimit të pronësisë që bën dallim nga ligji i mëparshëm.

Çdo cenim i të drejtës së pronësisë, pronarit i jep të drejtë që të kërkoj mbrojtje gjyqësore për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë. Trajtimi i kësaj teme për gjyqësorin shtrohet si domosdoshmëri për shkak të ndryshimeve në legjislacionin vendor dhe standardeve të përcaktuara me protokollin I të KEDNJ.

Si fitohet e drejta e pronësisë në sendet e luajtshme dhe të paluajtshme, sipas legjislacionit në fuqi? Çfarë mbrojtje i jepet të drejtës së pronësisë sipas Kushtetutës, ligjeve dhe akteve ndërkombëtare? Cilat janë autorizimet dhe kufizimet e së drejtës të pronësisë? Ku janë dallimet në mes të padive për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë? Si të bëhet zbatimi në praktikë i dispozitave materiale në rastet konkrete të kontestit pronësor?

Më këtë trajnim synohet të sqarohen të gjitha dilemat që paraqiten në praktikën gjyqësore lidhur me mënyrat e fitimit të drejtës së pronësisë dhe paditë për mbrojtjen e drejtës së pronësisë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij prezantimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zgjerojnë njohuritë për të drejtën e pronësisë, autorizimet, kufizimet si dhe mbrojtjen e saj;
- Dallojnë mënyrat e fitimit të drejtës së pronësisë sipas ligjit në fuqi;
- Krahasojnë llojet e padive për mbrojtjen e pronësisë;
- Zbatojnë praktikën e GJEDNJ-së, lidhur me rastet e mbrojtjes së të drejtës së pronësisë.

Përmbajtja

- Mënyrat e fitimit të drejtës së pronësisë;
- Mbrojtja e të drejtës së pronësisë në përgjithësi;
- Paditë për mbrojtjen e pronësisë;
- Protokollin I të KEDNJ;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj praktik, pjesëmarrje interaktive në trajnim si dhe metoda e prezantimit shkurt me pover-point.

Përfutuesit: Gjyqtarët e gjykatave themelore, të apelit dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditë

1.3.4 Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë

E drejta e pronësisë si një prej të drejtave elementare të njeriut, gëzon mbrojtje në të gjitha sistemet juridike dhe me aktet ndërkombëtare, e veçmas me Protokollin I të KEDNJ. Paditë për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë janë ato tradicionale që janë trashëguar që nga e drejta romake, dhe njohin të gjitha sistemet juridike pozitive. Këto padi janë: Padia e reivindikimit, Padia negatore dhe padia Publiciane, janë padi që mund të paraqiten në rastet kur pronarit të sendit në rastet e caktuara i cenohet e drejta e pronësisë.

Kush ka legjitimitet për ngritjen e këtyre padive? Çka duhet të provoj, paditësi ndaj të paditurit që ka cenuar të drejtën e pronësisë? Çfarë kundërshtime mund të përdor i padituri ndaj paditësit? Cilat janë karakteristikat e padive për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë? A parashkruhet e drejta për ngritjen e këtyre padive? Cilat janë kufizimet e drejtës së pronësisë?

Këto janë disa nga çështjet kryesore që do të trajtohen gjatë këtij trajnimi.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Dallojnë përkufizimet në mes të pronësisë dhe drejtës së pronësisë
- Avancojnë njohuritë lidhur me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ
- Zbatojnë të drejtën fqinjësore
- Zbatojnë dispozitat për imisionet
- Zbatojnë dispozitat për mbrojtjen e pronësisë
- Dallojnë qëllimin dhe specifikat e llojeve të padive

Përmbajtja

- Nocioni i pronësisë
- Pronësia dhe pasuria
- Rëndësia e mbrojtjes së të drejtës së pronësisë
- Paditë për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë
- Kufizimet e të drejtës së pronësisë

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, të përcjella me shembuj praktik dhe diskutime të përbashkëta.

Përfituesit: Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe bashkëpunëtorët profesional

Kohëzgjatja: Një ditor

1.3.5 Mbrojtja gjyqësore nga pengim posedimi dhe servituti

Posedimi është pushteti faktik mbi sendin, pronësia është pushteti juridik mbi sendin. Se një person është pronar në shikim të parë nuk mund të konstatohet, ndërsa si posedues i një sendi menjëherë mund të vërehet sepse këtu kërkohet pushteti faktik mbi sendin. Në të drejtën romake është bërë dallimi në mes të pronësisë dhe posedimit, sipas së cilës ka qenë e domosdoshme të plotësohen dy kushte: pushteti faktik mbi sendin apo Corpus possessiones dhe vullneti që sendin ta mbaj poseduesi si pronari i sendit. Të gjitha kodet civile bëjnë dallimet në mes të posedimit dhe pronësisë.

Të drejtat sendore, pra edhe e drejta e servitutit gëzojnë mbrojtje gjyqësore nga pengimi i të drejtës së servitutit. Servitutet, si të drejta sendore, gëzojnë mbrojtje juridike dhe legjislacioni pozitiv parasheh mënyrën e mbrojtjes së servituteve. Praktika gjyqësore ka dilema rreth padive për mbrojtjen e servituteve dhe çështjet që kanë të bëjnë me vërtetimin e ekzistimit të servitutit sendor dhe konstituimin e tyre.

Kush gëzon mbrojtje gjyqësore nga akti i pengim posedimit dhe te e drejta e shfrytëzimit të servitutit? Çfarë duhet të përmbajë kërkesëpadia për pengim posedimin? Cilat janë faktet që duhet të vërtetohen në kontestet e pengim posedimit dhe të servituteve? Çfarë afati është paraparë në kontestet e pengim posedimit?

Ky trajnim synon të sqaroj të gjitha dilemat që paraqiten në praktikën gjyqësore lidhur me mbrojtjen gjyqësore nga pengim posedimi dhe servituti.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Dallojnë specifikat e kontesteve të pengim posedimit dhe të drejtës së posedimit;
- Dallojnë padinë e pengim posedimit nga paditë tjera;
- Identifikojnë kushtet për mbrojtjen nga akti i pengim posedimit;
- Zbatojnë drejtë afatet për mbrojtje gjyqësore në kontestet e pengim posedimit dhe te servitutet;
- Zbatojnë drejtë praktikën gjyqësore lidhur me këto konteste;

Përmbajtja

- Specifikat në procedurën e kontesteve të pengim posedimit dhe të drejtës së servitutit;
- Elementet e aktit të pengim posedimit dhe servitutit;
- Afatet për mbrojtje gjyqësore në kontestet e pengim posedimit dhe të servitutet;
- Praktika gjyqësore lidhur me këto konteste;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, të përcjella me shembuj praktik, dhe diskutime të përbashkëta, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit.

Përfituesit: Gjyqtarët e Gjykatave Themelore dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditë

1.3.6 Mbrojtja gjyqësore në rastet e fyerjes dhe shpifjes

Sot qarkullojnë definicione apo përkufizime të ndryshme në lidhje me shpifjen. Në disa ligje moderne që rregullojnë të drejtat e njeriut, shpifjen e përkufizojnë si “sulm antiligjor” ndaj “nderit dhe reputacionit” të definuar në nenin 17 nga Pakti Ndërkombëtarë për të Drejtat Qytetare dhe Politike. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk i jep mbrojtje prerazi apo direkte të drejtës së nderit apo reputacionit, por në disa aktvendime të veçanta, pranon mbrojtjen e saj në suaza të privatësisë, jetës familjare dhe pacenueshmërisë së shtëpisë dhe letërkëmbimit nga neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ligji për shpifjen dhe fyerjen, shpifjen e përkufizon “publikimin e një fakti të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër”, ndërsa fyerja përkufizohet “deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese”. Nga fakti se në gjykatat tona ka një numër në rritje të rasteve për shpërblim të dëmit për shpifje dhe fyerje, po në këtë drejtim mungon praktika e gjykatave dhe shtjellimi i kësaj teme, për gjyqtarët do të jetë i nevojshëm.

Cili është nocioni i shpifjes dhe fyerjes? Cilat kushte duhet të plotësohen për ushtrimin e padisë për shpifje dhe fyerje? Një deklaratë apo publikimi i një fakti të vërtetë a mund të llogaritet shpifje? Çfarë forme e dëmit i takon personit të shpifur apo të fyer? Cila është praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me shpifjen dhe fyerjen?

Këto dhe çështje tjera do të adresohen përmes këtij trajnimi.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Dallojnë përgjegjësinë për shpifje dhe fyerje, rastet e përjashtimit të përgjegjësisë dhe kufijtë e përgjegjësisë;
- Zbatojnë drejtë mënyrën e caktimit të shpërblimit të dëmit lidhur me shpifjen dhe fyerjen si dhe
- Njohin praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me shpifjen dhe fyerjen;

Përmbajtja

- Ushtrimi i padisë për shpifje dhe fyerje;
- E drejta për shpërblimin e dëmit jo material në rastin e shpifjes dhe fyerjes;
- Praktika gjyqësore Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj praktik, pjesëmarrje interaktive në diskutime të pjesëmarrësve.

Përfitues: Gjyqtarët e gjykatave themelore, të Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditë

1.3.7 Mbrojtja gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit të Punës

Në vitet e fundit është rritur numri i kontesteve nga marrëdhënia e punës. Shkak për këtë është se legjislacioni në fuqi ka pasur mangësi dhe mbrojtja gjyqësore nuk ka qenë adekuate me ç 'rast i është cenuar e drejta e punëtorit nga marrëdhënia e punës. Si rrjedhojë dispozitat të cilat e kanë rregulluar këtë fushë kanë qenë të shpërndara në shumë ligje dhe rregullore, të cilat janë nxjerr dhe miratuar në rrethana të ndryshme ekonomike, shoqërore dhe politike. Si rezultat i kësaj edhe gjyqtarët kanë pasur dhe kanë vështirësi në zbatimin adekuat të këtyre ligjeve, të cilat i referohen mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Cila është fusha e zbatimit të Ligjit të Punës? Cilat janë llojet e kontratave të punës sipas Ligjit të Punës? Cilat janë shkaqet e ndërprerjes së marrëdhënies të punës sipas Ligjit të Punës? Cila është procedura para ndërprerjes së marrëdhënies të punës nga ana e punëdhënësit? Cilat janë mjetet e punëmarrësit për të siguruar mbrojtje gjyqësore? Cilat janë afatet ligjore për sigurimin e mbrojtjes gjyqësore të kontestet e punës? Cilat janë vendimet gjyqësore të gjykatës në kontestet e punës?

Ky trajnim është dizajnuar dhe strukturuar në mënyrë që të analizojë dhe zbërthej procedurën e filluar nga punëmarrësit në rastet e shkeljeve të detyrave të punës nga ana e punëdhënësit, përfshirë këtu edhe identifikimin e kushteve paraprake të cilat duhet të plotësohen nga kërkuesi para se t'i drejtohet gjykatës me padi për të siguruar mbrojtje gjyqësore në rastet kur i drejtohet gjykatës me padi.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Dallojnë kontestet për shërbyesit civil dhe kontestet e tjera nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës;
- Zbatojnë drejtë dispozitat e ligjit përkatës duke vlerësuar afatet për të kërkuar mbrojtje gjyqësore;

Përmbajtja

- Kontratat e punës dhe llojet e tyre;
- Kontestet nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës;
- Procedura gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të punës;
- Respektimi i afateve për të kërkuar mbrojtje gjyqësore;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, punë në grupe, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfitues: Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Gjykatës së Apelit, si dhe bashkëpunëtorët profesional të gjykatave.

Kohëzgjatja: Një ditor

1.3.8 Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve dhe pjesëtimi i saj

Bashkëshortët, për pos marrëdhënieve personale, gjatë jetës bashkëshortore, krijojnë edhe marrëdhënie pasurore, me ç' rast krijojnë vlera pasurore, të cilat sipas Ligjit për Familjen i Kosovës, emërtohet si pasuri e përbashkët e bashkëshortëve. Bashkëshortët, në martesë janë të barabartë në të gjitha marrëdhëniet personale dhe pasurore, e cila garantohet me Konventën Evropiane për të Drejtat Njeriut, si dhe me protokollin 7 të Konventës, pastaj Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me Ligjin për Familjen i Kosovës.

Çka përbënë pasuri të përbashkët të bashkëshortëve? Çka është pasuri e veçantë e bashkëshortëve? Çka përfshinë kontributi i bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët? Çka duhet të kenë parasysh me rastin e vendosjes për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët?

Këto janë çështjet më aktuale me të cilat ballafaqohen gjykatat gjatë vendosjes dhe zbatimit të legjislacionit për pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve dhe pjesëtimin e saj.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Vlerësojnë pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve, dhe të veçantë të bashkëshortëve.
- Vlerësojnë se çka përfshinë kontributi i bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët,
- Të vendosin në mënyrë të ligjshme dhe të drejtë, në kontestet në mes të bashkëshortëve në rast të mos marrëveshjes për pasurinë e përbashkët.

Përmbajtja

- Pasuria e përbashkët dhe e veçantë e bashkëshortëve;
- Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve;
- Pasuria e krijuar gjatë bashkësisë faktike (jashtëmartesore)
- Vërtetimi i kontributit të bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët
- Administrimi i pasurisë së përbashkët

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj praktik, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit, që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

Përfitues: Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe bashkëpunëtorët profesional

Kohëzgjatja: Një ditë

1.3.9 Shpërblimi i dëmit material dhe jo material dhe praktika gjyqësore

Numri i madh i kontesteve gjyqësore për shpërblimin e dëmit, qoftë të dëmit material apo jo material, praktika gjyqësore jo e harmonizuar sa i përket vendosjes dhe kriterëve për përcaktimin e lartësisë së dëmit jo material, janë indikator që tregojnë se kjo temë është shumë me rëndësi të trajtohet.

Mbrojtja juridiko civile e të mirave dhe ekzistimi i përgjegjësisë juridike civile, është segment i rëndësishëm në kuadër të sigurimit të një niveli më të lartë të mbrojtjes së të mirave njerëzore të mbrojtura juridikisht. Përcaktimi i saktë i përgjegjësisë së shkaktarit të dëmit dhe të realizimit të drejtës së palës së dëmtuar në shpërblimin e dëmit, në marrëdhënien juridike civile jo kontraktuale është një prej sfidave të gjyqtarëve të fushës civile. Ndonëse praktika gjyqësore është relativisht e zhvilluar lidhur me këtë temë, mirëpo numri i madh i rasteve nëpër gjykatat e Kosovës, dinamika e rritjes së numrit të rasteve të paraqitura për shpërblim të dëmit, ka ndikuar që të ketë dallime në praktikën gjyqësore sidomos sa i përket kriterëve për përcaktimin e lartësisë së dëmit material dhe jo material, por edhe mënyra e vërtetimit të gjendjes faktike në këto raste shpesh ka të meta.

Baza e përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit material dhe jo material? Cilat janë kriteret për përcaktimin e lartësisë së dëmit material dhe jo material? Si provohet gjendja faktike në procedurën e shpërblimit të dëmit material dhe jo material? Si të bëhet zbatimi në praktikë i dispozitave materiale në rastet konkrete të kontestit për shpërblimin e dëmit material dhe jo material? Cila është praktika për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jo material?

Tematika e trajnimit është strukturuar në mënyrën që t'iu përgjigjet pyetjeve dhe paqartësive të ngritura më lartë përmes analizës së të gjitha dispozitave materiale juridike që i referohen shpërblimit të dëmit material dhe jo material.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Interpretojnë dhe zbatojnë drejt dispozitat lidhur me përgjegjësinë e dëmit material dhe jo material;
- Zbatojnë kriteret e njëjta në praktikën gjyqësore sa i përket kriterëve dhe lartësisë së dëmit jo material;
- Zbatojnë drejtë dispozitat, lidhur me caktimin e lartësisë për shpërblimin e dëmit material dhe jo material;
- Llogarisin kumatën për dëmin jo material.

Përmbajtja

- Dëmi material dhe jo material sipas LMD-së;
- Përgjegjësia për shpërblimin e dëmit material dhe jo material;
- Kriteret për përcaktimin e lartësisë së dëmit material dhe jo material;
- Mënyra e të provuarit në procedurën e shpërblimit të dëmit material dhe jo material;
- Praktika për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jo material;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, të përcjella me shembuj praktik dhe diskutime të përbashkëta.

Përfitues: Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe bashkëpunëtorët profesional

Kohëzgjatja: Një ditor

1.3.10 Shpronësimi dhe caktimi i kompensimit

Siç dihet instituti juridik i shpronësimit lejon mundësinë që pronari të mund të zhvishet nga e drejta e pronësisë vetëm nën kushtet e parapara me ligj me kusht që shpronësimi të bëhet për qëllim të interesit të përgjithshëm. Meqenëse shpronësimi në praktikë paraqitet shumë shpesh, zbatimi i rregullt i dispozitave ligjore të ligjit për shpronësimin garanton të drejtën pronësore të pronarëve, prona e të cilëve shpronësohet për interes të përgjithshëm publik. Andaj, medoemos është e nevojshme që zbatuesit e këtij ligji të përfitojnë njohuri më të thella, në lidhje me këtë institut juridik, në mënyrë që këto njohuri të kontribuojnë edhe në unifikimin e praktikës gjyqësore në gjykatat e Kosovës.

Kur dhe në çfarë kushte mund të shpronësohet një paluajtshmëri? Cili organ e zhvillon procedurën e shpronësimit? Kush e cakton kompensimin për paluajtshmërinë e shpronësuar? Si caktohet dhe cilat janë kriteret për caktimin e kompensimit për paluajtshmërinë e shpronësuar?

Ky trajnim është dizajnuar dhe strukturuar në mënyrë që të analizojë dhe zbërthej procedurën e shpronësimit, të identifikoj kushtet paraprake për shpronësim, kriteret të cilat zbatohen për shpronësim, si në rastet kur organ shpronësues është komuna, ashtu edhe në rastet kur organ shpronësues është qeveria.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Vlerësojnë kushtet ligjore të cilat duhet të plotësohen për shpronësim;
- Zbatojnë drejtë dispozitat e Ligjit për Shpronësim, kur është në pyetje Qeveria apo Komuna si organ shpronësues; dhe
- Identifikojnë mënyrën dhe kriteret për caktimin e kompensimit në rastet e shpronësimit;

Përmbajtja

- Kushtet ligjore për shpronësim;
- Procedura e shpronësimit në rastet kur organ shpronësues është Qeveria apo Komuna;
- Vendimi preliminar dhe përfundimtar për shpronësim, si dhe mjetet juridike;
- Mënyra dhe kriteret për caktimin e kompensimit në rastet e shpronësimit;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, të përcjella me shembuj praktik dhe diskutime të përbashkëta.

Përfitues: Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe apelit, si dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave që merren me procedurat e kompensimit pranë organit shpronësues dhe bashkëpunëtorët profesional të gjykatave

Kohëzgjatja: Një ditë

1.3.11 Shkaqet e anulimit të kontratave, me theks të veçantë të kontrata e shitjes

Kontrata paraqet një nga burimet më të rëndësishme të detyrimeve dhe njëkohësisht institucionin qendror të komunikimit juridik në mes palëve kontraktuese. Që kontrata të jetë e vlefshme palët kontraktuese duhet të plotësojnë disa nga kushtet e parapara me ligj dhe në rastet kur kontrata është në kundërshtim me rendin publik, dispozitat urdhëruese ose moralin e shoqërisë, atëherë mund të vije deri të nuliteti i kontratës, ndërsa në rast se kontrata është lidhur nga pala me aftësi të kufizuar për të vepruar, apo ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve atëherë vije deri tek rrëzueshmëria e kontratës. Në praktikë ka shumë raste kur palët kontraktuese nuk respektojnë kushtet e parapara për vlefshmërinë e kontratës, për çka edhe trajtimi i kësaj teme do të ndihmonte gjyqtarët në analizimin dhe shtjellimin e shkaqeve në bazë të cilave mund të vije deri të anulimi dhe rrëzueshmëria e kontratës.

Cilat kontrata konsiderohen absolutisht nule, e cilat të rrëzueshme? Mënyra e vendosjes në këto raste? Në cilat raste mund të bëhet konversioni i tyre? Kush mund të kërkojë nulitetin dhe anulimin e kontratës?

Kjo temë është strukturuar në atë mënyrë që të ju jepet përgjigje pyetjeve, lidhur me kushtet të cilat duhet plotësuar për të ardhur deri te anulimi i kontratave dhe rrëzueshmëria e tyre, mënyrën e vendosjes dhe vlerësimi i afateve ligjore në rastet e tilla.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Vlerësojnë kushtet ligjore të cilat duhet të plotësohen për tu konsideruar një kontratë nule dhe e rrëzueshme.
- Identifikohen pasojat e nulitetit dhe anulimit të kontratave
- Zbatojnë drejt dispozitat e Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve që kanë të bëjnë me pavlefshmërinë e kontratave.

Përmbajtja

- Kontratat nule
- Kontratat e rrëzueshme
- Pasojat e nulitetit dhe anulimit të kontratave
- Konversioni

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, punë në grupe, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfitues: Gjyqtarët e Gjykatave Themelore, të Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditor

1.3.12 Parashkrimi sipas dispozitave të LMD-së

Parashkrimi është institut juridik i së drejtës së detyrimeve sipas të cilit kërkesa e kreditorit nuk mund të realizohet përmes rrugës gjyqësore, pra nga aparati i dhunës-gjykatës si organ shtetëror, për shkak të kalimit të kohës brenda të cilës është dashur të parashtrohet padia. Parashkrimi i kërkesave ndodh me qëllim të garantimit të sigurisë juridike, që kreditorët kërkesat e tyre t'i mbrojnë në afat të caktuar sepse mund të ndodh që të bëhet e pa mundur mbrojtja e të drejtave përmes rrugës gjyqësore, për shkak të kalimit të kohës së përcaktuar me ligj.

Parashkrimi, mund të thuhet se konsiderohet njëri ndër institutet më të rëndësishme të së drejtës detyrimore, sepse ai siguron marrëdhëniet juridike detyrimore të jenë më të qëndrueshme. Kreditorët duhet të jenë shumë të kujdesshëm që kërkesat e tyre të realizohen dhe të mos lejohet që parashkrimi të ketë ndikim në marrëdhëniet e tyre detyrimore. Andaj, parashkrimi paraqet një nga mënyrat e shuarjes së detyrimit deri te i cili vjen me sjellje pasive të kreditorit dhe sjellje aktive të debitorit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zgjerojnë njohuritë mbi parashkrimin,
- Llogarisin afatet e parashkrimit, dhe
- Përcaktojnë kohën e rrjedhjes së parashkrimit.

Përmbajtja

- Rregullat e përgjithshme të parashkrimit
- Llogaritja e fillimit, ndërprerjes së parashkrimit dhe rrjedha e parashkrimit
- Heqja dorë nga parashkrimi
- Afatet e parashkrimit për kërkesat e caktuara
- Ndalja e parashkrimit

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, të përcjella me shembuj praktik dhe diskutime të përbashkëta, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit.

Përfitues: Gjyqtarët e gjykatave themelore, apelit dhe bashkëpunëtorët profesional

Kohëzgjatja: Një ditë

1.3.13 Zgjidhja alternative e kontesteve, me theks të veçantë ndërmjetësimi

Aplikimi i formave alternative për zgjidhje të kontesteve, veçanërisht ndërmjetësimi është i një rëndësie të veçantë, pasi që rritë sigurinë juridike dhe mundëson tërheqjen e investimeve të huaja aq të nevojshme për zhvillimin e ekonomik, sepse në botën bashkëkohore të afarizmit bizneset dhe qytetarët, janë të interesuar për t'i zgjidhur kontestet e tyre jashtë procedurave gjyqësore. Kosova në përpjekjet e saj për krijimin e një sistemi juridik bashkëkohor, ka krijuar bazën juridike e cila mundëson zgjidhjen alternative të kontesteve. Trajtimi i kësaj teme është më se i domosdoshëm, pasi që gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës do të mësojnë rreth rregullave të reja kombëtare dhe ndërkombëtare për ndërmjetësim, përparësitë që ka ndërmjetësimi, pasojave ligjore të ndërmjetësimit, roli i gjyqtarëve dhe prokurorëve në referimin e rasteve në qendrat e ndërmjetësimit dhe rolin të ndërmjetësuesve në harmonizimin e qëndrimeve tek palët e përfshira në kontest.

Sa zbatohen procedurat alternative në praktikë? Cilat janë kompetencat e gjykatës për shqyrtimin e vlefshmërisë së marrëveshjes së ndërmjetësimit? Cilat janë përvojat dhe praktikat më të mira të vendeve në rajon në aplikimin e procedurave alternative? Sa është i harmonizuar legjislacioni vendor me atë ndërkombëtar?

Programi është hartuar në atë formë që të adresoj dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktikën gjyqësore aktuale, përmes diskutimeve interaktive dhe shqyrtimit të rasteve praktike.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Aplikojnë zgjidhjet alternative të kontesteve;
- Dallojnë kompetencat e gjykatës dhe të ndërmjetësuesve lidhur me ndërmjetësimin;
- Zbatojnë drejtë legjislacionin që rregullon këtë materie;

Përmbajtja

- Roli dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me referimin e rasteve në ndërmjetësim.
- Roli dhe përgjegjësia që ka ndërmjetësuesi në raport me palët e përfshira në kontest gjatë mbajtjes së seancës të ndërmjetësimit.
- Marrëveshjet për ndërmjetësim.
- Përmbartimi i marrëveshjeve të arritura në procedurën e ndërmjetësimit.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, punë në grupe, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfituesit: Gjyqtarët e Gjykatave Themelore, prokurorët e Prokurorive Themelore, bashkëpunëtorët profesional dhe ndërmjetësuesit.

Kohëzgjatja: Një ditë

1.3.14 Aktgjykimi dhe llojet e aktgjykimit sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore

Ligji për Procedurën Kontestimore për mënyrën meritore të vendosjes së kontesteve gjyqësore ka paraparë disa lloje të aktgjykimeve të cilat mund të nxirren nga gjykata, në rrethana të caktuara dhe me plotësimin e kushteve të veçanta procedurale. Vlerësimi i kushteve specifike për secilin lloj të aktgjykimit nga ana e gjykatave ka krijuar disa dilema të cilat po ndikojnë që në disa raste gjykatat t'i vlerësojnë në mënyrë të gabuar këto kushte, e rrjedhimisht edhe të nxjerrin përfundime përkatësisht aktgjykime me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore.

Cilat janë llojet e aktgjykimeve sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore? Cilat kushte duhet të plotësohen për nxjerrjen e secilit lloj të aktgjykimit? Çka duhet të përmbaj arsyetimi i secilit lloj të aktgjykimit?

Çështje e lartpërmendura që do të trajtohen në këtë trajnim janë ndër pyetjet thelbësore ku do të behën përpjekje që t'ju jepet përgjigje adekuate që ndërlidhen me aktgjykimin si formë e vendosjes meritore në një çështje juridike kontestimore dhe llojeve të aktgjykimeve që mund të nxjerr gjykata në një çështje juridike kontestimore.

Pjesëmarrësit do të kenë mundësi që përmes materialit të ofruar nga trajnuesi, diskutimeve, analizës së rasteve studimore t'i zbërthejnë dhe aplikojnë drejtë dispozitat e procedurës kontestimore lidhur me aktgjykimin dhe llojet e tij.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Vlerësojnë kushtet për nxjerrjen e llojeve të ndryshme të aktgjykimeve;
- Hartojnë drejtë arsyetimin e secilit lloj të aktgjykimit si formë të vendosjes meritore;

Përmbajtja

- Aktgjykimi;
- Llojet e aktgjykimeve dhe kushtet për nxjerrjen e tyre;
- Përmbajtja e aktgjykimit dhe arsyetimi i secilit lloj të aktgjykimit;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, të përcjella me shembuj praktik dhe diskutime të përbashkëta, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit.

Përfituesit: Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe bashkëpunëtorët profesional

Kohëzgjatja: Një ditë

1.3.15 Mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike sipas LPK-së

Me rastin e vendimmarrjes nga ana e gjykatave të instancës më të ulët, jo rrallë ndodhë që të bëhen gabime në aspektin formal dhe material, të cilat mund të kenë ndikim në garantimin e ligjshëm të të drejtave të palëve në procedurën kontestimore. Andaj, përmes shfrytëzimit të mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike, palët mund t'i atakojnë këto vendime dhe të kërkojnë respektimin e kërkesave dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre në këtë procedurë.

Çka duhet të përmbajnë mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike? Cilat janë shkaqet më të shpeshta për paraqitjen e tyre? Cila është procedura e pranimi dhe shqyrtimit të këtyre mjeteve? Cilat janë vendimet që mund t'i marrin gjykatat, lidhur me mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike?

Ky trajnim është dizajnuar dhe strukturuar në mënyrë që të analizojë dhe zbërthejë procedurën e paraqitjes së mjeteve juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme nga ana e palëve të autorizuar, si dhe vendosjen e gjykatave të instancave më të larta rreth këtyre mjeteve.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Analizojnë kushtet ligjore për paraqitjen dhe vendosjen sipas këtyre mjeteve juridike;
- Zbatojnë dispozitat ligjore që i referohen shqyrtimit paraprak të këtyre mjeteve juridike në gjykatën e shkallës së parë;

Përmbajtja

- Procedura e vendosjes me ankesë;
- Procedura e vendosjes sipas revizionit;
- Procedura e vendosjes sipas propozimi për përsëritje të procedurës;
- Raporti në mes revizionit dhe propozimit për përsëritjen e procedurës;
- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe procedura e vendosjes;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, të përcjella me shembuj praktik dhe diskutime të përbashkëta.

Përfitues: Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Gjykatës së Apelit (divizioni civil), si dhe bashkëpunëtorët profesional të gjykatave

Kohëzgjatja: Një ditë

1.3.16 Lejimi i përmbarimit dhe vendosja sipas prapësimit

Ligji i Procedurës Përmbarimore rregullon procedurën përmes së cilës gjykatat dhe përmbaruesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbaruese dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe. Ligji i Procedurës Përmbarimore parasheh prapësimin si mjet juridik me të cilin palët mund të atakojnë vendimin e organit përmbarues, me të cilin është lejuar përmbarimi. Zbatimi i procedurës së përmbarimit nga ana e përmbaruesve privat ka përparësinë e heqjes së përgjegjësisë së menaxhimit të procesit të përmbarimit nga gjyqtarët dhe zyrtarët përmbarues të gjykatave, që shpesh marrin një pjesë të rëndësishme të kohës së tyre.

Si vendos përmbaruesi privat lidhur me zbatimin e përmbarimit? Kush vendos lidhur me prapësimin kundër urdhrit përmbarues? Cila është kompetenca territoriale e përmbaruesve privat dhe gjykatave? Në cilat raste gjykata lejon dhe zbaton përmbarimin?

Programi është hartuar në atë formë që të adresoj dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktiken gjyqësore aktuale, përmes diskutimeve interaktive dhe shqyrtimit të rasteve praktike.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Dallojnë se cilat janë dokumentet përmbaruese dhe dokumentet e besueshme;
- Kategorizojnë dhe vlerësojnë rastet kur përmbarimin e zbaton përmbaruesi privat e kur gjykata;
- Vlerësojnë mjetet juridike në procedurën përmbarimore.

Përmbajtja

- Titujt e përmbarimit-dokumenti përmbarimor dhe dokumenti i besueshëm;
- Kushtet për lejimin e përmbarimit;
- Kompetenca për vendosje lidhur me prapësimin;
- Shkaqet për paraqitjen e prapësimit dhe vendimet e gjykatës lidhur me të;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, punë në grupe, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfitues: Gjyqtarët e Gjykatave Themelore, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, bashkëpunëtorët profesional dhe përmbaruesit privat.

Kohëzgjatja: Një ditë

1.3.17 Përmbartimi i vendimeve gjyqësore në çështjet familjare dhe kontestet e punës

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, është paraparë se procedurën e përmbartimit në shkallë të parë e udhëheqë dhe për të vendos përmbartuesi privat, ndërsa përjashtimisht gjyqtari individual kur me këtë ligj është caktuar se përmbartimin e cakton dhe zbaton gjykata si organ i shkallës së parë. Në kuptim të këtij ligji cilësinë e organit përmbartues e ka përmbartuesi privat dhe gjykata e shkallës së parë, gjë kjo e cila nuk ka qenë e paraparë me ligjet e mëhershme të procedurës përmbartimore. Përmes këtij ligji është synuar që lëndët përmbartimore për shkak të natyrës së tyre urgjente të mund të trajtohen brenda një afati sa më të shkurtër kohor, gjë e cila drejtpërdrejtë do të kishte ndikim pozitiv në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve për realizimin me kohë të kërkesave të tyre.

Kush e ka cilësinë e organit përmbartues në shkallë të parë? Kompetenca dhe detyrat e organit përmbartues të caktuar sipas ligjit? Cilat janë vendimet të cilat i nxjerr organi përmbartues në shkallën e parë? Për cilat raste gjykata kompetente e shkallës së parë ka kompetencë ekskluzive për vendosje sipas propozimit për përmbartim në bazë të dokumentit përmbartues?

Përmbajtja e trajnimit është e strukturuar në atë mënyrë që përmes analizimit të dispozitave ligjore të Ligjit të Procedurës Përmbartimore dhe praktikave të deritanishme gjyqësore, të përgjigjemi pyetjeve dhe heqim dilemat lartcekura.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Vlerësojnë drejtë se për cilat raste gjykata e shkallës së parë ka kompetencë ekskluzive për vendosje sipas propozimit për përmbartim;
- Vlerësojnë se në bazë të cilit dokument përmbartues gjykata e shkallës së parë si organ përmbartues mund të vendos lidhur me propozimin për përmbartim;
- Zbatojnë procedurën e përmbartimit nga organi përmbartues tek rastet e kthimit të punëtorit në punë dhe dorëzimin e fëmijës prindit, personit tjetër apo institucionit të cilit i është besuar fëmija në ruajtje, mbajtje dhe edukim.

Përmbajtja

- Organi përmbartues dhe kompetenca e tij;
- Vendimet e organit përmbartues dhe përmbajtja e tyre;
- Baza juridike për caktimin e përmbartimit tek rastet e kthimit të punëtorit në punë dhe dorëzimit të fëmijës;
- Veprimet e organit përmbartues dhe mënyra e zbatimit të përmbartimit;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara interaktive të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, punë në grupe, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfitues: Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore, bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditë

1.3.18 Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile

Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile është një prej fushave më komplekse e karakterizuar me vështirësi në përcaktimin, eksplorimin dhe aplikimin e ligjit të huaj, përfshirë këtu edhe një numër të çështjeve procedurale, siç janë çështjet e shërbimeve të dokumenteve ndërkufitare, ndihma juridike ndërkombëtare, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore, etj. Secili gjyqtar është ballafaquar njëjtë si me çështje të brendshme ashtu edhe me ato ndërkufitare, dhe si rrjedhojë secili gjyqtar civilist ka nevojë për trajnim në trajtimin e rasteve me element ndërkombëtar.

Si i rregullon legjislacioni vendor çështjet e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në aspektin civil? Cilat janë konventat ndërkombëtare që e rregullojnë këtë çështje? Çfarë parashohin direktivat e BE-së për bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë me element ndërkufitar në çështjet civile?

Programi është hartuar në atë formë që të adresoj dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktikën gjyqësore aktuale, përmes diskutimeve interaktive dhe shqyrtimit të rasteve praktike. Gjithashtu përmes rasteve studimore do të trajtohet praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Avancojnë njohuritë rreth bashkëpunimit juridik ndërkombëtar për çështjet civile;
- Zbatojnë legjislacionin vendor dhe ndërkombëtarë bashkëpunimin ndërkufitar në çështjet civile;

Përmbajtja

- Korniza ligjore vendore për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile;
- Rregulloret e BE-së për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile (Rregulloret Bruksel I, Bruksel II, Rome I si dhe rregulloret Nr. 805/2004, 1393/2007, 650/2012, 4/2009);
- Konventat e Hagës për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, punë në grupe, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit, në përmbushje të objektivave të trajnimit.

Përfitues: Gjyqtarët e gjykatave themelore, bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtar të Ministrisë së Drejtësisë – Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.

Kohëzgjatja: Një ditë

Drejtësia për fëmijë



1.4 Drejtësia për fëmijë

1.4.1 Drejtësia penale për fëmijë

1.4.1.1 Abuzimi seksual dhe veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve

Abuzimi seksual i fëmijëve ka shumë pasoja fizike dhe emocionale tek fëmijët. Kapitulli i veprave penale kundër integritetit seksual ka pësuar ndryshime të theksuara dhe pas hyrjes në fuqi të KPRK, janë paraqitur mjaft vështirësi dhe konfuzione me rastin e aplikimit të këtyre dispozitave ligjore. Zbatimi i drejtë i këtyre dispozitave ligjore, me të vërtetë ka qenë dhe është sfidë për gjyqtarët dhe prokurorët posaçërisht për veprat penale që prekin integritetin seksual të fëmijëve. Fëmijët janë kategoria më e ndjeshme e shoqërisë për të cilët shteti me mekanizmat e tij është i obliguar të kujdeset dhe të ju ofroj mbrojtje.

Cilat janë karakteristikat dalluese të veprave penale kundër integritetit seksual të fëmijëve? Cilat janë veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve sipas Kodit Penal të Kosovës? Këto pyetje dhe të tjera pyetje e dilema do të jenë pjesë e trajtimit të këtij trajnimi.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë procedurën penale kur fëmija është viktimë e veprave penale kundër integritetit seksual;
- Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me procedurën penale kur fëmija është viktimë;
- Dallojnë format e paraqitjes së dhunimit dhe veprave tjera të ngjashme lidhur me integritetin seksual të fëmijëve;

Përmbajtja

- Identifikojnë procedurën penale kur fëmija është viktimë e veprave penale kundër integritetit seksual;
- Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me procedurën penale kur fëmija është viktimë;
- Dallojnë format e paraqitjes së dhunimit dhe veprave tjera të ngjashme lidhur me integritetin seksual të fëmijëve;

Metodologjia e trajnimit

Trajnimi ka për qëllim që të përgjigjet në pyetjet lidhur me këtë çështje duke analizuar dhe sqaruar dispozitat ligjore që e rregullojnë shqiptimin dhe zbatimin e masave të diversitetit. Gjithashtu do të analizohen problemet praktike përmes diskutimeve dhe studimit të rasteve praktike.

Përfituesit: Gjyqtarët dhe prokurorët nga Departamenti për të Mitur i të gjitha niveleve.

Kohëzgjatja: Një ditë.

1.4.1.2 Burgu për të mitur

Dënimi i të miturit me burgim për të mitur, ka për qëllim rehabilitimin dhe zhvillimin e të miturit me anë të edukimit, zhvillimit të aftësive profesionale, zhvillimit të tij personal dhe ndikimit pozitiv, në të me qëllim të parandalimit që ai sërish të kryej vepër penale. Kodi i Drejtësisë për të Mitur e konsideron burgimin e fëmijëve vetëm si masë të fundit dhe sanksionon masa alternative për fëmijët në konflikt me ligjin. Kodi garanton që interesi më i lartë i fëmijës të përcaktohet me kujdes në sistemin e drejtësisë si dhe do ta sjellë sistemin e drejtësisë për të miturit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të cilat rrjedhin ng Konventa për të Drejtat e Fëmijës.

Cilat janë kushtet për shqiptimin e burgut për të mitur? A është e përcaktuar kohëzgjatja e burgut për të mitur? Si ndikon privimi i lirisë në rehabilitimin e të miturit? A mund të parashkruhet ekzekutimi i burgut për të mitur? Këto dhe pyetje e dilema tjera në këtë fushë do të trajtohen në këtë trajnim.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë drejtë dispozitat ligjore lidhur me kushtet për shqiptimin e burgut për të mitur;
- Përcaktojnë kohëzgjatjen e burgut për të mitur;
- Vlerësojnë kriteret për lirim me kusht;
- Zgjerorjnë njohurit lidhur me parashkrimin e ekzekutimit të burgut për të mitur

Përmbajtja

- Kushtet për shqiptimin e burgut për të mitur;
- Kohëzgjatja e burgut për të mitur;
- Parashkrimi i ekzekutimit të burgut për të mitur;

Metodologjia e trajnimit

Tema ka për qëllim që të ofroje njohuritë dhe shkathtësitë adekuate në zbatimin e dispozitave ligjore me rastin e shqiptimit të burgut për të mitur, zgjedhjes së burgut për të mitur, parashkrimit të ekzekutimit të burgut për të mitur në frymën e konventave dhe standardeve ndërkombëtare për mbrojtën e të drejtave të fëmijës

Përfituesit: Gjyqtarët dhe prokurorët nga Departamenti për të Mitur i të gjitha niveleve.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.4.1.3 Masat e diversitetit

Drejtësinë për të mitur në Kosovë e përshkojnë një numër i madh i parimeve, disa prej të cilave janë universale. Ndër parimet e veçanta dhe specifike është që kryerësve të mitur sipas nevojës u shqiptohen masat e diversitetit. Këto masa mund t'i shqiptohen të miturve si kryerës të veprave penale ku Kodi i Drejtësisë për të Mitur, ka përcaktuar edhe kushtet kur të miturit mund ti shqiptohen masat të cilat kanë për qëllim që ndaj të miturit të parandalohet fillimi i procedurës përgatitore për të mitur si dhe mos zhvillohet procedurë penale.

Cilat janë dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur që rregullojnë masat e diversitetit? Cilat janë kushtet ligjore që duhet të plotësohen për shqiptimin e masave të diversitetit? Si të vlerësojnë efektet e zbatimit të masave të diversitetit në praktikë? Me këtë trajnim do të tentohet që ti jepet përgjigje këtyre dilemave dhe dilemave tjera të mundshme.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë drejt dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur që rregullojnë masat e diversitetit;
- Interpretojnë kushtet ligjore për shqiptimin e masave të diversitetit;
- Vlerësojnë efektet e zbatimit të masave të diversitetit në praktikë;

Përmbajtja

- Kuptimi i masave të diversitetit;
- Llojet dhe kushtet ligjore që duhet të plotësohen për shqiptimin e masave të diversitetit;
- Vështrime praktike rreth shqiptimit të këtyre masave nga prokurori apo gjykata;

Metodologjia e trajnimit

Ky trajnim ka për qëllim që të trajtoj çështjet duke analizuar dhe sqaruar dispozitat ligjore që e rregullojnë shqiptimin dhe zbatimin e masave të diversitetit. Trajnimi do të fokusohet në elaborimin e praktikave më të mira lidhur me shqiptimin dhe zbatimin e këtyre masave të cilat shqiptohen në praktik nga prokurori apo gjykata.

Përfituesit: Gjyqtarët dhe prokurorët nga Departamenti për të Mitur i të gjitha niveleve.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.4.1.4 Masat edukative dhe dënimet ndaj të miturve

Fëmijët dallohen nga të rriturit për sa i përket zhvillimit fizik dhe psikologjik, si dhe nga nevojat emocionale dhe edukative. Kur ndaj të miturit shqiptohet ndonjë masë apo dënim, gjykata në radhë të parë merr parasysh interesin më të mirë të të miturit. Gjykata gjithashtu merr parasysh llojin dhe peshën e veprës penale, moshën e të miturit, nivelin e zhvillimit psikologjik, karakterin e tij dhe prirjet, motivet që e nxitën atë të kryejë veprën penale, edukimin e tij në atë fazë, mjedisin dhe rrethanat e jetës së tij, nëse është shqiptuar masë apo dënim më herët dhe rrethanat tjera që mund të ndikojnë në shqiptimin e masës apo dënimit.

Disa nga pyetjet të cilave ky trajnim di iu jep përgjigje janë: cilat janë kushtet të cilat duhet plotësuar që të miturit t'i shqiptohet masa edukuese apo dënimi ndaj të miturit; cilat janë llojet dhe kohëzgjatja e masave edukuese apo dënimeve dhe si të saktësojnë efektet e zbatimit të masave apo dënimeve?

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të marrin njohuri mbi:

- Kushtet të cilat duhet plotësuar që të miturit t'i shqiptohet masa edukuese apo dënimi ndaj të miturit;
- Interpretojnë llojet dhe kohëzgjatjen e masave edukuese apo dënimeve;
- Saktësojnë efektet e zbatimit të masave apo dënimeve;

Përmbajtja

- Llojet e masave edukuese të cilat mund ti shqiptohen të miturve;
- Format e vendimeve që bien gjykata kur shqipton masat edukative apo të dënimeve ;
- Ndryshimi i vendimit për ekzekutimin e masës edukuese;
- Ekzekutimi i masave dhe dënimeve tek rastet ku të miturit janë shtetas të huaj si dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar tek rastet ku kryesit e mitur janë shtetas të huaj;

Metodologjia e trajnimit

Trajnimi ka për synim që të përgjigjet në pyetjet lidhur çështjet praktike duke analizuar dhe sqaruar dilemat në zbatim masave edukative apo të dënimeve. Trajnimi do të fokusohet në elaborimin e praktikave më të mira lidhur me shqiptimin dhe zbatimin e masave edukuese duke përfshirë edhe llojet e dënimeve.

Përfituesit: Gjyqtarët dhe prokurorët nga Departamenti për të Mitur i të gjitha niveleve.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.4.1.5 Masat për sigurimin e prezencës së të miturve në procedurën penale

Masat për sigurimin e pranisë së të miturit në procedurë, shpeshherë nuk janë zbatuar sipas mënyrës dhe kushteve të parapara me ligj, andaj në praktikën gjyqësore ende ka vështirësi në identifikimin, vlerësimin dhe analizimin e rrethanave lidhur me vendosjen për secilën bazë për këto masa. Me qëllim të sigurisë së prezencës së të miturit dhe efikasitetit të procedurës penale, ndaj të miturit mund të caktohen masat e parapara me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Sipas këtij kodi, ndaj të miturit i cili ka rënë ndesh me ligjin mund të urdhërohet arresti i përkohshëm, ndalimi policor, arresti shtëpiak, dorëzania dhe paraburgimi vetëm si masë e fundit për një kohë sa më të shkurtër. Në procedurën ndaj të miturve paraburgimi si masë e fundit shpesh nuk është caktuar sipas mënyrës dhe kushteve të parapara nga KDM.

Për cilat raste caktohen masat për sigurimin e pranisë së të miturit? Cilat janë kushtet të cilat duhet plotësuar për të shqiptuar masat për sigurimin e pranisë së të miturit? Ku janë vështirësitë në identifikimin e rrethanave që e arsyetojnë kërkesën për këto masa dhe që e arsyetojnë caktimin e tyre? Këto pyetje, por jo edhe të vetmet do të shpjellohen në këtë trajnim.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Aplikojnë drejtë rregullat me rastin zgjedhjes së masave për prezencën e të miturit në procedurë;
- Zbatojnë drejtë masën e kufizimit të lirisë;
- Hartojnë dhe arsyetojnë mjaftueshëm vendimet për shqiptimin e këtyre masave;

Përmbajtja

- Masat për sigurimin e pranisë së të miturit në procedurë;
- Rastet kur gjykata cakton masën e paraburgimit për të miturin;
- Kushtet ligjore që duhet plotësuar në rastet e caktimit të këtyre masave

Metodologjia e trajnimit

Përmes këtij trajnimi synohet që përfituesit të mund të analizojnë masat e sigurisë së të pandehurit në procedurë dhe të mund ti tejkalojnë dilemat që paraqiten në praktikën gjyqësore. Gjatë trajnimit do të përdoren prezantime të materialeve në PowerPoint, prezantim i rasteve praktike dhe diskutim aktiv i çështjeve praktike me të cilat preokupohet sistemi gjyqësor në këtë fushë.

Përfituesit: Gjyqtarët dhe prokurorët nga departamenti për të mitur.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.4.1.6 Procedura penale me kryes madhor ku viktimja janë të miturit

Procedura kundër personit që kryen veprë penale kundër të miturit sipas nenit 145 të KDM zbatohet në pajtim me dispozitat e Kodit Procedurës Penale të Kosovës, përveç dispozitave për dhënien e urdhrit ndëshkimor i përcaktuar me dispozitat e Kodit të procedurës penale të Kosovës. Kur zbatohet procedurë për veprë penale e kryer ndaj fëmijës, autoritetet ose institucionet veprojnë me kujdes të posaçëm ndaj fëmijës i cili ka pësuar dëmtime nga vepra penale, duke e pasur parasysh moshën e tij, karakteristikat personale, edukimin dhe ambientin në të cilin jeton ai, në mënyrë që t'iu shmangen pasojave të mundshme të dëmshme për edukimin dhe zhvillimin e tij. Kjo mbrojtje realizohet, duke vepruar me kujdes të posaçëm me qëllim të eliminimit të pasojave, që fëmija (viktimë) ka pësuar gjatë kryerjes së veprës penale.

Cila procedure zbatohet kur madhori kryen veprën penale kundër të miturit ? Cilat janë veprat penale që kryhen ndaj fëmijëve sipas nenit 145 të KDM dhe pyetje e dilema tjera në këtë fushë do të preken në këtë trajnim.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë drejt dispozitat ligjore që zbatohen kur madhori kryen veprën penale kundër të miturit;
- Identifikojnë veprat penale kundër të miturit të cilat janë të rregulluara me nenin 145 të KDM ;
- Dallojnë procedurën penale në rastet kur madhori kryen veprë penale kundër të miturit;

Përmbajtja

- Karakteristikat e procedurës penale në rastet kur madhori kryen veprë penale kundër të miturit;
- Veprat penale të kryera ndaj të miturit (neni 145 të KDM);
- I mituri (fëmija) si viktimë kundër të cilit është kryer veprë penale;

Metodologjia e trajnimit

Ky trajnim ka për qëllim të përgjigjet në pyetjet lidhur me këtë çështje duke analizuar dhe sqaruar dispozitat ligjore që e rregullojnë këtë çështje. Gjithashtu do të analizohen problemet praktike përmes diskutimeve interaktive dhe studimit të rasteve hipotetike.

Përfituesit: Gjyqtarët dhe prokurorët nga Departamenti për të Mitur i të gjitha niveleve.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.4.1.7 Procedura penale ndaj të miturve

Autoritetet ose institucionet që marrin pjesë në procedura gjyqësore që kanë të bëjnë me të miturit, si edhe personat dhe institucionet e tjera nga të cilët kërkohen njoftime, raporte dhe mendime janë të obliguar që të veprojnë shpejt dhe pa vonesa të panevojshme. Po ashtu karakteristikë tjetër është se për t'iu shmangur lëndimit për shkak të publicitetit të tepruar ose etiketimeve, e drejta e fëmijës për privatësi respektohet në të gjitha fazat. Në parim, nuk publikohet asnjë informacion që shpie në identifikimin e kryerësit të mitur që do të thotë se procedura penale që zhvillohet ndaj të miturit që ka rënë ndesh me ligjin është konfidenciale me qëllim të ruajtjes së intimitetit dhe personalitetit të të miturit.

Për cilat vepra penale mund të zhvillohet procedura përgatitore ndaj të miturit ? Cilat janë karakteristikat e procedurës penale që kanë të bëjnë me të miturit? Cila është përbërja e trupit gjykues për të mitur dhe cilat janë karakteristikat esenciale të shqyrtimit gjyqësor kur kemi të bëjmë me të miturin?

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë drejt dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur që rregullojnë procedurën penale për të mitur;
- Dallojnë karakteristikat themelore të procedurës penale;
- Vlerësojnë procedurën penale në rastet kur i mituri kryen vepër penale;

Përmbajtja

- Parimi i Oportunitetit;
- Procedura përgatitore ndaj të miturit;
- Karakteristikat e procedurës penale që kanë të bëjnë me të miturit;
- Përbërja e trupit gjykues për të mitur dhe shqyrtimi gjyqësor;

Metodologjia e trajnimit

Ky trajnim ka për qëllim të përgjigjet në pyetjet lidhur me këtë çështje duke analizuar dhe sqaruar dispozitat ligjore që e rregullojnë këtë çështje. Gjithashtu do të analizohen problemet praktike përmes diskutimeve dhe studimit të rasteve hipotetike.

Përfituesit: Gjyqtarët dhe prokurorët nga Departamenti për të Mitur i të gjitha niveleve.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.4.2 Drejtësia civile për fëmijë

1.4.2.1 Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore – familjare

Numri i kontesteve martesore-familjare vazhdimisht është në rritje e sipër në gjykatat tona. Është me rëndësi të trajtohet kjo temë për arsye se marrëdhëniet martesore-familjare rrjedhimisht kontestet martesore-familjare janë mjaft komplekse për shkak të natyrës së tyre dhe se roli i gjykatës në këto konteste nuk është vetëm shqyrtues por edhe hetues. Krahas analizimit të rolit të gjykatës në kontestet martesore-familjare me rëndësi është edhe elaborimi i temës së rrëmbimit të fëmijëve pasi në vitin 2010 këtë çështje e ka rregulluar me ligj, që është një risi për sistemin tonë gjyqësor.

Cilat janë parimet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas legjislacionit në fuqi? Cili është legjislacioni ndërkombëtar i aplikueshëm në këto raste? Mbi çfarë kritere vendos gjykata? Çfarë vendimesh mund të merr gjykata tek këto konteste? Cili është roli i Organit të Kujdestarisë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore?

Ky program është hartuar me qëllim që të përgjigjet në të gjitha pyetjet dhe dilemat, duke analizuar legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar mbi çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore–familjare.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë mbrojtje efikase dhe efektive të të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit;
- Interpretojnë dhe zbatojnë drejtë ligjin me rastin e besimit, ruajtjes dhe kujdesit të fëmijëve;
- Vendosin për alimentacion duke respektuar drejtshmërinë;

Përmbajtja

- Parimet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtarë;
- Kriteret që merr për bazë gjykata në rastet e besimit të fëmijëve;
- Parimet për përcaktimin e alimentacionit;
- Roli aktiv që duhet të ketë gjykata në këto çështje/konteste;
- Rrëmbimi ndërkombëtar i fëmijëve në çështjet civile-procedura;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, punë në grupe, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfituesit: Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, gjyqtarët e gjykatave themelore, bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët e Organit të Kujdestarisë.

Kohëzgjatja: Dy ditë

1.4.2.2 Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre

Detyrimi i shtetit që të përdor mekanizmat e tij që të kujdeset për krijimin e kushteve për mirëritjen dhe mirëqenien e fëmijëve dhe nga aktet ndërkombëtare të cilat janë të miratuara nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtave të fëmijëve në veçanti, por edhe nga infrastruktura ligjore e miratuar nga vet shtetet veç e veç.

Kush ka të drejtë të parashtrojë padinë në gjykatë për vërtetimin e atësisë dhe amësisë së fëmijës dhe padinë për kundërshtimin e atësisë apo amësisë? A është i lidhur me afat parashtrimi i padisë për çështjet e cekura më lartë? Cilat janë efektet e njohjes apo kundërshtimit të atësisë/amësisë në raport me fëmijën? Cili është legjislacioni i zbatueshëm në rastet e cekura më lartë? Cili është roli i Organit të Kujdestarisë në procedurën gjyqësore në rastet e ndryshimit të statusit të tyre?

Ky program është hartuar me qëllim që të përgjigjet në të gjitha pyetjet dhe dilemat, duke analizuar legjislacionin vendor dhe ndërkombëtarë mbi çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë dispozitat ligjore lidhur me atësinë dhe amësinë;
- Zbatojnë parimin e interesit më të lartë të fëmijës;
- Aplikojnë drejtë mënyrat dhe metodat e komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurën gjyqësore.

Përmbajtja

- Amësia dhe atësia;
- Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në procedurën e kundërshtimit dhe vërtetimit të atësisë apo amësisë;
- Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e dhunës në familje;
- Parimi i interesit më të lartë të fëmijës;
- Mënyrat dhe metodat e komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, punë në grupe, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfitues: Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, gjyqtarët e gjykatave themelore, bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët e Organit të Kujdestarisë dhe mbrojtësit e viktimave.

Kohëzgjatja: Dy ditë

1.4.2.3 Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror

Kosova është një nga shtetet e cila është angazhuar mjaftë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve fillimisht duke sanksionuar në Kushtetutë se krahas marrëveshjeve dhe instrumenteve tjera ndërkombëtare edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës zbatohet drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet. Në këtë program ndër të tjera do të trajtohen çështjet rreth mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror, si dhe për format e mbrojtjes së veçantë të këtyre fëmijëve (adoptimin, kujdestarinë etj.), të cilat janë të normuara me Ligjin për Familjen, duke pasur si referencë Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Gjithashtu do të flitet rreth mënyrës dhe metodave të komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore, rreth parimit të interesit më të lartë të fëmijës, rolit të gjykatës dhe organit të kujdestarisë në procedurat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror, si dhe legjislacionit të zbatueshëm vendor dhe atij ndërkombëtarë.

Kush konsiderohet fëmijë pa përkujdesje prindërore sipas ligjit të zbatueshëm? Cilat janë format e veçanta për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror? Cilat janë kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen për tu lejuar adoptimi i fëmijës? Cila është procedura ligjore që duhet të ndiqet nga prindi adoptues për të adoptuar një fëmijë? Cila gjykatë ka kompetencë lëndore për të themeluar adoptimin? A mund të adoptohen fëmijët shtetas të Kosovës nga shtetasit e huaj? Cilat janë aktet ndërkombëtare që zbatohen në procedurën e themelimi të adoptimit?

Ky program është hartuar të përgjigjet në pyetjet dhe dilemat, duke analizuar legjislacionin e zbatueshëm që i referohet procedurës gjyqësore për dhënien e mbrojtjes juridike për të drejtat e fëmijëve pa përkujdesje prindërore.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë dispozitat ligjore mbi adoptimin;
- Zbatojnë kriteret e vendosjes së fëmijës në familje tjetër;
- Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore mbi kujdestarinë, të drejtën prindërore në frymën e parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Përmbajtja

- Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror;
- Adoptimi;
- Vendosja e fëmijës në familjen tjetër;
- Kujdestaria;
- Ushtrimi, pezullimi, kufizimi, heqja dhe vazhdimi i të drejtës prindërore;
- Mënyrat dhe metodat e komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, punë në grupe, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfitues: Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, gjyqtarët e gjykatave themelore, bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët e Organit të Kujdestarisë.

Kohëzgjatja: dy ditore

Fusha Ekonomike



1.5 Fusha Ekonomike

1.5.1 Kontrata e ndërtimit

Kontratat mbi ndërtimin dhe Kontrata për zhvillimin e projekteve ndërtimore (inxhinjeringu) aktualisht kanë gjetur përdorim shumë të madh në fushën e ndërtimit duke pasur parasysh fazën e rindërtimit të vendit. Po ashtu kontratat e ndërtimit në sektorin publik kanë një përdorim të gjerë. Shoqëritë tregtare gjatë zhvillimit të biznesit në sferën ndërkombëtare shpesh aplikojnë kontratat për të cilat zbatohet Konventa për shitje ndërkombëtare të mallrave.

Këto kontrata kanë specifika të veçanta dhe kërkojnë njohuri të veçantë me rastin e zbatimit dhe interpretimit të dispozitave kontraktuese, andaj kërkojnë njohuri të posaçme, jo vetëm juridike por edhe nga fushat që mbulojnë këto kontrata, për zgjidhjen e kontesteve që lindin nga raporti afarist i krijuar përmes këtyre kontratave. Në praktikën gjyqësore numri i kontesteve që rrjedhin nga këto kontrata është i konsiderueshëm, me tendencë të rritjes, prandaj trajtimi i kësaj sfere është në interes të madh.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Rrisin ekspertizën profesionale për ta kuptuar Kontratën e ndërtimit, specifikat e saj, klauzolat e posaçme dhe karakteristikat tjera;
- Krijimi i praktikës gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane;
- Njohuri lidhur me përvojat dhe praktikat më të mira të shteteve në rajon;
- Aplikimi i instrumenteve ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë;

Përmbajtja

- Kuptimi i kontratës mbi ndërtimit dhe kontratës për inxhinieringun dhe specifikat e tyre;
- Karakteristikat e kontratës publike të ndërtimit dhe specifikat e tyre;
- Kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të kontratës;
- Klauzola “çelësi në dorë”;
- Ndryshimet e çmimeve për shkak të ndryshimeve në treg;
- Procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve afariste, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e këtyre kontratave;
- Mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të elementeve specifike në rastet të pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së këtyre kontratave;
- në rastet të pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së këtyre kontratave;

Metodologjia e trajnimit

Ky trajnim do të aplikojë një metodologji intera-ktive të të mësuarit e cila përbëhet prej ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve dhe do të përfshijë, trajtimin teorik të kontratave specifike, prezantim i rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore. Gjithashtu diskutim për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete, diskutim-bashkëbisedim, dhënie e ideve me qëllim që të arrihet që të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktiv gjatë gjithë kohës duke e dhënë kontributin e tyre më parashtrimin e pyetjeve, ofrimin e zgjidhjeve dhe opinionëve.

Përfituesit: Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Administrative të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit.

Kohëzgjatja: Një ditë.

1.5.2 Kontrata e sigurimit

Sigurimet luajnë një rol tepër të rëndësishëm jo vetëm në jetën e individëve, por edhe në aspektin ekonomik e politik të një vendi. Në kohën e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe qarkullimit të lirë të mallrave sigurimet paraqiten si komponentë e domosdoshme për tu mbrojtur nga dëmet eventuale që mund të lindin.

Për trajtimin e duhur të rasteve të sigurimit, kërkohen njohuri të mjaftueshme jo vetëm në aspektin e trajtimit të dëmeve që lindin nga rastet e siguruar por edhe njohuri lidhur me natyrën e sigurimeve, specifikat e kontratave të sigurimit, mënyrën e lidhjes dhe interpretimit të tyre, procedurën e trajtimit të dëmit si dhe mënyrat e vlerësimit të dëmit në aspektin e përgjegjësisë dhe kompensimit adekuat. Meqenëse në praktikën gjyqësore numri më i madh i kontesteve paraqiten nga sfera e dëmeve të shkaktuara në komunikacion, fokusi i trajnimit do të jetë siguri i detyrueshëm nga auto-përgjegjësia e duke përfshirë edhe mënyrat e trajtimit të dëmit, kompensimin e dëmit, bazat e përgjegjësisë dhe regresimin në rastet e sigurimeve “kasko”.

Objektivat

- Rritja e ekspertizës profesionale të gjyqtarëve në fushën e sigurimeve, specifikat e saj, klauzolat e posaçme dhe karakteristikat tjera;
- Krijimi i praktikës gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane;
- Aplikimi në praktikë i përvojave dhe praktikave me të mira të shteteve në rajon;
- Aplikimi i instrumenteve ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë;

Përmbajtja

- Qëllimet dhe rëndësia e sigurimeve;
- Specifikat e kontratës së sigurimit – kushtet e përgjithshme dhe të veçanta;
- Procedurat për kompensimin e dëmit jashtë procedurës gjyqësore;
- Procedura gjyqësore për kompensimin e dëmit;
- Bazat e përgjegjësisë në rastet e shkaktimit të dëmit;
- Llojet e kompensimit adekuat në rastet e dëmeve të paraqitura;
- Regresimi i dëmit në rastet e sigurimeve “Kasko”;

Metodologjia e trajnimit

Në këtë trajnim do të aplikohet metodologji inter-aktive të të mësuarit e cila përbëhet prej ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve dhe do të përfshijë: trajtimi teorik i sigurimeve, prezantim i rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritorie për rastet konkrete. Materiali i trajnimit i cili do t’iu shpërndahet përfshinë: komente, shënime, prezantime, shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore në lidhje me falimentimin dhe shembuj të cilët ilustrojnë zbatimin e këtyre rregullave.

Përfituesit: Gjyqtarët e Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme të Kosovës, me theks të veçantë gjyqtarët të cilët vendosin në çështje ekonomike.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.5.3 Kontratat në ekonomi

Në ekonominë e tregut bizneset e zhvilluara të cilat merren me veprimtari specifike, përdorin kontrata specifike për afarizmin e tyre, të cilat dallojnë si për nga struktura ashtu edhe nga të drejtat dhe detyrimet që krijojnë për palët.

Kontratat e franshizës, asignacionit, lizingut, know-how, licencën, etj., kanë gjetur përdorim në fushën e afarizmit. Po ashtu kontratat publike kanë një përdorim të gjerë në sferën publike. Ndërsa shoqëritë tregtare gjatë zhvillimit të biznesit në sferën ndërkombëtare shpesh aplikojnë kontratat për të cilat zbatohet Konventa për shitje ndërkombëtare të mallrave,

Këto kontrata kanë specifika të veçanta dhe kërkojnë njohuri të veçantë me rastin e zbatimit dhe interpretimit të dispozitave kontraktuese andaj kërkojnë njohuri të posaçme jo vetëm juridike por edhe nga fushat që mbulojnë këto kontrata, për zgjidhjen e kontesteve që lindin nga raporti afarist i krijuar përmes këtyre kontratave.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë kontratën e franshizës, asignacionit, lizingut, know-how, licencën, etj., dhe specifikat e tyre;
- Kuptimi i kontratës se garancionit për ekzekutimin e kontratës;
- Kuptimi i kontratës për shitje ndërkombëtare të mallrave dhe specifikat e tyre;
- Konventa ndërkombëtare për shitjen e mallrave, karakteristikat dhe zbatimin e saj në Kosovë;

Përmbajtja

- Kontrata franshizës dhe karakteristikat e saj;
- Kontrata e asignacionit dhe karakteristikat e saj;
- Kontrata lizingut dhe karakteristikat e saj;
- Kontrata për know-how dhe karakteristikat e saj;
- Kontrata për licencën dhe karakteristikat e saj;
- Kontratat e garancionit për ekzekutimin e kontratës;
- Konventa ndërkombëtare për shitjen e mallrave, karakteristikat dhe zbatimin e saj në raportet afariste me element të huaj;
- Procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve afariste, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e këtyre kontratave;
- Mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të elementeve specifike në rastet të pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së këtyre kontratave;

Metodologjia e trajnimit

Ky trajnim do të aplikojë një metodologji inter-aktive të të mësuarit e cila përbëhet prej ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve, ku do të përfshijë edhe trajtimin teorik të kontratave specifike, prezantim i rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritorie për rastet konkrete, diskutim-bashkëbisedim, dhënie e ideve me qëllim që të arrihet që të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktiv gjatë gjithë kohës duke e dhënë kontributin e tyre në parashtrimin e pyetjeve, ofrimin e zgjidhjeve dhe opinioneve.

Përfituesit: Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit si dhe prokurorët e Prokurorive Themelore dhe të Apelit të cilët merren me procedimin e çështjeve nga krimet financiare.

Kohëzgjatja: Dy ditore.

1.5.4 Trajtimi praktik i kontratës për kredisë

Kontratat e kredisë kanë përdorim të gjerë në jetën shoqërore dhe kanë gjetur përdorim shumë të madh në fushën ekonomike të vendit, sepse shoqëritë tregtare gjatë zhvillimit të biznesit të tyre e sigurojnë kapitalin për financimin e projekteve të tyre, kryesisht përmes kredive nga Institucionet financiare.

Këto kontrata kanë specifika të veçanta dhe kërkojnë njohuri të veçanta gjatë zbatimit dhe interpretimit të dispozitave kontraktuese andaj kërkojnë njohuri të posaçme, jo vetëm juridike por edhe nga fushat që mbulojnë këto kontrata. Për më tepër tregu financiar në Republikën e Kosovës në vazhdimësi ka pësuar ndryshime thelbësore çka ka pasuar edhe me ndryshim legjislativ në këtë fushë. Për të mundur përditësimin e njohurive të gjyqtarëve me ndryshimet legjislative dhe aplikimin e tyre në kontestet që paraqiten në gjykata, është i nevojshëm trajnimi i vazhdueshëm në këtë fushë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi tek pjesëmarrësit do të arrihet:

- Rritja e ekspertizës profesionale të gjyqtarëve për ta trajtuar Kontratën e kredisë, specifikat e saj, klauzolat e posaçme dhe karakteristikat tjera;
- Krijimi i praktikës gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane;
- Njohuri lidhur me përvojat dhe praktikat më të mira të shteteve në rajon;
- Aplikimi i instrumenteve ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë;

Përmbajtja

- Kuptimi i kontratës së kredisë dhe elementet e saj;
- Karakteristikat e kontratës së kredisë dhe specifikat e saj;
- Klauzolat e posaçme lidhur me kamatat dhe llogaritjen e tyre;
- Klauzolat e veçanta për kamatëvonesën dhe penalitetet;
- Kthimi i parakohshëm i kredisë dhe pasojat juridike;
- Mjetet e sigurimit të përmbushjes së kredisë – Pengu dhe Hipoteka;
- Ndryshimet e çmimeve për shkak të ndryshimeve në treg;
- Procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e këtyre kontratave;
- Mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të elementeve specifike në rastet e pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së dispozitave të veçanta kontraktuese;

Metodologjia e trajnimit

Në këtë trajnim do të aplikohen metodologji inter-aktive e të mësuarit e cila përbëhet prej ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve dhe do të përfshijë, trajtimin teorik të kontratave specifike, prezantim i rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore, të gjitha këto që të jepen përgjigje dilemave dhe paqartësive të cilat lindin në praktikën gjyqësore.

Përfituesit: Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Administrative të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit.

Kohëzgjatja: Një ditorë

1.5.5 Shkëputja e kontratës dhe efektet e shkëputjes

Edhe pse palët i lidhin kontratat në bazë të vullnetit të tyre më qëllim të përmbushjes dhe realizimit të qëllimit për të cilin i lidhin, megjithatë në praktikë gjatë implementimit të kontratave paraqiten situata të ndryshme të cilat imponojnë shkëputjen e kontratave respektivisht pamundësojnë përmbushjen e tyre. Te disa kontrata na paraqiten edhe dispozita nule të cilat nuk krijojnë efekte juridike ndaj palëve kontraktuese.

Mos përmbushja e kontratës, shkëputja e saj dhe nulimi i dispozitave kontraktuese, krijon pasoje juridike për palët kontraktuese të cilat shpesh bëhen objekt shqyrtimi në procedura gjyqësore. Këto pasoja janë të theksuara në sektorin ekonomik sepse kompanitë gjatë operimit të tyre për shkak të shkëputjes së kontratës mund të pësojnë dëme të natyrave specifike, si fitimi i humbur, dëmi ndaj palëve të treta, kompensimi i penalteteve ndaj kontraktorëve tjerë, etj. Prandaj trajtimi i këtyre rasteve kërkon njohuri specifike, jo vetëm të ligjeve materiale por edhe të specifikave të operimit në fushën ekonomike.

Në praktikën gjyqësore numri i kontesteve të kësaj natyre, sidomos në sferën e qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, është i konsiderueshëm me tendencë të rritjes, prandaj trajtimi i kësaj teme është i një rëndësie të veçantë.

Objektivat

- Rritja e ekspertizës profesionale të gjyqtarëve në sferën kontraktuale;
- Pasojë juridike për palët kontraktuese në rastet e mos përmbushjes së kontratës, shkëputjes së kontratës dhe nulimin e dispozitave kontraktuese;
- Specifikat e shkëputjes, klauzolat e posaçme dhe karakteristikat tjera;
- Krijimi i praktikës gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane;
- Aplikimi në praktikë i përvojave dhe praktikave me të mira të shteteve në rajon;
- Aplikimi i instrumenteve ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë;

Përmbajtja

- Karakteristikat e kontratave në ekonomi dhe detyrimet kontraktuese;
- Mos përmbushja e plotë dhe mos përmbushja e pjesshme e kontratës;
- Kushtet specifike të kontraktuara në rast të mos përmbushjes së kontratës;
- Të drejtat e palëve në rast të mos përmbushjes së kontratës;
- Pasojat juridike në rast të shkëputjes së kontratës;
- Pasojat juridike në rast të nulitetit të dispozitave kontraktuese;
- Llojet e kompensimit për shkak të mos përmbushjes së kontratave në ekonomi;
- Mënyra e llogaritjes së lartësisë së kompensimit;
- Procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve afariste, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e këtyre kontratave;
- Mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të elementeve specifike në rastet të pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së këtyre kontratave;

Metodologjia e trajnimit

Ky kurs do të aplikojë një metodologji interaktive të të mësuarit e cila përbëhet prej ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve dhe do të përfshijë, trajtimin teorik të kontratave specifike, prezantim i rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritorie për rastet konkrete, diskutim-bashkëbisedim, dhënie e ideve, me qëllim që të arrihet që të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktiv gjatë gjithë kohës duke e dhënë kontributin e tyre më parashtrimin e pyetjeve, ofrimin e zgjidhjeve dhe opinionëve.

Përfituesit: Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Administrative të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit.

Kohëzgjatja: Një ditë.

1.5.6 Të drejtat e pronësisë industriale – Markat tregtare

Markat tregtare janë kategori e rëndësishme nga të drejtat e pronësisë intelektuale që luajnë rol të rëndësishëm në ekonominë e tregut, pasi që ndërmarrjet gjatë zhvillimit të afarizmit të tyre përdorin markat tregtare me qëllim të dallimit të produkteve dhe shërbimeve të tyre nga produktet dhe shërbimet e të tjerëve, si dhe për mbrojtjen e produkteve të tyre.

Mbrojtje e markave tregtare garantohet me Ligjin për Markat Tregtare, Kodin Penal si dhe me masat tjera administrative duke përfshirë ato doganore, megjithatë në praktikën juridike hasen vështirësi të shumta në zbatimin e dispozitave ligjore dhe ofrimin e mbrojtjes efektive.

Në praktikën gjyqësore numri i kontesteve që rrjedhin nga markat tregtare është i konsiderueshëm, me tendencë të rritjes, prandaj trajtimi i kësaj teme është i një rëndësie të veçantë për rritur njohuritë në trajtimin e rasteve.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të kuptojnë:

- Kuptimin e markës tregtare dhe nevojën për mbrojtje juridike;
- Llojet e markave tregtare dhe mbrojtja juridike që ato gëzojnë;
- Të drejtat e titullarëve të markave tregtare;
- Mënyrat e regjistrimit dhe humbja e të drejtës nga marka tregtare;
- Procedurat ligjore dhe aplikimin e tyre në mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga markat tregtare;
- Mënyrat dhe kriteret e vlerësimit në rastet kur titullari pretendon për shkelje të markës së tij tregtare;

Përmbajtja

- Kuptimi i markave tregtare;
- Markat Tregtare si identifikues i burimit - llojet: individuale, kolektive, e kualitetit, e rezervuar, defanzive;
- Markat Tregtare sipas spektrit të dallueshmërisë - llojet: imagjinare, sugjeruese, përshkruese, gjenerike;
- Kushtet e regjistrimit të markës tregtare dhe mbrojtja juridike që gëzojnë;
- Të drejtat dhe detyrimet e pronarëve të markave tregtare;
- Mbrojtja gjyqësore dhe procedura për mbrojtjen e markave tregtare;
- Kriteret e vlerësimit të shkeljes së markës tregtare;
- Humbja e të drejtës nga marka tregtare “pas shitjes së parë” të produktit;

Metodologjia e trajnimit

Trajtimi teorik i Markave Tregtare dhe të drejtat që derivojnë nga ato. Prezantim i rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete. Diskutim-bashkëbisedim, dhënie e ideve, me qëllim që të arrihet që të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktiv gjatë gjithë kohës duke e dhënë kontributin e tyre më parashtrimin e pyetjeve, ofrimin e zgjidhjeve dhe opinionëve.

Materiali i trajnimit i cili do t'ju shpërndahe përfshinë komente, shënime, prezantime, dhe shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore në lidhje me temën, si dhe shembuj të cilët ilustrojnë zbatimin e këtyre rregullave.

Përfituesit: Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarët dhe Prokurorët nga lëmi penale të cilët i procedojnë lëndë të natyrës së krimit financiar me theks markat tregtare.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.5.7 Të drejtat e pronësisë intelektuale – të drejtat e autorit

E drejta e autorit gjithnjë e më tepër po tregohet si një faktor i rëndësishëm zhvillimor në ekonominë e tregut dhe zhvillimin ekonomik të vendit, prandaj respektimi dhe zbatimi i drejtës së autorit është i një rëndësie të veçantë. Përveç zhvillimit ekonomik zbatimi i drejtës së autorit ndikon po ashtu në stimulimin e krijimtarisë kulturore dhe kreative. Sistemi ekonomik dhe sistemi i mbrojtjes së të drejtës së autorit janë tregues i zhvillimit ekonomik të një vendi.

Edhe pse në Kosovë ekziston infrastruktura ligjore për mbrojtjen e të drejtës së autorit, si në aspektin civil ashtu edhe penal, megjithatë ende nuk është arritur që të krijohen mekanizma funksional për parandalimin e shkeljes së kësaj të drejte, andaj rrjedhimisht titullarëve të këtyre të drejtave të vetmen mundësi të mbrojtjes efektive të së drejtave e kanë mbrojtjen gjyqësore. Si rezultat i të cekurave, në gjykatë janë paraqitur një numër i caktuar i rasteve por ky numër pritet të rritet shumë në të ardhmen e afërt. Prandaj trajtimi i kësaj teme, është e një rëndësie të veçantë për të rritur njohuritë e pjesëmarrësve dhe krijimin e praktikave uniforme në trajtimin e rasteve.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të kuptojnë:

- Kuptimi i të drejtave të autorit dhe autorizimet e titullarit të së drejtës;
- Mbrojtja juridike në aspektin civil dhe penal;
- Mbrojtja alternative e të drejtave të autorit – shoqatat profesionale;
- Procedura gjyqësore për mbrojtjen e të drejtës së autorit;
- Kontrata për bartjen e të drejtës së autorit;

Përmbajtja

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të kuptojnë se:

- Çka përfshin e drejta e autorit;
- Të vlerësojnë pretendimet për shkelje të së drejtës së autorit;
- Procedurat ligjore dhe aplikimin e tyre në mbrojtjen e kësaj të drejte;
- Mënyrat dhe punët juridike për bartjen e së drejtës së autorit nga një titullar në tjetrin;

Metodologjia e trajnimit

Trajnimi do të përfshijë, trajtimin teorik të drejtave të autorit. Prezantimin e rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritorie për rastet konkrete. Diskutim-bashkëbisedim, dhënie e ideve, me qëllim që të arrihet që të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktiv gjatë gjithë kohës duke e dhënë kontributin e tyre më parashtrimin e pyetjeve, ofrimin e zgjidhjeve dhe opinionëve.

Materiali i trajnimit i cili do t'ju shpërndahet përfshinë komente, shënime, prezantime, dhe shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore në lidhje me temën, si dhe shembuj të cilët ilustrojnë zbatimin e këtyre rregullave.

Përfituesit: Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarët dhe Prokurorët nga lëmi penale të cilët i trajtojnë çështjet e të drejtës së autorit.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.5.8 Ligji për shoqëritë tregtare

Shoqëritë tregtare janë bartës i zhvillimit ekonomik në vendet me ekonomi të tregut. Kosova në përpjekjet e saj për zhvillim ekonomik ka ndërmarrë masa të ndryshme për të siguruar infrastrukturën e nevojshme për krijim e parakushteve për zhvillimin e biznesit. Në këtë drejtim Kosova ka miratuar Ligjin për shoqëritë tregtare i cili përbën një bazament të mirë për krijimin e një ekonomie të tregut dhe mundësimin e investime të huaja në Kosovë. Ky ligj përcakton llojet e shoqërive tregtare, kushtet e regjistrimit, themelimin dhe shuarjen e shoqërive, të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, zyrtarëve të shoqërive tregtare, përfaqësuesve të tyre.

Në praktikën gjyqësore numri i kontesteve që rrjedhin nga veprimtaria afariste e shoqërive tregtare është i konsiderueshëm, me tendencë të rritjes, prandaj trajtimi i kësaj teme, është e një rëndësie të veçantë për rritur njohuritë e gjyqtarëve në trajtimin e rasteve.

Objektivat

Rritja e ekspertizës profesionale të gjyqtarëve për të kuptuar:

- Llojet e Shoqërive tregtare, specifikat e tyre, dhe karakteristikat tjera;
- Kapaciteti dhe struktura juridike e shoqërive tregtare;
- Kushtet e regjistrimit, themelimit dhe shuarjes së shoqërive tregtare;
- Të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, zyrtarëve të shoqërive tregtare, përfaqësuesve të tyre dhe personave të tretë;
- Krijimi i praktikës gjyqësore në trajtimin e rasteve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane;

Përmbajtja

- Qëllimet kryesore të ligjit dhe fushëveprimin e tij;
- Mënyrat e themelimit dhe shuarjes së shoqërive tregtare dhe pasojat juridike që krijojnë;
- Mënyrat e organizimit, struktura e kapitalit, dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, zyrtarëve të shoqërive tregtare, përfaqësuesve të tyre dhe personave të tretë;
- Procedurat ligjore dhe aplikimin e tyre në mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga shoqëritë tregtare;

Metodologjia e trajnimit

Metodologjia e kursit përfshinë prezantime të cilat orientohen dhe përdorin si shembuj raste konkrete dhe hipotetike. Kjo metodologji bazohet në ushtrime, diskutime, simulime, dhe aktivitete të përpiluara për aplikimin e koncepteve të strukturave afariste në situata praktike. Materiali i kursit i cili do t'iu shpërndahet përfshinë komente, shënime, prezantime, dhe shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore në lidhje me shoqëritë tregtare, si dhe shembuj të cilët ilustrojnë zbatimin e këtyre rregullave.

Përfituesit: Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.5.9 Procedura e Falimentimit të shoqërive tregtare

Ligji i ri për falimentimin u shfaq si nevojë e domosdoshme për rregullimin e procedurës së likuidimit dhe riorganizimit të shoqërive tregtare, pasi ligji i mëparshme ishte i pakompletuar, mbështetej në rregullore të cilat asnjëherë nuk ishin shpallur dhe si pasojë ky ligji u bë i pazbatueshëm. Ligji i ri për falimentimin përbën ligj gjithëpërfshirës mbi falimentimin dhe josolvencën, i cili i pasqyron praktikën më të mirë ndërkombëtare, por përmban shumë institute dhe specifika tjera të cilat pothuajse ishin të panjohura në sistemin tonë juridik.

Ky ligj rregullon procedurat e likuidimit dhe riorganizimit të të gjitha shoqërive tregtare, duke përfshirë edhe bizneset individuale, ortakëritë dhe shoqëritë komandite, që përbën ndryshim thelbësor nga ligji i vjetër. Ligji përmban 9 kapituj në të cilët rregullon procedurën e ri-organizimit dhe likuidimit duke përfshirë edhe konceptet e reja si: Lehtësimi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, Lirimi Individual dhe Procedurat ndërkombëtare.

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji pritet një rritje e dukshme e rasteve, prandaj duke pasur parasysh risitë që sjell ky ligj dhe rritja e rasteve që pritet të paraqiten para gjykatave, trajtimi i kësaj teme, është e një rëndësie të veçantë për rritur njohuritë e gjyqtarëve.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të kuptojnë:

- Qëllimet kryesore të ligjit dhe fushëveprimin e tij;
- Procedurat e përshpejtuara dhe specifikat e tyre;
- Specifikat e hapjes së rastit të falimentimit, procedurat ligjore, afatet dhe vendimet e gjykatës.
- Pasojat e hapjes së rastit;
- Kërkesat e kreditorëve, mënyra e paraqitjes, afatet dhe prioriteti i kërkesave;
- Riorganizimi - specifikat;
- Likuidimi - specifikat;
- Lirimin individual dhe Mbyllja e rastit - kushtet ligjore;
- Dispozitat ndërkufitare - përmbajtja dhe zbatimi i tyre;

Përmbajtja

- Dispozitat e përgjithshme të Ligjit;
- Procedurat e përshpejtuara (NVM dhe para-pakot);
- Fillimi dhe hapja e rasteve;
- Pasojat e hapjes së rastit;
- Kërkesat e kreditorëve;
- Riorganizimi;
- Likuidimi;
- Lirimi individual dhe Mbyllja e rastit;
- Dispozitat ndërkufitare;

Metodologjia e trajnimit

Në këtë trajnim do të aplikohet metodologji interaktive të të mësuarit e cila përbëhet prej ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve dhe do të përfshijë:

- Trajtimi teorik i falimentimit, procedura e likuidimit dhe riorganizimit të personave juridik në procedurën e falimentimit.;
- Prezantim i rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete;
- Diskutim-bashkëbisedim, dhënie e ideve, me qëllim që të arrihet që të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktiv gjatë gjithë kohës duke e dhënë kontributin e tyre më parashtrimin e pyetjeve, ofrimin e zgjidhjeve dhe opinioneve;
- Materiali i trajnimit i cili do t'ju shpërndahet përfshinë komente, shënime, prezantime, dhe shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore në lidhje me falimentimin, si dhe shembuj të cilët ilustrojnë zbatimin e këtyre rregullave;

Përfituesit: Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit.

Kohëzgjatja: Dy ditore.

Fusha Administrative



1.6 Fusha Administrative

1.6.1 Lëvizja dhe qëndrimi i të huajve si dhe procedurat ligjore ndaj tyre në Republikën e Kosovës

Në këtë trajnim do të trajtohen statusi dhe qëndrimi i të huajve, procedura ligjore e mbajtjes dhe dëbimit të tyre nga Republika e Kosovës në bazë të dispozitave të Ligjit për të Huajt. Duke marr parasysh se ky ligj rregullon hyrjen në territorin e Kosovës, daljen prej saj si dhe qëndrimin e të huajve në Republikën e Kosovës është e domosdoshme që procedurat që zhvillohen lidhur me këto të trajtohen në gjerësi dhe nga këndvështrimi i praktikës gjyqësore, si dhe dispozitave për integrimin e të huajve në shoqërinë kosovare.

Çështjet për diskutim dhe dilemat ndërlidhen me statusin dhe qëndrimin e të huajve, procedurën ligjore të mbajtjes dhe dëbimit të tyre nga Republika e Kosovës në bazë të dispozitave të Ligjit për të Huajt si dhe zbatimin e drejt të tyre nga organet kompetente të Republikës së Kosovës. Fokusi do të jetë edhe në çështjet e kategorive se ndaj kujt zbatohen dispozitat e ligjit për të huajt dhe ndaj cilës kategori nuk janë të zbatueshme.

Dilemat dhe pyetjet në këtë trajnim do të adresohen përmes trajtimit të rasteve nga praktika gjyqësore.

Objektivat

Pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi do të jenë në gjendje që të:

- Interpretojnë dispozitat mbi hyrjen në territorin e Kosovës, dalja prej saj si dhe qëndrimin e të huajve në Republikën e Kosovës.
- Vlerësojnë drejtë zbatimin e procedurës ligjore të mbajtjes dhe dëbimit të të huajve nga Republika e Kosovës konform Ligjit për të Huajt.
- Zbatojnë drejt dispozitat procedurale lidhur me qëndrimin e paligjshëm, kthimin dhe dëbimin e të huajve.

Përmbajtja

- Hyrja në territorin e Kosovës, dalja prej saj si dhe qëndrimi i të huajve në Republikën e Kosovës.
- Procedura ligjore e mbajtjes dhe dëbimit të të huajve nga Republika e Kosovës konform Ligjit për të Huajt, nr.04/4-217.
- Qëndrimi i paligjshëm, kthimi dhe dëbimi i të huajve.

Përfitues: Gjyqtarët e Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, Zyrtarë të Departamentit të Policisë Kufitare, DSHAM-MPB (Divizioni për kthim dhe përfaqësues nga Qendra e Mbajtjes për të huaj) si dhe MPJ, zyrtarë të UNHCR-it; IOM-it dhe shoqërisë civile (KRTC dhe CRPK) dhe të tjerë.

Kohëzgjatja: Njëditorë

1.6.2 Fillimi dhe zhvillimi i procedurës së konfliktit administrativ

Në trajnimin mbi procedurën e konfliktit administrativ do të trajtohen temat që lidhen me mbrojtjen gjyqësore dhe adresimin e ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit. Në procedimin e këtyre rasteve në gjykata po paraqiten dilema të ndryshme profesionale, procedurale dhe materiale përkitazi me vendosjen e këtyre lëndëve. Me këtë trajnim synohet ofrimi i zgjidhjeve praktike të bazuara në ligj të cilat do të lehtësonin punën e kësaj gjykate, dhe në instancë të fundit do të ndikonin në reduktimin e përgjithshëm të numrit të lëndëve në gjykata.

Cila është procedura e inicimit të konfliktit administrativ dhe si zhvillohet ajo në gjykatën kompetente ndaj vendimeve të organeve të administratës publike dhe organeve të qeverisjes në Kosovë? Cilat janë lëndët me problematikën më të theksuar?

Në këtë trajnim dilemat dhe pyetjet do të adresohen përmes shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste dhe duke përdorur shembuj konkret të cilat rëndom paraqiten në procedurat gjyqësore.

Objektivat

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Interpretojnë drejtë dispozitat ligjore për procedurën e konfliktit administrativ;
- Kuptojnë rolin dhe rëndësinë e mjeteve juridike kundër vendimeve të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore;
- Zbatojnë drejtë dispozitat e procedurës së konfliktit administrativ;

Përmbajtja

- Dispozitat ligjore për procedurën në konfliktin administrativ;
- Procedura ligjore në Departamentin për Çështje Administrative të gjykatës Themelore dhe mjetet juridike kundër vendimeve të saj;
- Përmbartimi i vendimeve të Departamentit për Çështje Administrative të gjykatës Themelore;

Metodologjia e trajnimit

Dilemat dhe çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes ushtrimeve, diskutimeve dhe shembujve praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit për Konfliktet Administrative si dhe punës në grupe.

Përfitues: Gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit.

Kohëzgjatja: Një ditorë

1.6.3 Zbatimi i Ligjit për Azilin në Republikën e Kosovës

Në këtë trajnim pjesëmarrësit do të njihen me karakteristikat e Ligjit për Azilin të Kosovës, raportin e këtij ligji me Konventën Ndërkombëtare për Azilin dhe zbatimin e dispozitave të ligjit në fjalë me rastin e vendosjes për azilin. Do të shpjegohen edhe roli i palëve në procedurën e azilit që zhvillohet në Republikën e Kosovës. Çështjet për diskutim dhe dilemat ndërlidhen me statusin dhe qëndrimin e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, procedurën ligjore të mbajtjes dhe dëbimit të tyre nga Republika e Kosovës në bazë të dispozitave të Ligjit për Azilin si dhe zbatimin e drejt të tyre nga organet kompetente të Republikës së Kosovës. Fokusi do të jetë edhe në çështjet e kategorive ndaj të cilave zbatohen dispozitat e ligjit për të azilin.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë karakteristikat e ligjit për azilin të Kosovës
- Analizojnë raportin e Ligjit për Azilin të Kosovës me Konventën Ndërkombëtare për Azilin
- Zbatojnë drejtë dispozitat e Ligjit për Azilin të Kosovës me rastin e vendosjes në çështjet për azilin

Metodologjia

Ndër metodat kryesore që do të përdoren gjatë trajnimit janë: ligjërime të pjesshme teorike, diskutime interaktive, të cilat do të mbrojnë dhe argumentojnë qëndrime të ndryshme dhe analizë kritike të dispozitave ligjore dhe rasteve nga praktika. Materiali teorik është strukturuar në mënyrë që koha më e madhe t'iu lihet debateve dhe diskutimeve me pjesëmarrësit.

Përfitues: Gjyqtarët e Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, zyrtarë të Dep. të Policisë Kufitare, DSHAM-MPB (Divizioni për kthim dhe përfaqësues nga Qendra e Mbajtjes për të huaj) si dhe MPJ, zyrtarë të UNHCR-it, IOM-it dhe shoqërisë civile (KRTC dhe CRPK) dhe të tjerë.

Kohëzgjatja: Një ditore

1.6.4 Procedurat e prokurimit sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës në veçanti kontestet me OSHP-në

Tematika që do të trajtohet në këtë trajnim ka të bëjë me procedurat e prokurimit, zbatimin fillestar të procedurës së shqyrtimit, vlerësimin e shkresave nga eksperti shqyrtues dhe rekomandimin për OSHP. Do të analizohen dispozitat ligjore që përmban Ligji për Prokurimin Publik duke zbërthyer kriteret lidhur me ciklin e procesit të prokurimit publik dhe kontestet me OSHP-në. Meqenëse në praktikë shpeshherë ka probleme rreth këtyre kriterëve dhe në vlerësimin e tyre konform peshës së tyre si dhe dilema ligjore, shtrohet nevoja e trajtimit të tyre. Me interes është edhe trajtimi i procedurave në Organin për Shqyrtimin e Prokurimit Publik dhe mënyrën e inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Në këtë trajnim çështjet që do të trajtohen do të jenë udhëheqja e procedurave të prokurimit, fillimi dhe zbatimi i procedurës së shqyrtimit, trajtimi fillestar i shkresave nga eksperti shqyrtues dhe rekomandimi për OSHP. Në procedurën e prokurimit publik nëse autoriteti kontraktues ka përcaktuar në dosjen e tenderit se kontrata publike do t'i jepet operatorit ekonomik që dorëzon tenderin e përgjegjshëm ekonomikisht më të favorshëm, dhënia e kësaj kontrate a do të bëhet vetëm në bazë të kriterëve dhe peshës së tyre përkatëse të përcaktuar në dosjen e tenderit në pajtim me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 52 të këtij ligji.

Dilemat dhe pyetjet në këtë trajnim do të adresohen përmes: ligjërimit të pjesshëm teorik, diskutimeve interaktive, të cilët do të argumentojnë qëndrime të ndryshme dhe analizë kritike të dispozitave ligjore dhe rasteve nga praktika. Materiali teorik do të jetë i strukturuar në mënyrë që koha më e madhe të veçohet për debate dhe diskutime me pjesëmarrës si dhe shembuj nga praktika si në gjykatë ashtu edhe në OSHP.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbërthejnë etapat e procedurës së prokurimit publik;
- Identifikojnë karakteristikat e padisë në procedurën e konfliktit administrativ sipas Ligjit për Prokurimin Publik;
- Interpretojnë dhe zbatojnë drejtë dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në praktikën gjyqësore.

Përmbajtja

- Udhëheqja e procedurave të prokurimit – dispozitat e përgjithshme;
- Fillimi dhe zbatimi fillestar i procedurës së shqyrtimit;
- Shqyrtimi fillestar i shkresave nga eksperti shqyrtues dhe rekomandimi për OSHP.

Metodologjia

Metodat kryesore që do të përdoren gjatë trajnimit janë: ligjërime të pjesshme, diskutime interaktive dhe analizë kritike të dispozitave ligjore dhe rasteve nga praktika. Materiali teorik është strukturuar në mënyrë që koha më e madhe t'iu lihet debateve dhe diskutimeve me pjesëmarrësit.

Përfitues: Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Gjykatës së Apelit dhe zyrtarët e OSHP-së.

Kohëzgjatja: Një ditor

1.6.5 Procedura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, dhe mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës në shërbimin civil të Republikës së Kosovës

Në këtë trajnim do të trajtohet procedura që zhvillohet në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (KPMK) dhe mbrojtja gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës me përqendrim tek Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës. Në procedurën që zhvillohet me rastin e cenimit të drejtave të shërbyesve civil si në KPMK dhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë ka dilema dhe paqartësi lidhur me kompetencën për të vendosur në këto konteste. Po ashtu ka vështirësi që kanë të bëjnë me moszbatimin e disa vendimeve të Këshillit, përmbarimin e vendimeve nga gjykatat, zbatimin e standardeve kushtetuese për të drejtën në punë dhe zbatimin e kërkesave të KEDNJ-së.

Gjithashtu do të trajtohen pyetjet dhe dilemat që ndërlidhen me zbatimin e dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil që bëjnë ndarjen e nëpunësve civilë nga nëpunësit e tjerë që i nënshtrohen Ligjit të Punës, institucionet dhe njësitë e përfshira në mbrojtjen gjyqësore nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil si dhe procedurën dhe afatet e ankimimit administrativ. Inicimi i konfliktit administrativ ndaj vendimit të KPMK-së, dhe mbrojtja gjyqësore e të drejtave të punës për shërbyesit civil, kompetencën, afatet dhe mjetet juridike etj.

Këto dilema do të shtjellohen përmes shpjegimit teorik, diskutimeve dhe shembujve nga praktika gjyqësore, me angazhimin edhe të pjesëmarrësve për zgjedhjen e rasteve të cilat rëndom ndodhin në procedurat gjyqësore në gjykata.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të zbërthejnë dispozitat ligjore për shërbyesit civil;
- Të shqyrtojnë mjetet juridike kundër vendimeve të KPMK-së
- Të zbatojnë drejtë dispozitat e LSHC në konteste për shërbyesit civil
- Të zbërthejnë procedurën në çështjet që lidhen me shërbyesit civil.

Përmbajtja

- Dispozitat ligjore për shërbyesit civil;
- Procedura ligjore në KPMK dhe mjetet kundër vendimeve të tij;
- Përmbarimi i vendimeve të KPMK-së;
- Raste nga praktika gjyqësore lidhur me procedurën në çështjet që lidhen me shërbyesit civil.

Metodologjia

Metodat kryesore që do të përdoren gjatë trajnimit janë: ligjërime të përgjithshme, diskutime interaktive dhe analizë kritike të dispozitave ligjore dhe rasteve nga praktika. Materiali teorik është strukturuar në mënyrë që koha më e madhe t'iu lihet debateve dhe diskutimeve me pjesëmarrësit.

Përfitues: Gjyqtarët e Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit dhe zyrtarët e KPMK-së.

Kohëzgjatja: Një ditore

1.6.6 Procedura dhe objekti i konfliktit administrativ

Në trajnimin mbi procedurën e konfliktit administrativ do të trajtohen temat që lidhen me mbrojtjen gjyqësore dhe adresimin e ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe rrjedhimisht atij të Gjykatës së Apelit. Në procedimin e këtyre rasteve në gjykata po paraqiten dilema të ndryshme profesionale, procedurale dhe materiale përkitazi me vendosjen e këtyre lëndëve. Me këtë trajnim synohet ofrimi i zgjidhjeve praktike të bazuara në ligj të cilat do të lehtësonin punën e kësaj gjykate dhe në instancë të fundit do të ndikojnë në reduktimin e përgjithshëm të numrit të lëndëve. Trajnimi do të fokusohet në procedurën e inicimit të konfliktit administrativ dhe si zhvillohet ajo në gjykatën kompetente ndaj vendimeve të organeve të administratës publike dhe organeve të qeverisjes në Kosovë, dhe cilat lloje të lëndëve paraqiten më shpesh pranë Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore.

Objektivat

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që :

- Të interpretojnë dispozitat ligjore për procedurën e konfliktit administrativ;
- Të zbërthejnë objektin e konfliktit administrativ.
- Të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e vendimeve të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore;
- Të zbatojnë drejtë dispozitat e procedurës së konfliktit administrativ;

Përmbajtja

- Dispozitat ligjore për procedurën konfliktin administrativ;
- Objekti i konfliktit administrativ;
- Procedura ligjore në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore;
- Përmbartimi i vendimeve të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore;
- Raste nga praktika gjyqësore lidhur me procedurën e konfliktit administrativ.

Metodologjia e trajnimit

Dilemat dhe çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste dhe shembuj konkret. Përmes ushtrimeve, diskutimeve dhe shembujve praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit për Konfliktet Administrative, puna në grupe - ndarja paraprake e detyrave, raste praktike dhe diskutimi i tyre me pjesëmarrës.

Përfitues: Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit.

Kohëzgjatja: Një ditore

1.6.7 Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional lidhur me aplikimin dhe zbatimin Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Gjithashtu do të trajtohen metodat e vlerësimit të mallit importues, metodat e vlerësimit të shpenzimeve të transportit duke analizuar Udhëzimin Administrativ nr.11/2009 dhe përcaktimi i kodeve tarifore. Po ashtu do të zbërthehen dispozitat ligjore që përmban Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës dhe udhëzimet administrative përcjellëse për zbatimin e tij. Gjithashtu do të trajtohet vendosja e kodeve tarifore duke u mbështetur në dokumentacionet përcjellëse që duhet t'i bashkëngjiten Deklaratës Doganore për vendosje të mallit në qarkullim të lirë. Me interes është edhe trajtimi i çështjes së importeve të përkohshme.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë Kodin Doganor dhe të Akcizave të Kosovës dhe udhëzimet administrative përcjellëse në kontestet gjyqësore;
- Vlerësojnë drejtë kodet tarifore dhe dokumentet e detyrueshme doganore;
- Kuptojnë drejtë dispozitat dhe kriteret mbi importet e përkohshme;

Përmbajtja

- Aplikimi i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës;
- Kodet tarifore (TARIK) dhe dokumentet e detyrueshme doganore për vlerësimin e drejtë të kodit tarifar
- Trajtimi i importeve të përkohshme

Metodologjia

Dilemat dhe çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste dhe shembuj konkret. Gjithashtu trajnimi do të realizohet përmes ushtrimeve, diskutimeve dhe shembujve praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Kodit Doganor dhe i Akcizave në Kosovë, puna në grupe dhe raste praktike.

Përfitues: Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit si dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Dy ditë

1.6.8 Interpretimi i legjislacionit tatimor në Kosovë

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional lidhur me aplikimin dhe zbatimin e legjislacionit mbi çështjet tatimore si në formatin e trajnimit të drejtpërdrejtë ashtu edhe në formatin e mësimit elektronik (në distancë), në mënyrë që gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët të trajtojnë çështjet tatimore në mënyrë efektive. Gjithashtu në këtë trajnim do të trajtohen dispozitat e Ligjit mbi të Ardhurat e Korporatave, Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale, Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Udhëzimi Administrativ për Transferimin e Çmimeve dhe Marrëveshjet për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njihen me rregullat për zbatimin e Ligjit mbi të Ardhurat e Korporatave,
- Të zbatojnë drejtë Udhëzimin Administrativ për Transferimin e Çmimeve,
- Të zbërthejnë Ligjin për Tatimin në të Ardhurat Personale,
- Të interpretojnë dispozitat e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe
- Të kuptojnë dhe zbatojnë drejtë Marrëveshjet për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë duke i aplikuar ato drejtë në kontestet gjyqësore.

Përmbajtja

- Ligji mbi të Ardhurat e Korporatave
- Udhëzimi Administrativ për Transferimin e Çmimeve
- Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale
- Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat
- Marrëveshjet për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë

Metodologjia

Ndër metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: ligjërimi i pjesshëm teorik, diskutime interaktive, analizë kritike të dispozitave ligjore dhe rasteve nga praktika. Materiali teorik do të jetë i strukturuar në mënyrë që koha më e madhe të veçohet për debate dhe diskutime me pjesëmarrës si dhe shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfitues: Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit si dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Dy ditor

1.6.9 Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës një ndër të drejtat fundamentale është edhe e drejta e privatësisë. Kjo dispozitë kushtetuese është konkretizuar më tej përmes Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë. Mbrojtja e të dhënëve është një temë e re për Kosovën dhe përbën një kriter për liberalizimin e vizave për Kosovën si dhe për procesin e integritimit në BE. Raportet e fundit të progresit theksojnë se Kosova duhet të përmirësojë implementimin dhe harmonizimin e ligjeve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e ligjit. Ky trajnim ka për qëllim që të shqyrtoj mbrojtjen gjyqësore të së drejtës së privatësisë siç garantohet me dispozita kushtetuese dhe ligjore.

Janë edhe disa çështje që do të shtrohen në formë pyetjesh që kërkojnë përgjigje në këtë trajnim si: Cilat janë garantitë kushtetuese dhe ligjore të së drejtës së privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave në Kosovë? Cilat janë problemet kryesore në zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale? Si po trajtohen pretendimet e palëve në mbrojtjen e të dhënave personale nga gjyqësori dhe cilat janë standardet e vendosura?

Objektivat

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që :

- Të interpretojnë dispozitat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale,
- Të dallojnë kornizën ligjore vendore për mbrojtjen e të dhënave personale me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe të KEDNJ-së;
- Të zbërthejnë mënyrat e mbrojtjes administrative të të dhënave personale,
- Të zbatojnë drejt dispozitat për mbrojtjen gjyqësore të të dhënave personale.

Përmbajtja

- Dispozitat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Mbrojtja e të dhënave në kontekst të së drejtës së Bashkimit Evropian dhe të KEDNJ-së,
- Mbrojtja administrative e të dhënave personale,
- Mbrojtja gjyqësore e të drejtave personale.

Metodologjia e trajnimit

Metodat që do të përdoret gjatë këtij trajnimi do të jenë shpjegim i pjesshëm teorik, ushtrime, diskutime dhe shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, diskutime interaktive, pyetje dhe përgjigje si dhe raste nga praktika gjyqësore. Vëmendje e veçantë do ti kushtohet jurisprudencës së GJEDNJ në Strasburg për të analizuar qëndrimet e saj lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale në relacion me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut..

Përfitues: Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës dhe Gjykatës së Apelit, zyrtarë të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kohëzgjatja: Një ditore

1.6.10 Zbatimi i Ligjit për Shtetësinë e Kosovës

Në praktikë janë evidentuar probleme dhe paqartësi ligjore rreth mënyrave të fitimit, humbjes dhe rifitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës dhe çështje të tjera të ndërlidhura me shtetësinë. Andaj për këto probleme dhe procedurat e fitimit të shtetësisë ka nevojë që të trajtohet përmes një trajnimi të gjithanshëm ku do të shpjegohen mënyrat e fitimit të shtetësisë, zbatimi i procedurave për humbjen e shtetësisë dhe afatet për shqyrtimin të kërkesave dhe ankesave.

Janë edhe disa çështje që do të shtrohen në formë pyetjesh që kërkojnë përgjigje në këtë trajnim si: cilat janë dilemat që po shfaqen lidhur me shtetësinë dhe mënyrat e fitimit dhe humbjes së saj në Kosovë? Cilat janë problemet kryesore në zbatimin e Ligjit për Shtetësinë e Kosovës?, etj.

Objektivat

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që :

- Të interpretojnë dispozitat ligjore për shtetësinë në Republikën e Kosovës,
- Të zbërthejnë mënyrat e fitimit të shtetësisë,
- Të kuptojnë format e humbjes së shtetësisë.
- Të respektojnë afatet për shqyrtimin të kërkesave dhe ankesave.
- Të zbatojnë drejt dispozitat e Ligjit për Shtetësinë e Kosovës.

Përmbajtja:

- Dispozitat ligjore për shtetësinë në Republikën e Kosovës,
- Fitimi i shtetësisë – mënyrat e fitimit të shtetësisë,
- Humbja e shtetësisë,
- Afatet për shqyrtimin të kërkesave dhe ankesave,

Metodologjia e trajnimit

Metodat që do të përdoret gjatë këtij trajnimi do të jenë shpjegim i pjesshëm teorik, ushtrime, diskutime dhe shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit për Shtetësinë e Kosovës, diskutime interaktive, pyetje dhe përgjigje si dhe raste nga praktika gjyqësore. Vëmendje e veçantë do ti kushtetohet edhe rasteve nga praktika gjyqësore në këtë lëmi.

Përfitues: Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, dhe zyrtarët e Departamentit për Shtetësi, Azil, dhe Migrim-MPB.

Kohëzgjatja: Një ditore

1.6.11 Zbatimi i Ligjit për Regjistrimin Civil, (Regjistrat e gjendjes civile, regjistrimi i mëvonshëm dhe ri-regjistrimi)

Qëllimi dhe arsyeja e organizimit dhe mbajtjes së këtij trajnimi është thellimi i njohurive të gjyqtarëve për regjistrat e gjendjes civile – si bëhet korigjimi dhe plotësimi në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile, regjistrimin e lindjes në bazë të dokumenteve bazë të lindjes dhe regjistrimin e mëvonshëm dhe ri regjistrimin. Dispozitat e këtij ligji kanë nevojë të trajtohen nga se ky ligj rregullon përbërësit e gjendjes civile të shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës, përcaktimin e rregullave për krijimin, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Kosovës.

Objektivat

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që :

- Të zbatojnë drejtë dispozitat përkatëse lidhur me regjistrimin e lindjes në bazë të dokumenteve bazë të lindjes.
- Të kuptojnë mënyrat e regjistrimit të lindjes në bazë të dokumenteve bazë të lindjes.
- Të bëjnë dallimin e procedurave në mes të regjistrimit të mëvonshëm dhe ri regjistrimit.
- Të interpretojnë dhe zbatojnë drejt dispozitat e Ligjit për Regjistrimin Civil të Kosovës.

Përmbajtja:

- Dispozitat ligjore për regjistrat e gjendjes civile në Republikën e Kosovës,
- Regjistrat e gjendjes civile – korigjimi dhe plotësimi në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile.
- Regjistrimi i lindjes në bazë të dokumenteve bazë të lindjes.
- Regjistrimi i mëvonshëm dhe ri regjistrimi.

Metodologjia e trajnimit

Metodat që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë shpjegim i pjesshëm teorik, ushtrime, diskutime dhe shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit për Regjistrat Civil të Kosovës, diskutime interaktive, pyetje dhe përgjigje si dhe raste nga praktika gjyqësore. Vëmendje e veçantë do ti kushtetohet edhe rasteve nga praktika në këtë lëmi.

Përfitues: Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, dhe zyrtarët e Departamentit për Regjistrim Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës.

Kohëzgjatja: Një ditore

1.6.12 Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional lidhur me aplikimin dhe zbatimin e TVSH në Republikën e Kosovës dhe në rajon, kushtet e regjistrimit për TVSH dhe normat e TVSH-së. Gjithashtu do të zbërthehen dispozitat ligjore që përmban Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar duke shpjeguar kriteret lidhur me ciklin e procesit të TVSH nga Dogana e deri te pagesa e konsumatorit të fundit. Meqenëse në praktikë shpeshherë ka probleme rreth çështjes së aplikimit të TVSH-së dhe në vlerësimin e tyre konform peshës së tyre si dhe dilema ligjore, shtrohet nevoja e trajtimit të tyre.

Me interes është edhe trajtimi i praktikave të vendeve tjera me të cilat Republika e Kosovës ka më shumë eksport-importe në mënyrë që të definohen qartë të drejtat dhe obligimet e TVSH-së që paguhen në Doganën e Kosovës dhe në Administratën Tatimore të Kosovës.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin rregullat e aplikimit të TVSH-së në Republikën e Kosovës ;
- Interpretojnë dhe zbatojnë drejtë dispozitat ligjore për TVSH në praktikën gjyqësore;
- Të njihen me dispozitat ligjore mbi TVSH-në dhe praktiken e zbatimit në vendet e rajonit.

Përmbajtja

- Aplikimi i TVSH-së në Republikën e Kosovës;
- Analizë e dispozitave ligjore që përmban Ligji mbi TVSH-në;
- Dispozitat ligjore dhe praktikat e TVSH-së në vendet e rajonit dhe diskutimi i rasteve gjyqësore.

Metodologjia e trajnimit

Metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore; diskutime interaktive në grupe të ndara, të cilët do të mbrojnë dhe argumentojnë qëndrime të ndryshme dhe analizë të rasteve gjyqësore. Materiali teorik do të jetë i strukturuar në mënyrë që koha më e madhe të veçohet për debate dhe diskutime me pjesëmarrës.

Përfitues: Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit si dhe bashkëpunëtorët profesional të Departamentit për Çështje Administrative – Divizioni Fiskal dhe Departamenteve Ekonomike.

Kohëzgjatja: Dy ditë

Fusha e kundërvajtjeve



1.7 Fusha e kundërvajtjeve

1.7.1 Personat Juridik si kryes të kundërvajtjes

Bazuar në lëndët të cilat sipas ankesave po arrijnë në Gjykatën e Apelit, është konstatuar se në shumë raste, gjykatat e shkallës së parë, sikurse edhe ushtruesit e kërkesave për fillimin e procedurës për kundërvajtje-inspektorët e lemive përkatëse, nuk e definojnë qartë subjektin afarist si person juridik, ashtu që subjektet afariste si biznese individuale, i identifikojnë si persona juridik, kurse pronarët e bizneseve individuale i trajtojnë si persona përgjegjës të personave juridik, prandaj rrjedhimisht paraqitet nevoja e elaborimit të këtyre paqartësive, duke sqaruar dallimin mes subjekteve afariste si persona juridik në raport me subjektet afariste si biznese individuale, dhe përgjegjësinë e personit përgjegjës të personit juridik.

Si zhvillohet procedura kundërvajtëse ndaj subjekteve afariste si biznes individual, dhe dallimi me zhvillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj subjekteve afariste si persona juridik?

Ky trajnim synon që përmes elaborimit të legjislacionit, të adresohen çështjet e parashtruara, dhe përmes shembujve praktikë të ofrohen zgjidhjet e duhura.

Objektivat

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Bëjnë dallimin mes subjekteve afariste si biznese individuale në raport me personat juridik (SH.A. dhe SH.P.K.) si dhe personin përgjegjës të personit juridik;
- Zhvillojnë drejt dhe në mënyrë ligjore procedurën për kundërvajtje ndaj personave juridik dhe personave përgjegjës të personave juridik;
- Zhvillojnë drejt dhe në mënyrë ligjore procedurën për kundërvajtje ndaj subjekteve afariste si biznese individuale;

Përmbajtja

- Baza ligjore për mënyrën e zhvillimit të procedurë kundërvajtëse ndaj subjekteve afariste si persona juridik;
- Kur konsiderohen përgjegjës subjektet afariste si persona juridik, përgjegjësia e personit përgjegjës të personit juridik, dhe rastet kur personi përgjegjës i personit juridik nuk mbanë përgjegjësi;
- Kush konsiderohet person përgjegjës në personin juridik?
- Zhvillimi i procedurës ligjore ndaj subjekteve afariste si biznese individuale.

Metodologjia e trajnimit

Elaborimi i legjislacionit të zbatueshëm në procedurën kundërvajtëse lidhur me statusin e personave juridik si subjekte afariste, përmes diskutimeve interaktive, shembujve praktik, puna në grupe për zgjidhjen e detyrës konkrete-skenar i rasteve, dhe ofrimi i alternativave për paqartësitë e paraqitura nga gjyqtarët.

Përfitues: Gjyqtarët e divizioneve për kundërvajtje në Gjykatat e shkallës së parë.

Kohëzgjatja: Një ditore

1.7.2 Prishja e rendit dhe e qetësisë publike

Ligji në fuqi për rendin dhe qetësinë publike është mjaft i varfër dhe i mangët në përfshirjen dhe përkufizimin e kundërvajtjeve nga lëmi i rendit dhe qetësisë publike, dhe si i tillë, në shumë raste praqet problem për zbatim nga gjyqtarët e shkallës së parë.

Cilat janë dallimet e veprës kundërvajtëse nga vepra penale, me theks të veçantë te vepra e rrahjes? Si të kuptohet nenet 4 dhe 5 e sidomos neni 16 i LRQP?

Elaborimi hollësishëm i këtyre çështjeve do të jetë qëllim i këtij trajnimi i cili do të bëhet përmes rasteve praktike.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë veprimet inkriminuese kundërvajtëse nga lëmi i mbrojtjes së rendit dhe qetësisë publike;
- Përkufizojnë qartë sulmin verbal, dhe kompetencën për të vendosur;
- Aplikojnë drejt dispozitat ligjore nga lëmi i Rendit dhe Qetësisë Publike.

Përmbajtja

- Përkufizimi i vendit publik;
- Dallimi mes nenit 4 dhe 5 të LRQP, si dhe dallimi mes mosrespektimit të urdhrit të personit të autorizuar zyrtar - neni 16 LRQP, dhe kundërvajtjes – mosveprim sipas urdhrit të personit të autorizuar zyrtar nga lëmi i trafikut rrugor;
- Sanksionet e parapara për kryesit e kundërvajtjeve prishje e rendit dhe qetësisë publike;
- Ndëshkimet për kryesit e kundërvajtjeve prishje e rendit dhe qetësisë publike.

Metodologjia e trajnimit

Elaborim i hollësishëm i të gjitha dispozitave të Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike, përmes prezantimit në power point, diskutimeve interaktive, shembujve praktik, duke ofruar alternativa rreth vështirësive të hasura në praktikë, etj.

Përfitues: Gjyqtarët e divizioneve për kundërvajtje në gjykatat themelore.

Kohëzgjatja: Një ditë

1.7.3 Fillimi dhe zhvillimi i procedurës kundërvajtëse

Ligji në fuqi për kundërvajtje, përmban mjaft risi në raport me ligjin paraprak, sidomos lidhur me kompetencën për të vendosur, fillimin dhe zhvillimin e procedurës, mënyrën e vendosjes-sanksionet, ekzekutimin e sanksioneve, etj. Rastet e dukurisë së paraqitjes së kërkesave për fillimin e kundërvajtjes nga organi jo kompetent, me përmbajtje jo të plotë, etj.

Cilat janë kushtet ligjore për iniciimin e procedurës që duhet plotësuar, kundërvajtjet në vazhdimësi dhe si bëhet bashkimi i tyre? Cila është procedura për të miturit në procedurën për kundërvajtje? Pse dhe si duhet zhvilluar procedurën e veçantë ndaj të miturve?

Fokusi i trajnimit do të jetë në trajtimin e këtyre dilemave të cilat paraqiten në procedurën kundërvajtëse lidhur me fillimin dhe zhvillimin e procedurës kundërvajtëse.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë plotësimin e kushteve ligjore për fillimin dhe zhvillimin e procedurës për kundërvajtje,
- Zbatojnë drejt dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me fillimin dhe zhvillimin e procedurës për kundërvajtje,
- Zbatojnë drejt procedurën për kundërvajtje ndaj të miturve,
- Dallojnë provat e pranueshme nga ato të pa pranueshme,
- Aplikojnë drejt sanksionet për kundërvajtje.

Përmbajtja

- Paraqitja e të dhënave përmbledhëse lidhur me fillimin dhe zhvillimin e procedurës për kundërvajtje,
- Kushtet për përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve për kundërvajtje,
- Përgjegjësia kundërvajtëse dhe masat e veçanta të kundërvajtjes,
- Procedura për të mitur,
- Veprimet e gjykatës pas pranimit të kërkesës për fillimin e procedurës

Metodologjia e trajnimit

Elaborimi i hollësishëm i dispozitave të Ligjit për Kundërvajtje, me theks të veçantë në ndryshimet me ligjin paraprak, përmes shembujve praktik dhe diskutimeve interaktive, qasja në adresimin e dilemave – pyetjeve gjatë trajnimit.

Përfitues: Gjyqtarët e divizioneve për kundërvajtje në gjykatat themelore.

Kohëzgjatja: Një ditore

1.7.4 Administrimi i provave - parimet

Në praktikën gjyqësore, shpesh hasim në vendime të bazuara në prova, të cilat nuk janë administruar në pajtim me dispozitat ligjore, të cilat janë të pa pranueshme, apo edhe në vendime të pa bazuara në prova të administruara nga gjykata.

Lidhur me këto paqartësi në zbatimin e procedurës kundërvajtëse paraqitet nevoja për ngritjen e njohurive lidhur me mënyrën dhe trajtimin e provave në procedurën e kundërvajtjes.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Përkufizojnë drejt provën,
- Identifikojnë provat e pranueshme nga ato të pa pranueshme në procedurën e kundërvajtjes,
- Vlerësojnë drejt provën

Përmbajtja

- Paraqitja e parimeve themelore për identifikimin dhe mënyrën e administrimit të provave në procedurën kundërvajtëse, me theks të veçantë në vlerësimin e drejtë të tyre;
- Kuptimi i provës dhe faktit;
- Llojet e provave që mund të administrohen;

Metodologjia e trajnimit

Elaborimi i parimeve për vlerësimin e provave, shembuj përkitazi me administrimin e ndryshëm të provave, prezantimi përmes power point, punim në grupe i rastit hipotetik, diskutimi i rasteve praktike, etj.

Përfitues: Gjyqtarët e divizioneve për kundërvajtje në gjykatat themelore.

Kohëzgjatja: Një ditorë

1.7.5 Aktgjykimi në procedurën kundërvajtëse

Ligji aktual për kundërvajtje, për dallim nga ligji paraprak, e parasheh mënyrën e vendosjes me aktgjykim, dhe në rastet e caktuara me aktvendim, rrjedhimisht paraqitet nevoja e elaborimit të rasteve kur vendoset me aktgjykim dhe kur me aktvendim.

Sidomos, paraqiten raste jo të rralla, të aktgjykimeve të cilat gjatë përpilimit nuk bazohen në dispozitat ligjore, qoftë ato procedurale, materiale, qoftë në ato sanksionuese, gjithashtu arsyetimet e vendimeve lënë për të dëshiruar, rrjedhimisht paraqitet nevoja e elaborimit të mënyrës së përpilimit të aktgjykimit me një dispozitiv dhe arsyetim të qartë dhe të drejtë ligjor.

Gjithashtu ka nevojë të trajtohet edhe mënyra e dorëzimit të rregullt dhe ligjor të aktgjykimit, rrjedhimisht paraqitet nevoja e elaborimit të mënyrës ligjore të dorëzimit të aktgjykimit si dhe shkresave tjera, si dhe bazën ligjore për mënyrën e dorëzimit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Hartojnë drejt dispozitivin dhe arsyetimin ligjor të tij,
- Identifikojnë llojet e aktgjykimeve, dhe mënyrën e arsyetimit të tyre,
- Njohin mënyrën ligjore të dorëzimit të shkresave

Përmbajtja

- Aktgjykimi dhe arsyetimi ligjor,
- Vendosja me aktvendim,
- Dorëzimi i rregullt i aktgjykimit,

Metodologjia e trajnimit

Prezantimi përmes power point, diskutime interaktive, diskutim i rasteve praktike, do të ofrohen alternativa për paqartësitë dhe dilemat, etj.

Përfitues: Gjyqtarët e divizioneve për kundërvajtje në gjykatat themelore,

Kohëzgjatja: Një ditorë

E drejta kushtetuese



1.8. E drejta kushtetuese

1.8.1 Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe efektet juridike të tyre

Qëllimi i organizimit të këtij trajnimi është thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me rolin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe vendimeve të saj, natyrën juridike, efektin si dhe mënyrën e përmbartimit të tyre. Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese dallohen disa lloj vendimesh në varësi nga qëndrimi që ato mbajnë ndaj normave që kontrollojnë. Po kështu, edhe proceset që kryhen nëpërmjet vendimeve mund të kenë natyra të ndryshme. Roli i Gjykatës Kushtetuese qëndron pikërisht në fuqinë e vendimeve të saj. Mirëpo realizimi dhe zbatimi praktik i vendimeve gjyqësore kushtetuese është një çështje me rëndësi të veçantë që kërkon trajtim të gjithanshëm.

Cili është roli i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese? Cila është natyra juridike e vendimeve të saj? Cilat llojet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese? Si bëhet përmbartimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese?

Këto janë çështjet që janë shtruar për trajtim gjatë këtij trajnimi, për shkak të rëndësisë së tyre për punën e gjykatave.

Objektivat

Pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi do të jenë në gjendje që:

- Të njohin rolin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe të zbërthejnë efektet juridike të cilat prodhojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese,
- Të vlerësojnë drejtë natyrën juridike dhe detyrueshmërinë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës,
- Të bëjnë dallimin e llojeve të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese,
- Të zbatojnë drejtë vendimet e Gjykatës Kushtetuese në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës

Përmbajtja

- Roli i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe vendimeve të saj.
- Natyra juridike e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe efektet e tyre,
- Llojet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese,
- Përmbartimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Metodologjia

Ndër metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore, diskutime interaktive në grupe të ndara dhe analizë të rasteve gjyqësore nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Përfituesit: Gjyqtarët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës.

Kohëzgjatja: Një ditore

Trajnimet për DHPGJS



1.9 Trajnimet për DHPGJS

1.9.1 Procedura me shkrim dhe ajo verbale para Dhomës së Posaçme

Në Dhomën e Posaçme procedura zhvillohet në dy faza, në atë me shkrim dhe atë verbale. Kërkesa apo ankesë dorëzohet me shkrim në Dhomën e Posaçme. Ligji ka përcaktuar qartë se çfarë duhet të përmbajë kërkesa apo ankesa e tillë duke përfshirë të dhënat e palëve, lëndën dhe të gjitha faktet materiale që kanë të bëjnë me kërkesën ose ankesën, bazën për juridiksionin parësor të Dhomës së Posaçme në lidhje me kërkesën apo ankesën, argumentet ligjore mbi të cilat mbështetet kërkesa apo ankesa dhe një listë provash që parashtuesi synon t'i paraqesë. Në Dhomën e Posaçme procedura me shkrim është mjaft e stërzgatur ajo përbëhet nga mbrojtja e palës kundërshtare, përgjigjja e parashtuesit, kundërpërgjigjja e palës kundërshtare, si dhe kundërkërkesa. Pra është me e gjatë se procedura sipas LPK-së.

Si zhvillohet procedura në DHP? Çka duhet të përmbaj një kërkesë? Cilat janë pasojat e palëve nëse ata nuk u përmbahen rregullave për paraqitjen e provave? Çfarë janë pasojat e mosparaqitjes së mbrojtjes? A duhet që mbahet seance dëgjimore për secilin rate që procedohet para Dhomën e Posaçme?

Trajnimi do të fokusohet në diskutimet dhe çështjet e ngritura nga pjesëmarrësit rreth dilemave lidhur me procedurat para DHPGJS.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë drejtë procedurën me shkrim dhe atë verbale në Dhomën e Posaçme;
- Njohin se cilat janë pasojat e mosparaqitjes së mbrojtjes;
- Identifikojnë më lehtë kriteret për pranueshmërinë e kërkesës/ankesës;

Përmbajtja

- Procedura me shkrim dhe ajo verbale;
- Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës/ankesës;
- Mbrojtja e palës kundërshtare, përgjigjja e parashtuesit, kundërpërgjigjja e palës kundërshtare, si dhe kundërkërkesa;

Metodologjia e trajnimit

Diskutime interaktive me pjesëmarrësit, raste praktike dhe shtjellimi i tyre, prezantimi me PowerPoint.

Përfitues: Gjyqtarët nga Dhoma e Posaçme, gjyqtarët e Gjykatave themelor-divizionit civil, zyrtaret ligjor dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditë

1.9.2 Kompetencat e Dhomës së Posaçme dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit, parashtruesit dhe palët kundërshtare para Dhomës së Posaçme

Juridiksionin e Dhomës së Posaçme e përcakton nenin 4 i Ligjit për DHPGJS, (Nr. 04/L-033).

Kjo dispozitë përcakton se Dhoma e Posaçme ka kompetencë ekskluzive mbi të gjitha rastet dhe procedurat në lidhje me kundërshtimet ndaj një vendimi apo veprimi të AKM-së, tani AKP-së, apo kërkesat e palëve që pretendojnë ndonjë të drejtë, titull apo interes me të cilën administrojnë Agjencia Kosovare e Privatizimit, kërkesa kundër AKM-së apo Agjencisë për humbjet financiare që pohohen të jenë shkaktuar nga një vendim a veprim i ndërmarrë nga AKM-ja apo Agjencia, kërkesa kundër një Ndërmarrjeje apo Korporate që pohohet të ketë lindur gjatë apo para kohës kur ajo Ndërmarrje apo Korporatë i është nënshtruar autoritetit administrativ të AKM-së, apo Agjencisë.

Cili është juridiksioni sipas nenit 4 të ligjit të DHP? Cilat janë kompetencat e Agjencisë? Cilat janë llojet e kompetencës? Çka është kompetenca funksionale? Pse ka ngecje të AKP-së në zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë të viteve 1990-1999? Cilët persona mundën më qenë parashtrues dhe palë kundërshtare para Dhomës së Posaçme?

Trajnimi do të fokusohet në diskutimet dhe çështjet e ngritura nga pjesëmarrësit rreth dilemave lidhur me kompetencat e DHP, Agjencisë, respektivisht për kërkesat të cilat mund të ngritin dilemat edhe tek vet gjyqtarët se a hyn në juridiksionin ekskluziv të Dhomës së Posaçme.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë juridiksionin ekskluziv të Dhomës së Posaçme;
- Zbatojnë drejtë normat juridike lidhur me kompetencën;
- Identifikojnë personat kompetent që mund të jenë parashtrues dhe palë kundërshtare në procedurë para Dhomës së Posaçme;
- Zgjidhin apo vlerësojnë me lehtë rastet që kanë të bëjnë me kompetencën;

Përmbajtja

- Kompetencat e Dhomës së Posaçme dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Kompetenca funksionale me fokus në Dhomën e Posaçme;
- Zbatimi i vendimeve gjyqësore të viteve 1990-1999, nga AKP;
- Parashtruesit dhe palët kundërshtare në Dhomën e Posaçme;

Metodologjia e trajnimit

Diskutime interaktive me pjesëmarrësit, raste praktike dhe shtjellimi i tyre, prezantimi me PowerPoint.

Përfitues: Gjyqtarët nga Dhoma e Posaçme, gjyqtarët e gjykatave themelore-divizionit civil, zyrtarët ligjor dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditor

1.9.3 Procedura gjyqësore për kundërshtimin e vendimeve të Agjencisë që krijohen nga procesi i Privatizimit dhe i Likuidimit

Secili person që kundërshton një vendim a veprim të Agjencisë, që është ndërmarrë në datën apo pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të parashtojë kërkesën apo ankesën në fjalë tek Dhoma e Posaçme jo më vonë se njëqind e njëzet ditë (120) pas datës në të cilën vendimi apo veprimi i është dorëzuar personit në fjalë. Çdo kreditor i ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendimi i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit. Ankesa duhet të jetë në pajtim me kërkesat e paragrafit 2. të nenit 27 të kësaj shtojce dhe të bashkëngjisë një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi.

A duhet që parashtruesi i kërkesës t'i shtjerr mjetet juridike pranë AKP-së, në mënyrë që pastaj ti drejtohet Gjykatës? A është ky një kriter i cili duhet përmbushur në mënyrë që të shkohet tutje apo jo? A duhet personat e interesuar që kanë pretendime pronësore apo kreditore ndaj një NSH-je të presin fillimin e likuidimit, në mënyrë që t'i drejtohen komisionit të Likuidimit?

Këto dhe dilema tjera të ngritura nga pjesëmarrësit do të trajtohen përmes diskutimeve gjatë trajnimit, rasteve praktike të paraqitura, në mënyrë që dilemat e tilla të eliminohen.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë procedurën lidhur me kërkesat/ankesat në Dhomën e Posaçme;
- Respektojnë afatet kohore për kundërshtimin e vendimeve të Agjencisë;
- Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore të cilat aplikohen varësisht nga vendimi i kundërshtuar;
- Kuptojnë drejtë dhe qartë procedurën e privatizimit dhe likuidimet;

Përmbajtja

- Paraqitja e kërkesave/ankesave kreditore dhe pronësore në Komisionin e Likuidimit dhe në Dhomën e Posaçme;
- Kundërshtimi vendimeve të Agjencisë në Dhomën e Posaçme dhe procedura e shqyrtimit të këtyre vendimeve;

Metodologjia e trajnimit

Diskutime interaktive me pjesëmarrësit, raste praktike dhe shtjellimi i tyre, prezantimi me PowerPoint.

Përfitues: Gjyqtarët nga Dhoma e Posaçme, gjyqtarët e gjykatave themelore-divizionit civil, zyrtaret ligjor dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditë

1.9.4 Roli i Agjencisë dhe procesi i privatizimit të subjekteve nga AKP

Agjencia Kosovare e Privatizimit si organ i pavarur publik ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome, dhe sipas ligjit të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e AKM-së tani janë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë. Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit parasheh rolin respektivisht synimin dhe qëllimin e Agjencisë se për çka është krijuar. Në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë ligj, Agjencia është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe aseteve të përkufizuara në këtë ligj.

A ka shkelje të procedurave nga AKP me rastin e aprovimit apo refuzimit të ofertave? Në çfarë gjendje ndodheshin NSH-të në Kosovë pas luftës? A kishin lënë NSH-të borxhe? A ka ngecje në procesin e likuidimit të NSH-së? Cilat janë vështirësitë e gjyqësorit në zgjidhjen e rasteve që paraqiten para saj? etj.

Trajnimi do të fokusohet në diskutimet dhe çështjet e ngritura nga pjesëmarrësit rreth rolit të Agjencisë në procesin e privatizimit të subjekteve të AKP-së.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë drejtë rrjedhën e procedurave për privatizimin e subjekteve nga AKP;
- Vlerësojnë rastet kur transformimi i një NSH-je ka qenë apo nuk ka qenë diskriminues;
- Njohin kompetencat e Agjencisë lidhur me administrimin e NSH-ve;
- Identifikojnë se cilët janë personat me ndalesa ofertomi;

Përmbajtja

- Autorizimet e Agjencisë në procesin e privatizimit;
- Ofertuesit me ndalesa ofertimi;
- Verifikimi dhe shpallja e fituesit të përkohshëm;
- Aprovimi dhe refuzimi i ofertës;

Metodologjia e trajnimit

Diskutime interaktive me pjesëmarrësit, raste praktike dhe shtjellimi i tyre, prezantimi me Power Point.

Përfitues: Gjyqtarët nga Dhoma e Posaçme, gjyqtarët e gjykatave themelore-divizionit civil, zyrtarët ligjor dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditor

1.9.5 Mjetet e goditjes në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës

Ligji për Dhomën e Posaçme njih vetëm mjetin e rregullt të goditjes e ajo është ankesa. Me ankesë mund të goditen të gjitha llojet e vendimeve gjyqësore të lëshuar nga kolegjet e specializuara, me përjashtim të aktgjyqimit për mosparaqitje që mund të ushtrohet kërkesë. Me ankesë si mjet i goditjes mund të kundërshtohen të gjitha vendimet apo veprimet e AKM-së, apo Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me të cilën refuzohen kërkesat pronësore, kreditore kundër ndërmarrjeve që janë futur në procedurë të likuidimit, ankesat që kanë të bëjnë me listën zyrtare të punëtorëve që kanë të drejta legjitime për të marr një pjesë në 20% të ardhurave nga çmimi i shitjes së ndërmarrjes shoqërore, ankesat që kanë të bëjnë me likuidimin e një ndërmarrje sipas autorizimit administrues të Agjencisë dhe ankesat apo kundërshtimet për anulimin e transaksioneve të ndonjë ndërmarrjeje që i është nënshtruar procedurës së likuidimit. Procedura sipas ankesës para gjykatës zhvillohet në dy nivele: në të parin veprojnë Kolegjet e Specializuara, në të dytin Kolegji i Apelit.

Kujt i drejtohet ankesa? Cilat janë shkaqet për ushtrimin e ankesës? Çka duhet të përmbaj ankesa? Cilët janë kufijtë e shqyrtimit të ankesës/apelit?

Trajnimi do të fokusohet në diskutime, raste praktike dhe çështjet e ngritura nga pjesëmarrësit rreth dilemave lidhur me kufijtë e shqyrtimit të ankesave.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore lidhur me kufijtë e ekzaminimit të ankesës;
- Vlerësojnë se cilat janë afatet ligjore për paraqitjen e ankesës;
- Vlerësojnë se çka duhet të përmbaj një ankesë/apel.

Përmbajtja

- Ankesa si mjet i vetëm i goditjes;
- Kufijtë e shqyrtimit të ankesës;
- Afatet për paraqitjen e ankesës;
- Mjetet e jashtëzakonshme juridike;

Metodologjia e trajnimit

Diskutime interaktive me pjesëmarrësit, raste praktike dhe shtjellimi i tyre dhe prezantimi me Power Point.

Përfitues: Gjyqtarët nga Dhoma e Posaçme, gjyqtarët e gjykatave themelore-divizionit civil, zyrtarët ligjor dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditor

Trajnimet për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe të drejtën e BE-së

1.10 Trajnimet për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe të drejtën e BE-së

1.10.1 E Drejta për Jetën – Neni 2 i KEDNJ

Qëllimi i organizimit të këtij trajnimi është avancimi dhe thellimi i njohurive për të drejtën e jetës dhe zërthimin e interpretimi të gjerë i mbrojtjes së të drejtës në jetë. Gjithashtu në këtë sesion do të trajtohen obligimet e shtetit për të respektuar të drejtën e jetës dhe detyrimet pozitive të shtetit për të mbrojtur individët nën mbikëqyrjen e tyre si dhe interpretimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) lidhur me aspektet procedurale të së drejtës për jetën.

Cilat janë detyrimet e shtetit për mbrojtjen e individëve të cilët mbahen nën mbikëqyrjen e shtetit? Cilat janë situatat kur jeta nuk konsiderohet e privuar në kundërshtim me këtë nen, në rastet kur ky privim vjen nga përdorimi i forcës, i bërë absolutisht i domosdoshëm? Cilat janë kriteret që përmbahen në dispozitat e nenit 2 të KEDNJ?

Këto dhe çështje tjera të rëndësishme për praktikën gjyqësore synohet që të shtjellohen gjatë këtij trajnimi.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të kuptojnë aspektet substantive të së drejtës për jetën,
- Të zërthejnë detyrimet e shtetit për mbrojtjen e individëve të cilët mbahen nën mbikëqyrjen e shtetit,
- Të vlerësojnë kur jeta nuk konsiderohet e privuar në kundërshtim me këtë nen, në rastet kur ky privim vjen nga përdorimi i forcës, i bërë absolutisht i domosdoshëm,
- Të zbatojnë drejtë kriteret që përmbahen në dispozitat e nenit 2 të KEDNJ dhe aspektet procedurale të së drejtës për jetën.

Përmbajtja

- Aspektet substantive të së drejtës për jetën,
- Detyrimet e shtetit për mbrojtjen e individëve të cilët mbahen nën mbikëqyrjen e shtetit,
- Situatat kur jeta nuk konsiderohet e privuar në kundërshtim me këtë nen, në rastet kur ky privim vjen nga përdorimi i forcës, i bërë absolutisht i domosdoshëm,
- Zbatimi i drejtë i kriterëve që përmbahen në dispozitat e nenit 2 të KEDNJ dhe aspektet procedurale të së drejtës për jetën.

Metodologjia e trajnimit

Metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore, diskutime interaktive në grupe të ndara, dhe analizë të rasteve gjyqësore nga GJEDNJ.

Përfituesit: gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditore

1.10.2 E drejta për liri dhe siguri – neni 5 i KEDNJ

Qëllimi i organizimit të këtij trajnimi është avancimi dhe thellimi i njohurive mbi të drejtën për liri dhe siguri konform KEDNJ, nocionet dhe mënyrën e interpretimit që bën Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg, si dhe zbatimi i drejtë i dispozitave lidhur me të drejtën për liri dhe siguri. Gjithashtu në këtë sesion do të trajtohen standardet të cilat mbrojnë lirinë fizike dhe veçmas lirinë nga arrestimi dhe ndalimi arbitrar. Krejt kjo do të shoqërohet me shembuj nga praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të aplikojnë nenin 5 të KEDNJ.
- Të interpretojnë standardet kryesore të përmbajtura në dispozitat e nenit 5 të KEDNJ lidhur me rastin e ndalimit të personit nga ana e shtetit,
- Të zbërthejnë bazën ligjore specifike dhe dispozitat që rregullojnë situatën e të ndaluarit,
- Të njihen me praktikën gjyqësore dhe risitë që sjell ajo lidhur me zbatimin e nenit 5 të KEDNJ.

Përmbajtja

- Përmbajtja e dispozitave dhe nocioneve themelore të nenit 5 të KEDNJ.
- Standardet kryesore në dispozitat e nenit 5 të KEDNJ lidhur me rastin e ndalimit të personit nga ana e shtetit,
- Baza ligjore specifike dhe dispozitat që rregullojnë situatën e të ndaluarit,
- Praktika gjyqësore dhe risitë që sjell ajo lidhur me zbatimin e nenit 5 të KEDNJ.

Metodologjia e trajnimit

Metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë, shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore, diskutime interaktive në grupe të ndara dhe analizë të rasteve gjyqësore nga GJEDNJ.

Përfituesit: gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditore

1.10.3 E drejta për një proces të rregullt gjyqësor– neni 6 i KEDNJ

Qëllimi i organizimit të këtij trajnimi është avancimi i njohurive të pjesëmarrësve mbi të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Gjithashtu synohet zbërthimi i nocioneve dhe interpretimi që bën Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg, lidhur me të drejtën për një proces të rregullt në kontekst të nenit 6 të KEDNJ. Ky nen përmban dispozita për të drejtën në një proces të rregullt gjyqësor, që është shumë e rëndësishme për të gjitha shtetet që janë palë të KEDNJ si dhe ato që zbatojnë Konventën.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të kuptojnë nocionet dhe kategoritë që përmban neni 6 i KEDNJ,
- Të zbërthejnë mbrojtjen procedurale sipas dispozitave të nenit 6 të KEDNJ,
- Të interpretojnë nocionin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatave në kontekst të këtij neni.
- Të zbatojnë drejtë standardet dhe kërkesat që përmban neni 6 i KEDNJ.

Përmbajtja

- Nocionet dhe kategoritë që përmban neni 6 i KEDNJ,
- Mbrojtjet procedurale sipas dispozitave të nenit 6 të KEDNJ,
- Pavarësia dhe paanshmëria e gjykatave në kontekst të këtij neni,
- Standardet dhe kërkesat që përmban neni 6 i KEDNJ,

Metodologjia e trajnimit

Metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore, diskutime interaktive në grupe të ndara, dhe analizë të rasteve gjyqësore nga GJEDNJ.

Përfituesit: gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditore

1.10.4 E drejta për jetë private, jetë familjare, të vendbanimit dhe korrespondencës, për tu martuar dhe krijuar familje dhe për barazi të bashkëshortëve – neni 8 i KEDNJ

Synimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me të drejtën e jetës private dhe familjare. Arsye tjetër shtesë për trajtim të kësaj tematike është edhe nxitja e gjyqtarëve që të zbatojnë KEDNJ duke ju referuar vendimeve dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ. Fokusi i trajnimit do të jetë në zbërthimin e nocioneve dhe kategorive që përmban neni 8 për të drejtën në respektimin e jetës private dhe familjare si dhe mënyrën e interpretimit që bënë Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të kuptojnë nocionin dhe natyrën juridike të jetës private,
- Të njihen me kriteret e KEDNJ lidhur me privatësinë, korrespondencën dhe vendbanimin-përgjimin si dhe mbledhjen e të dhënave.
- Të zbatojnë drejtë dispozitat e nenit 8 lidhur me ndërhyrjen e autoritetit publik në ushtrimin e kësaj të drejte, në shkallën e parashikuar me ligj.

Përmbajtja

- Nocioni dhe natyra juridike e jetës private.
- Kuptimi dhe natyra juridike e jetës familjare.
- Privatësia, korrespondenca dhe vendbanimi-përgjimi dhe mbledhja e të dhënave.
- Ndërhyrja e autoritetit publik në ushtrimin e kësaj të drejte, në shkallën e parashikuar me ligj.

Metodologjia e trajnimit

Metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore; diskutime interaktive në grupe të ndara dhe analizë të rasteve gjyqësore nga GJEDNJ.

Përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditore

1.10.5 Liria e shprehjes dhe e informimit - neni 10 i KEDNJ

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me shprehjen e lirë për të marrë dhe dhënë informacione ose ide. Arsye tjetër shtesë për trajtim të kësaj tematike është shpjegimi i lirisë së shprehjes në kontekstin e debatit publik, komentet e çështjeve publike nga figura publike apo nga media. Fokusi i trajnimit do të jetë edhe në zbërthimin e nocioneve dhe kategorive që përmban neni 10 si dhe mënyrën e interpretimit që bënë Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të kuptojnë nocionet themelore mbi lirinë e shprehjes në kontekstin e debatit publik,
- Të njihen me rolin e lirisë së shprehjes dhe informacionit të disponueshëm për publikun,
- Të zbërthejnë rëndësinë e lirisë së shprehjes dhe respektit për pushtetin gjyqësor,
- Të zbatojnë drejtë dispozitat që kanë të bëjnë me detyrimet pozitive të shtetit sipas nenit 10 të KEDNJ.

Përmbajtja

- Liria e shprehjes në kontekstin e debatit publik,
- Roli i lirisë së shprehjes dhe informacioni i disponueshëm për publikun,
- Rëndësia e lirisë së shprehjes dhe respekti për pushtetin gjyqësor,
- Detyrimet pozitive të shtetit sipas neni 10 të KEDNJ,

Metodologjia e trajnimit

Metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore; diskutime interaktive në grupe të ndara dhe analizë të rasteve gjyqësore nga GJEDNJ.

Përfituesit: gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja - Një ditorë

1.10.6 E drejta e mbrojtjes së pronës - neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me të drejtën e respektimit të pronës së personit dhe mundësia e privimit nga kjo e drejtë për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuar nga ligji, si dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Arsye tjetër shtesë për trajtim të kësaj tematike është shpjegimi i ndërhyrjes së domosdoshme në një shoqëri demokratike nga ana e autoriteteve kombëtare. Fokusi do të jetë edhe në zbërthimin e nocioneve dhe kategorive që përmban neni 1. i Protokollit 1, si dhe mënyra e interpretimit që bën Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të kuptojnë nocionet themelore që përmban neni 1 i Protokollit nr.1 i KEDNJ,
- Të njihen me rolin e së drejtës për respektimin e pronës së individit,
- Të zërthejnë kushtet për ndërhyrjen e të drejtës së pronës për arsye të interesit publik,
- Të zbatojnë drejtë standardet dhe kriteret për kompensim për privimet nga prona në kontekst të nenit 1 Protokollit nr.1 të KEDNJ dhe praktikës së GJEDNJ

Përmbajtja

- Nocionet themelore që përmban neni 1 i Protokollit nr.1 i KEDNJ,
- Roli i së drejtës për respektimin e pasurisë së individit,
- Kushtet për ndërhyrjen e të drejtës së pronës për arsye të interesit publik,
- Standardet dhe kriteret për kompensim për privimet nga prona në kontekst të nenit 1 Protokollit nr.1 të KEDNJ dhe praktikës së GJEDNJ.

Metodologjia e trajnimit

Metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore; diskutime interaktive në grupe të ndara dhe analizë të rasteve gjyqësore nga GJEDNJ.

Përfituesit: gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja - Një ditore

1.10.7 Zbatimi i së drejtës së Bashkimit Evropian nga ana e gjykatave nacionale – veçmas në Republikën e Kosovës dhe efekti i saj interpretativ para anëtarësimit

Qëllimi i organizimit të këtij trajnimi është avancimi dhe thellimi i njohurive mbi efektin interpretativ të së drejtës së Bashkimit Evropian dhe analizimi i aspekteve të zbatimit të këtij parimi para anëtarësimit në BE. Po ashtu synim tjetër është thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me efektin e së drejtës evropiane në të drejtën nacionale, të Republikës së Kosovës pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim – Asocim. Gjithashtu do të trajtohen edhe mënyrat e zbatimit të saj nga ana e gjykatave nacionale, veçmas nga ato të Republikës së Kosovës, pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim – Asocim. Në këtë trajnim do të trajtohen edhe vështirësitë e dilemat që lidhen me interpretimin e efektit të së drejtës evropiane në nivel nacional si dhe zbatimin e drejtë të saj me vështirim nga praktika e gjykatave të një shteti anëtarë të BE-së, dhe të shteteve tjera në regjion.

Objektivat

Pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi do të jenë në gjendje që:

- Të interpretojnë efektin e drejtpërdrejt dhe të tërthortë të së drejtës evropiane në nivel nacional, veçmas në Republikën e Kosovës.
- Të zbërthejnë efektin e së Drejtës së BE-së në sistemin kushtetues dhe të drejtën e Republikës së Kosovës - pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim – Asocimin.
- Të zbatojnë drejtë legjislacionin e BE-së në Republikën e Kosovës pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim – Asocimin.
- Të zbërthejnë raste praktike të zbatimit të së drejtës së BE-së nga ana e gjykatave të një shteti anëtarë të BE-së.

Përmbajtja

- Zbatimi i së drejtës evropiane dhe efektet e saj në nivel nacional (efektet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta)
- Efekti i së Drejtës së BE-së në sistemin kushtetues dhe të drejtën e Republikës së Kosovës - pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim – Asocimin.
- Zbatimi së drejtës së BE-së nga ana e gjykatave nacionale – përvoja nga shtetet në regjion.
- Raste praktike të zbatimit të së drejtës së BE-së nga ana e gjykatave të një shteti anëtarë të BE-së.

Metodologjia

Metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore, diskutime interaktive në grupe të ndara dhe analizë të rasteve gjyqësore.

Përfitues: gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës.

Kohëzgjatja: Një ditore

Kompetenza interdisciplinare

1.11 Kompetenca interdisiplinare

1.11.1 Kodi i etikës

Sundimi i ligjit në shoqëritë reale demokratike paraqet bazën e garantimit dhe respektimit të të drejtave themelore të njeriut të përcaktuara me akte kombëtare e ndërkombëtare juridike. Lind pyetja se a mundë një rend juridik i cili ka për qëllim sundimin e ligjit të ndërtohet pa i dhënë rëndësi mekanizmit të etikës, apo të ndërtohet një rend juridik real pa etikë profesionale dhe ndërpersonale. Duke e marrë bazë rëndësinë që ka etika në përgjithësi e në veçanti etika gjyqësore, në këtë trajnim në mënyrë specifike do të trajtohen parimet e përgjithshme të etikës gjyqësore, do të paraqiten krahasime me parimet e Bangalorit dhe të Kodit të Etikës në Kosovë. Do të trajtohet në përgjithësi Kodi Etikës, e në veçanti dilemat etike si dhe Rregulloja për Sjelljet e Pahijshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Po ashtu nuk do të lihen pa u trajtuar edhe çështjet si: cilat standarde të sjelljes duhet të përfaqësojnë gjyqtarët dhe prokurorët; cilat janë parimet e përgjithshme të Kodit të Etikës; si duhet të zgjidhen dilemat etike; karakterizimi i sjelljeve të pahijshme; masat disiplinore të cilat mundë të shqiptohen në rast të shkeljeve etike etj. Pra ky trajnim është hartuar me qëllim të trajtimit të çështjeve të lartë theksuara etike dhe gërshetimi i tyre me rastet praktike dhe praktikën e zgjidhjes së këtyre dilemave.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Njohin dhe zbatojnë rregullat bazë të etikës gjyqësore ashtu siç parashikohen ato në Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtar dhe Prokurorë;
- Zbërthejnë parimet dhe rregullat e Kodit në situata të ndryshme të jetës reale;
- Identifikojnë dhe zgjidhin problemet etike;
- Njohin rregullat për përcaktimin e sjelljeve të pahijshme;
- Njohin masat dhe llojet e masave të cilat mundë të shqiptohen për sjelljet e pahijshme;

Përmbajtja

Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtarë dhe Prokurorë - parimet themelore:

- Rregullorja për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme;
- Definimi i sjelljeve të pahijshme;
- Kategorizimi i sjelljeve të pahijshme;
- Masat disiplinore;

Metodologjia e trajnimit

Trajtimi teorik i normativës nga Kodi i Etikës Profesionale për gjyqtarët dhe prokurorët, dhe i Rregullores për Sjelljet e Pahijshme. Për demonstrimin e çështjeve, kryesisht do të përdoret forma e diskutimit- bashkëbisedimit me qëllim që të arrihet që të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktiv gjatë gjithë kohës duke e dhënë kontributin e tyre më parashtrimin e pyetjeve, ofrimin e zgjidhjeve me sugjerimet e tyre, e sidomos duke përdorur raste reale praktike.

Përfituesit: Gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve, duke përfshirë dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.11.2 Menaxhimi i rasteve

Në punën e përditshme të gjyqtarit dhe prokurorit, përpos vendimmarrjes një rol të rëndësishëm për të arritur deri tek vendimmarrja, luan dhe menaxhimi i rasteve, e sidomos kur gjyqtarët dhe prokurorët përballen me numër të madh të lëndëve të cilat duhet ti vendosin. Pra menaxhimi i rasteve dhe zbatimi i teknikave të menaxhimit të rasteve nga gjyqtarët dhe prokurorët e sidomos me një fluks të madh të rasteve të cilat i kanë para tyre, paraqet një sfidë shumë të madhe dhe çështje kyçe janë: menaxhimi i rasteve në bazë të natyrës, kompleksitetit dhe prioritetit në punën praktike; identifikimi i vështirësive në raport me menaxhimin e rasteve dhe cilat janë ato metoda të cilat do të mundë të shfrytëzoheshin në menaxhimin efikas të rasteve dhe sfidave të cilat dalin gjatë menaxhimit të rasteve.

Ky trajnim është hartuar t'i përgjigjet pyetjeve dhe çështjeve të cilat janë të ndërlidhura drejtpërdrejtë në menaxhimin dhe administrimin e lëndëve në gjykata dhe prokurori. Fokusi qëndron në adresimin e problemeve dhe strategjive të reja me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të efektivitetit të punës dhe evitimit të problemeve praktike.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë parimet e menaxhimit të rasteve;
- Zbatojnë njohuritë në menaxhimin e rasteve;
- Aplikojnë teknikat e menaxhimit të rasteve.

Përmbajtja

- Menaxhimi i rasteve;
- Parimet themelore të menaxhimit të rasteve;
- Teknikat kryesore të menaxhimit të rasteve;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, shpjegime teorike dhe praktike, punë në grupe, të përcjella me shembuj praktik, gjithashtu duke shfrytëzuar edhe Power Point prezantime.

Përfituesit: Gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor.

Kohëzgjatja: Një ditore

1.11.3 Menaxhimi i kohës si predispozitë e menaxhimit të stresit

Gati është e pamundur të mendohet jeta e përditshme në “botën moderne” pa stresin, e sidomos kur kemi të bëjmë me ushtrimin e funksionit të gjyqtarit dhe prokurorit.

Stresi është tërësi e reagimeve emocionale, trupore dhe të sjelljes ndaj atyre kërkesave, sfidave dhe ngarkesave të cilave individ u nënshtrohet në rrethana të ndryshme të punës e jetës. Në përgjithësi stresi është pasojë dhe tregues i një “ngufatje” të jetës shpirtërore në nivelin e dominimit të tehosferës ndaj socio sferës. Prezenca e shpeshtë e stresit në përditshmërinë e individit shkakton de-motivimin, redukton produktivitetin, dobëson performancën, shkakton probleme mentale fizike, ndryshon sjelljen e individit etj.

Menaxhimi i mirë i kohës dhe prioritizimi i nevojave janë nga predispozitat e menaxhimit të mirë dhe mbajtjes nën kontroll të vazhdueshëm të stresit si parakusht i ruajtjes së shëndetit dhe mirëqenies së individit. Shumë njohës të kësaj problematike preferojnë vendosjen e kufijve si teknikë e parandalimit të efektit negativ të stresit. Vendosja e kufijve material dhe formal, si dhe përmbajtja e kufijve emocional janë elementet e përmbajtjes së kësaj teknike. Edhe identifikimi i nevojave është një predispozitë e nevojshme në menaxhimin e stresit.

Çka duhet që të jam është pyetja që duhet t’ia parashtrojmë vetës për të ditur përgjigjen se a do të jem i lumtur? Çka dua unë përballë asaj se çka kam nevojë? Çka kisha bërë nëse nuk do të kisha probleme me...?

Këto janë disa nga pyetjet që individ duhet t’ia parashtroj vetës në mënyrë që të jetë në epërsi me menaxhimin e kohës dhe stresit si qëllim i arritjes së mirëqenies më të lartë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij sesi trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Njohin karakteristikat dhe veçorit dalluese të personaliteteve të cilat do të jenë në raport me ta në cilësi të ndryshme;
- Dallojnë elementet dhe faktorët influencues pozitiv dhe ata degjenerues negativ në solum dhe në ambientin e punës;
- Identifikojnë faktorët determinues të individit në sjellje devijante dhe kundërligjore;
- Mësojnë mënyrat më të mira të tejkalimit të situatave stresuese;
- Zhvillojnë shkathtësi mbi menaxhimin e mirë të kohës dhe stresit;

Përmbajtja

- Faktorët e stresit;
- Llojet e stresit;
- Shenjat dhe simptomat paralajmëruese të stresit;
- Stresi në punë;
- Administrimi i kohës;

Metodologjia e trajnimit

Vijuesit do ta kenë një ushtrim lidhur mbi prioritetet e aktiviteteve, interferimi i anekdotës së profesorit të filozofisë dhe dy paqetave me kafë.

Përfituesit: Gjyqtarë dhe prokurorë nga gjitha nivelet.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.11.4 Shkathtësitë e përfaqësimit në gjykim

Zhvillimi i shkathtësive të përfaqësimit në një gjykim është esenciale jo vetëm për prokurorët që përfaqësojnë rastet në gjykatë por edhe për gjyqtarët që udhëheqin më gjykime. Duke marr parasysh dispozitat procedurale që zbatojnë gjyqtarët dhe prokurorët, është më se e domosdoshme që prokurorët të jenë të përgatitur profesionalisht për paraqitjen e rasteve në gjykim, dhe gjyqtarët për udhëheqjen e gjykimit.

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës ka paraparë teknika të veçanta të paraqitjes së fjalës hyrëse, marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje, marrjes së tërthortë në pyetje, ri-marrjes në pyetje dhe fjalës përfundimtare, këto teknika ende nuk janë duke u zbatuar ashtu siç është parashikuar në KPPK dhe ashtu siç aplikohen në vendet anglosaksone prej nga janë marr si model këto teknika. Gjatë praktikës gjyqësore janë vërejtur mjaft mangësi në aftësinë e zbatimit të fjalës hyrëse dhe marrjes së tërthortë në pyetje, por edhe të teknikave tjera të shkathtësive të përfaqësimit, sepse shpesh herë gjatë paraqitjes së fjalës hyrëse bëhet argumentimi i rastit, sikur të ishte fjala përfundimtare, ndërsa shumë rrallë bëhet siç duhet marrja e tërthortë në pyetje, ndërsa ende nuk është duke u bërë dallimi i qartë në mes marrjes së drejtpërdrejtë dhe marrjes së tërthortë në pyetje.

Për të evituar këto dilema, gjatë trajnimit do të përdoren metoda interaktive, duke përfshirë edhe simulimin e aplikimit të këtyre teknikave dhe incizimet me video kamerë, në mënyrë që pastaj pjesëmarrësit të kenë mundësi të bëjnë edhe vetë video kritikën, në mënyrë që të përmirësojnë lëshimet e mundshme.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Prezantojnë fjalën hyrëse duke përdorur teknikat adekuate;
- Zbatojnë marrjen në pyetje të drejtpërdrejtë;
- Prezantojnë provat të cilat vërtetojnë faktet para gjykatës;
- Zbatojnë parimet dhe rregullat e marrjes së tërthortë në pyetje;
- Zbatojnë vënien në dyshim përmes hapave (konfirmo, kredito, konfronto);
- Demonstrojnë rimarrjen në pyetje;
- Prezantojnë fjalën përfundimtare;
- Argumentojnë gjendjen faktike përmes provave të administruara në procedurë;

Përmbajtja

Fjala hyrëse duke përdorur teknikat adekuate;

- Marrja e drejtpërdrejtë në pyetje;
- Marrja e tërthortë në pyetje dhe vënia në dyshim;
- Rimarrja në pyetje;
- Fjala përfundimtare;

Metodologjia e trajnimit

Metoda interaktive, simulimi i rasteve, incizimet me video kamerë, kritika dhe vetë kritika.

Përfituesit: Prokurorët dhe gjyqtarët e shkallës së parë dhe të dytë.

Kohëzgjatja: dy ditë e gjysmë.

1.11.5 Hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore

Shkrimi dhe arsyetimi ligjor paraqet standard vlerësimi të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në këtë kuptim shkrimi dhe arsyetimi ligjor në punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve përfaqëson një objektiv jo lehtë të arritshëm. Shkrimi dhe arsyetimi ligjor ka për qëllim të ndihmoj gjyqtarët dhe prokurorët në ngritjen e aftësive analitike dhe shkathtësive për të shkruar në mënyrë efektive me rastin e hartimit të akteve dhe vendimeve gjyqësore.

Kualiteti i vendimeve gjyqësore kryesisht varet nga kualiteti i arsyetimit. Arsyetimi i vendimeve jo vetëm se ju mundëson palëve që lehtësisht ti kuptojnë dhe pranojnë vendimet, por para së gjithash paraqet mbrojtje nga arbitrariteti. Në rend të parë, arsyetimi i obligon gjyqtarët të përgjigjen në pretendimet e palëve, ti paraqesin qëndrimet të cilat justifikojnë vendimin dhe e bëjnë të ligjshëm, i mundësojnë shoqërisë të kuptoj funksionimin e sistemit gjyqësor.

Përmes metodës IRAC, ekziston mundësia që problemi të trajtohet në mënyrë logjike, konsistente dhe të plotë. Fillimisht identifikohet çështja gjyqësore ose problemi që adresohet, pastaj shpjegohet norma ligjore (premise e parë), duke vazhduar me aplikimin e saj në faktet specifike të situatës së çështjes (premise sekondare), për të arritur tek konkluzioni me përgjigjen në pyetjen e parashtruar në hapin e parë. Cilat janë llojet e arsyetimit ligjor? Cilat janë parimet e shkrimit dhe arsyetimit të mirë ligjor? Cila janë metodat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor? Si duhet të respektohen kërkesat e ligjeve/kodeve procedurale për përmbajtjen e arsyetimit të vendimeve gjyqësore?

Trajnimi është hartuar me qëllim që t'ju përgjigjet pyetjeve dhe paqartësive të ngritura më lartë përmes trajtimit teorik dhe rasteve praktike për të gjitha komponentët e përfshira brenda këtij trajnimi siç janë: llojet e arsyetimit ligjor, parimet e shkrimit të mirë ligjor, metodat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe kërkesat ligjore për përmbajtjen e arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë gjendje të:

- Avancojnë zbatimin e metodologjisë së shkrimit të vendimeve, akteve akuzuese dhe shkresave tjera ligjore;
- Zhvillojnë shkathtësitë e arsyetimit dhe shkrimit ligjor;
- Hartojnë vendimet gjyqësore sipas standardeve më të larta;
- Zbatojnë metodën IRAC gjatë hartimit të vendimeve gjyqësore;

Përmbajtja

Llojet e arsyetimit ligjor:

- Parimet e shkrimit të mirë ligjor;
- Kërkesat ligjore për shkrimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore;
- Zbatimi i metodës IRAC gjatë hartimit të vendimeve gjyqësore;

Metodologjia e trajnimit

Diskutim teorik dhe praktik për metodat e analizës ligjore në rastet konkrete, bashkëbisedimi me qëllim që të arrihet që të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktiv gjatë gjithë kohës duke e dhënë kontributin e tyre në parashtrimin e pyetjeve, ofrimin e zgjidhjeve me sugjerimet e tyre. Pjesëmarrësit përveç kontributit të tyre në diskutime sfidojnë edhe idetë e trajnuesit lidhur me shtruarjen dhe zgjidhjen e shumë çështjeve.

Përfituesit: Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditore.

1.11.6 Vendimmarrja dhe qasja në drejtësinë mjedisore -- standardet ndërkombëtare dhe legjislacioni në fuqi

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me drejtësinë mjedisore. Trajnimi do të trajtoj problemet në zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit në fuqi në këtë lëmi në Republikën e Kosovës. Pastaj si mbrohen të drejtat e individëve për qasje në informacione mjedisore dhe pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes dhe si mund të zbatohet Konventa e Aarhusit në mënyrë të drejtpërdrejt si dhe përgjegjësia penale për ndotjen e mjedisit.

Republika e Kosovës nuk është palë e Konventës së Aarhusit, por nga të dhënat e siguruar rezultojnë se zbatimi gjyqësor i kësaj Konvente në trajtimin e kontesteve administrative dhe civile është ende i mangët. Rrjedhimisht, gjyqtarët por edhe prokurorët kanë nevojë të konsiderueshme që të avancojnë njohuritë e tyre rreth zbatimit të kësaj Konvente. Konventa përmban tre shtylla themelore: 1. E drejta e publikut për të pasur e për të kërkuar informacion mjedisor; 2. E drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrjet publike për çështje të mjedisit; 3. E drejta e publikut për t'u ankuar në gjykatë për çështje të mjedisit. Konventa e UNECE (KEE-OKB-Komisioni Ekonomik për Evropën i OKB-së) lidhur me të drejtën në informacion, pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje dhe qasjes në drejtësi në çështje mjedisore vendos një sërë të drejtash për publikun dhe detyrime për autoritetet shtetërore për të fuqizuar demokracinë mjedisore.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të kuptojnë nocionet themelore që përmban Konventa e Aarhusit dhe legjislacioni nacional në fuqi,
- Të zbërthejnë mënyrat e qasjes në informacione mjedisore;
- Të njihen me rolin e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe të drejtat për qasje në informacionet mjedisore;
- Të zbatojnë drejtë dispozitat mbi të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës;
- Të kuptojnë dhe njihen me përgjegjësin penale në fushën e mjedisit;

Përmbajtja

- Nocionet themelore që përmban Konventa e Aarhusit dhe legjislacioni nacional në fuqi,
- Mënyrat e qasjes në informacione mjedisore;
- Roli i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe të drejtat për qasje në informacionet mjedisore;
- Rëndësia e dispozitave mbi të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës
- Përgjegjësia penale në fushën e mjedisit.

Metodologjia e trajnimit

Metodat që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore nacionale dhe në nivel regional. Dilemat dhe pyetjet do të adresohen përmes analizës teorike dhe normative të Konventës duke u mbështetur edhe në raste konkrete gjyqësore. Për më tepër, në kuadër të trajnimit do të përdoren ushtrime, diskutime dhe shembuj praktik duke u mbështetur në Konventën e Aarhusit, dhe aktet tjera që rregullojnë këtë fushë.

Përfitues: gjyqtarët dhe prokurorët të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditore.

Trajnimet kundër diskriminimit

1.12 Trajnimet kundër diskriminimit

1.12.1 Barazia gjinore në procedurë gjyqësore në përgjithësi dhe në rastet e dhunës në familje në veçanti

Ekziston pajtimi i përgjithshëm se çështjet gjinore në çdo shoqëri demokratike përfaqësojnë vlera për të cilat shteti dhe shoqëria duhet të kujdesen që t'i promovojnë dhe mbrojnë të njëjtat përmes mekanizmave përkatëse ligjore. Padyshim se barazia gjinore është një parametër i rëndësishëm përmes të cilit matet niveli demokratik i një shoqërie por edhe niveli i funksionimit të shtetit ligjor. Edhe vlerësimi i raporteve të nxjerra të organizatave të ndryshme që merren me çështje gjinore potencojnë se barazia gjinore në shoqërinë tonë është në nivel jo të dëshirueshëm, e në këtë drejtim edhe efikasiteti i procedurave gjyqësore për të ofruar mbrojtjen adekuate gjyqësore në rastet e barazisë gjinore. Në anën tjetër dhuna në familje është ndër veprimet e dëmshme përmes të cilave shkelen të drejtat e njeriut si dhe rrezikohen vlerat e çmueshme të individit dhe shoqërisë.

Cilat akte ndërkombëtare i referohen barazisë gjinore? Si është e rregulluar me legjislacionin e Kosovës barazia gjinore? Si është e përcaktuar barazia gjinore sa i përket procedurave gjyqësore? Si është e rregulluar çështja e dhunës në familje? Si zhvillohet procedura gjyqësore në çështjet e dhunës në familje dhe cilat masa mund të caktohen për të parandaluar dhunën në familje? Cilat janë masat mbrojtëse të cilat mund të shqiptohen tek rastet e dhunës në familje? Cila është mbrojtja gjyqësore e cila ofrohet në rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje? Cilat janë pasojat e dhunës në familje? Kujt i ofrohet mbrojtje gjyqësore sipas Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje? Çfarë duhet të përmbajë kërkesa për urdhër mbrojtje? Kush duhet të njoftohet për urdhrin e mbrojtjes? Cilët janë urdhrat për mbrojtje?

Trajnimi është hartuar me qëllim që t'iu përgjigjet pyetjeve dhe paqartësive të ngritura më lartë përmes analizës së të gjitha akteve ndërkombëtare dhe vendore për barazinë gjinore në përgjithësi dhe për barazinë gjinore në procedurë gjyqësore duke u fokusuar specifikisht në rastet e dhunës në familje.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Njohin parimet kryesore të konventave ndërkombëtare për barazinë gjinore;
- Njohin dispozitat kushtetuese dhe legjislacionin e brendshëm për barazinë gjinore;
- Vlerësojnë kushtet dhe nevojën për caktimin e urdhrin mbrojtës;
- Vendosin masat mbrojtëse adekuate për mbrojtjen e viktimave nga dhuna e përsëritur;
- Zbatojnë drejtë procedurat e veprimt për rastet e mbrojtjes nga dhuna në familje;
- Hartojnë vendimet gjyqësore sipas specifikave që kanë çështjet e dhunës në familje.

Përmbajtja

- Legjislacioni ndërkombëtarë dhe vendor për barazinë gjinore;
- Dhuna në familje dhe format e shfaqjes së saj më fokus gjinor dhe urdhri për mbrojtje;
- Kushtet për caktimin e urdhrin për mbrojtje si dhe masat për parandalimin e dhunës;
- Procedura gjyqësore për vendosje sipas kërkesës për urdhër mbrojtje;
- Hartimi dhe arsyetimi i vendimit sipas specifikave të çështjes duke respektuar dispozitat

- ligjore;
- Ekzekutimi i urdhrit për mbrojtje dhe pasojat për shkelje të urdhrit për mbrojtje;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda e trajtimit teorik rreth akteve ndërkombëtare dhe vendore, lidhur me barazinë gjinore, dhe në funksion të arritjes së objektivave do të ofrohen raste praktike për diskutim dhe rrjedhimisht edhe modele për situata të caktuara procedurale dhe të vendosjes meritore.

Përfitues: Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore, prokurorët e prokurorive themelore, bashkëpunëtorët profesional, mbrojtësit e viktimave, etj.

Kohëzgjatja: Një ditorë

1.12.2 Barazia gjinore në çështjet familjare-pasuria e përbashkët e bashkëshortëve

Në praktikën gjyqësore çështjet e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve paraqiten si mjaft komplekse për shkak të vështirësive për të përcaktuar me saktësi pasurinë e përbashkët, kontributin dhe pjesëtimin e pasurisë. Në procedurat e tilla hasen vështirësi edhe për vërtetimin e fakteve vendimtare që janë përcaktuese për të vlerësuar se cila është pasuria e përbashkët dhe cili është kontributi i bashkëshortëve në krijimin e saj. Në lidhje me vështirësitë në procedurë është trajtuar mënyra se si gjykata duhet t'i qaset llogaritjes së kontributit të secilit bashkëshort në krijimin e pasurisë së përbashkët dhe rrjedhimisht edhe kriteret që duhet të vlerësohen për mënyrën e pjesëtimit të pasurisë së përbashkët.

Çka kuptohet me pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve? Si vlerësohet kontributi në krijimin e pasurisë së përbashkët? Cilat janë llojet e kontributit që merren në konsideratë në krijimin e pasurisë së përbashkët? Si bëhet pjesëtimi i pasurisë së përbashkët? A mund të bëhet kompensimi në vend të pjesëtimit të pasurisë për kontributin? Si duhet të duket dispozitivi i aktgjykimit në rastet e tilla? Si duhet të arsyetohet aktgjykimi për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët?

Trajnimi është hartuar me qëllim që t'iu përgjigjet pyetjeve dhe paqartësive të ngritura më lartë përmes analizës së të gjitha dispozitave ligjore që i referohen pasurisë së përbashkët dhe praktikës së gjykatave për rastet e tilla.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Dallojnë pasurinë e veçantë dhe të përbashkët të bashkëshortëve;
- Vlerësojnë nëse ekziston pasuri e përbashkët, apo rritje e ndonjë pasurie me kontributin e bashkëshortëve;
- Njohin llojet dhe mënyrën e vlerësimit të kontributit në krijimin e pasurisë së përbashkët;
- Hartojnë vendimet në përputhje me kërkesat ligjore, specifikat e rastit dhe standardet e praktikës gjyqësore;

Përmbajtja

- Barazia gjinore në çështjet familjare;
- Pasuria e veçantë dhe e përbashkët e bashkëshortëve;
- Kontributi në krijimin e pasurisë së përbashkët;
- Natyra juridike dhe regjistrimi i pasurisë së përbashkët;
- Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët;
- Hartimi dhe arsyetimi i vendimit gjyqësor për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda e trajtimit teorik lidhur me aktet ndërkombëtare dhe vendore, lidhur me barazinë gjinore, dhe në funksion të arritjes së objektivave do të ofrohen raste praktike për diskutim dhe rrjedhimisht edhe modele për situata të caktuara procedurale dhe të vendosjes meritore.

Përfituesit: Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditore

1.12.3 Barazia gjinore në kontestet për të drejtën e trashëgimisë dhe në kontestet nga marrëdhënia e punës

Rol të rëndësishëm në të drejtën e trashëgimisë përbën procedura për dhënien e mbrojtjes gjyqësore në rastet e cenimit të së drejtës së trashëgimisë mbi baza gjinore dhe rrjedhimisht edhe mundësitë ligjore për të dhënë mbrojtje adekuate. Po ashtu, edhe procedura për dhënien e mbrojtjes gjyqësore në rastet e diskriminimit në punë është e rëndësishme duke pasur parasysh eliminimin e diskriminimit në baza gjinore. Mënyra e procedimit me çështje të tilla për shkak të ndjeshmërisë që përfaqësojnë këto çështje në gjykatë është shumë komplekse dhe kërkon maturi dhe profesionalizëm.

Çka nënkuptojmë me të drejtën në trashëgimi? Çka përfaqëson pjesa e domosdoshme? Si veprohet në rastet e cenimit të pjesës së domosdoshme? Si veprohet në rast të mos deklarimit të trashëgimtarëve? Si veprohet në rast të mos përfshirjes në vendimin e trashëgimisë të të gjithë trashëgimtarëve? Çka nënkuptojmë me diskriminimin në punë? Si mund të shfaqet diskriminimi në punë mbi baza gjinore? Si mund të ofrohet mbrojtje gjyqësore në raste të tilla? Cilat masa mund të ndërmerren në këtë procedurë?

Trajnimi është hartuar me qëllim që t'ju përgjigjet pyetjeve dhe paqartësive të ngritura më lartë përmes analizës së të gjitha dispozitave ligjore që i referohen të drejtës në trashëgimi dhe mbrojtjes në kontestet e punës për shkak të diskriminimit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore për barazinë gjinore në trashëgimi;
- Zhvillojnë procedurën në mënyrë efikase dhe nxjerrin vendime të drejta në rastet e cenimit të pjesës së domosdoshme;
- Zhvillojnë procedurën dhe ofrojnë mbrojtjen e duhur në rastet e mos deklarimit të trashëgimtarëve mbi baza gjinore;
- Hartojnë dhe arsyetojnë vendimet sipas specifikave që përfaqësojnë çështjet e trashëgimisë dhe diskriminimit në punë;

Përmbajtja

- Cenimi i pjesës së domosdoshme dhe procedura gjyqësore në rastet e cenimit;
- Mos deklarimi i trashëgimtarëve dhe procedura pas shpalljes së trashëgimisë;
- Diskriminimi në të drejtën e trashëgimisë në forma tjera si cenimi për së gjalli apo edhe ndarja faktike;
- Diskriminimit në punë, mënyra e shfaqjes së diskriminimit mbi baza gjinore;
- Mbrojta gjyqësore në rastet e diskriminimit mbi baza gjinore;
- Hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore sipas specifikave të procedurës dhe rasteve;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda e trajtimit teorik lidhur me legjislacionin dhe praktikën gjyqësore lidhur me të drejtën në trashëgimi dhe kundër diskriminimin në marrëdhëniet e punës dhe në funksion të arritjes së objektivave do të ofrohen raste praktike për diskutim dhe rrjedhimisht edhe modele për situata të caktuara procedurale dhe të vendosjes meritore.

Përfituesit: Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja: Një ditore

Trajnimet për avancim për Gjyqtarët dhe Prokurorët e Shtetit

2. Trajnimet për avancim për Gjyqtarët dhe Prokurorët e Shtetit

Për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të cilët janë avancuar nga një nivel në tjetrin, apo nga një departament në tjetrin, do të ofrohen trajnime adekuate me qëllim të përmbushjes së nevojave dhe kërkesave të tyre të karakterit profesional, interdisiplinar dhe personal. Programi orientues i përcaktuar për këtë kategori përgatit përfutuesit për kryerjen e punës me sukses menjëherë pas marrjes së detyrës së re.

2.1 Gjyqtarët dhe prokurorët e avancuar nga një departament në tjetrin në kuadër të njëjtë nivel

Avancimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga një departament në tjetrin, shtrojnë nevojën që këto ndryshime të shoqërohen edhe me ndjekjen e disa trajnimeve specifike nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilat do t'i përshtaten veçorive të tyre. Në këtë drejtim Akademia ofron programe orientuese të cilat janë të gatshme për zbatim në çdo kohë kur ndodhin këto avancime brenda sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Programet orientuese për gjyqtarët dhe prokurorët që avancohen nga një departament në tjetrin fokusohen në zhvillimin e shkathtësive dhe praktikave si më poshtë:

- Ballafaqimi me procedurat e reja dhe juridiksionin e ri;
- Roli i gjyqtarit apo prokurorit sipas kompetencës së departamentit përkatës;

2.2 Gjyqtarët dhe Prokurorët e avancuar nga niveli themelor në atë të Apelit

Ky program trajnimi përmban module që fokusohen në kompetencën profesionale të gjyqtarëve apo prokurorëve të avancuar, e të cilat janë:

- Kompetenca dhe juridiksioni në nivelin e apelit;
- Kompetenca dhe juridiksioni në departamentin përkatës të nivelit të apelit.

2.3 Gjyqtarët e avancuar nga Gjykata e Apelit në Gjykatën Supreme

Programi i trajnimit për gjyqtarët e avancuar nga Gjykata e Apelit në Gjykatën Supreme, përmban module që fokusohen në kompetencën profesionale, që fokusohet në:

- Kompetenca dhe juridiksioni në nivelin e Gjykatës Supreme;
- Kompetenca dhe juridiksioni në fushën përkatëse;

2.4 Prokurorët e avancuar nga Prokuroria e Apelit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit

Programi i trajnimit për prokurorët e avancuar nga Prokuroria e Apelit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, përmban module që fokusohen në kompetencën profesionale, që fokusohet në:

- Kompetenca dhe juridiksioni në nivelin e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit;
- Kompetenca dhe juridiksioni në fushën përkatëse;

Programi i Trajnimit Fillestar

3. Programi i Trajnimit Fillestar

Programi i Trajnimit Fillestar (PTF), fokusohet në zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapoemëruar.

Akademia e Drejtësisë, trajnimin fillestar gjatë vitit 2019 do ta organizoj për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar nga komuniteti serb, të cilët pjesën më të madhe të trajnimit fillestar e kanë vijuar gjatë vitit 2018, gjeneratën e shtatë të gjyqtarëve, si dhe gjeneratën e tetë të prokurorëve të shtetit të sapo emëruar. Programi i trajnimit fillestar për gjeneratat e reja, do të rishikohet dhe miratohet nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në konsultim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Objektivë kryesore në kuadër të PTF-së, Akademia ka përcaktuar zhvillimin e kompetencave profesionale, personale dhe interdisiplinare si dhe zhvillimin e shkathtësive praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapo emëruar.

Programi i trajnimit fillestar zgjatë 12 muaj dhe është i strukturuar sipas modelit të kombinuar teorik dhe praktik. Pjesa teorike përfshinë trajnimin teorik i cili përmban përveç moduleve profesionale dhe karakterit ndërdisiplinor edhe shqyrtime të rasteve nga praktika gjyqësore, simulime etj. Ndërsa pjesa e dytë, trajnimi praktik zhvillohet në gjykata/prokurorit përkatëse ku ata janë emëruar si dhe trajnime në institucione jo gjyqësore që lidhën me punën e gjyqtarit dhe prokurorit të shtetit.

Trajnimi fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar do të vazhdoj në përmbushjen e programit teorik dhe praktik sipas plan programit dhe orarit të përcaktuar. Në kuadër të trajnimit teorik sipas programit do të realizohen dy ditë trajnimi në Akademi, duke filluar nga moduli i Kodit të Procedurës Penale, Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar, E drejta Civile Administrative dhe Ekonomike, Shkathtësitë Personale dhe Interdisiplinare, Legjislacioni dhe Shkathtësitë plotësuese si dhe Mësimi në Distançë. Trajnimi praktik do të realizohet në gjykatat deh prokuroritë përkatëse ku ata janë të emëruar si dhe në institucionet jo gjyqësore sipas programit. Në përfundim të këtij programi do të realizohet vlerësimi përfundimtar në pajtim me Rregulloren e Trajnimit Fillestar.

Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë të përcjellë zhvillimet në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, sa i përket procesit të rekrutimit të gjyqtarëve deh prokurorëve të rinj, në mënyrë që të përgatisë trajnimet për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar.

Ndryshimet legislative

4. Ndryshimet legislative

Jeta legislative është mjaft dinamike. Nevoja për ligje të reja dhe ndryshim të legjislacionit në shumicën e rasteve vjen natyrshëm, por ka edhe raste kur ligjet e reja miratohen, ndërsa ato ekzistuese ndryshohen me një dinamikë më të shpejtë se zakonisht për shkak të zhvillimeve të shpejta shoqërore.

Një pjesë e madhe e ligjeve prekin drejtpërdrejt punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve, në përditshmërinë e punës së tyre, prandaj Akademia e Drejtësisë me të drejt i mban në fokus të punës së vet aspektin e ndryshimit të legjislacionit për të përshtatur ato me programin e trajnimeve.

Edhe gjatë vitit 2019 do të ketë ndryshime të tilla të cilat do të trajtohen me kujdes dhe do të përfshihen në Programin e Trajnimeve. Deri më tani janë ndryshuar disa ligje bazike të cilat do të trajtohen si pjesë e këtij programi të trajnimeve, sipas procedurave standarde të hartimit dhe zbatimit të tij.

- **Kodi Penal i Republikës së Kosovës** - ndryshimet e Kodit Penal të Republikës së Kosovës janë miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës me datë 23 nëntor 2018. Këto ndryshime do të bëhen pjesë e programit të trajnimeve pas analizimit nga na e ekspertëve dhe hartimit të programit të trajnimeve.
- **Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës** – është në proces të ndryshimit, prandaj në kohën e miratimit të tij, ndryshimet do të përfshihen në programin e trajnimit.
- **Kodi i Drejtësisë për të Mitur** – ndryshimet e Kodit të Drejtësisë për të Mitur janë përfshirë në programin e trajnimit tek pjesa e drejtësisë penale për fëmijë.
- **Ligji për Procedurën Jokontestimore** – këto ndryshime janë miratuar me datë 23 nëntor dhe si të tilla do të përfshihen në programin e trajnimeve për vitin 2019.
- **Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë** – ndryshimet në këtë ligj janë miratuar me datë 23 nëntor 2018, dhe do të trajtohen gjatë trajnimeve në vitin 2019.

Këto ndryshime do të përfshihen në Programin e Trajnimeve për vitin 2019 në dy mënyra.

- Të gjitha trajnimet e parapara të trajtohen gjatë vitit 2019, nga këto fusha ku janë bërë ndryshimet ligjore, do të trajtohen në kontekst të ndryshimeve të ligjeve të reja, dhe
- Ndryshimet tjera të cilat nuk janë të përfshira në këtë program trajnimi, do të trajtohen në mënyrë të veçantë në program trajnimi të përshtatur vetëm për këto ndryshime.

Akademi e Drejtësisë do të përcjellë me vëmendje ndryshimet tjera ligjore, dhe do t'i përfshijë në programin e trajnimeve secilin ndryshim ligjor që vlerësohet se ka nevojë të trajtohet në trajnime, duke vlerësuar edhe shkallën e atyre ndryshimeve.

Programi për Hulumtime dhe Publikime

5. Programi për Hulumtime dhe Publikime

Akademia e Drejtësisë përveç organizimit të trajnimeve për gjyqtarë, prokuror, staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial dhe profesionistëve tjerë, kryen edhe analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Gjatë vitit 2019, Programi për Hulumtime dhe Publikime do të fokusohet në komponentët e saj siç janë: analiza, hulumtime, publikime dhe ofrimi i qasjes në burimet ligjore përmes bibliotekës së Akademisë.

Qëllimi i PHP-së:

Programi ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve si dhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, përmes ofrimit të burimeve të nevojshme juridike si dhe zhvillimin e programeve trajnuese të AD-së përmes aktiviteteve hulumtuese.

5.1 Analiza dhe hulumtime

Analizat dhe hulumtimet gjatë vitit 2019 do të jenë të përkushtuara në drejtim të zhvillimit të programeve trajnuese në përputhje me standardet euro integruese si dhe për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Në dobi të zhvillimit të programeve trajnuese do të realizohet:

- Procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese përmes zbatimit efikas të mekanizmave të AD-së, analiza të programeve të vlerësimit të sesioneve trajnuese, pyetësorëve në gjykata dhe prokurori, që do të ketë në fokus, profilin, metodologjinë e trajnimit, përmbajtjen dhe çështjet tjera organizative;
- Analiza e strategjive, raporteve të ndryshme të institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare që merren me monitorimin e sistemit të drejtësisë, lidhur me kapacitetet profesionale në gjyqësor;
- Hulumtime rreth problemeve praktike të cilat mund të adresohen qoftë përmes trajnimeve ashtu edhe përmes krijimit dhe zhvillimit të burimeve të ndryshme juridike;
- Hulumtime sipas nevojave të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit;

5.2 Veprimtaria botuese – publikimet

Komponentë e rëndësishme e këtij programi është veprimtaria botuese e cila është e orientuar në publikime të ndryshme në fushën juridike, me theks në punën e gjyqësorit, për të kontribuar në zhvillimin profesional të gjyqtarëve, prokurorëve të shtetit, stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive si dhe profesionistëve tjerë ligjor.

Në publikimet e Akademisë do të angazhohen ekspertë të fushave të ndryshme të së drejtës për të dhënë ekspertizën e tyre qoftë në revista, module trajnuese dhe materiale tjera ligjore përmes të cilave do të ndikohet në pasurimin e kulturës juridike me njohuri praktike dhe teorike.

PROGRAMI I TRAJNIMEVE 2019

Publikimet e Akademisë synojnë që të jenë burim informimi veçanërisht me praktikën gjyqësore dhe risitë në legjislacion dhe në përgjithësi në lëmin e drejtësisë si dhe informues për aktivitetet trajnuese të Akademisë.

Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2019 do të realizoj publikimin e revistës “Opinio Juris” e cila do të vazhdojë të nxisë komunitetin ligjor në publikimin e rezultateve hulumtuese, veçanërisht të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit, revistën “Justicia” e cila përmbledhë punimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar të cilët vijnë trajnimet në Programin e Trajnimit Fillestar si dhe module të ndryshme të trajnimit fillestar, trajnimeve të vazhdueshme, trajnimeve për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive, programe pune si raporte tjera informative.

Akademia e Drejtësisë do të realizoj edhe publikimin e një Udhëzuesi për zbatimin e ndryshimeve të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës me qëllim të lehtësimit të zbatimit të dispozitave ligjore të ndryshuara.

Përveç këtyre, do të publikohet edhe “Praktika e Gjykatës së Apelit fokusuar në çështjet e kthyerave në rishqyrtim”, si dhe publikime tjera të kësaj natyre bazuar në kërkesat dhe nevojat e gjyqësorit.

5.3 Biblioteka

Sigurimi dhe ofrimi i burime ligjore për gjyqtarët, prokurorët e shtetit dhe profesionistët e tjerë ligjor do të bëhet përmes aktiviteteve të bibliotekës e cila edhe gjatë vitit 2019 do të vazhdojë me pasurimin dhe menaxhimin e koleksioneve të saj.

Në kuadrin e aktiviteteve të bibliotekës do të vazhdohet me:

- Katalogimin dhe klasifikimin e materialeve të reja ligjore;
- Skanimin e librave fizik dhe publikimi i tyre në bibliotekën elektronike për të dhënë informacion më të detajuar për përmbajtjen e tyre;
- Ofrimit të qasjes në disa data baza të ndryshme ligjore deri në korrik 2018, si dhe me vazhdimin e anëtarësimit në Asociacionin e Bibliotekave Elektronike;
- Ofrimin e materialeve të reja ligjore për përfituesit e Akademisë;

Trajnimet për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive

6. Trajnimet për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive

Menaxhmenti i gjykatave dhe prokurorive janë faktorë kyç në mbarëvajtjen e proceseve brenda gjykatave dhe prokurorive që ata drejtojnë. Për udhëheqje të drejtë dhe efikase të gjykatave dhe prokurorive është e rëndësishme ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të kryetarëve, kryeprokurorëve, gjyqtarëve mbikëqyrës të degëve, udhëheqësve të departamenteve dhe divizioneve. Kjo me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, qëndrueshmërisë dhe rritjes së efikasitetit të punës në gjykata dhe prokurori.

Në funksion të kësaj, Akademia e Drejtësisë do të organizojë trajnime specifike për kategoritë e theksuara më lartë në përputhje me politikat dhe standardet e aplikueshme, dhe me kërkesat ligjore.

6.1 Menaxhimi i gjykatës dhe prokurorisë

Menaxhimi nënkupton organizimin dhe harmonizimin e resurseve për të arritur qëllimet e caktuara drejt sukseseve. Menaxhimi kërkon planifikim, organizim, udhëzime dhe monitorim. Prandaj, njohuritë e përgjithshme mbi menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive, duke filluar nga menaxhmenti, udhëheqësit tjerë që merren me menaxhimin e burimeve njerëzore, financave, zyrës qendrore të menaxhimit të lëndëve, zyrës për mbështetje juridike, zyrës për logjistike dhe zyrën për informim, duhet të zhvillohen edhe më tutje nëpërmjet trajnimeve praktike.

Si menaxhohet suksesshëm një gjykatë apo prokurori? Cilat janë parimet standarde të menaxhimit të mirë? Cilat janë sfidat dhe mangësitë aktuale të menaxhimit të gjykatës dhe prokurorisë?

Ky trajnim është hartuar për të ju përgjigjur pyetjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive përmes kombinimit të prezantimeve ku do të trajtohen strategjitë e avancuara që kanë të bëjnë me menaxhimin e suksesshëm të gjykatave dhe prokurorive. Gjatë tërë procesit do të behet një qasje pragmatike e implementimit të rregullave për një menaxhim të suksesshëm dhe efektiv.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë parimet standarde të menaxhimit të mirë;
- Identifikojnë kriteret për planifikimin e suksesshëm;
- Zbatojnë parimet dhe metodologjinë e planifikimit;

Përmbajtja

- Menaxhimi në përgjithësi dhe menaxhimi i gjykatës dhe prokurorisë;
- Përgjegjësitë menaxheriale;
- Burimet njerëzore dhe financat;

Përfituesit: Kryetarët, kryeprokurorët, gjyqtarët mbikëqyrës të degëve, udhëheqësit e departamenteve dhe divizioneve.

Kohëzgjatja: Një ditë

6.2 Komunikimi në gjykata dhe prokurori

Komunikimi është transmetimi i informacionit ndërmjet anëtarëve të një institucioni dhe përfshinë një gamë të gjerë të strategjive të brendshme si: komunikimin vertikal, horizontal, formal dhe joformal. Ekzistojnë dy elemente në strategjinë e komunikimit të brendshëm, strategjia dhe plani i veprimit për zbatimin e saj dhe qasja për komunikimin e brendshëm, i cili duhet të jetë i pozicionuar në një plan më shumë se të thjeshtë për të prekur intervenimet taktike në mbështetje të aktiviteteve të organizatës.

Çka është komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm? Cilat janë stilet e komunikimit? Sa është i rëndësishëm komunikimi në mbështetje të aktiviteteve të gjykatës apo prokurorisë?

Deri në fund të këtij trajnimi, menaxhmenti i gjykatave dhe prokurorive do të përmirësojnë aftësitë e tyre personale të komunikimit dhe do të jenë në gjendje të zgjedhin rrugën e duhur të komunikimit brenda gjykatës apo prokurorisë për të cilën ata janë përgjegjës.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë aftësitë e tyre personale të komunikimit;
- Dallojnë komunikimin e jashtëm dhe të brendshëm;
- Njohin stilet e komunikimit.

Përmbajtja

- Hyrje në strategjinë e komunikimit të brendshëm;
- Komunikimi i menaxhmentit me mediat,
- Shpërndarja e mesazhit;
- Zgjedhja e kanaleve dhe kontrollit;
- Komunikimi i projektit, komunikimi i ndryshimit, komunikimi i krizës.

Përfituesit

Kryetarët, kryeprokurorët, gjyqtarët mbikëqyrës të degëve, udhëheqësit e departamenteve dhe divizioneve.

Kohëzgjatja: Një ditor

Trajnimet për gjyqtarë porotë

7. Trajnimet për gjyqtarë porotë

Gjyqtarët porotë nuk janë gjyqtarë profesionist, ata kanë përgatitje të ndryshme arsimore duke filluar nga arsimimi i mesëm e deri te arsimimi i lartë. Pjesa dërmuese e gjyqtarëve porotë nuk janë me profesionin e juristit por profesione të ndryshme si: pedagog, sociolog, edukatorë, punonjës arsimor etj. Meqë fushat prej nga ata vinë janë të ndryshme, rezulton nevoja e familjarizimit me praktikatat dhe proceset që zhvillohen në gjykatë duke qenë se ata shërbejnë krahas gjyqtarëve profesionistë në trupe gjykuese në çështjet familjare dhe proceset gjyqësore që zhvillohen ndaj të miturve.

Qëllimi i trajnimeve për gjyqtarët porotë konsiston në nevojën për ngritje të njohurive lidhur me ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi që ju jep ligji.

7.1 Roli dhe detyrat e gjyqtarit porotë në procedurë gjyqësore

Kodi i Drejtësisë për të Mitur dhe Ligji për Familjen parashohin kushtet ligjore kur gjyqtarët porotë janë pjesë përbërëse e trupit gjykues. Gjyqtarët porotë luajnë një rol të rëndësishëm në proceset gjyqësore, ku ata marrin pjesë, duke dhënë kontributin e tyre nga profile të ndryshme të cilave ju takojnë.

Cili është roli dhe detyra e gjyqtarëve porotë? Sa janë gjyqtarët porotë të familjarizuar me praktikatat dhe proceset që zhvillohen në gjykatë?

Ky trajnim synon përmirësimin e shkathtësive praktike të gjyqtarëve porotë në zbatimin e ligjit dhe etikes profesionale.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Vlerësojnë rëndësinë dhe peshën e vendimmarrjes nga ana e tyre;
- Dallojnë trupin gjykues për të mitur dhe të rritur;
- Njohin sjelljen e mirë dhe të pahijshme në bazë të parimeve dhe rregullave të etikes së gjyqtarëve porotë.

Përmbajtja

- Roli dhe detyrat e gjyqtarit porotë në procedurën për të mitur;
- Roli dhe pozita e gjyqtarit porotë në procedurën për çështje familjare;
- Etika e gjyqtarit porotë.

Përfituesit: Gjyqtarët porotë

Kohëzgjatja: Një ditë

Trajnimi i stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive

8. Trajnimi i stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive

Akademia e Drejtësisë, përveç trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në mandatin e saj ka përgjegjësi edhe për organizimin e kurseve trajnuese për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive, përfshirë këtu edhe zyrtarë të SKGJK dhe SKPK.

Stafi administrativ i gjykatave dhe prokurorive janë faktorë kyç në procesin e punës në gjykata dhe prokurori dhe përbëhen nga kategori dhe profile të ndryshme të stafit, në varësi të strukturës organizative, detyrave të punës si dhe kompetencave specifike.

Si rezultat i këtij programi trajnues synohet:

- Ngritja profesionale e vazhdueshme stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve në gjykata dhe prokurori
- Aplikimi i standardeve adekuate gjatë procesit të punës në gjykata dhe prokurori

Skema programore për stafin administrativ të sistemit gjyqësor/prokurorial përbëhet nga këto module:

1. Sistemi Gjyqësor/Prokurorial i Kosovës-struktura dhe kompetencat
2. Menaxhimi i punës në administratën e Sistemit Gjyqësor/Prokurorial
3. Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore
4. Menaxhimi i dosjes në gjykatë/prokurori
5. Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun
6. Integriteti dhe sjelljet etike
7. Shkathtësitë e buta

Stafi administrativ i gjykatave dhe prokurorive dhe stafi i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial do të vijojnë modulet trajnuese që i përgjigjen detyrave dhe natyrës së punës.

Këtij programi të trajnimeve mund t'i shtohen edhe module tjera nëse vlerësohet e nevojshme nga KGJK, KPK apo varësisht nga zhvillimet tjera.

8.1 Moduli 1 - Sistemi gjyqësor dhe prokurorial, struktura dhe kompetencat

Sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial janë kategori kushtetuese dhe ligjore. Në kuadër të sistemit gjyqësor dhe prokurorial hyjnë trupat administruese të tyre si: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Gjykatat dhe Prokurori i Shtetit.

Mandati, struktura dhe kompetencat e këshillave, gjykatave dhe prokurorive janë të përcaktuara me ligje të veçanta.

Qëllimi kryesor i këtij moduli trajnues është që përmes temave konkrete të njoftojë stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive me kompetencat, strukturën organizative, mandatin dhe kornizën ligjore të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Në kuadër të modulit trajnues do të trajtohen edhe zhvillimet aktuale përreth punës së këshillave, vendimet më të rëndësishme të tyre, aktet normative kryesore dhe politikat e ndryshme për administrimin e sistemit. Gjithashtu sfidat në ushtrimin e mandatit të këshillave, gjykatave dhe prokurorit të shtetit do të jenë pjesë e diskutimeve në trajnimet e këtij moduli.

Objektivat

Pas përfundimit të trajnimeve të këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Njohin strukturën, organizimin dhe kompetencat e sistemit gjyqësor / prokurorial;
- Zbatojnë aktet normative dhe politikat e Këshillave.

Përmbajtja

- Korniza ligjore e sistemit gjyqësor-prokurorial
- Organizimi i sistemit gjyqësor-prokurorial
- Kompetencat e sistemit gjyqësor-prokurorial

Metodologjia e trajnimit

Gjatë mbajtjes së trajnimeve të cilat janë pjesë e këtij moduli do të përdoret metodologjia si në vijim:

- Prezantim i shkurtër i temave përmes teknikave moderne trajnuese;
- Diskutime interaktive me pjesëmarrës (pyetje / përgjigje / komente);
- Demonstrim i dokumenteve të Këshillit / video eventuale (takime / pune të këshillit).

Përfituesit

Zyrtarët ligjorë (përfshirë zyrtarët ligjor të sekretariateve), referentët administrativ dhe zyrtarët për komunikim me mediat dhe publikun.

Kohëzgjatja: Një ditore

8.2 Moduli 2 - Menaxhimi i punës në administratën e sistemit gjyqësor dhe prokurorial

Sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial përbëjnë njërin nga shtyllat kryesore të pushtetit shtetëror. Korniza ligjore aktuale përkthet me gjyqësorin dhe prokurorinë është e veçantë dhe ka themeluar dy trupa administruese, përkatësisht Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK).

Kjo kornizë ligjore po ashtu ka rregulluar edhe strukturën e gjykatave dhe prokurorive. Në kuadër të trupave administruese të sistemit gjyqësor (KGJK) dhe prokurorial (KPK) si dhe në kuadër të gjykatave dhe prokurorive, funksionon administrata e cila ka status, strukturë organizative dhe kompetenca specifike. Kjo administratë përfshinë kategori dhe profile të ndryshme të stafit, në varësi të strukturës organizative dhe detyrave të punës.

Trajnimet të cilat do të ofrohen në kuadër të këtij moduli do të trajtojnë aspekte të menaxhimit dhe udhëheqjes, planifikimit, vendimmarrjes dhe punës së përditshme, përfshirë por pa u kufizuar në efikasitetin dhe llogaridhënien e stafit administrativ. Qëllimi i organizimit të trajnimeve nga ky modul është forcimi i sistemit të menaxhimit të shërbimeve të cilat i ofrojnë sekretariatet përkatëse të këshillave (KGJK dhe KPK), duke filluar nga ofrimi i shërbimeve efikase dhe efektive për këshille, gjykata dhe prokurori.

Roli dhe përgjegjësitë e sekretariatit të KGJK-së në raport me gjykatat duhet të merret parasysh në krahasim me rolin dhe përgjegjësitë e sekretariatit të KPK-së në raport me Prokurorin e Shtetit. Trajnimet e ofruara përmes këtij moduli trajnues, gjithashtu kanë për qëllim të rrisin kualitetin e shërbimeve të administratës së gjykatave dhe prokurorive.

Objektivat

Pas përfundimit të trajnimeve të këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Aplikojnë standardet adekuate të menaxhimit dhe udhëheqjes;
- Hartojnë plane për një punë të suksesshme dhe marrin vendime të arsyeshme;
- Krijojnë ambient për një punë kreative, efikase dhe efektive;
- Menaxhojnë situatat stresuese dhe punës me presion.

Përmbajtja

- Menaxhimi dhe udhëheqja;
- Planifikimi dhe vendimmarrja;
- Proceset e brendshme dhe të jashtme të punës;
- Efikasiteti dhe llogaridhënia e stafit administrativ.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë mbajtjes së trajnimeve të cilat janë pjesë e këtij moduli do të përdoret metodologjia si në vijim:

- Prezantim i shkurtër i temave përmes teknikave moderne trajnuese;
- Diskutime interaktive me pjesëmarrës (pyetje / përgjigje);

PROGRAMI I TRAJNIMEVE 2019

- Pune në grupe (ndarje paraprake e detyrave);
- Përdorimi i kuizeve, videove, lojërave dhe filmave;
- Përgatitje e rasteve praktike dhe diskutimi i tyre me pjesëmarrës (modele te planeve te punës, planeve strategjike, agjendave të punës, raporteve etj);
- Hartim i dokumenteve të ndryshme ne mënyrë individuale dhe në grupe (plane pune, plane strategjike, procedura standarde operative, raporte etj).

Përfituesit

Udhëheqësit e njësive organizative të sekretariateve të këshillave (SKGJK dhe SKPK), stafi i njësitit për shqyrtimin e performances së Prokurorisë, administratorët, ndihmës administratorët e gjykatave, administratoret e prokurorive, udhëheqësit e shkrimoreve.

Kohëzgjatja: Sesion dy ditor

8.2.1 Nën moduli 1 - Menaxhimi dhe Udhëheqja

Konceptet e menaxhimit dhe udhëheqjes përfshijnë në vete segmente të diskutueshme vazhdimisht, pothuajse në të gjitha vendet. Se çka diskutohet, për çfarë arsye, cili është qëllimi i këtyre diskutimeve, mbetet ende i pa definuar përfundimisht. Në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës mbetet sfida e vazhdueshme ngritja e kapaciteteve menaxhuese dhe udhëheqëse. Ky sistem ka nevojë të ndërtojë një strukturë të qëndrueshme menaxhuese dhe udhëheqëse në mënyrë që të jetë më efikas, efektiv dhe llogaridhënës.

Zhvillimet aktuale lidhur reformimin dhe ristrukturimin e administratës e shtojnë edhe më tepër nevojën për ngritjen e nivelit të menaxhimit dhe forcimit të lidershit në administratën e gjyqësorit dhe prokurorisë. Nevojat e sipërpërmendura do të adresohen përmes trajtimit të nën temave të ndryshme të planifikuara që përfshihen në kuadër të kësaj teme.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Aplikojnë standardet adekuate të menaxhimit dhe udhëheqjes;
- Hartojnë plane për një punë të suksesshme dhe marrin vendime të arsyeshme;
- Krijojnë ambient për një punë kreative, efikase dhe efektive;
- Menaxhojnë situatat stresuese dhe punës me presion.

Përmbajtja

- Koncepti dhe parimet e menaxhimit dhe udhëheqjes;
- Praktikrat dhe standardet bashkëkohore të menaxhimit dhe udhëheqjes;
- Efektet e menaxhimit dhe udhëheqjes së mirë;
- Delegimi, mbikëqyrja dhe llogaridhënia.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë mbajtjes së këtij trajnimi do të përdoret metodologjia si në vijim:

- Prezantim i shkurtër i temave përmes teknikave moderne trajnuese;
- Diskutime interaktive me pjesëmarrës (pyetje / përgjigje);
- Punë në grupe (ndarje paraprake e detyrave);
- Përdorimi i kuizeve, videove, lojërave dhe filmave;
- Përgatitje e rasteve praktike dhe diskutimi i tyre me pjesëmarrës.

Përfituesit

Udhëheqësit e njësive organizative të sekretariateve të këshillave (KGJK dhe KPK), stafi i Njësitit për Shqyrtimin e Performances së Prokurorisë, Administratorët, Ndihmës administratorët e gjykatave, administratorët e prokurorisë, udhëheqësit e shkrimoreve.

Kohëzgjatja: Një ditor

8.2.2 Nën moduli 2 - Proceset e brendshme dhe të jashtme të punës

Në kuadër të administratës së sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës ekziston administrata e këshillave dhe ajo e gjykatave dhe prokurorive. Përgjegjësitë dhe detyrat e këtij stafi administrativ janë të ndryshme dhe të orientuara për arritjen e qëllimeve të përbashkëta. Në praktike është vërejtur aplikim i ndryshëm i standardeve të komunikimit dhe realizimit të detyrave të përditshme.

Me qëllim të harmonizimit dhe unifikimit të praktikave, krijimit të standardeve të qëndrueshme dhe zbatimit unik të akteve ligjore e nënligjore lidhur me punën e administratës së sistemit gjyqësor dhe prokurorial, në kuadër të këtij trajnimi do të trajtohen çështje të ndryshme rreth proceseve të brendshme dhe të jashtme të punës.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Aplikojnë standardet adekuate të komunikimit;
- Zbatojnë në mënyrë unike përgjegjësitë dhe detyrat e punës;
- Përbushin detyrat e punës në afat dhe në mënyrë efektive.

Përmbajtja

- Struktura organizative dhe përgjegjësitë reciproke, përfshirë llogaridhënien;
- Mënyra e komunikimit dhe standardet e kërkuara;
- Rëndësia e unifikimit të praktikave dhe mënyrës së punës.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë mbajtjes së këtij trajnimi do të përdoret metodologjia si në vijim:

- Prezantim i shkurtër i temave përmes teknikave moderne trajnuese;
- Diskutime interaktive me pjesëmarrës (pyetje / përgjigje);
- Punë në grupe (ndarje paraprake e detyrave);
- Përgatitje e rasteve praktike dhe diskutimi i tyre me pjesëmarrës.

Përfituesit: Udhëheqësit e njësive organizative të sekretariateve të këshillave (KGJK dhe KPK), stafi i Njësitit për Shqyrtimin e Performances së Prokurorisë, Administratorët, Ndihmës administratorët e gjykatave, administratorët e prokurorive, udhëheqësit e shkrimoreve.

Kohëzgjatja: Një ditore

8.2.3 Nën moduli 3 - Planifikimi dhe vendimmarrja

Planifikimi konsiderohet element kyç i çdo pune të suksesshme, përmes të cilit krijohen kushte më të mira për një vendimarrje në kohë, të arsyeshme dhe bazuar në objektiva konkrete. Përmes planifikimit krijohen mundësitë që të ngritet niveli i llogaridhënies dhe përgjegjësive në përmbushje të detyrave të punës sidomos të stafi menaxherial dhe jo vetëm.

Ekziston një nevojë e padiskutueshme që menaxhmenti i të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial të ngritë shkathtësitë e planifikimit dhe aftësitë e vendimmarrjes. Një gjë e tillë synohet të arrihet përmes diskutimit të çështjeve të ndryshme relevante gjatë trajnimit të organizuar për këtë qellim.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Aplikojnë standardet dhe praktikat më të mira të planifikimit;
- Hartojnë plane për arritjen e objektivave të caktuara;
- Marrin vendime të arsyeshme dhe të drejta.

Përmbajtja

- Planifikim si mundësi për një punë të suksesshme;
- Vendimmarrja e bazuar në planifikim.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë mbajtjes së këtij trajnimi do të përdoret metodologjia si në vijim:

- Prezantim i shkurtër i temave përmes teknikave moderne trajnuese;
- Diskutime interaktive me pjesëmarrës (pyetje / përgjigje);
- Punë në grupe (hartimi i planeve të punës dhe vendimeve).

Përfituesit

Udhëheqësit e njësive organizative të sekretariateve të këshillave (KGJK dhe KPK), stafi i Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, Administratorët, Ndihmës administratorët e gjykatave, administratorët e prokurorive, udhëheqësit e shkrimoreve.

Kohëzgjatja: Një ditore

8.2.4 Nën moduli 4 - Efikasiteti dhe Llogaridhënia

Efikasiteti në punë do të ishte satisfaksioni i vetëm për çdo angazhim në kryerje të punëve të zyrës. Efikasiteti është edhe baza kryesore e një vlerësimi pozitiv të performancës individuale dhe kolektive në kuadër të institucionit.

Një punë efikase do të mundësonte edhe një llogaridhënie kuptimplote. Llogaridhënia përmes mekanizmave institucional ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e imazhit dhe integritetit të institucionit dhe stafit që është pjesë e tij. Gjithashtu efikasiteti në punë dhe llogaridhënia ndikojnë drejtpërdrejt në nivelin e perceptimit të publikut për punën e institucionit.

Përmes trajnimeve të stafit administrativ të sistemit gjyqësor dhe prokurorial synohet që të arrihet ngritja e efikasitetit dhe llogaridhënies së tyre.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Aplikojnë standardet adekuate të menaxhimit dhe udhëheqjes;
- Hartojnë plane për një punë të suksesshme dhe marrin vendime të arsyeshme;
- Krijojnë ambient për një punë kreative, efikase dhe efektive;
- Menaxhojnë situatat stresuese dhe punës me presion.

Përmbajtja

- Metodologjia e një pune efikase;
- Rëndësia e llogaridhënies së stafit administrativ;
- Raportimi (llojet e ndryshme të raportimit).

Metodologjia e trajnimit

Gjatë mbajtjes së këtij trajnimi do të përdoret metodologjia si në vijim:

- Prezantim i shkurtër i temave përmes teknikave moderne trajnuese;
- Diskutime interaktive me pjesëmarrës (pyetje / përgjigje);
- Puna në grupe;
- Përgatitja e rasteve praktike dhe diskutimi i tyre me pjesëmarrës.

Përfituesit

Udhëheqësit e njësive organizative të sekretariateve të këshillave (KGJK dhe KPK), stafi i Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, Administratorët, Ndihmës administratorët e gjykatave, administratorët e prokurorive, udhëheqësit e shkrimoreve.

Kohëzgjatja: Një ditë

8.3 Moduli 3 - Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore

Moduli shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore ka për qëllim të ndihmoj juristët (bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe asistentët-sekretarët juridik) në ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale.

Ky modul është i fokusuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale të juristëve lidhur me zhvillimin e shkathtësive profesionale për të dhënë vlerësimet e duhura më rastin e pranimit të kërkesave për fillimin e procedurave të ndryshme ligjore. Gjithashtu, për të ndërmarrë veprimet e duhura procedurale lidhur me përgatitjen e fazave pasuese të procedurës dhe për të hartuar aktet / vendimet e ndryshme varësisht nga përfundimi që është arritur si rezultat i procedurës përkatëse.

Me fokus të veçantë në kuadër të këtij moduli do të shtjellohen teknikat e hulumtimit ligjor, shkrim dhe arsyetimi ligjor si parakushte për ngritjen e cilësisë dhe efikasitetit në zbatimin e kompetencave gjyqësore dhe prokuroriale për trajtuar me kohë dhe në mënyrë profesionale çështjet e ngritura.

Ky modul do zhvillohet në një ambient interaktiv diskutimi në mënyrë që drejtpërdrejtë të ndihmohet në zhvillimin e aftësive analitike tek juristët. Përveç udhëzimeve teorike do të ofrohen edhe raste konkrete nga procedura të ndryshme (gjyqësore dhe prokuroriale) si mundësi që drejtpërdrejtë në mënyrë konkrete të demonstrohet mënyra e trajtimit të rastit sipas një strukture analitike hap pas hapi që garanton përfundimet e duhura.

Shkrimi dhe arsyetimi ligjor përveç që paraqet një standard të vlerësimi në punës së juristëve, rrjedhimisht përfaqëson edhe një objektivë jo lehtë të arritshme, prandaj përmes këtij moduli synohet që të përmirësohet cilësia e arsyetimit dhe shkrimit ligjor.

Cilat janë teknikat e hulumtimit ligjor? Cilat veprime duhet të ndërmerren me rastin e fillimit të një procedure? Cilat veprime duhet të ndërmarrën për përgatitjen e fazave pasuese pas fillimit të procedurës? Çka nënkupton metoda IRAC? Si mund të zbatohet metoda IRAC gjatë hartimit të vendimeve gjyqësore? Cila është struktura dhe përmbajtja e vendimeve gjyqësore sipas dispozitave ligjore?

Ky trajnim është hartuar për të dhënë udhëzimet teorike dhe praktike lidhur me shkathtësitë e hulumtimit ligjor, shkathtësitë e trajtimit të rasteve dhe shkathtësitë për shkrimin dhe arsyetimin ligjor, sipas metodave dhe standardeve që garantojnë objektivitet, siguri, cilësi dhe efikasitet.

Objektivat

Si rezultat i këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Njohin teknikat e hulumtimit ligjor;
- Zbatojnë kompetencat për shqyrtimin e rasteve dhe përgatitjen e fazave pasuese të procedurës;
- Njohin procesin dhe parimet e shkrimit të mirë ligjor;
- Zbatojnë në mënyrë efektive metodën IRAC;
- Hartojnë në mënyrë të pavarur vendimet gjyqësore dhe aktet akuzuese.

Përmbajtja

- Teknikat e hulumtimit ligjor;
- Shqyrtimi paraprak i rasteve dhe ndërmarrja e veprimeve për përgatitjen e fazave pasuese në procedurë;
- Shkrimi dhe arsyetimi ligjor.

Metodologjia e trajnimit

Trajtimi teorik dhe demonstrim praktik i teknikave të hulumtimit ligjor, i parimeve të shkrimit të mirë ligjor dhe i metodave për shkrimin dhe arsyetimin ligjor. Trajtim teorik dhe praktik i veprimeve në fazën e shqyrtimit paraprak të procedurës dhe veprimeve për përgatitjen e fazave pasuese deri në përfundimin e procedurës.

Për të arritur objektivat e trajnimit në mënyrë praktike do të demonstrohen teknikat e hulumtimit ligjor (përmes internetit). Për nën modulën e shkrimit dhe arsyetimit ligjor do të përdoret Power Point, rastet praktike dhe detyrat. Për nën modulën e shqyrtimit paraprak dhe përgatitjes së fazave të procedurës do të përdoret Power Point, shpjegimet teorike dhe rastet praktike.

Përfituesit: Bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe asistentet-sekretaret juridike.

Kohëzgjatja: Tre (3) ditore

8.3.1 Nën moduli 1 - Teknikat e hulumtimit ligjor

Përmes këtij nën moduli synohet që të ngriten njohuritë e juristeve për teknikat e hulumtimit si parakusht i organizimit, studimit dhe vlerësimit të rastit. Është i pamundshme zhvillimi dhe përfundimi i procedurave gjyqësore-prokuroriale pa referencën e duhur ligjore dhe rrjedhimisht është e pamundshme të sigurojmë burimet duhura pa hulumtim. Andaj, përmes këtij nën moduli, do të ndihmohet në zhvillimin e shkathtësive që përmes teknikave të hulumtimit të sigurohet efikasiteti i duhur në sigurimin e burimeve të nevojshme për të trajtuar një çështje, por edhe për tu siguruar për validitetin e veprimeve tona në procedurë.

Objektivat

Si rezultat i këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Njohin teknikat e hulumtimit ligjor si dhe burimet në dispozicion;
- Mësojnë opsionet e kërkimit;
- Avancojnë njohuritë për resurset e burimeve në Kosovë.

Përmbajtja

- Hyrje në hulumtimin juridik si dhe burimet në dispozicion;
- Kategoritë e informatave;
- Cilësia e resurseve;
- Hulumtimi i bazës së të dhënave - çka ka në dispozicion si dhe si funksionon
- Opsionet e kërkimit - dallimet në bazat e të dhënave;
- Operatorët logjikë;
- Teknikat e kërkimit në përgjithësi;
- Strategjitë e përgjithshme të kërkimit;
- Resurset në Kosovë;
- Akademia e Drejtësisë e Kosovës;
- Hyrje në përmbledhjet e komentareve të ligjeve;
- Organizimi brenda një gjykate të veçantë.

Metodologjia e trajnimit

Trajtimi teorik dhe demonstrim praktik i teknikave të hulumtimit ligjor, i parimeve të shkrimit të mirë ligjor dhe i metodave për shkrimin dhe arsyetimin ligjor. Trajtim teorik dhe praktik i veprimeve në fazën e shqyrtimit paraprak të procedurës dhe veprimeve për përgatitjen e fazave pasuese deri në përfundimin e procedurës.

Për të arritur objektivat e trajnimit në mënyrë praktike do të demonstrohen teknikat e hulumtimit ligjor (përmes internetit). Për nën modulën e shkrimit dhe arsyetimit ligjor do të përdoret PowerPoint, rastet praktike dhe detyrat. Për nën modulën e shqyrtimit paraprak dhe përgatitjes së fazave të procedurës do të përdoret PowerPoint, shpjegimet teorike dhe rastet praktike.

Përfituesit: Bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe asistentet-sekretaret juridike.

Kohëzgjatja: Një ditore

8.3.2 Nën moduli 2 - Shqyrtimi paraprak i rasteve dhe ndërmarrja e veprimeve për përgatitjen e fazave pasuese në procedurë

Përmes këtij nën moduli synohet që të ngritën kapacitetit profesionale të juristëve lidhur me fazën paraprake të shqyrtimit qoftë të rasteve në prokurori, apo në gjykatë, si në çështje civile ashtu edhe në çështje penale. Parakusht i zhvillimit të një procedure të rregullt: ligjërish, objektive, efikase dhe të besueshme është njohja dhe zbatimi i duhur i kompetencave në fazën e shqyrtimit paraprak. Vlerësimi i kushteve nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor apo e inicimit të procedurës penale tek prokurori është parakusht për kalimin në fazat tjera të procedurës.

Pra nëse nuk ndërmerren veprimet e duhura në fazën e shqyrtimit paraprak, apo nëse behën gabim në këtë fazë, atëherë sigurisht edhe fazat tjera të procedurës e rrjedhimisht edhe vendimi përfundimtarë do të përcjellën me të meta e njëjta, prandaj është shumë e rëndësishme që zyrtarët që ndihmojnë gjyqtarët apo prokuroret të kenë njohurit e duhura për trajtimin/shqyrtimin e rasteve.

Objektivat

Si rezultat i këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Njohin kompetencat dhe veprimet që duhet të ndërmerren në fazën e shqyrtimit paraprak;
- Zbatojnë dispozita ligjore për vlerësimin e lejueshmërisë së procedurës së iniciuar;
- Ndërmarrin veprime për evitimin e të metave nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor;
- Ndërmarrin veprime për përgatitjen e fazave pasuese në procedurë.

Përmbajtja

- Vlerësimi i kallëzimit penal dhe mënyrat e veprimit pas vlerësimit të kallëzimit penal
- Shqyrtimi paraprak i padisë
- Veprimet për evitimin e pengesave procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor
- Veprimet për përgatitjen e shqyrtimit kryesor

Metodologjia e trajnimit

Trajtimi teorik dhe demonstrim praktik i teknikave të hulumtimit ligjor, i parimeve të shkrimit të mirë ligjor dhe i metodave për shkrimin dhe arsyetimin ligjor. Trajtim teorik dhe praktik i veprimeve në fazën e shqyrtimit paraprak të procedurës dhe veprimeve për përgatitjen e fazave pasuese deri në përfundimin e procedurës.

Për të arritur objektivat e trajnimit në mënyrë praktike do të demonstrohen teknikat e hulumtimit ligjor (përmes internetit). Për nën modulën e shkrimit dhe arsyetimit ligjor do të përdoret PowerPoint, rastet praktike dhe detyrat. Për nën modulën e shqyrtimit paraprak dhe përgatitjes së fazave të procedurës do të përdoret PowerPoint, shpjegimet teorike dhe rastet praktike.

Përfituesit: Bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe asistentet-sekretarët juridike.

Kohëzgjatja: Një ditore

8.3.3 Nën moduli 3 - Shkrimi dhe arsyetimi ligjor

Përmes këtij moduli synohet të ngritën kapacitetet profesionale për shkrimin dhe arsyetimin ligjor duke ju dhënë mundësi pjesëmarrësve të njihen me standardet bashkëkohore të shkrimit dhe arsyetimin ligjor. Shkrimi dhe arsyetimi ligjor është pjesë e punës së përditshme për secilin zyrtar të gjykatave dhe prokurorive, prandaj është edhe parakusht për ngritje të cilësisë së vendimeve gjyqësore dhe akteve të tjera të ndryshme, e rrjedhimisht edhe parakusht për efikasitetin dhe besueshmërinë e publikut në vendimet gjyqësore.

Objektivat

Si rezultat i këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Njohin parimet e shkrimit të mirë ligjor;
- Njohin metodat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor;
- Hartojnë vendimet sipas metodës IRAC.

Përmbajtja

- Procesi dhe parimet e të shkruarit mirë ligjor;
- Procesi i të shkruarit;
- Parimet e të shkruarit ligjor;
- Shkrimi dhe arsyetimi ligjor përmes metodës IRAC, si dhe metoda “IRAC”;
- Pyetje të Strukturuar;
- Procesi Analitik;
- Rëndësia dhe nevoja për procesin analitik;
- Sfidat analitike;
- Analiza e Shkruar Ligjore;
- Struktura dhe përmbajtja e arsyetimit të aktgjykimit;
- Udhëzime për Shkrimin dhe Arsyetimin e Aktgjykimeve

Metodologjia e trajnimit

Trajtimi teorik dhe demonstrim praktik i teknikave të hulumtimit ligjor, i parimeve të shkrimit të mirë ligjor dhe i metodave për shkrimin dhe arsyetimin ligjor. Trajtim teorik dhe praktik i veprimeve në fazën e shqyrtimit paraprak të procedurës dhe veprimeve për përgatitjen e fazave pasuese deri në përfundimin e procedurës.

Për të arritur objektivat e trajnimit në mënyrë praktike do të demonstrohen teknikat e hulumtimit ligjor (përmes internetit). Për nën modulën e shkrimit dhe arsyetimit ligjor do të përdoret PowerPoint, rastet praktike dhe detyrat. Për nën modulën e shqyrtimit paraprak dhe përgatitjes së fazave të procedurës do të përdoret PowerPoint, shpjegimet teorike dhe rastet praktike.

Përfituesit: Bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe asistentet-sekretaret juridike.

Kohëzgjatja: Një ditore

8.4 Moduli 4 - Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial

Prokuroria si organ shtetëror i pavarur, është në funksion të zbatimit të ligjit në mënyre të drejt, të pavarur dhe të paanshme. Bazuar në kushtetutë dhe ligje të veçanta, roli i Prokurorit të Shtetit është zbulimi i veprave penale dhe ndjekja e kryerësve të tyre. Në funksion të zbatimit të drejtë të ligjit, prokuroria ka për detyrim që rastet ti trajtoj në kohë duke respektuar të drejtat e palëve të përfshira në procedure.

Ndërkaq gjykatat si organe shtetërore janë formuar me qëllim të ndarjes së drejtësisë për subjektet procedurale dhe që të gjitha rastet që paraqiten para tyre të adresohen dhe zgjidhen brenda një kohe të arsyeshme duke u munduar që në çdo kohë ti përmbahen kufizimeve kohore të përcaktuar sipas ligjeve pozitive.

Prandaj, njëra nga funksionet qendrore të gjykatave dhe prokurorive është menaxhimi i lëndëve. Teoria moderne për menaxhimin e lëndëve është që gjyqtarët dhe prokurorët, së bashku me stafin mbështetës, në mënyrë aktive të monitorojnë dhe të kontrollojnë lëvizjen e lëndëve në atë gjykatë dhe prokurori.

Menaxhimi i rasteve, zhvillimi dhe aplikimi i teknikave të menaxhimit të rasteve individuale nga gjyqtarët dhe prokurorët në krahasim me menaxhimin e fluksit të rasteve me të cilat merren gjykatat dhe prokurorit paraqesin sfida të cilat janë mjaft problematike në punën e përditshme në këto institucione.

Andaj, është parë nevoja e trajtimit të këtij moduli me qëllim që pas përfundimit të të njëjtit gjyqtarët dhe prokuror së bashku me stafin administrativë gjatë menaxhimit të rastit të bëjnë monitorimin e rasteve duke u bazuar në indikatorët të komisionit evropian për efikasitetin e gjykatave (CEPEJ), me qëllim të përcjelljes së efikasitetit të asaj gjykate, prokurorie dhe njëkohësisht përcjelljen e performances individuale të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe të stafit administrativë.

Bazuar në praktikat e mira të përdorimit të TI-së sistemi gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës është në fazën e transformimit të punës manual në gjykata dhe prokurori në atë elektronike duke bërë zhvillimin dhe implementimin e sistemit informativ të menaxhimit të lendeve.

Qëllimi kryesor i këtij moduli është që nëpërmjet prezantimit të koncepteve dhe parimeve të menaxhimit të rrjedhës së rasteve, pjesëmarrësit të njoftohen dhe të përgatiten me shkathtësi për identifikimin, fillimisht të problemeve të menaxhimit të rasteve dhe më pas për të zhvilluar dhe zbatuar një planë për menaxhimin e rrjedhjes së lendes.

A është adekuate mënyra e regjistrimit të lëndëve në regjistrat manual duke marrë parasysh vëllimin e madh të lëndëve të pranuar në gjykatë dhe prokurori? Regjistrat manual a ofrojnë të dhënat të mjaftueshme për statusin e lëndës? Regjistrat e tanishëm a janë burim i mjaftueshëm për ofrimin e të dhënave për matjen e performances së punës të stafit mbështetës? Sa janë të mjaftueshëm të dhënat nga regjistrat manual për përpilimin e raporteve statistikore? Cilët janë indikatorët bazik për monitorimin e performancës së Gjykatës dhe Prokurorisë? Si do të ndikojë procesi i dixhitalizimit të punës në prokurori dhe gjykata?

Objektivat

Si rezultat i këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Avancojnë njohuritë në menaxhimin e rasteve;
- Respektojnë parimet e menaxhimit të rasteve;
- Demonstrjnë teknikat e menaxhimit të rasteve.
- Të njoftohen me mbledhjen, analizimin dhe raportimin e statistikave;
- Të njoftohen me parimet – metodologjinë e CEPEJ;
- Mësojnë përdorimin e sistemit elektronik në gjykata dhe prokurori.

Përmbajtja

- Regjistrat e gjykatave dhe prokurorive;
- Organizimi i rrjedhës së punës dhe zhvillimit të lëndës;
- Mbledhja e të dhënave statistikore dhe raportimi;
- Menaxhimi efikas i lendeve bazuar në metodologjinë CEPEJ;
- Digjitalizimi i procesit të punës në gjykata dhe prokurori.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë mbajtjes së trajnimeve të cilat janë pjesë e këtij moduli do të përdoret metodologjia si në vijim:

- Prezantim i shkurtër i temave përmes teknikave moderne trajnuese;
- Diskutime interaktive me pjesëmarrës (pyetje/përgjigje);
- Pune në grupe (ndarje paraprake e detyrave);
- Përdorimi i kuizeve, videove, lojërave dhe filmave;
- Përgatitje e rasteve praktike dhe diskutimi i tyre me pjesëmarrës (modele të planeve të punës, planeve strategjike, agjendave të punës, raporteve etj);
- Hartim i dokumenteve të ndryshme në mënyrë individuale dhe në grupe

Përfituesit: Administratorët, ndihmës administrator, shefi i ZML-së, referentët, zyrtarët e statistikave, zyrtarët ligjor, sekretarët juridike, zyrtarët e informimit, njësi për vlerësimin e performances së prokurorëve.

Kohëzgjatja: Dy ditor

8.4.1 Nën moduli 1 - Regjistrat e gjykatave dhe prokurorive

Qëllimi kryesor i këtij nën moduli është që pjesëmarrësit të njoftohen me regjistrat përkatës të gjykatave dhe prokurorive, duke kuptuar drejtë nevojën e ekzistimit të tyre dhe njëkohësisht të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për evidentimin e të gjitha aktiviteteve gjyqësore respektivisht prokuroriale, dhe njëkohësisht këto regjistra të mirëmbahen dhe të ruhen sipas rregullave të përcaktuara në rregulloret mbi organizimin e brendshëm.

Zyrtarët përgjegjës për përdorim dhe mirëmbajtjen e regjistrave? A janë të mjaftueshëm llojet e regjistrave të tanishëm? A ofrojnë mundësi të mjaftueshme për evidentimin e të gjitha aktiviteteve gjyqësore-prokuroriale? A janë burim i mjaftueshëm për nevojat e statistikave? Si të veprohet në rast të humbjes – dëmtimeve të regjistrave?

Gjatë këtij prezantimi trajnuesit do të ofrojnë njohuri ligjor edhe teknikat e praktikës së mirë për adresimin e dilemave dhe pyetjeve, në atë mënyrë që pas paraqitjes së infrastrukturës ligjore do të japin shembuj praktik për zgjidhjen e këtyre dilemave – vështirësive që hasin zyrtarët gjatë regjistrimit të shkresave, mirëmbajtjes së regjistrit, lëvizjen e lëndës tek zyrtarët tjerë përkatës në gjykata dhe prokurori, dhe njëkohësisht pritjen e kthimit të tyre nga gjykatë dhe prokuror me qëllim të shënimit të aktiviteteve të nevojshme në regjistrat e deri tek përgatitja e shkresave të lëndës për arkivim të tyre dhe regjistrim në regjistrin e arkivit.

Objektivat:

Pas këtij prezantimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Njohin aktet normative lidhur me regjistrat dhe llojet e tyre të cilët zbatohen në gjykata dhe prokurori.
- Bëjnë evidentimin në mënyrën e duhur të shkresave të lëndës në regjistra.
- Ruajnë dhe mirëmbajnë në mënyrën e duhur këta regjistra.
- Bëjnë lëvizjen e shkresave të lëndës dhe përgatitjen e tyre për arkivim në kohën e duhur.

Përmbajtja

- Llojet e regjistrave
- Pranimi i shkresave
- Regjistrimi i lëndës
- Mirëmbajtja e regjistrave
- Asgjësimi i regjistrave

Metodologjia e trajnimit

Gjatë mbajtjes së trajnimeve të cilat janë pjesë e këtij moduli do të përdoret metodologjia si në vijim: Prezantim i shkurtër i temave përmes teknikave moderne trajnuese; Diskutime interaktive me pjesëmarrës (pyetje/përgjigje); Pune në grupe (ndarje paraprake e detyrave); Përdorimi i kuizeve, videove, lojërave dhe filmave; Përgatitja e rasteve praktike dhe diskutimi i tyre me pjesëmarrës (modele të planeve të punës, planeve strategjike, agjendave të punës, raporteve etj); Hartim i dokumenteve të ndryshme në mënyrë individuale dhe në grupe (plane pune, plane strategjike, procedura standarde operative, raporte etj).

Përfituesit: Shefat e ZML-së, referentët e gjykatave dhe prokurorive

Kohëzgjatja: 1 ditë

8.4.2 Nën moduli 2 - Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial

Qëllimi kryesor i këtij prezantimi është që pjesëmarrësit të njoftohen me organizimin rrjedhës së punës në gjykata dhe prokurori, duke kuptuar drejtë nevojën e organizimit të mbarëvajtjes së punës duke identifikuar rolin dhe rendësin e secilit zyrtarë administrativ si dhe aktivitetet e regjistrimit dhe të zhvillimit të lëndës nga momenti i pranimit të shkresave e deri të përgatitja për arkivim të tyre, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloret mbi organizimin e brendshëm.

Kush janë zyrtarët përgjegjës për organizimit të rrjedhës së punës dhe zhvillimit të lëndës? Cilat janë përgjegjësit dhe kompetencat e tyre për organizimit të rrjedhës së punës dhe zhvillimit të lëndës? Si zbatohet në praktikë caktimi i lëndëve tek gjyqtarët dhe prokurorët? Si veprohet në rastet lëvizjes dhe zhvillimit të lëndës? A veprohet drejtë në praktikën e përditshme për bashkimin – veçimin dhe përtëritjen e shkresave të lëndës?

Gjatë këtij prezantimi trajnuesit do të ofrojnë njohuri ligjor edhe teknikat e praktikës së mire për adresimin i dilemave dhe pyetjeve, në atë mënyrë që pas paraqitjes së infrastrukturës ligjore do të japin shembuj praktik për zgjidhjen e këtyre dilemave – vështirësive që hasin zyrtarët gjatë organizimit të rrjedhës së punës dhe zhvillimit të lëndës, regjistrimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Objektivat

Pas këtij prezantimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Njohin akte normative lidhur me organizimit të rrjedhës së punës dhe zhvillimit të lëndës.
- Njohin kompetencat dhe përgjegjësit e zyrtarëve administrativ për organizimit të rrjedhës së punës dhe zhvillimit të lëndës.
- Njohin hapat e lëvizjes e shkresave të lëndës dhe përgatitjen e tyre për arkivim.

Përmbajtja

- Kompetencat dhe përgjegjësit e zyrtarëve për organizimit të rrjedhës së punës
- Pranimi i shkresave
- Regjistrimi i lëndës
- Caktimi i lëndës dhe Mirëmbajtja e dosjes së lëndës
- Lëvizja e lëndës
- Bashkimi dhe veçimi i lëndëve
- Përtëritja e shkresave të lëndës
- Arkivimi i lëndës
- Asgjësimi i lëndëve

Metodologjia e trajnimit

Prezantim i shkurtër i temave përmes teknikave moderne trajnuese; Diskutime interaktive me pjesëmarrës (pyetje/përgjigje); Pune në grupe (ndarje paraprake e detyrave); Përdorimi i kuizeve, videove, lojërave dhe filmave; Përgatitje e rasteve praktike dhe diskutimi i tyre me pjesëmarrës.

Përfituesit: Administratorët dhe ndihmës administrator, shefat e ZML-së, zyrtarët ligjor dhe referentët.

Kohëzgjatja: Një ditë

8.4.3 Nën Moduli 3 - Mbledhja e të dhënave statistikore dhe raportimi

Qëllimi kryesor i këtij prezantimi është që pjesëmarrësit të njoftohen me mënyrën e mbledhjes së të dhënave statistikore dhe raportimit të tyre, duke kuptuar drejtë nevojën e mbledhjes së të dhënave statistikore dhe raportimin e tyre në funksion të monitorimit të punës së gjykatave dhe prokurorive në veçanti për statusin e lëndëve të vjetra, matjen e efikasitetit të punës në këto institucione si dhe vlerësimin individual të performancës të zyrtarëve të gjykatave dhe prokurorive.

Kush janë zyrtaret përgjegjës për mbledhjen e të dhënave statistikore dhe raportimin? A janë të mjaftueshme udhëzimet e tanishme për mbledhjen dhe raportimin e statistikave? A respektohen afatet e përcaktuara me rregullore për raportim? A janë regjistrat aktual burim i mjaftueshëm për mbledhjen dhe raportimin statistikor?

Gjatë këtij prezantimi trajnuesit do të ofrojnë njohuri ligjor edhe teknikat e praktikës së mirë për adresimin e dilemave dhe pyetjeve, në atë mënyrë që pas paraqitjes së infrastrukturës ligjore do të japin shembuj praktik për zgjidhjen e këtyre dilemave – vështirësive që hasin zyrtarët mbledhjes së të dhënave statistikore dhe raportimit të tyre, ruajtjes së të dhënave, adresimi i raportimit dhe konfidencialiteti i raporteve statistikore.

Objektivat

Pas këtij prezantimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Njohin akte normative lidhur me mbledhjen e të dhënave statistikore dhe raportimin.
- Të qasen në mënyrë të drejtë raportit statistikor.
- Raportojnë në afat ligjor dhe tek institucioni adekuat.

Përmbajtja

- Llojet e raporteve statistikore;
- Zyrtarët përgjegjës për mbledhjen e statistikave dhe raportim;
- Afatet kohore për raportim;
- Institucionet që duhet të paraqiten raportet statistikore.

Metodologjia e trajnimit

- Prezantimi në PowerPoint dhe material të shkruar;
- Trajnimi interaktiv;
- Demonstrimi i praktikave të mira.

Përfituesit: Administratorët dhe zëvendës administratorët, shefat e ZML-së, zyrtarët e statistikave për gjykata dhe prokurori

Kohëzgjatja: Një ditë

8.5 Moduli 5 - Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun

Qasja e publikut dhe e medieve në procedurat gjyqësore paraqet një ndër elementet kryesore të transparencës. Publiku në Kosovë është i etshëm të dijë se çka punohet nëpër gjykata. Në përgjithësi gjykatat në Kosovë kanë hapësirë të vogël dhe mungesë të sallave të gjyimit. Qasja e publikut në seancat gjyqësore rrit njohuritë e publikut për punën e gjykatave dhe besimin e qytetarëve tek gjykatat. Mediet paraqesin një nga mjetet dhe format më efikase të transparencës. Raportimet, historitë apo pjesët interesante nga proceset gjyqësore ishin, janë dhe mbetën çështje mjaft interesante për publikun.

Vrasjet e rënda, një divorc i të ashtuquajturve VIP-a, keqpërdorimi i pozitës zyrtare, çështjet me natyrë korrupsioni të udhëheqësve të lartë qeveritarë, udhëheqësve të ndërmarrjeve të mëdha publike, etj, janë vërtetë interesante dhe tërheqëse për median dhe interesante për t'u përfolur. Në anën tjetër, është e pamundur që i tërë publiku të mundet që të jetë prezent në seancat gjyqësore apo edhe të marrë njohuri për tërë atë që zhvillohet nëpër gjykata. Për këtë arsye edhe shtrohet nevoja që puna e gjykatave dhe prokurorive të bëhet e njohur për publikun. E tërë kjo realizohet përmes komunikimit me mediet dhe publikun.

Përderisa seancat gjyqësore janë të hapura për publikun (përveç atyre që me ligj duhet të jenë të mbyllura), publiku informohet nga ana e pjesëmarrësve të mediave. Megjithatë neve na duhet që të krijojmë raporte informacioni për ato që kanë ndodhur në seancat gjyqësore. Kjo realizohet nga ana e zëdhënësve të gjykatave dhe dilemat lindin se çfarë duhet raportuar, si duhet raportuar dhe a e kemi arritur qëllimin e raportimit. Po këto dilema shtrohen para nesh edhe atëherë kur neve na duhet që punën e institucionit tonë ua bëjmë të njohur medieve apo publikut.

Objektivat

Si rezultat i këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Kuptojnë rëndësinë e komunikimit në përgjithësi
- Zbatojnë në praktikë raportimin nga seancat gjyqësore
- Zbatojnë në praktikë komunikimin me media dhe publikun

Përmbajtja

- Qasja në komunikim dhe marrëdhëniet me medie
- Qasja e publikut në procedurat gjyqësore
- Qasja mediave në procedurat gjyqësore
- Raportimi nga seancat gjyqësore
- Prezantimi institucional dhe informata për publikun
- Rëndësia e prezantimit publik
- Kuptimi i kontekstit
- Kuptimi i kërkesës /interesimit
- Kuptimi i informatës/mesazhit
- Organizimi i konferencës për shtyp
- Procesi i përgatitjes së prezantimit, rezultatet e prezantimit
- Prezantimi publik, para publikut dhe prezantimi në media

Metodologjia e trajnimit

Metoda interaktive, diskutimi lidhur me raste praktike, loja e roleve etj., të cilat do të mundësojnë që pjesëmarrësit të marrin njohuri dhe në mënyrë praktike të demonstrojnë njohuritë e fituara.

Përfituesit: Zyrtaret përgjegjës për komunikim me medie dhe publikun në Gjykata dhe Prokurori.

Kohëzgjatja: Dy ditore.

8.5.1 Nën Moduli 1 - Qasja në komunikim dhe marrëdhënie me media

Qasja e publikut dhe e mediave po bëhet një gjë e pa shmangshme në procedurat gjyqësore. Me pjesëmarrjen e mediave dhe publikut në këto seanca plotësohet gjegjësisht respektohet parimi i publicitetit. Përveç kësaj, bëhet edhe respektimi i asaj se drejtësia jo vetëm që duhet të bëhet, por edhe duhet që të shihet se si po bëhet.

Mediat në të shumtën e rasteve, plasojnë për publikun e gjerë, çështje që veç atyre u interesojnë apo që bëjnë bujë në diskursin e përditshëm të komunikimit. Raportimet e tyre shpeshherë paraqiten tejet sipërfaqësore, duke u dhënë rëndësi në raportim çështjeve që kanë shumë më pak rëndësi për atë që është zhvilluar në seancën gjyqësore. Përfaqësuesit e mediave që raportojnë nga seancat gjyqësore por edhe redaktorët e tyre në të shumtën e rasteve janë të pa arsimuar në aspektin ligjor. Në praktikë shfaqen edhe raste kur përmes mediave tentohet që të ndikohet në vendimin përfundimtar të trupit gjykues.

Për të përmbushur këtë boshllëk që krijohet, por edhe për pasimin e vërtetë dhe të paanshëm të asaj që ka ndodhur më seancat gjyqësore apo në aktivitete prokurorie, kjo barrë u bie mbi supe zyrtarëve të gjykatave apo prokurorëve që janë të ngarkuar për komunikim me publikun. Ata janë të veshur me njohuri juridike, por edhe me paanësinë institucionale. Në këtë mënyrë atyre ju bie mbi supe barra e hartimit të raportit nga seanca gjyqësore, hartimi i komunikatave dhe plasimi në web-faqet e institucioneve.

Trajnimi mëton që të ofroj njohuri se cila është rëndësia e raportimeve të tilla, si bëhet hartimi i raportimeve të tilla dhe si ato raporte japin apo shfaqin vërtetësinë e tërë asaj që ka ndodhur në seancën gjyqësore apo aktivitetin e ngjashëm në prokurori apo institucion tjetër të gjyqësorit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë rëndësinë e komunikimit dhe marrëdhënieve me mediat
- Kuptojnë rëndësinë e qasjes së mediave dhe publikut në seancat gjyqësore
- Zbatojnë në praktikë raportimin nga seancat gjyqësore

Përmbajtja

- Qasja në komunikim dhe marrëdhëniet me medie;
- Qasja e publikut në procedurat gjyqësore;
- Qasja e mediave në procedurat gjyqësore;
- Raportimi nga seancat gjyqësore.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda si: metoda interaktive, diskutimi lidhur me raste praktike, loja e roleve etj, të cilat do të mundësojnë që pjesëmarrësit të marrin njohuri dhe në mënyrë praktike të demonstrojnë njohuritë e fituara.

Përfituesit: Zyrtarët përgjegjës për komunikim me medie dhe publikun në Gjykata dhe në Prokurori.

Kohëzgjatja: Një ditor

8.5.2 Nën moduli 2 - Prezantimi institucional dhe informata për publikun

Çështjet e prezantimit të punës së institucionit gjithnjë e më tepër po bëhen çështje me rëndësi në komunikimin e përditshëm. Publiku punën e institucionit e sheh përmes zëdhënësve apo zyrtarëve të tjerë të ngarkuar për komunikim me mediet apo publikun. Puna e parë që parashtrohet në këtë kontekst është se, a e ka zgjedhur institucioni personin që është i përgatitur profesionalisht për të kryer këtë punë. Plasimi i informatave në publik kërkon që të bëhet në mënyrë shumë të shpejtë. Vonesat në këtë drejtim e humbin kuptimin e informimit dhe publiku nuk do të jetë i interesuar që të marr apo dëgjoj informata të cilat veçanti janë të njohura për të. Ky lloj komunikimi bëhet qoftë në organizimin e konferencave për shtyp qoftë përmes komunikimit të drejtpërdrejtë me publikun përmes komunikatave, reagimeve pasimit të raporteve etj. Në situata normale rëndësi ka zgjedhja e informatës që duhet të plasohet dhe momenti i përshtatshëm për një publikim të tillë. Jo rrallë here ky lloj komunikimi duhet që të bëhet në situata të ndjeshme dhe emergjente gjë që zyrtarët për informim i bie në siklet dhe gjendje të pa përshtatshme që informatën që ata kanë për ta plasuar ta thonë në mënyrë sa më të qartë dhe pa shkaktuar dykuptimësi apo konfuzion në publik. Në situata të tilla, ata nuk gjejnë as mbështetjen më të vogël të eprorëve të tyre duke hedhur tërë peshën e përgjegjësisë tek zëdhënësit.

Trajnimi mëton që të ofroj njohuri se cila është rëndësia e raportimeve të tilla, si bëhet hartimi i komunikatave dhe reagimeve, si bëhet përzgjedhja e materialit dhe përgatitja dhe organizimi i konferencës për medie, si të plasohet dhe të duket në mënyrë sa më të besueshme ajo që dëshirojmë ta themi në këtë konferencë, si bëhet në mënyrë sa më të suksesshme komunikimi me publikun etj.

Objektivat

Si rezultat i këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë rëndësinë e prezantimit institucional
- Kuptojnë rëndësinë e dhënies së informatave në situata të ndjeshme dhe emergjente
- Zbatojnë në praktikë komunikimin me mediet dhe publikun

Përmbajtja

- Prezantimi institucional dhe informata për publikun
- Rëndësia e prezantimit publik
- Kuptimi i kontekstit
- Kuptimi i kërkesës /interesimit
- Kuptimi i informatës/mesazhit
- Teknikat e informimit në situata të ndjeshme dhe emergjente
- Organizimi i konferencës për shtyp
- Procesi i përgatitjes së prezantimit dhe rezultatet e prezantimit
- Prezantimi publik, para publikut dhe prezantimi në media

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda si: metoda interaktive, diskutimi lidhur me raste praktike, loja e roleve etj, të cilat do të mundësojnë që pjesëmarrësit të marrin njohuri dhe në mënyrë praktike të demonstrojnë njohuritë e fituara.

Përfituesit: Zyrtarët përgjegjës për komunikim me medie dhe publikun në Gjykata dhe në Prokurori.

Kohëzgjatja: Një ditë

8.6 Moduli 6 - Integriteti dhe sjelljet etike

Qëllimi më i lartë i administratës gjyqësore dhe prokuroriale në Kosovë, për të gjithë stafin që i përket sistemit gjyqësor dhe prokurorial, është rritja e cilësisë së performancës profesionale, duke siguruar zbatimin e duhur praktik të parimeve dhe standardeve etike në përputhje me Kodin e Etikës siç janë: profesionalizmi, disiplina në punë, paanësia, pavarësia, konfidencialiteti, shmangia nga konflikti i interesit dhe nga sjelljet e pa hijshme, ndershmëria dhe llogaridhënia.

Në këtë modul shtrohen disa pyetje për të ardhur deri te një përfundim që ndihmon stafin e administratës gjyqësore dhe prokuroriale për të arritur objektivat e përcaktuara, në mes tjerash: Cilat janë standardet që i përcakton Kodi i Etikës? Si ndikon sjellja e stafit administrativ në krijimin e besimit të publikut në institucione gjyqësore dhe prokuroriale? Si dhe sa zbatohen rregullat etike në punën e përditshme të stafit administrative të gjykatave dhe prokurorive?

Moduli është hartuar në atë formë që përmes shpjegimeve të pjesshme teorike dhe diskutimeve interaktive, të trajtojë rregullat e përcaktuara të sjelljes etike dhe profesionale, duke ofruar bazën ligjore dhe shembuj praktik për pjesëmarrësit.

Objektivat

Si rezultat i këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Dallojnë sjelljet e etike brenda dhe jashtë zyrës;
- Zbatojnë në mënyrë të drejtë Kodin e Etikës dhe parimet e tij dhe
- Identifikojnë rastet kur kemi të bëjmë me shkelje etike.

Përmbajtja

- Parimet dhe normat e sjelljes etike;
- Sjellja brenda dhe jashtë zyrës dhe
- Ndërgjegjësimi social dhe përgjegjësia.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij moduli do të aplikohet metodologjia e kombinuar me shpjegime të pjesshme teorike përmes powerpoint dhe diskutime interaktive rreth Kodit të Etikës, duke ofruar edhe shembuj praktik (video, raste të shkruara nga praktika) lidhur me rastet e shkeljeve të Kodit të Etikës. Sipas nevojës, do të aplikohet metoda e ndarjes së pjesëmarrësve në grupe.

Përfituesit: Stafi administrativ i sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Kohëzgjatja: Tre ditore

8.6.1 Nën moduli 1 - Parimet dhe normat e sjelljes etike

Duke synuar promovimin e sjelljes etike dhe vendosjen e standardeve të integritetit moral dhe udhëzimeve për sjellje të hijshme personale dhe profesionale të stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Ky trajnim ka për qëllim ngritjen e prestigjit dhe imazhit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Në këtë trajnim shtrohen disa pyetje për të ardhur deri te një përfundim që ndihmon stafin e administratës gjyqësore dhe prokuroriale për të arritur objektivat e përcaktuara, në mes tjerash : Cilat janë standardet etike për tu arritur besueshmëria e publikut në sistemin gjyqësor dhe prokurorial? Si ndikojnë parimet e ndershmërisë, paanësisë, pavarësisë, korrektësisë, respektimit të konfidentalitetit, shmangja nga konfliktet e interesit dhe shmangja nga sjelljet e pahijshme për të rritur prestigjin dhe imazhin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial?

Trajnimi është hartuar në atë formë që përmes shpjegimeve të pjesshme teorike dhe diskutimeve interaktive, të trajtojë rregullat e përcaktuara të sjelljes etike dhe profesionale, duke ofruar dhe shembuj praktik për pjesëmarrësit.

Objektivat

Si rezultat i këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë parimet e Kodit të Etikës;
- Zbatojnë në mënyrë të drejtë parimet e Kodit të Etikës dhe
- Kuptojnë rastet kur kemi të bëjmë me shkelje të parimeve dhe normave të sjelljes etike.

Përmbajtja

- Parimet e sjelljes etike;
- Normat e sjelljes etik dhe
- Rastet praktike të shkeljes së parimeve dhe normave etike.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të aplikohet metodologjia e kombinuar me shpjegime të pjesshme teorike dhe diskutime interaktive rreth Kodit të Etikës, duke ofruar edhe shembuj praktik lidhur me rastet e shkeljeve të Kodit të Etikës. Sipas nevojës, do të aplikohet metoda e ndarjes së pjesëmarrësve në grupe të vogla punuese.

Përfituesit: Stafi administrativ i sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Kohëzgjatja: Një ditor

8.6.2 Nën moduli 2 - Sjellja brenda dhe jashtë zyrës

Për të pasur një prestigj dhe imazh të mirë sistemit gjyqësor dhe prokurorial ka nevojë që të ketë staf administrativ i cili duhet të respektojë rregullat dhe standardet etike jo vetëm gjatë kohës sa është në zyre në orarin e punës, por edhe jashtë zyrës pas orarit të punës, sepse ata paraqesin pasqyrën e të punësuarve në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Punësimi në sistemin gjyqësor dhe prokurorial nuk nënkupton vetëm privilegje, por edhe përgjegjësi dhe një ndër përgjegjësitë kryesore është edhe respektimi i parimeve dhe normave etike, si gjatë orarit të punës, po ashtu edhe jashtë orarit të punës.

Në këtë trajnim shtrohen disa pyetje për të ardhur deri te një përfundim që ndihmon stafin e administratës gjyqësore dhe prokuroriale për të arritur objektivat e përcaktuara, në mes tjerash : Si duhet stafi administrativ i sistemit gjyqësor dhe prokurorial të sillet ndaj publikut gjatë orarit të punës? Si duhet ky staf të sillet në publik dhe me publikun jashtë orarit të punës? Si ndikojnë këto sjellje të këtij stafi ngritjen ose uljen e prestigjit të imazhit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial?

Trajnimi është hartuar në atë formë që përmes shpjegimeve të pjesshme teorike dhe diskutimeve interaktive, të trajtojë rregullat e përcaktuara të sjelljes etike dhe profesionale, duke ofruar dhe shembuj praktik për pjesëmarrësit.

Objektivat

Si rezultat i këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Kuptojnë sjelljet etike brenda dhe jashtë zyrës;
- Zbatojnë parimet dhe normat etike brenda dhe jashtë zyrës dhe
- Identifikojnë rastet e shkeljeve të parimeve dhe normave të sjelljes etike brenda dhe jashtë zyrës.

Përmbajtja

- Sjelljet etike brenda zyrës;
- Sjelljet etike jashtë zyrës dhe
- Rastet praktike të shkeljes së parimeve dhe normave etike brenda dhe jashtë zyrës.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të aplikohet metodologjia e kombinuar me shpjegime të pjesshme teorike dhe diskutime interaktive rreth sjelljeve etike brenda dhe jashtë zyrës, duke ofruar edhe shembuj praktik lidhur me rastet e shkeljeve të kësaj natyre. Sipas nevojës, do të aplikohet metoda e ndarjes së pjesëmarrësve në grupe të vogla punuese.

Përfituesit: Stafi administrativ i sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Kohëzgjatja: Një ditë

8.6.3 Nën moduli 3 - Ndërgjegjësimi social dhe përgjegjësia

Bazuar në zhvillimet e fundit të rrjeteve sociale dhe mënyrë së të jetuarit ndërgjegjësimi social luan një rol shumë të madh edhe në sjelljet e stafit administrativ në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, në veçanti në sjelljet e të punësuarve në moshë të re të cilët shfrytëzojnë rrjetet sociale brenda dhe jashtë zyrës.

Në këtë trajnim shtrohen disa pyetje për të ardhur deri te një përfundim që ndihmon stafin e administratës gjyqësore dhe prokuroriale për të arritur objektivat e përcaktuara, në mes tjerash : Si duhet stafi administrativ i sistemit gjyqësor dhe prokurorial shfrytëzojë rrjetet sociale? A mundet t'i shfrytëzojë ky staf rrjet sociale gjatë orarit të punës? Si mund ndikojnë këto sjellje të këtij stafi në ngritjen ose uljen e prestigjit të imazhit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial?

Trajnimi është hartuar në atë formë që përmes shpjegimeve të pjesshme teorike dhe diskutimeve interaktive, të trajtojë rregullat e përcaktuara të sjelljes etike dhe profesionale, duke ofruar dhe shembuj praktik për pjesëmarrësit.

Objektivat

Si rezultat i këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Identifikojnë sjelljet sociale që lidhen me etikën brenda dhe jashtë zyrës;
- Zbatojnë sjelljet e pranueshme sociale etike brenda dhe jashtë zyrës dhe
- Kuptojnë përgjegjësitë për sjelljet e tyre sociale.

Përmbajtja

- Sjelljet etike sociale brenda dhe jashtë zyrës;
- Ndërgjegjësimi për sjelljet sociale dhe
- Përgjegjësia për sjelljet sociale.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të aplikohet metodologjia e kombinuar me shpjegime të pjesshme teorike dhe diskutime interaktive rreth sjelljeve etike brenda dhe jashtë zyrës, duke ofruar edhe shembuj praktik lidhur me rastet e shkeljeve të kësaj natyre. Sipas nevojës, do të aplikohet metoda e ndarjes së pjesëmarrësve në grupe të vogla punuese.

Përfituesit: Stafi administrativ i sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Kohëzgjatja: Një ditor

8.7 Shkathtësitë e buta

Ambienti i punës në institucione karakterizohet nga punonjës me karaktere individuale, sjellje të ndryshme dhe nivel të ndryshëm të profesionalizmit dhe kualifikimeve. Ky ambient me njerëz të ndryshëm në një hapësirë të përbashkët shkakton probleme në komunikim dhe në atë se jo secili angazhohet me gjithë kapacitetin në përmbushjen e detyrave. Megjithatë, të gjithë këta individ kanë një detyrim të përbashkët e që është arritja e objektivave të institucionit.

Zhvillimi i shkathtësive të menaxhimit të kohës dhe stresit përfshirë zgjidhjen e konflikteve për stafin administratës së gjykatave dhe prokurorive si një predispozitë e përmirësimit të performancës së tyre në funksion të mbështetjes së punës dhe rritjes së efikasitetit të punës gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve të tyre të përcaktuara me ligj.

Stresi sot është një dukuri negative përcjellëse në të gjitha aktivitetet, zhvillimet, veprimet e sjelljet e individit dhe dukuri e pashmangshme në përgjithësi në socium. Stafi i administratës së Gjykatave dhe Prokurorive gjatë punës së tyre të përditshme përballen me situata të shumta stresuese dhe u ekspozohen gjatë punës stresorëve të shumtë të cilët interferojnë negativisht në shërbimet e këtyre zyrtarëve në raport me Gjykatësit e Prokurorët por edhe në raport me palët e subjektet tjerë. Për më tepër gjatë punës së tyre të përditshme përballen me situata konfliktuale të cilat interferojnë negativisht në shërbimet e tyre. Menaxhimi i mirë i kohës, stresit dhe situatave konfliktuale është nevojë imediate si parandalim i atakimit të personaliteteve të zyrtarëve në administratë në mënyrë që puna e tyre të jetë cilësore dhe efikase.

Në baza ditore ne punojmë me njerëz të cilët kanë mendime, qasje, vlera, besime dhe nevoja të ndryshme. Aftësitë tona për të shkëmbyer ide me të tjerët, për të kuptuar perspektivat e të tjerëve, për të zgjidhur me sukses problemet shumë do të varet nga ajo se sa jemi ne në gjendje që efektivisht të komunikojmë me të tjerët. Efikasitetit dhe efektivitetit në punë i kontribuon edhe digjitalizimi i proceseve të punës në prokurori dhe gjykata. KGJK/KPK vazhdimisht janë duke investuar në modernizimin e infrastrukturën e TIK-ut ka e cila ka për qëllim kryerjen e shërbimeve administrative në mënyrën sa më efikase si dhe duke u fokusuar në sigurinë e informacionit. Pra, qëllimi është të ofroj pjesëmarrësve informacione lidhur përdorimin e sistemeve dhe pajisjeve të TI-së dhe po ashtu edhe ngritjen e nivelit të komunikimit në mënyrë elektronike.

Por si mund të arrihet motivimi i stafit për punë ekipore? Si duhet menaxhohet puna në ekip? Cilat janë rregullat e punës ekipore? Cilat aktivitete mund të realizohen në ekip? Cilat janë mënyrat apo mekanizmat e shmangies nga stresi? Cilat janë instrumentet apo mënyra e menagjimit të kohës dhe stresit dhe si ndikon kjo e fundit në krijimin e një mjedisi relaksues të punës? Cilat janë mënyrat apo mekanizmat e shmangies nga situatat konfliktuale? Cilat janë instrumentet apo mënyra e menagjimit të situatave të tilla dhe konflikteve në përgjithësi dhe si ndikon ky menaxhim në krijimin e një mjedisi relaksues të punës së këtyre zyrtarëve? Cilat janë shkathtësitë relevante për komunikim të qartë dhe konciz? Sa e njohim stilin tonë të komunikimit? Çka e karakterizon dëgjimin aktiv? Cilat janë njohurit e juaja në fushën e TI-së? Cilat janë përparësitë e përdorimit të TI-së në punën tuaj? Cili program mundëson përgatitjen e prezantime?

Trajnimi synon që për temat e lartpërmendura të fitohen njohuritë dhe shkathtësitë në identifikimin dhe menaxhimin efikas të punës në arritjen objektivave të institucionit dhe zhvillimin e sjelljes sociale përfshirë shkathtësitë në fushën e IT-së si një kusht i zotërimit të aftësive sociale, emocionale dhe sjelljeve të duhura për të përmirësuar performancën në punë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë punën ekipore në realizimin e aktiviteteve në kuadër të mandatit të tyre;
- Zotërojnë aftësitë e zhvillimit të marrëdhënieve të qëndrueshme.
- Menaxhojnë mirë kohën;
- Njohin dhe aplikojnë teknikat dhe mënyrat e ruajtjes së shëndetit dhe kondicionit të punës.
- Aftësohen të menaxhojnë mirë konfliktet dhe problemet ;
- Zhvillojnë shkathtësitë relevante për komunikim të qartë dhe konciz;
- Zhvillojnë dëgjimin aktiv.
- Përdorin dhe menaxhojnë në mënyrë efikase përdorimin pajisjeve dhe sistemeve të IT-së.

Përmbajtja

Rregullat dhe teknikat e punës ekipore.

- Menaxhimi i kohës
- Prioritizimi i aktiviteteve
- Teknikat e ruajtjes së shëndetit dhe kondicionit të punës
- Marrëdhëniet ndër njerëzore dhe ndër kolegjiale në punë
- Shkathtësitë relevante për komunikim
- Përdorimi i sistemeve dhe të pajisjeve të TI-s

Metodologjia e trajnimit

- Prezantim i shkurtër i koncepteve përmes teknikave moderne trajnuese;
- Diskutimeve interaktive me pjesëmarrës (pyetje dhe përgjigje);
- Puna në grupe (ndarja paraprake e detyrave;
- Përdorimi i kuizeve dhe filmave dokumentar lidhur me temën;
- Përgatitja e rasteve praktike dhe diskutimi i tyre me pjesëmarrës.
- Pjesëmarrës do të jetë i pajisur individualisht me një kompjuter
- Secili dhe gjatë gjithë kohës do të jetë aktiv në kryerjen e ushtrimeve dhe të prezantimeve që paraqiten nga trajnimi.
- Pjesëmarrësit do të demonstrojnë dhe ekzekutojnë shembuj të ndryshëm që kanë të bëjnë me përdorimin e sistemit ose pajisjeve së prezantuar

Përfituesit: Administratorët e Gjykatave dhe Prokurorive, ndihmës administratorët, udhëheqës të shkrimore, bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor (sekretarët ligjor), referentët, zyrtarët për media dhe arkivistët, stafi i Sekretariatit dhe NJSHPP.

Kohëzgjatja: Katër ditore

8.7.1 Nën moduli 1 - Puna në ekip dhe sjellja sociale

Ambienti i punës në institucione karakterizohet nga punonjës me karaktere individuale, sjellje të ndryshme dhe nivel të ndryshëm të profesionalizmit dhe kualifikimeve. Megjithatë, të gjithë këta individ kanë një detyrim të përbashkët e që është arritja e objektivave të institucionit.

Ky ambient me njerëz të ndryshëm në një hapësirë të përbashkët shkakton probleme në komunikim dhe në atë se jo secili angazhohet me gjithë kapacitetin në përmbushjen e detyrave. Andaj, parakushte për efikasitetin dhe efektivitetin në punë janë ambienti të dëshirueshëm social dhe kolegialiteti në arritjen e objektivave të institucionit.

Por si mund të arrihet motivimi i stafit për punë ekipore? Si duhet menaxhohet puna në ekip? Cilat janë rregullat e punës ekipore? Cilat aktivitete mund të realizohen në ekip.

Trajnimi synon që për temat e lartpërmendura të fitohen njohuritë dhe shkathtësitë në identifikimin dhe menaxhimin efikas të punës ekipore, intensifikimin e punës ekipore në arritjen objektivave të institucionit dhe zhvillimin e sjelljes sociale si një kusht i zotërimit të aftësive sociale, emocionale dhe sjelljeve të duhura për të përmirësuar performancën në punë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Prioritetizojnë aktivitetet adekuate për punë ekipore;
- Vlerësojnë rregullat dhe teknikat e punës ekipore;
- Zbatojnë punën ekipore në realizimin e aktiviteteve në kuadër të mandatit të tyre;
- Zotërojnë aftësitë e zhvillimit të marrëdhënieve të qëndrueshme.

Përmbajtja

- Marrëdhëniet ndër personale dhe relacioni me grupin;
- Rregullat dhe teknikat e punës ekipore.

Metodologjia e trajnimit

- Prezantim i shkurtër i koncepteve përmes teknikave moderne trajnuese;
- Diskutimeve interaktive me pjesëmarrës (pyetje dhe përgjigje);
- Puna në grupe (ndarja paraprake e detyrave;
- Përdorimi i kuizeve dhe filmave dokumentar lidhur me temën;
- Përgatitja e rasteve praktike dhe diskutimi i tyre me pjesëmarrës.

Përfituesit: Administratorët e Gjykatave dhe Prokurorive, ndihmës administratorët, udhëheqës të shkrimore, bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor (sekretarët ligjor), referentët, zyrtarët për media dhe arkivistët.

Kohëzgjatja: Një ditore

8.7.2 Nën moduli 2 - Menaxhimi i kohës dhe stresit

Ky trajnim është i konceptuar si projekt i nevojshëm i zhvillimit të shkathtësive të menaxhimit të kohës dhe stresit për zyrtarët e administratës së Gjykatave dhe Prokurorive si një predispozitë e përmirësimit të performancës së tyre në funksion të mbështetjes së punës dhe rritjes së efikasitetit të punës së Gjykatave dhe Prokurorive gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve të tyre të përcaktuara me ligj.

Stresi sot është një dukuri negative përcjellëse në të gjitha aktivitetet , zhvillimet , veprimet e sjelljet e individit dhe dukuri e pashmangshme në përgjithësi në socium . Zyrtarët e administratës së Gjykatave dhe Prokurorive gjatë punës së tyre të përditshme përballen me situata të shumta stresuese dhe u ekspozohen gjatë punës stresorëve të shumtë të cilët interferojnë negativisht në shërbimet e këtyre zyrtarëve në raport me Gjykatësit e Prokurorët por edhe në raport me palët e subjektet tjerë. Menaxhimi i kohës dhe stresit është nevojë imediate si parandalim i atakimit të personaliteteve të zyrtarëve në administratë në rastin konkret, nga ana e stresorëve të ndryshëm , në mënyrë që puna e tyre të jetë cilësorë dhe efikase.

Cilat janë mënyrat apo mekanizmat e shmangies nga stresi? Cilat janë instrumentet apo mënyra e menaxhimit të kohës dhe stresit dhe si ndikon kjo e fundit në krijimin e një mjedisi rielaksues të punës?

Objektivat

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Dinë të menaxhojnë mirë kohën;
- Bëjnë prioritetizimin e aktiviteteve të tyre ditore, javore dhe mujore;
- Njohin dhe aplikojnë teknikat dhe mënyrat e ruajtjes së shëndetit dhe kondicionit të punës.

Përmbajtja

- Stresi dhe përkufizimi teorik
- Menaxhimi i kohës
- Prioritetizimi i aktiviteteve
- Teknikat e ruajtjes së shëndetit dhe kondicionit të punës
- Ruajtja nga “djegia” e profesionit

Metodologjia

Gjatë këtij trajnimi do të aplikohen metoda e teknika bashkëkohore, prezantimi do të përcillet me slajde, pastaj do të realizohet një interaktivitet i mirëfilltë i trajnerit me të pranishmit, do të epen detyra praktike, ushtrime si dhe do të ilustrohen temat teorike me raste praktike e ilustrime vizuale përmes teknikes së avancuar .

Përfutuesit: Ky trajnim u dedikohet zyrtarëve të administratës së Gjykatave dhe Prokurorive. Përzgjedhja e vijuesve bëhet në bazë të interesimit të tyre dhe nevojave të Gjykatave dhe Prokurorive

Kohëzgjatja: Dy ditore

8.7.3 Nën moduli 3 - Zgjidhja e problemeve dhe konflikteve

Ky modul është i konceptuar si tërësi tematike e zhvillimit të shkathtësive të menagjimit dhe zgjidhjes së problemeve e konflikteve për zyrtarët e administratës së Gjykatave dhe Prokurorive si një predispozitë e përmirësimit të performancës së tyre në funksion të mbështetjes së punës dhe rritjes së efikasitetit të punës së Gjykatave dhe Prokurorive gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve të tyre të përcaktuara me ligj.

Problemet e ndryshme dhe konfliktet janë dukuri përcjellëse gjatë punës së secilit shërbim. Zyrtarët e administratës së Gjykatave dhe Prokurorive gjatë punës së tyre të përditshme përballen me situata konfliktuale të cilat interferojnë negativisht në shërbimet e këtyre zyrtarëve në raport me Gjykatësit e Prokurorët por edhe në raport me palët e subjektet tjerë. Menagjimi i mirë i situatave të tilla dhe barrierave të ngjashme është nevojë imediate si parandalim i atakimit të personaliteteve të zyrtarëve në administratë në rastin konkret, nga ana e këtyre faktorëve në mënyrë që puna e tyre të jetë cilësore dhe efikase.

Cilat janë mënyrat apo mekanizmat e shmangies nga situatat konfliktuale? Cilat janë instrumentet apo mënyra e menagjimit të situatave të tilla dhe konflikteve në përgjithësi dhe si ndikon ky menaxhim në krijimin e një mjedisi rrethues të punës së këtyre zyrtarëve.

Objektivat

Si rezultat i këtij moduli trajnues pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Aftësohen të menaxhojnë mirë konfliktet dhe problemet ;
- Bëjnë vlerësimin real të shkaqeve të problemeve e konflikteve
- Njohin dhe aplikojnë teknikat dhe mënyrat e ruajtjes së balancës ndër-njerëzore e ndër-kolegiale në mes të kolegëve, vijës hierarkike menaxheriale e subjekteve tërë.

Përmbajtja

- Konfliktet dhe përkufizimi teorik;
- Problemet dhe barrierat tjera në punë;
- Marrëdhëniet ndër-njerëzore dhe ndër-kolegiale në punë;
- Mandati formal dhe përgjegjësi individuale ndaj rrethit në punë;
- Ruajtja dhe mbrojtja nga mobingu.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të aplikohen metoda e teknika bashkëkohore. Prezantimi do të përcillet me slajde, do të realizohet një interaktivitet i mirëfilltë i trajnerit me të pranishmit. Do të kenë ushtrime si dhe do të ilustrohen temat teorike me raste praktike e ilustrime vizuale përmes teknikes së avancuar, do të luhet loja dhe luajtja e roleve.

Përfituesit: Zyrtarët e administratës së Gjykatave dhe Prokurorive. Përzgjedhja e vijuesve bëhet në bazë të interesimit të tyre dhe nevojave të Gjykatave dhe Prokurorive.

Kohëzgjatja: Dy ditore

8.7.4 Nën moduli 4 - Komunikimi ndërpersonal

Në baza ditore në punojmë me njerëz të cilët kanë mendime, qasje, vlera, besime dhe nevoja të ndryshme. Aftësitë tona për të shkëmbyer ide me të tjerët, për të kuptuar perspektivat e të tjerëve, për të zgjidhur me sukses problemet shumë do të varet nga ajo se sa jemi në gjendje që efektivisht të komunikojmë me të tjerët. Aktiviteti i komunikimit përfshinë tri segmente; verbale, joverbale dhe paraverbale. Segmenti verbal ka të bëjë me përmbajtjen e mesazhit tonë, zgjedhjes dhe renditjes së fjalëve tona. Segmenti joverbal ka të bëjë me mesazhin të cilin ne e dërgojmë përmes gjuhës së trupit tonë. Segmenti paraverbal ka të bëjë me atë se si e themi atë që e themi – toni dhe volumi i zërit tonë.

Cilat janë shkathtësitë relevante për komunikim të qartë dhe konciz? Sa e njohim stilin tonë të komunikimit? Çka e karakterizon dëgjimin aktiv.

Në mënyrë që të kemi një komunikim efektiv, ne duhet të përdorim tri komponentët e përmendura më lartë me qëllim që të bëjmë dy gjëra; të dërgojmë mesazh të qartë dhe konciz dhe të dëgjojmë dhe kuptojmë drejt mesazhin që dikush është duke e dërguar tek ne.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zhvillojnë shkathtësitë relevante për komunikim të qartë dhe konciz;
- Analizojnë komponentët kryesore të komunikimit;
- Njohin stilin tonë të komunikimit;
- Zhvillojnë dëgjimin aktiv.

Përmbajtja

- Shkathtësitë relevante për komunikim
- Stilet e komunikimit;
- Komponentët e komunikimit.

Metodologjia e trajnimit

- Prezantim i shkurtër i koncepteve përmes teknikave moderne trajnuese;
- Diskutimeve interaktive me pjesëmarrës (pyetje dhe përgjigje);
- Puna në grupe (ndarja paraprake e detyrave;
- Përdorimi i kuizeve dhe filmave dokumentar lidhur me temën;
- Përgatitja e rasteve praktike dhe diskutimi i tyre me pjesëmarrës.

Përfituesit: Administratorët e Gjykatave dhe Prokurorive, Ndhmës Administratorët, Udhëheqës të shkrimore, Bashkëpunëtorët profesional, Zyrtarët ligjor (sekretarët ligjor), Referentët, Zyrtarët për media dhe arkivistët.

Kohëzgjatja: Një ditore

8.7.5 Nën moduli 5 - Menaxhimi i TIK-ut

Teknologjia informative në administratën e sistemit prokurorial dhe gjyqësor vijon të avancohet çdo ditë. Ky është si rezultat i investimit dhe modernizimit të vazhdueshëm në infrastrukturën e TIK-ut e cila ka për qëllim zhvillimin dhe kryerjen e shërbimeve administrative në prokurori dhe gjykata në mënyrën sa më efikase si dhe duke u fokusuar edhe në sigurinë e informacionit. Në fushën e Teknologjisë Informative do të ofrohen trajnime fillestare dhe të specializuara për t'iu bërë të mundur që stafit të zotëroj punën e tyre. Pra, pjesëmarrësit do të kenë mundësi të përfitojnë njohuri lidhur me përdorimin e sistemeve elektronike, ngritjen e nivelit të komunikimit elektronik, pastaj ofrimin e shërbimeve administrative të besueshme dhe efikase duke përdorur teknologjinë informative. Si rezultat i kësaj stafi i prokurorive dhe gjykatave, do të jenë në gjendje të përballojnë sfidat e reja dhe do të jenë promotor të ndryshimeve pozitive në administratën e sistemit prokurorial dhe gjyqësor.

Cilat janë njohurit e juaja në fushën e TI-së? Cilat janë përparësitë e përdorimit të TI-së në punën tuaj? Cilat programe janë të nevojshme të përdoren për punë tuaj?

Trajnimi synon që për temat e lartpërmendura, stafi i prokurorive dhe gjykatave të fitoj njohuri dhe shkathtësi në fushën e TI-së për të përmirësuar performancën në punë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Përdorin sisteme softuerike bazike dhe të avancuar;
- Përdorimi i pajisjeve të TI-së,
- Ngritin nivelin e komunikimit elektronik,
- Ngritin nivelin e sigurisë së informacioneve

Përmbajtja

- Përdorimi i sistemeve elektronike
- Përdorimi i pajisjeve të TI-së
- Komunikimi elektronik
- Siguria e Informacionit

Metodologjia e trajnimit

Prezantim i shkurtër i koncepteve përmes teknikave moderne trajnuese, diskutimeve interaktive me pjesëmarrës. Pjesëmarrësi do të jetë i pajisur individualisht me një kompjuter dhe secili do të jetë aktiv në kryerjen e ushtrimeve dhe të prezantimeve që paraqiten nga trajnimi.

Përfituesit: Administratorët e Gjykatave dhe Prokurorive, ndihmës administratorët, udhëheqës të shkrimore, bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor (sekretarët ligjor), referentët, zyrtarët për media dhe arkivistët, stafi i Sekretariatit dhe NJSHPP.

Kohëzgjatja: Dy ditore

Programi për trajnimin e trajnuesve

9. Programi për trajnimin e trajnuesve

Bazuar në Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, trajnuesit janë të detyruar të marrin pjesë në programet për trajnim të trajnuesve, duke pasur parasysh se ata janë faktorë kyç për cilësinë dhe zbatimin e programeve trajnuese. Në funksion të kësaj, Akademia aplikon standarde sa i përket përzgjedhjes së trajnuesve si dhe trajnime për trajnues për ngritjen e kapaciteteve prezantuese.

Si rezultat i këtij programi trajnues synohet:

- Avancimi i metodologjisë trajnuese;
- Ngritja e aftësive dhe strategjive të mësimdhënies;
- Vazhdimi i edukimit gjyqësor;
- Mbajtja dhe përmirësimi i kompetencës profesionale dhe interdisiplinare të përfituesve të Akademisë;
- Reformimi i programeve trajnuese.

Përmes Programit për trajnimin e trajnuesve Akademia e Drejtësisë do të ofrojë nivelin më të lartë të trajnimit teorik dhe praktik, duke krijuar dhe mbajtur trajnues të përditësuar me metodologjitë trajnuese bashkëkohore me qëllim të realizimit të trajnimeve sa më atraktive, praktike dhe efektive për të përmbushur synimet e përcaktuara në programin trajnues.

Mësimi në distancë



10. Mësimi në distancë

Me aplikimin e teknologjisë informative dhe rritjes në masë të përdorimit të kompjuterit dhe mjeteve të tjera elektronike, janë përhapur dhe forma të reja të edukimit në vazhdim, të ndryshme nga ato tradicionale.

Mësimi në distancë (e-learning) është të mësuarit interaktiv nga distanca duke shfrytëzuar teknologjinë elektronike online, jashtë një salle trajnimi tradicionale.

Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar një platformë të mësimit në distancë e cila do të përmbushë të gjitha kërkesat për trajnime. Përparësitë e këtij mësimi është ruajtja/kursimi i buxhetit të Akademisë, ulja e shpenzimeve që krijojnë pjesëmarrësit, kursimi i kohës dhe cilësia e lartë e trajnimeve. Mësimi në distancë realizohet përmes kurseve trajnues të vilat përmbajnë module trajnues, incizimeve audio dhe videove.

Platforma e mësimit në distancë do të jetë në dispozicion të përfituesve të Akademisë së Drejtësisë për një kohë të gjatë, me synim rritjen e njohurive dhe zhvillimin profesional të të gjitha kategorive përfituese të Akademisë, si dhe rritjen e efikasitetit të trajnimeve.

Përfitues të trajnimeve në platformën e mësimit në distancë janë: gjyqtarët, prokurorët e shtetit, gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të sapo emëruar si dhe stafi administrative i gjykatave dhe prokurorive. Kjo platformë përfituesve të saj do të ju mundësoj ndjekjen e kurseve trajnues, por duke ia përshtatur kohën e mësimit agjendës së tyre.

Përmbajtja

Në kuadër të platformë së mësimit në distancë/ e-learning, gjatë vitit 2019 do të organizohen këto kurse trajnues:

- Anglishtja ligjore;
- Drejtësia për fëmijë;
- Fazat e aktakuzës dhe deklarimit për fajësinë;
- Kundërkorrupsioni;
- Menaxhimi dhe udhëheqja e gjykatave/prokurorive;
- Menaxhim i stresit;
- Teknologjia Informative;
- Kontabiliteti për gjyqtarë në rastet e falimentimit;
- Ndërmjetësimi në aspektin penal dhe civil;
- Etika profesionale
- Trajnimi për Implementimin e Legjislacionit Tatimor në Kosovë
- Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore;
- Prokurimi Publik;
- Shkathtësitë e komunikimit social;
- Kodi i Etikes dhe sjelljes profesionale;
- Komunikimi;
- Krimi kibernetik;
- E Drejta e Autorit;

Akademia duhet të konsideroj organizimin edhe të kurseve tjera varësisht nga nevojat, kërkesat dhe mundësitë.

Trajnimet me donatorë

11. Trajnimet me donatorë

Akademia e Drejtësisë ka bashkëpunim me partner dhe donatorë të ndryshëm të cilët e mbështesin në realizimin e aktiviteteve të shumta të planifikuara me programin e trajnimeve të Akademisë apo edhe zbatimin e programeve tjera të përgatitura nga donatorët.

Aktualisht Akademia ka marrëveshje me disa donatorë për të zbatuar disa aktivitete trajnuese gjatë vitit 2019, siç janë:

- Projekti i Këshillit të Evropës “JUFREX”
- Projekti i financuar nga Bashkimi Evropian për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtarë
- Projekti me UNODC për hetimin financiar
- Projekti me Programin e USAID-it për të Drejtat Pronësore
- Projekti i USAID-it, për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë, JSSP
- Projekti i mbështetur nga OSBE
- Si dhe aktivitete tjera me donatorë tjerë

Zbatimi këtyre projekteve, por edhe projekteve tjera me donatorë, janë mbështetje për Akademinë dhe vlerë e shtuar e programit të trajnimeve, prandaj si të tilla marrin mbështetje për realizim, duke e vlerësuar në radhë të parë interesin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe bartësve të funksioneve gjyqësore.

Anekset



12. Anekset

Kalendari i trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë

Akademia e Drejtësisë Kalendari i trajnimeve në PTV 2019 janar-korrik 2019								
Nr.	PROGRAMI I TRAJNIMIT TË VAZHDESHËM	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik
1	Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale	17						
2	Shqyrtimi paraprak i padisë	21						
3	Procedurat alternative	25						
4	Personat juridik si kryes të kundërvajtjes	28						
5	Program i Specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftën e shpëlarjes së parave - Sesioni I	30-31						
6	Përgjegjësia penale e personave juridik		4					
7	Sigurimi i kërkesëpadisë		7					
8	Kontratat në ekonomi		11					
9	Krimi i organizuar		13					
10	Barazia gjinore në procedurë gjyqësore në përgjithësi dhe në rastet e dhunës në familje në veçanti		19					
11	E Drejta për jetën - Neni 2 KEDNJ		20					
12	Abuzimi seksual dhe veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve		22					
13	Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre		25-26					
14	Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale		28					
15	Prishja e rendit dhe e qetësisë publike			5				
16	Procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore			7				
17	Burgu për të mitur			12				
18	Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve dhe pjesëtimi i saj			14				
19	Procedura me shkrim dhe ajo verbale para Dhomës së Posaçme			15				
20	E drejta e mbrojtjes së pronës - Neni 1 i Protokollit nr.1 të KEDNJ			18				

PROGRAMI I TRAJNIMEVE 2019

21	Program i Specializuar Trajnimi për Zhvillimin e Kapaciteteve në Luftën Kundër Korrupsionit - Sesi I			19-20				
22	Vendimmarrja dhe qasja në drejtësinë mjedisore — standardet ndërkombëtare dhe legjislacioni në fuqi			22				
23	Shqyrtimi kryesor dhe marrja e provës në procedurën penale			25				
24	Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile			27				
25	Procedura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, dhe mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës në shërbimin civil të Republikës së Kosovës			28				
26	Të drejtat e pronësisë industriale – Markat tregtare			29				
27	Fillimi dhe zhvillimi i procedurës kundërvajtëse				2			
28	Mundësia hetuese e veçantë				4			
29	Mënyrat e fitimit të pronësisë dhe mbrojtja e saj				10			
30	Kodi i etikës				11			
31	Procedura penale ndaj të miturve				16			
32	Roli i Agjencisë dhe procesi i privatizimit të subjekteve nga AKP				18			
33	Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore – familjare				21-22			
34	Mbrojtja gjyqësore nga pengim posedimi dhe servituti				25			
35	Menaxhimi i kohës si predispozitë e menaxhimit të stresit				30			
36	Krimet e luftës					3		
37	Interpretimi i legjislacionit tatimor në Kosovës					7		
38	Barazia Gjinore në kontestet për të drejtën e trashëgimisë dhe në kontestet nga marrëdhënia e punës					10		
39	Zbatimi i Ligjit për Azilin në Republikën e Kosovës					13		
40	Bashkëpunimi Juridik ndërkombëtar në çështjet penale					14		
41	Lejimi i përmbarimit dhe vendosja sipas prapësimit					16		
42	Menaxhimi i gjykatës dhe prokurorisë					21		

43	E drejta për liri dhe siguri - neni 5 i KEDNJ					23		
44	Masat edukative dhe dënimet ndaj të miturve					28		
45	Masat e fshehta					29		
46	Trajtimi praktik i kontratës për kredinë					31		
47	Shpronësimi dhe caktimi i kompensimit						3	
48	Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe efektet juridike të tyre						6	
49	Procedura dhe objekti i konfliktit administrativ						11	
50	Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës - Sesioni 1						13-14	
51	Kontrata e sigurimit						18	
52	Masat e diversitetit						19	
53	Veprat penale kundër ekonomisë me theks të posaçëm luftimi i ekonomisë joformale						21	
54	Mbrojtja gjyqësore në rast të fyerjes dhe shpifjes						25	
55	E drejta për një proces të rregullt gjyqësor – neni 6 i KEDNJ						26	
56	Shkathtësitë e përfaqësimit në Gjykim						26-27-28	
57	Ligji për shoqëritë tregtare							2
58	Parashkrimi sipas dispozitave të LMD-së							3
59	Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve							5
60	Procedurat e prokurimit sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës në veçanti kontestet me OSHP-në							11
61	Program i Specializuar Trajnimi për Zhvillimin e Kapaciteteve në Luftën e Krimit Kibernetik - Sesioni I							16-17

Formulari i aplikimit për trajnime të vazhdueshme

Formular për Aplikim
Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm / PTV
Janar - Korrik 2019

Emri & Mbiemri: _____
 Gjykata/Prokuroria: _____
 Departamenti: _____ Divizioni: _____
 Tel: _____ E-mail: _____

Mënyra e aplikimit: Ju lutem plotësoni të dhënat tuaja **të plota** në formular. Për të aplikuar në trajnimin e caktuar, klikoni te katrori në anën e majtë të hapësirës ku është i vendosur trajnimi dhe automatikisht shfaqet shenja ☒

☐	Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale Data: 17/01/2019	☐	Roli i Agjencisë dhe procesi i privatizimit të subjekteve nga AKP Data: 18/04/2019
☐	Shqyrtimi paraprak i padisë Data: 21/01/2019	☐	Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore – familjare Data: 21-22 prill 2019
☐	Procedurat alternative Data: 25/01/2019	☐	Mbrojtja gjyqësore nga pengim posedimi dhe servituti Data: 25/04/2019
☐	Personat juridik si kryes të kundërvajtjes Data: 28/01/2019	☐	Menaxhimi i kohës si predispozitë e menaxhimit të stresit Data: 30/04/2019
☐	Përgjegjësia penale e personave juridik Data 04/02/2019	☐	Krimet e luftës Data: 03/05/2019
☐	Sigurimi i kërkesëpadisë Data: 07/02/2019	☐	Interpretimi i legjislacionit tatimor në Kosovës Data: 07/05/2019

☐	Kontratat në ekonomi Data: 11/02/2019
☐	Krimi i Organizuar Data: 13/02/2019
☐	Barazia gjinore në procedurë gjyqësore në përgjithësi dhe në rastet e dhunës në familje në veçanti Data: 19/02/2019
☐	E Drejta për jetën - Neni 2 KEDNJ Data: 20/02/2019
☐	Abuzimi seksual dhe veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve Data: 22/02/2019
☐	Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre Data: 25-26/02/2019
☐	Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale Data: 28/02/2019
☐	Prishja e rendit dhe e qetësisë publike Data: 05/03/2019
☐	Procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore Data: 07/03/2019

☐	Barazia Gjinore në kontestet për të drejtën e trashëgimisë dhe në kontestet nga marrëdhënia e punës Data: 10/05/2019
☐	Zbatimi i Ligjit për Azilin në Republikën e Kosovës Data 13/05/2019
☐	Bashkëpunimi Juridik ndërkombëtar në çështjet penale Data: 14/05/2019
☐	Lejimi i përmbarimit dhe vendosja sipas prapësimit Data: 16/05/2019
☐	Menaxhimi i gjykatës dhe prokurorisë Data 21/05/2019
☐	E drejta për liri dhe siguri - neni 5 i KEDNJ Data: 23/05/2019
☐	Masat edukative dhe dënimet për të mitur Data: 28/05/2019
☐	Masat e fshehta Data: 29/05/2019
☐	Trajtimi praktik i kontratës për kredinë Data: 31/05/2019

☐	Burgu për të mitur Data: 12/03/2019	☐	Shpronësimi dhe caktimi i kompensimit Data: 03/06/2019
☐	Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve dhe pjesëtimi i saj Data: 14/03/2019	☐	Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe efektet juridike të tyre Data: 06/06/2019
☐	Procedura me shkrim dhe ajo verbale para Dhomës së Posaçme Data: 15/03/2019	☐	Procedura dhe objekti i konfliktit administrativ Data: 11/06/2019
☐	E drejta e mbrojtjes së pronës - Neni 1 i Protokollit nr.1 të KEDNJ Data: 18/03/2019	☐	Kontrata e sigurimit Data: 18/06/2019
☐	Vendimarrja dhe qasja në drejtësinë mjedisore -- standardet ndërkombëtare dhe legjisllacioni në fuqi Data: 22/03/2019	☐	Masat e diversitetit Data: 19/06/2019
☐	Shqyrtimi kryesor dhe marrja e provës Data: 25/03/2019	☐	Veprat penale kundër ekonomisë me theks të posaçëm luftimi i ekonomisë joformale Data: 21/06/2019
☐	Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile Data: 27/03/2019	☐	Mbrojtja gjyqësore në rast të fyerjes dhe shpifjes Data: 25/06/2019
☐	Procedura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, dhe mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës në shërbimin civil të Republikës së Kosovës Data 28/03/2019	☐	E drejta për një proces të rregullt gjyqësor-- neni 6 i KEDNJ Data: 26/06/2019
☐	Të drejtat e pronësisë industriale – Markat tregtare Data: 29/03/2019	☐	Shkathtësitë e përfaqësimit në Gjykim Data: 26-27-28/06/2019

☐	Fillimi dhe zhvillimi i procedurës kundërvajtëse Data: 02/04/2019
☐	Mundësia hetuese e veçantë Data: 04/04/2019
☐	Mënyrat e fitimit të pronësisë dhe mbrojtja e saj Data: 10/04/2019
☐	Kodi i etikës Data: 11/04/2019
☐	Procedura penale ndaj të miturve Data: 16/04/2019

☐	Ligji për shoqëritë tregtare Data: 2/07/2019
☐	Parashkrimi sipas dispozitave të LMD-së Data: 03/07/2019
☐	Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve Data: 05/07/2019
☐	Procedurat e prokurimit sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës në veçanti kontestet me OSHP-në Data: 11/07/2019
☐	

Formulari i aplikimit për trajnime të specializuara

Formular për Aplikim në Programet e Specializuara

☐ **Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftën e shpëlarjes së parave – Sesiioni 1**

Sesiioni I

Data: 30-31/01/2019

☐ **Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftën kundër Korrupsionit**

Sesiioni I

Data: 19-20/03/2019

☐ **Program i specializuar trajnimi për Prokurimin Publik**

Sesiioni I

Data: 13-14/06/2019

☐ **Program i specializuar trajnimi për Zhvillimin e Kapaciteteve në Luftën Kundër Krimin Kibernetik**

Sesiioni I

Data: 16-17/07/2019

Akademia e Drejtësisë
<https://ad.rks-gov.net>
infoad@rks-gov.net
Rr. “Muharrem Fejza” – Prishtinë
Tel: +381 38 200 18 670

Kalendari i trajnimeve për staf administrativ

Kalendari i trajnimeve për staf administrativ mars-korrik 2019						
Nr.	Programi i Trajnimeve për Stafin Administrativ gjyqësor dhe prokurorial	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik
1	Moduli 1- Sistemi gjyqësor dhe prokuroria, struktura dhe kompetencat	6				
2	Moduli 2 - Menaxhimi i punës në administratën e sistemit gjyqësor dhe prokurorial Nenmoduli 1- Menagjimi dhe Udhëheqja	20				
3	Moduli 2 - Menaxhimi i punës në administratën e sistemit gjyqësor dhe prokurorial Nenmoduli 2 - Proceset e brendshme dhe të jashtme të punës		12			
4	Moduli 2 - Menaxhimi i punës në administratën e sistemit gjyqësor dhe prokurorial Nënmoduli 3 - Planifikimi dhe vendimmarrja		24			
5	Moduli 2 - Menaxhimi i punës në administratën e sistemit gjyqësor dhe prokurorial Nënmoduli 4- Efikasiteti dhe Llogaridhënia			8		
6	Moduli 3- Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore Nënmoduli 1 - Teknikat e hulumtimit ligjor			22		
7	Moduli 3- Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore Nënmoduli 2 - Shqyrtimi paraprak i rasteve dhe ndërmarrja e veprimeve për përgatitjen e fazave pasuese në procedurë				12	
8	Moduli 3- Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore Nënmoduli 3 Shkrimi dhe arsyetimi ligjor				19	
9	Moduli 4 - Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial Nënmoduli 1- Regjistrat e gjykatave dhe prokurorive				26	
10	Moduli 4 - Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial Nënmoduli 2 - Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial					3
11	Moduli 4 - Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial Nënmoduli 3 - Mbledhja e të dhënave statistikore dhe raportimi					9

